

PROFILI VLEROR DHE DEMOKRACIA EFEKTIVE NË SHQIPËRINË POSTKOMUNISTE

Ina K. Zhupa

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Sociale, me profil Shkenca Politike, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Tonin Gjuraraj

Numri i fjalëve: 65.357

Tiranë, Nëntor 2014

DEKLARATA E AUTORËSISË

Ky punim publikohet për herë të parë si punim doktoral, pranë Universitetit European të Tiranës. Asnjë pjesë nuk është përfshirë në punim pa citimet përkatëse, çdo analizë që vjen si rrjedhojë i leximit të autorëve të tjerë sqarohet dhe bëhet me dije. Ky punim është pronësi intelektuale i autores.

© **Ina K.Zhupa**

Tiranë, 2014

ABSTRAKT

Punimi ka si qëllim kuptimin e lidhjes që ekziston midis profilit të vlerave, që mbart një shoqëri, dhe nivelit të demokracisë efektive. Punimi sqaron kuptimin e vlerave, rëndësinë e tyre për sjelljes e njeriut dhe për t'u studiuar, më pas, konceptin e demokracisë dhe përkatësisht të demokracisë efektive. Në kuptimin tonë për sistemin social dhe shoqërinë në përgjithësi i referohemi teorisë funksionaliste të shkencave sociale. Modeli vleror, që është zgjedhur, është ai i Ronald Inglehart-it, që i ndan vlerat në 3 boshte kryesore, atë të vlerave materialiste përballë postmaterialiste, atë të vlerave tradicionale përballë vlerave shekullare dhe atë të vlerave të mbijetesës përballë vlerave të vetafirmimit. Ndërsa modeli për kuptimin dhe matjen e demokracisë efektive është marrë nga modeli i Welzel-it dhe Inglehart-it, ku sqarohet nevoja që qytetari të jetë realisht në qendër të sistemit politik. Demokracia efektive, sipas autorëve të përmendur më sipër, është e lidhur me vlerat e vetafirmimit. Niveli i vlerave të vetafirmimit që ndikon në nivelin që ka demokracia efektive është edhe hipoteza qendrore e punimit. Koncepti i demokracisë efektive lidhet me mundësinë, që ka brenda një vendi, që të fuqizohen dhe të funksionojnë realisht të drejtat e qytetarit të zakonshëm, zëri i tij në vendimmarrje, roli i tij në qeverisje dhe trajtimi i tij si i barabartë dhe i rëndësishëm. Por fakti i thjeshtë, që ekzistojnë zgjedhjet ku qytetarët vendosin dhe zgjedhin qeverinë e tyre bashkë me programin përkatës, nuk e arrin këtë qëllim. Po ashtu vetëm aprovimi i ligjeve, që vendosin formalisht të drejtat politike dhe civile, nuk është i mjaftueshëm për të fuqizuar qytetarin. Pikërisht kjo bën që t'ia vlejë të studiohet niveli i demokracisë efektive në një shoqëri, për të kuptuar sesa e kanë vërtet fuqinë njerëzit dhe sa demokracia po plotëson misionin e vet si “pushtet i popullit”. Gjithashtu në këtë punim del në pah edhe çfarë profili vlerash për të tria boshtet vlerore kanë shqiptarët. Metoda e përdorur për sa i përket kuptimit të sistemit të vlerave është ajo sasiore dhe për këtë u përdor një anketë dhe më pas të dhënat u hodhën dhe u përpunuan në programin SPSS. Ndërsa për të matur nivelin e demokracisë efektive u përdorën të dhënat dytësore që na vinin nga raportet e përvitshme të Freedom House mbi liritë civile dhe liritë politike në Shqipëri dhe nga raportet e Bankës Botërore për sa i përket shtetit të së drejtës. Nga të dhënat e anketimit na rezultoi se të anketuarit kishin një profil vleror, me vlera materialiste, tradicionale dhe të mbijetesës. Ndërsa për matjen e demokracisë efektive nga viti 2002 deri në vitin 2012 na rezultoi që niveli është i ulët. Morrëm gjithashtu një konfirmim hipotezës qendrore, që doli nga lidhja mes një niveli të ulët të vlerave vetafirmimit që kishin qytetarët me një nivel po të ulët të demokracisë efektive që kishte vendi. Për këtë ne morëm në shqyrtim se a kishte ndryshim në nivelin e vlerave të vetafirmimit mes të rinjve dhe të moshuarve, sepse kjo do të ishte një shpresë për demokracinë në të ardhmen. Ky korrelim moshë-vlera nuk na rezultoi si u mundshëm. Në fund jepen disa konkluzione mbi gjetjet e punimit dhe rekomandime që mendohet se do t'i vlejë studiuesve, politikbërësve, por edhe shoqërisë shqiptare me qëllimin për të kuptuar më mirë ku ndodhet dhe ku duhet të shkojë.

ABSTRACT

This study aims at understanding the link between the values profile of a society and the level of effective democracy. Furthermore, the study clarifies the meaning of values, their relevance to human behavior and it explores the concept of democracy and effective democracy, respectively. In our understanding of the social system and the society in general, we refer to the functionalist social science theory. The value based model, which is selected, is that of Ronald Inglehart, who divides values in three main axes: materialistic values versus postmaterialist values, traditional values versus secular values and finally, survival values versus self-affirmation values. Meanwhile, the model on the conception and estimation of effective democracy is borrowed from the model of Welzel and Inglehart, in which it is explained the necessity to the citizen to really be in the center of the political system. Effective democracy, according to the above mentioned authors, is associated with self-affirmation values. The level of self-affirmation values that affects the level of effective democracy is also the main hypothesis of the study. The concept of effective democracy is related to the capacity of a country to strengthen and guarantee the proper functioning of ordinary citizens' rights so that they have a voice in decision-making, a role in governance and that they are treated as equal and important. But, the simple fact that there are elections in which citizens decide and choose their own government along with their respective program, is not enough to achieve this goal. Moreover, the approval of laws that formally establish civil and political rights is not sufficient to empower citizens. This is exactly why it is worthwhile to analyze the level of effective democracy in a society, in order to understand whether people possess real power and how democracy is fulfilling its mission as the "power of the people". Also, in this study it comes out what values profile Albanians have for the three values axes. The method used in terms of understanding the system of values is the quantitative method and for this a survey has been conducted and then the collected data has been processed in the SPSS program. As for the evaluation of the effective democracy level, secondary data has been obtained from the annual reports of Freedom House on civil liberties and political freedom in Albania and also from the World Bank reports regarding the rule of law. According to the survey data, it resulted that the respondents had a values profile based on materialistic, traditional and survival values. As for the estimation of effective democracy from 2002 to 2012, it was found out that the level was low. At the meantime, we confirmed the central hypothesis, deriving from the link between the low level of self-affirmation values of the citizens and an equally low level of effective democracy of the country. For this, we examined whether there was any difference in the level of self-affirmation values between the young and the elderly, as it would be a hope for democracy in the future. This age-values correlation did not result possible. In the end, there are some conclusions on the findings of the study and recommendations which are supposed to be useful not only to researchers, policy makers, but also to the Albanian society with the aim to better understand where this society is and where it should go.

*Vlera e patjetërsueshme e çdo kohe është dashuria
Ja kushtoj dashurisë time Fabian Goçi.*

Falenderime

Vlera e vërtetë e një punimi të tillë, me shumë mundim, me shumë pasion, me dëshirë dhe me vullnet është se të jep mundësinë të mbështetesh te njerëzit e tu më të afërt, te miqtë, tek ata që besojnë tek ty. Pjesa më e bukur, edhe më e lehtë për t'u shkruar, është pikërisht kjo dhe falenderimi, që më vjen spontanisht; nuk kam nevojë të citoj askënd përveçse zemrën sime, nuk kam nevojë të kem kujdes kur përdor vetën e parë njëjës, sepse në këtë rast unë jam ajo që do të falënderoj. Mezi prisja ditën që do ta shkruaja këtë pjesë jo vetëm sepse do të thoshte që tashmë e kam shkruar doktoraturën, por edhe sepse ndihem e lumtur që sado pak mund t'ua kthej ndihmën e dhënë këtyre njerëzve.

Nuk mund të ketë punim doktoral, pa një udhëheqës shkencor, dhe në rastin tim udhëheqësi është prof. dr. Tonin Gjuraj, i cili është i pari që dua të falënderoj. E falënderoj profesor Toninin, për mbështetjen pa kushte, për komentet dhe këshillat e tij të vlefshme, për kohën e dedikuar, për qetësinë e veçantë që e karakterizon përherë. Profesori, edhe në cilësinë e rektorit të Universitetit European të Tiranës, është një nga njerëzit më të angazhuar, në krye të punës, me rol publik dhe tejet i zënë, por pavarësisht gjithçkaje ka ditur që me mjeshtëri të kombinonte kohën e tij me nevojën time, duke më lënë kështu edhe lirinë akademike për të punuar dhe për të dhënë një produkt, por nën mbikëqyrjen e tij të vlefshme dhe fort të rëndësishme.

Është me rëndësi për mua të them që kjo doktoraturë përveçse ambicie personale është edhe falë dëshirës dhe vullnetit për mbështetje të Administratorit të UET, Henri Çili, PhD, i cili mund të jetë nga të vetmit, për mos thënë i vetmi, që avancimin akademik të pedagogëve të tij e shikon me rëndësi parësore dhe i jep vlerë. Henri Çili ka ditur gjithmonë të shohë përtej interesit të momentit, por në interes afatgjatë për të mirën dhe zhvillimin e një universiteti ku unë angazhohem prej vitesh në mësimdhënie, si edhe në detyra të tjera të rëndësishme me studentët, lider i shkencës dhe i kontributit në fushën arsimore shqiptare.

Për të qëndruar në fushën e akademizmit dhe UET-it, dua të falënderoj presidentin, prof. dr. Ardian Civici, që me urtësinë që e karakterizon ka ditur gjithnjë të thotë fjalë inkurajuese që ta ngrenë moralin në kohë të vështirë dhe të bëjnë të punosh me më shumë forcë. Tani radha të falënderoj mikeshat, ato që janë dhuratë e çmuar, që na i jep zoti në rrugën e jetës, kam pasur fatin të rrethohem nga mikesha të shkëlqyera që më kanë mbështetur përherë pa kushte. Mikesha ime prof. asoc. dr. Edlira Gjuraj, jo vetëm më ka dhënë këshilla në çdo fushë dhe në çdo moment më ka mbështetur pa kushte, por edhe ka qenë si një bashkudhëheqëse e doktoraturës sime. Me eksperiencën në mësimdhënie, me njohuri të shumta në udhëheqje e doktorantëve të saj, ka qenë atje sa herë unë kam pasur nevojë. Doktoraturës së saj i jam kthyer herë pas herë si një model i shkëlqyer për të kryer një punë kërkimore cilësore. Tjetër mikeshe është dr. Teuta Xhindi, pedagogia e shkëlqyer e statistikës që nuk më ka mohuar kurrë ndihmën e saj në kuadër të përpunimit statistikor, por jo vetëm, ka qenë përherë atje duke dëgjuar çdo problem timin, çdo dilemë timen dhe duke më këshilluar me gjithë dashurinë edhe kujdesin e mundshëm. Miken time, Ketrina Cabiri, e cila ka pasur përherë besim të madh që unë do bëja një doktoraturë të mirë, por edhe te puna ime në përgjithësi. Me Ketin kemi bërë shpesh udhëtime pune, të cilat pavarësisht

angazhimit që kërkojnë kanë rezultuar shumë të bukura falë shoqërisë së njëra -tjetrës mund t'ia dalim çdo vështirësi. Po ashtu Blerjana Bino, një tjetër mikeshë e mirë tek e cila mund të mbështetesh përherë, me përgjigjet e saj të matura dhe me përkushtimin e saj di të të bëjë të ndihesh e rëndësishme dhe e vlerësuar.

Në UET kam pasur fatin të njoh një njeri të mrekullueshëm, e cila për mua ka qenë një mike edhe supermike, që më ka qëndruar pranë në çdo moment, që të gjithë e quajnë vajzën time edhe pse nga mosha jemi si motra, që është shqetësuar përherë për afatet edhe punën time doktorale, një vajzë e shkëlqyer që quhet Marinela Seitaj. Po ashtu mikeshat e mia të papara, Besa Xhumari, Sonila Sferdelli, Rovenë Xhafa, Bisej Kapo dhe shokun e papërtuar Andi Verçani. Po ashtu edhe studentët e mi që punuan dhe u trajnuan si anketues, nga të cilët në veçanti falënderoj Alda Abazaj.

Doktoratura ime flet për vlerat, ne vlerat i mësojmë fillimisht nga familja, pikërisht asaj i shkon falenderimi im më i madh. Babanë tim, Kadri, e falënderoj sepse ka qenë përherë përkrah meje, ka dashur shkollën dhe shkollimin dhe më ka shtyrë që e vogël drejt dijes, sepse më ka falur shumë dashuri, më ka dhënë këshilla, por edhe sepse për mua është babi më i mirë në botë. Mamanë time, Lilin, e falënderoj sepse ka pasur përherë durimin që të ishte shoqja ime më e mirë, më ka dhuruar shumë dashuri, sepse përkushtimi i saj ndaj meje shkon deri në sakrificat më të mëdha dhe pavarësisht çdo problemi ajo është përherë në krahun tim, sepse përkujdesjet e saj nuk mund t'i gjesh asgjëkund edhe sepse është mami më e mirë në botë. Vëllanë tim, Ivi, e falënderoj sepse më ka qenë përherë gëzimi dhe hareja e shtëpisë sonë, më ka dhuruar shumë dashuri, sepse është një djalë i mrekullueshëm që e ka bërë motrën krenare, dhe sepse është vëllai më i mirë në botë. Jeni familja ime e dashur dhe ju falënderoj pa masë. Si dhe dua të falënderoj ata që mund ti quaj prindër të dytë, Apostol Goçi dhe Lubina Goçi që më kanë dhuruar shumë dashuri që nga dita e parë që i kam takuar dhe çdo ditë, që janë gjithmonë gati të më mbështesin në çdo aspekt. Ndjem e privilegjuar dhe me fat që i kam përkrah.

Në fund është ai që është edhe në fillim, sepse ai plotëson gjithçka në jetën time, është ai që më mësoi ç'është dashuria dhe të dashurosh, është ai që më bën të lumtur, është ai që më ka qëndruar përkrah që ditën e parë të shkollës doktorale duke besuar verbërisht tek unë, është ai që di të më thotë fjalën e duhur në çdo moment, është ai pa këshillën e të cilët unë nuk bëj dot më asnjë hap në jetë, është ai që i ka dhënë kuptim jetës sime, është dashuria ime e parë, e vetme, e madhe, Fabian Goçi. Askush përveç Fabit nuk ka ditur çdo stres doktoral, çdo afat, çdo takim, çdo detyrim doktoral dhe përherë më ka thënë: shpirt ti do të shkëlqesh aty. Fjalët, mbështetja dhe dashuria e tij më kanë dhënë vrullin e nevojshëm për të ecur përpara dhe më kanë shtuar besimin se do t'ia dilja. E falënderoj me zemër, e falënderoj me gjithë dashurinë time që i përket vetëm atij, e falënderoj për gjithçka.

Tabela e Përmbajtjes

KAPITULLI I: HYRJE.....	14
KAPITULLI II: METODOLOGJIA	32
KAPITULLI III: STUDIMI TEORIK.....	60
3.1. Ç’janë vlerat?	60
3.2. Vlerat sipas aksiologjisë filozofike	69
3.4. Vendosja hierarkike e vlerave	78
3.5. Karakteristika të vlerave.....	79
3.5.1.Vlera si “projekte ideale”	79
3.5.2.Vlera si mundësi zgjedhjeje	82
3.5.3.Vlera si “karakteristikë të veprimit njerëzor”	84
3.5.4. Karakteri sociokulturor i vlerave.....	87
3.5.5.Karakter i vlerave i lidhur me përditshmërinë.	87
3.5.6. Karakteri dualist i vlerave	88
3.5.7. Vlerat formohen gjatë jetës dhe ndryshojnë.....	89
3.6. Klasifikimi dhe teoritë mbi vlerat.	94
3.6.1 Klasifikime për vlerat.....	94
3.6.2.Teoria aksiologjike e Hofstede-s.....	96
3.6.3.Teoria aksiologjike e Triandis-it	97
3.6.4.Teoria e Hall & Tonna	98
3.6.5. Taksonomia e Rokeach	101
3.6.6.Teoria e vlerave e Schwartz-it.....	102
3.6.7. Teoria e vlerave të Inglehart-it.....	106
3.7.Ndikimi i vlerave te sjellja	116
3.8.Demokracia efektive	117
3.8.1. Çfarë është demokracia dhe demokracia efektive	117

3.8.2. Si e masim demokracinë efektive?	121
3.8.3. A matet dot demokracia efektive? Kritikë dhe kundërpërgjigjet	124
3.9. Vlerat e vetafirmimit dhe demokracia efektive	129
KAPITULLI IV : KONTEKSI HISTORIK	135
4.1. Vlerat dhe demokracia në vendet ish- komuniste të Europës Juglindore	135
4.2. Vlerat dhe demokracia në Shqipëri	141
KAPITULLI V: PUNIMI EMPIRIK	151
5.1. Rezultatet demografike të anketimit	151
5.2. Rezultatet empirike për boshtin e vlerave, tradicionale përkundrejt shekullare	160
5.4 Rezultatet empirike për boshtin e vlerave, mbijetesë përkundrejt vetafirmim	195
KAPITULLI VI :SHQYRTIMI I HIPOTEZAVE	246
Shtojca 1 : Anketa « Profili vleror »	292
Bibliografia.....	311

LISTA E TABELAVE:

Tabela 1: Valët e studimit të vlerave

Tabela 2: Popullsia e qytetit të Tiranës

Tabela 3: Kampionimi për qytetin e Tiranës

Tabela 4: Propocionet e minibashkive dhe nr i anketuesve për secilës

Tabela 5: Shpërndarja e anketuesve dhe anketave

Tabela 6: Trasformimi i renditjes së Freedom House në DRI

Tabela 7: Klasifikimi i shteteve sipas të drejtave të garantuara

Tabela 8: Variablat e demokratizimit

Tabela 9: Përkatësia fetare e shqiptarëve sipas CENSUS-it

Tabela 10: Indeksi i të Drejtave Demokratike 2002-2012

Tabela 11: Indeksi i Shtetit të së Drejtës 2002-2012

Tabela 12: Indeksi i Demokracisë Efektive 2002-2012

Tabela 13: GDP e Shqipërisë sipas FMN 1980-2013 dhe parashikimi deri ne 2018

LISTA E SKEMAVE

Skema 1: Piramida e nevojave të Masllow

Skema 2: Procesi i ndryshimit të vlerave

Skema 3: Skematizimi i vlerave sipas Schwartz

Skema 4: Influenca e vlerave të vetafirmimit në forcimin e institucioneve demokratike

Skema 5: Zhvillimi ekonomik si faktor demokratizimi

LISTA E HARTAVE:

Harta 1: Harta Kulturore e Botes, Inglehart dhe Welzel 1999-2004

KAPITULLI I: HYRJE

Ky punim doktoral fokusohet te profili i vlerave dhe te demokracia efektive në postkomunizmin shqiptar dhe ka për qëllim të zbulojë dhe të qartësojë lidhjen që ekziston midis llojit të vlerave që kanë shqiptarët me nivelin e demokracisë efektive që ata përjetojnë. Nëse për demokracinë flitet shumë dhe kemi gati një konsensus, që është sistemi më i mirë i njohur deri sot, që mund t'i vlejë shoqërisë shqiptare, edhe për vlerat flitet shumë, por ato njihen dhe kuptohen pak, shpeshherë edhe ngatërrohen me koncepte të tjera të ngjashme. Po ç'rëndësi reale ka studimi i vlerave të një shoqërie? Dihet tashmë se diskutimi për vlerat nuk është aspak pronë e një fushe të dijes, por përkundrazi e shumë fushave njëkohësisht. Kemi të bëjmë me një truall të ndërmjetëm, ku mund të kontribuojnë shumë shkenca e dije si: filozofia, sociologjia, psikologjia, shkencat politike, ekonomia etj. Një shikim i shumëfishtë ndihmon për plotësimin e kuadrit të studimeve të fushës në fjalë, duke përmirësuar më tepër njohjen e saj, por edhe për shkak të interesave të ndryshme në fusha të ndryshme. Ne do të përqendrohemi te kuptimi i vlerave si i lidhur me degët e shkencave sociale, me kuptimin e saj të brendshëm dhe të jashtëm si tregues i rëndësishëm i kuptimit të mënyrës sesi sillen individët në një shoqëri. Studimet e vlerave për shkencat sociale kanë pothuajse atë rëndësi që kanë radiografitë për mjekësinë (Kocani, 2013:5).

Njerëzit në të shumtën e herëve marrin vendime dhe kryejnë veprime të ndryshme duke u orientuar më shumë nga emocionet e nga gjykimet vlerore sesa të nisur nga një bazë e mirëfilltë logjike, domethënë racionale e pastër. Po ashtu testimi dhe njohja e ndryshimeve

vlerore në shoqëri shërben për të treguar se ku po shkon shoqëria në fjalë, çfarë problemesh e përfytyrimesh ka ajo në përgjithësi për të ardhmen e saj, gjë që shprehet mjaft mirë në vlerat e saj, duke e ditur se shpesh një shoqëri e caktuar orientohet nga vlera të cilat i mendon si tepër të rëndësishme për të. Vlerat e zgjedhura plotësojnë instinktin si motor i njerëzve. Nëse nuk ka vlera, sjellja njerëzore nuk ka drejtim, është kaotike dhe vetëshkatërruese. Vlerat personale janë shumë të rëndësishme, pa vlera nuk mund të jetohet dhe aq më pak të kesh një ekzistencë të kënaqshme dhe plotësuese. Për rëndësinë e vlerave flet edhe studiuesi, Angell, sipas tij vlerat i japin kuptim ekzistencës së shoqërisë duke u shprehur se “përbërësi më i rëndësishëm për ta bërë jetën në grup, për çdo anëtar, të dobishme është masa në të cilën ata kanë një set të përbashkët vlerash dhe qëllimesh, drejt të cilave të gjithë janë të orientuar dhe sipas së cilave është organizuar edhe jeta në grup” (Angell, 1951:2).

Markus S. Schulz thotë që studimi i vlerave është jo vetëm i rëndësishëm për kohezionin social, por gjithashtu edhe për transformimin social. Ai po ashtu shton se studimi i vlerave mund të luajë një rol të rëndësishëm edhe në përmirësimin e cilësisë së jetës (Schulz, 2011). Vlerat janë parë si një nga faktorët determinues për sjelljen e individëve (Rokeach, 1973; Super, 1990) si të tilla ia vlen që të studiohen jo vetëm për të kuptuar sjelljen e individëve, por ç’është më e rëndësishme për ta parashikuar atë në mënyrë të tillë që shoqëria të mos gjendet përpara problemeve madhore, por t’i asimilojë ato duke i parakuptuar dhe duke i zbutur në kohën e duhur. Autorë të ndryshëm kanë treguar rëndësinë e vlerave në aspekte të ndryshme të shkencave sociale, dhe jo vetëm në dobinë, dobi që studimi ynë e sheh te rritja e efikasitetit dhe te niveli i demokracisë në shoqëri.

Në këtë drejtim mund të përmendim disa nga aspektet dhe studimet konkrete në mënyrë të tillë që të kuptohet se ky studim mund të përdoret jo vetëm si material i mirë në qëllimin që i ka vendosur vetes, por edhe për studime të karaktereve të tjera, falë përdorshmërisë dhe rëndësisë që kanë vlerat për individët dhe shoqëritë. Vlerat janë lidhur empirikisht me aspekte të rëndësishme të sjelljes organizative (Meglino, Ravlin& Adkins, 1989; Hofstede, 1984), të vendimmarrjes për zgjedhjen e karrierës (Ravlin&Meglino, 1987), për performacën akademike (Coyne, 1988). Vlerat kanë rol të rëndësishëm për studiuesit e shkencave politike edhe në aspektin e kuptimit të krahut politik, në aspekt ideologjik, pra me besimet politike. “Vlerat përfaqësojnë një aspekt të vetidentifikimit, i cili është një burim i rëndësishëm për besimet politike.

Në fakt vlerat individuale përcaktojnë çfarë njeriu je ti dhe në këtë mënyrë ndikojnë në besimet e tyre politike” (Conover, Feldman, 1984:152) Në këtë drejtim kemi studiuesin Rokeach që ka ndërmarr një studim nisur nga modeli teorik i vlerave që jep Ronald Inglehart (që është edhe modeli i këtij studimi) dhe i përcakton njerëzit në boshtin majtas apo djathtas të politikës (Rokeach, 1973:170-186). Kjo gjë, duke përdorur këtë studim mbi vlerat, mund të bëhet edhe për realitetin shqiptar.

Vlerat janë shumë të rëndësishme edhe për të studiuar marrëdhëniet ndërkombëtare; Eleonora Barbieri Masini sugjeron që dialogu ndërkulturor i vlerave në të ardhmen mund të jetë një parakusht për çdo konflikt të mundshëm politik dhe ekonomik. Ajo shprehet për nevojën që shkencëtarët socialë duhet t’i kushtojnë më shumë vëmendje efekteve

përplasjeve ndërkulturore, në veçanti impaktin e tyre te vlerat, zgjedhjet dhe sjelljet e qëndrimet (Bachika, Schulz, 2011:114).

Antropologu shqiptar, Aleksandër Dhima na jep një shpjegim tjetër shumë interesant në lidhje me rëndësinë që ka njohja e vlerave, duke u shprehur që “nga shkalla e përafrimit të vlerave kulturore të sistemeve të ndryshme përcaktohet në një masë të madhe ecuria e përshtatjes kulturore të njerëzve, kur ata kalojnë përkohësisht ose përgjithnjë nga mjedisi i njërit sistem kulturor në atë të një tjetri” (Dhima, 2010:192)

Po ashtu është i rëndësishme fakti që të njihen se kush janë vlerat personale sepse në përgjithësi nuk je automatikisht i ndërgjegjshëm për to. Kur bëhen eksplicit dhe të njohur për secilin edhe për të tjerët, çdo person mund të drejtoj jetën e tij, vendimet e tij dhe aksionet e tij. Duke njohur vlerat e tua, ke mundësi të bëhesh i ndërgjegjshëm për to, është si të bësh të dukshme, atë që është e heshtura dhe të nënkuptuara. Kur e di se ku je, atëherë mund të vendosësh se ku do të shkosh. Kur dimë se ku është shoqëria shqiptare, vetëm atëherë mund të kuptojmë potencialet e saj për të ardhmen dhe mundësinë e saj për të qenë demokratike.

Rëndësia e studimit ka të bëjë pikërisht me faktin që kuptimi i profilit tonë vleror na jep mundësinë që të mund të shpjegojmë dhe të parashikojmë sjelljen tonë në lidhje me demokracinë. Pra edhe të kuptojmë kushtet në të cilat ndodhemi, por edhe të kuptojmë kushtet që duhet të përmirësojmë për të qenë më demokratikë. Pse demokracia është e rëndësishme për Shqipërinë? Sepse deri më sot demokracia ka treguar që është sistemi që

mund të garantojë më shumë të drejta, liri, zgjedhje, më shumë vend qytetarit, individit të thjeshtë në shoqëri. Po ashtu demokracia është sistemi i zgjedhur nga shqiptarët dhe i nevojshëm për të plotësuar tërësisht nevojat dhe kriteret e tyre për të jetuar në një shtet të së drejtës dhe të mirëqenies.

Shqipëria ka provuar komunizmin dhe nuk besojmë se është në aspiratat dhe në kërkesat e shqiptarëve, sepse pasojat e tij i vuajnë ende sot edhe pas vendosjes së sistemit demokratik. Pikërisht sepse ato kanë ndikuar fort në kulturën sociale dhe politike të qytetarëve të këtij vendi. Për këtë arsye, ia vlen të matim llojin e vlerave dhe nivelin e demokracisë që të mund të kuptojmë më shumë për to, për të kuptuar edhe si mund të përmirësohet sistemi ynë dhe jeta jonë e përditshme.

Është me vend që të sqarohet se në kuptimin tonë për sistemin social dhe shoqërinë në përgjithësi i referohemi teorisë funksionaliste të shkencave sociale me përfaqësues kryesor Talcott Parsons, Robert K. Merton, Alfred Radcliffe Brown, të inspiruar nga idetë dhe veprat e Emile Durkheim-it, Marx Weber-it. Funksionalistët e shikojnë shoqërinë si një sistem me pjesë të ndërlidhura ku asnjë pjesë nuk mund të shihet dhe nuk mund të funksionojë e shkëputur nga pjesët e tjera (Theodorson & Theodorson, 1969:167). Për këtë teori përdoret shpesh metafora e trupit të njeriut duke e krahasuar atë me “trupin social”; në trupin e njeriu çdo pjesë e jona kryen funksionon vetëpërkates, veshka të saj, zemra të vetin, mushkëritë të vetin etj, por funksionojnë si një të tërë në kuadër të trupit të individit. Trupi i individit, ashtu si “trupin social” funksionon në një ekuilibër të plotë, ku secili kryen funksionet e veta. Kur njëra nga ato ndryshon, pëson dëmtime, pëson ndërhyrje të

çfarëdolloj forme, i gjithë organizmi preket nga këto ndryshime dhe reagon kundrejt tyre, duke u rregulluar për të rivendosur një ekuilibër të ri. Sepse trupi njerëzor, ashtu edhe “trupi social” funksionon vetëm në ekuilibër. Pra ndryshimi në çdo pjesë të sistemit çon në mënyrë të pashmangshme në ndryshime edhe në pjesët e tjera të sistemit. Kjo në fushën tonë do të thotë që ndryshimet në aspektet ekonomike të një vendi, do të çojnë në ndryshime në aspektet sociale dhe në aspektet politike. Pyetjes se si sipas funksionalistëve sistemi social e mban ose e rivendos ekuilibrin, shprehen që këtë rol e luajnë vlerat e përbashkëta, që shërbejnë si standarde të pranueshme për atë që është e dëshirueshmja për shoqërinë (Wallace & Wolf, 2006:18).

Në modelin AGIL të Parsons-it, përfaqësues kryesor i funksionalizmit, ku jepen 4 imperativët funksionalë të sistemit social ne gjejmë: 1. Adaptamin (lidhet me ekonominë) 2. Arritja e qëllimeve (lidhet me politikën) 3. Integrimi (lidhet me sistemin ligjor) 4. Modelet latente (lidhet me vlerat kulturore) (Parsons, 1951). Pikërisht këto funksione plotësojnë njëri-tjetrin, bashkëveprojnë dhe mbajnë në këmbë shoqërinë. Të ndalemi tek elementi i 4-ërt, që lidhet më drejtpërdrejt me fokusin tonë, sipas tij funksioni i këtij elementi lidhet me ruajtjen e sistemit dhe me menaxhimin e tensioneve. Vlerat për të, siç do ta sqarojmë edhe në studimin teorik, janë guida dhe i japin kuptimin sjelljes, veprimit. Në këtë drejtim funksioni më i rëndësishëm i vlerave është që mund të krijojnë kuptime të përbashkëta midis pjesëtarëve të së njëjtës shoqëri, me anë të së cilës ata mund të gjykojnë kuptimin e veprimeve kolektive (Parsons, 1951). Sipas Parsons-it: “integrimi në një sistem të përbashkët vlerash dhe brendësimi i tyre janë ‘fenomen qendror’ në studimin e dinamikave të sistemit social; stabiliteti i çdo sistemi do të varej nga kjo” (Parsons,

1951:42) Po ashtu Robert Merton edhe pse ka këndvështrime të ndryshme nga Parsons për elemente të caktuara të teorisë, megjithatë bashkohen në rolin e rëndësishëm që i japin vlerave në sistemin social dhe në kuptimin e sistemit si një trup i tërë, që secila nga pjesët ndikon tek tjetra dhe funksionon në harmoni me të tërën. Ai shprehet që “vlerat e përbashkëta janë qendrore për të shpjeguar sesi shoqëria dhe institucionet funksionojnë” (<http://www.sociologyguide.com/thinkers/RK-Merton.php> parë për herë të fundit në 21 qershor 2013)

Teoria funksionaliste, që ne këtu e paraqitëm me idetë kryesore si një të tërë, ku janë pjesët për të cilat bihen dakord të gjithë funksionalistët, pavarësisht nga teori të tjera ose modele shpjeguese që mund të ketë elaboruar çdo autor i kësaj teorie, është zgjedhur si teori kryesore shpjeguese në kuadër të punimit sepse:

Së pari, shpjegon rëndësinë e vlerave si element thelbësor pa të cilën është i pamundur që të mund të funksionojë shoqëria dhe që nuk mund të anashkalohet në studimet për shoqërinë.

Së dyti, i kupton vlerat si të ndara me njëri-tjetrin në një shoqëri, duke kuptuar kështu që vlerat e individëve të një shoqërie mund të ndahen, por janë edhe të përbashkëta e që lidhet me idenë se ne mund të studiojmë vlerat kulturore të një shoqërie. Pra na legjitimon që edhe pse analizën dhe të dhënat i marrim për individë të veçantë të shoqërisë, në këtë rast për një kampionim, të mund të përgjithësojmë rezultatet për shoqërinë. Pra anëtarët e së njëjtës shoqërie ndajnë vlera të përbashkëta dhe të ngjashme në një profil bazik të tyre, me

diferenca shumë të vogla individuale në hierarkinë që mund të vendosin në situata të caktuara.

Së treti, i shpjegon vlerat si pjesë të gjithë sistemit, duke bërë që ato të ndikohen, por edhe të ndikojnë nga ndryshimet dhe ngjarjet që ndodhin në pjesë të tjera të sistemit. Kjo na legjitimon në dy anë: në kuptimin tonë që vlerat ndryshojnë falë faktorëve të ndryshëm, qofshin ekonomikë, ligjorë, etj. dhe duhen matur dhe studiuar në kohë dhe nuk mund të qëndrojnë të pandryshuara në një shoqëri, ku vlerat e shoqërisë shqiptare, të shprehura në kanune, të jenë të njëjta me atë të demokracisë sot, apo me atë të komunizmit dje. Dhe në ndihmë të hipotezës së ngritur se vlerat ndikojnë në nivelin e demokracisë efektive, pra në këtë mënyrë lidhen me pjesë të sistemit politik.

Në kuadër të teorisë së madhe, siç është funksionalizmi, modeli ynë teorik i studimit të vlerave dhe të demokracisë efektive dhe relacioni mes, tyre lidhet me një emër të rëndësishëm në fushën e shkencave sociale dhe ai është Ronald Inglehart. Inglehart vetë e ndërton modelin e tij teorik brenda kuadrit të supozimeve shkencore dhe shtyllave shpjeguese të funksionalizmit. Vlen për t'u theksuar që Inglehart është autori kryesor që gjendet në modelin tonë teorik të këtij punimi, por nuk është i vetëm. Punimet, gjetjet, botimet e tij në shumicën e rasteve i gjejmë në bashkëpunim me autorë të tjerë, që besojnë në të njëjtin model teorik si ai, dhe bëjnë të gjithë pjesë të një organizmi ndërkombëtar që quhet: Vëzhgimi Botëror i Vlerave (World Values Survey), në të cilin Inglehart ka qenë president. Këta bashkautorë sipas tematika të ndryshme janë: Christian Welzel, Wayne E. Baker, Pippa Norris, Amy Alexander, Hans Dieter Klingemann.

Inglehart bashkë me autorët e sipërpërmendur, nuk janë të vetmit që kanë folur për vlerat, për demokracinë, nuk janë të vetmit që kanë krijuar klasifikime mbi llojin e vlerave, pyetësorë dhe metoda matëse etj. Edhe të tjerë autorë janë marrë me këto çështje, por ne në këtë rast i zgjodhëm jo rastësisht, por qëllimisht, që modeli ynë teorik të jetë ai i Inglehart-it, pra modeli i hipotezave, gjetjeve që do të shërbejnë si shtyllë bazë ku do të mbështetet ky studim. Ndërsa për ndihmesën e autorëve të tjerë do të jepen sqarime në pjesën e studimit teorik; është me vend që të parashtrojmë arsyet pse zgjodhëm Inglehart-in dhe pse besojmë se zgjedhja jonë është e duhura dhe e nevojshme.

Arsyet pse u zgjodh Inglehart lidhem fillimisht me faktin që ai është një funksionalit, i cili përputhet me teorinë e përzgjedhur nga ne si më shpjeguesja për këtë studim. Po ashtu institucioni që ai drejtonte, por edhe puna e tij individuale kanë qenë të vazhdueshme për të njëjtën temë, mbi vlerat për më shumë se tri dekada, duke dhënë një ndihmesë reale për fushën dhe duke qenë autori më i cituar sot për sot për studimet mbi vlerat. Vazhdimësia e studimit na jep të dhëna për 6 valë të studimit të vlerave dhe konkretisht:

Vala	Vitet	Shtetet e përfshira	Respondetët
1	1981-1984	20	25000
2	1989-1993	42	61000
3	1994-1998	52	75000
4	1999-2004	67	96000
5	2005-2008	54	77000

6	2010-2012	ende pa publikuar	ende pa publikuar
---	-----------	-------------------	-------------------

Tabela 1: Valët e studimit të vlerave

(tabela e krijuar nga të dhënat që gjenden në

http://www.worldvaluessurvey.org/index_surveys, parë për herë të fundit në 12 qershor 2013)

Brenda këtyre valëve është marrë edhe në shqyrtim Shqipëria në valën e tretë dhe të katërt, konkretisht te puna e tyre gjejmë të dhëna për vitin 1998 dhe për vitin 2002. Kjo ka krijuar mundësi që, duke u matur me mjete të njëjta, me metodologji dhe pyetësor të njëjtë, të mund të kuptosh më shumë mbi dinamikën e vlerave brenda vendeve të caktuara, në ndryshimin e tyre, por edhe në krahasimin e shoqërive dhe në nxjerrjen e grupimeve të përbashkëtave në bazë të profilit të tyre vleror. Një database unike, që siguron të dhënat të saktë, me metodologji të saktë për çdo studiues që synon studime krahasuese në fushën e vlerave, por edhe që synon të kuptojë shoqërinë e tij në perspektivën e vlerave siç është ky studim.

Po ashtu për ne ka pasur rëndësinë në zgjedhje edhe fakti që ka një koncept të fortë teorik, me fuqi shumë shpjeguese dhe koherent. Gjetjet e tij provojnë sesa të rëndësishme janë vlerat dhe kultura në përgjithësi për shoqëritë. Po ashtu modeli jep shpjegim mbi shkaqet pse ndryshojnë vlerat dhe parashikimet, por edhe sesi mund të ndryshojnë ato duke i lidhur me faktorë të tjerë siç është ekonomia, psikologjia, feja etj. Ai propozon që ndryshimi i vlerave është pasoja e drejtpërdrejtë e zhvillimit ekonomik e teknologjik. “Zhvillimi ekonomik udhëheq ndryshimet në vlerat sociale dhe në sistemin e besimeve”(Inglehart,

1997:69). Kjo përsëri brenda logjikës funksionaliste ku ndryshimi në një pjesë të çon në ndryshimin e pjesëve të tjera. Në lidhje me vlerat ai mban një qëndrim, që lidhet edhe me një hipotezë tonën për vlerat, që mendohet se mund të gjejmë në vendin tonë “përparësitë individuale që reflektojnë mjedisin socio-ekonomik: duke i thënë më shumë vlera subjektive atyre gjërave që relativisht janë më të pakta dhe mungojnë” (Inglehart, 1997:33). Dhe nga ana tjetër propozon që demokracia efektive në një vend dhe fuqia reale e qytetarit për të qenë në qendër të sistemit është pasojë e drejtpërdrejtë e llojit të profilit vleror që kanë qytetarët. Vlerat e vetafirmimit krijojnë qytetarë që kanë tolerancë për të ndryshmen, vetëshprehje në publik, pra mbajnë qëndrime publike, janë të prirur drejt lirisë dhe pjesëmarrjes dhe karakterizohen nga besim ndërpersonal. Pikërisht në përputhje të plotë me studimin tonë, ne duam të shohim se a gjenden ose jo këto vlera për vendin tonë, si edhe të kërkojmë lidhjen e tyre me nivelin e demokracisë efektive në vend.

Gjithashtu zgjodhëm modelin teorik të Inglehart-it sepse na sugjeron edhe një hipotezë “shprese” për të ardhmen e demokracisë. Ai beson se brezat e rinj i përqafojnë më shpejt vlerat e vetafirmimit dhe postmaterializmit, më shumë sesa brezat e moshuar dhe kjo si rezultat kur ata jetojnë kushte më të mira ekonomike dhe sociale sesa brezat e mëparshëm (Inglehart, Welzel, 2005). Pikërisht sugjerimi dhe provat e tij empirike për ndryshimin e vlerave mes brezave të ndryshëm, na bënë që ne ta trajtojmë si një mundësi për të kuptuar të ardhmen e vlerave dhe të demokracisë në vendin tonë. Pra në një farë mënyre modeli Inglehart na plotëson ambiciet tona që ky studim mund të përshkruajë, të skanojë, të shpjegojë dhe të mund të parashikojë gjendjen tonë, gjithmonë në lidhje me vlerat dhe me demokracinë.

Çdo studim has në disa vështirësi që nuk varen, por janë përtej vullnetit të studiuesit, përtej objektivitetit dhe pasionit të tij për të bërë më të mirën e mundshme. Vështirësitë tona në studimin e vlerave dhe demokracisë mund të grupohen në 4 kategori:

E para, po e quaj vështirësi “kuptimore”, sepse lidhet me kuptimin e burimit nga rrjedhin vlerat për individin dhe shoqërinë. Në këtë drejtim, feja na jep një konceptim për vlerat të cilat e bëjnë të parëndësishëm çdo lloj studimi shkencor në këtë fushë sepse e quan që burimet e vlerave janë shpirtërore dhe të dhëna nga Zoti, duke hequr mundësinë e një analize kritike nga qeniet njerëzore në botën materiale. Megjithatë kjo mbetet një vështirësi tradicionale, që nuk dëmton punimin tonë, por lidhet me debatin e përhershëm mes shkencës dhe fesë si burim dijeje dhe reflektimi mbi mënyrën e funksionimit të jetës, të shoqërisë, të gjithçkaje në botën e gjallë. Po ashtu vështirësia “kuptimore” lidhet edhe me konceptin e demokracisë; janë shumë llojet e demokracisë, shumë janë modelet që ngrihen për një demokraci të suksesshme, për rëndësinë dhe problematikat e saj. Kështu që ne na lindte detyra të mirëpërcaktonin konceptin tonë mbi demokracinë, në rastin tonë atë të demokracisë efektive, dhe ta operacionalizonin për të shmangur çdo vështirësi “kuptimore” më pas.

E dyta, lidhet me vështirësitë e “përkatësisë disiplinore” sepse siç e përmendëm edhe në fillim nuk ka një ndarje të qartë se kujt discipline i përket studimi i vlerave, gjejmë autorë shumë të mirë shpjegues nga fusha e psikologjisë, e filozofisë, e sociologjisë, e shkencave politike që i kanë trajtuar gjerësisht edhe me detaje vlerat. Studimi jonë është në fushën e

shkencave politike, vetë Inglehart i përket departamentit të shkencave politike dhe është politolog. Mirëpo kjo gjë nuk na limiton për të mos marrë në konsideratë gjithë ndihmesën në lidhje me vlerat që na vinin nga fusha të tjera të shkencave sociale, të cilat i shërbejnë fokusit tonë. Vlerat trajtohen edhe në ekonomi dhe në fushën e shkencave të tjera ekzakte, por në këtë drejtim nuk e kemi parë dhe nuk ka qenë ndonjë objekt i studimit tonë. Po ashtu demokracia ka një shumësi disiplinore, mjafton që të sjellim ndërmend faktin që për të është folur që nga filozofët më të lashtë si Aristoteli e Platoni dhe vazhdohet edhe në ditët tona. Mund ta quajmë çështje të sociologjisë politike, të filozofisë politike edhe të vetë shkencave politike. Edhe për këtë është zgjedhur të krijohet një kuadër i përgjithshëm teorik dhe të përqendrohemi te koncepti i përzgjedhur për studim.

E treta, në këtë kategori hyjnë ato që po i emërtojmë vështirësitë “e qasjes teorike” sepse mungonte një teori bazë mbi të cilën të kishin rënë dakord të gjithë studiuesit që kanë fuqinë më të madhe shpjeguese në lidhje me vlerat. Një teori e madhe (grand theory) ishte e nevojshme për ta kuptuar studimin si një të tërë edhe në kuadër të çdo tentative të mundshme për të dhënë ndihmesë në shkencat sociale. Të gjitha teoritë e mëdha të shkencave sociale kishin folur për vlerat, për sistemin social dhe jepnin këndvështrimet e tyre. Zgjedhja e njëres do të thoshte mospranimi i të tjerave, kjo pati vështirësitë e veta, por që përfunduan me zgjedhjen e funksionalizmit për arsyet dhe bindjet që parashtruam më lart.

E fundit, në këtë kategori po vendosim ato që u quajtën vështirësi “organizative”, sepse ky studim merr përsipër të bëjë edhe një anketim të vetin për ta parë me të dhënat e veta dhe

sesi rezulton sot profili vleror i qytetarëve shqiptarë dhe si rrjedhojë përballej me nevojën për burime njerëzore, që do të kryenin anketimin në terren, për burime monetare, për menaxhimin e kohës si edhe të çdo të papriture etj. Anketimi për të shmangur pamundësitë, që të bëhej në të gjithë Shqipërinë, sepse kërkonte një kosto të madhe, për një punim doktorat, u bë vetëm për Tiranën. Kjo zgjidhje nuk do të ishte bërë nëse: së pari, nuk do të kishim asnjë studim të mëparshëm për të na krijuar idenë e plotë të vlerave në Shqipëri, të cilat nuk ndryshojnë dot brenda 1-2 vitesh. Këtë mundësi ne e kishim falë studimeve të Inglehart-it, i cili e kishte kryer dy herë për të gjithë vendin tonë dhe falë studimeve të Kocanit, që e kishte kryer disa herë për Tiranën dhe për Shqipërinë. Dhe së dyti, nëse do të besonim se Tirana nuk mund të përfaqësonte në rezultatet e saj Shqipërinë. Por ne besonim te kjo gjë, jo vetëm sepse rezultatet e Tiranës dhe rezultatet e gjithë Shqipërisë i kishin dalë në profil vleror të njëjta studiuesit Aleksandër Kocani (Kocani, 2013), por edhe për arsye të tjera që lidhen me përbërjen e kryeqytetit që do të sqarohen në pjesën metodologjike.

Pavarësisht vështirësive, që lidhen me objektin e studimit dhe me këndvështrimet e shumëllojshme mbi të, ato janë kapërcyer dhe është krijuar një strukturë e qartë mbi mënyrën e trajtimit të tij. Sepse për ne vështirësitë nuk krijuan pamundësi, por më shumë bindje që ky studim duhet të bëhej edhe do të ishte i vlefshëm për të interesuarit për temën dhe për krijimin e një optike për shoqërinë shqiptare. Ky punim përmban 6 kapituj të strukturuar në mënyrë të tillë, që t'i përgjigjen objektivit, qëllimit, pritshmërive dhe motiveve pse është ndërmarrë ky studim.

Kapitulli i dytë është një kapitull tërësisht metodologjik. Që puna shkencore të jetë e garantuar dhe të njihet nga studiuesit e tjerë, sqarimi metodologjik është nevojë dhe rëndësi e veçantë. Në këtë kapitull ne sqarojmë fillimisht pyetjen tonë kërkimore dhe hipotezën kryesore të studimit të ngritur pikërisht në bazë të pyetjes sonë, duke kërkuar të shohim lidhjen mes vlerave të vetafirmimit dhe demokracisë efektive në vendin tonë. Më pas përcaktojmë qartësisht, variablat e studimit, implikimet e hipotezës së ngritur, konceptet operacionale, që merr në matje ky studim, ndarjen e tyre në treguesit përkatës, që më pas gjenden në anketën e përkthyer nga anketa e përdorur nga studiuesi Inglehart dhe të tjerë në kuadër të Vëzhgimit Botëror të Vlerave. Po ashtu kemi parashtruar një hipotezë përshkruese, që lidhet me pritshmëritë tona në lidhje me profilin vleror, që do ta gjejmë tek të anketuarit dhe kjo në bazë të modelit teorik vleror që ngre Ingleharti. Dhe po sipas të njëjtit model kemi ngritur edhe një hipotezë parashikuese për ndryshimin e vlerave, që lidhet me ndryshimin e brezave, të cilën do ta marrin në shqyrtim falë anketimit tonë. Po ashtu në këtë kapitull sqarohen llojet e metodave që janë përdorur. Shqyrtimi i literaturës, që shërben për gjithë kuadrin konceptual, teorik, me prurjet dhe gjetjet e secilit studiues të rëndësishëm për tematikat, dhe metodat sasiore që shërbejnë për punimin empirik, duke sqaruar llojin dhe masën e kampionimit, ndarjen e zonave, ndarjen sipas grup-moshave dhe gjinisë në kuadër të përfaqësueshmërisë.

Kapitulli i tretë është kapitulli në të cilin pasqyrohen të gjitha studimet dhe konceptimet e mundshme teorike. Fillimisht ofron një gamë të gjerë përcaktimesh teorike nga studiues mbi atë çfarë janë vlerat, ç'do të kuptojmë me konceptin vlerë me qëllim që të jemi të qartë se çfarë jemi duke studiuar. Vazhdojmë me karakteristikat e vlerave sipas filozofisë, dhe

më pas japim arsyetimin tonë se cilat janë karakteristikat e përgjithshme për vlerat, sipas përcaktime që kanë autorët që janë përzgjedhur. Për të kuptuar më mirë vlerat është arsyetuar që këto të krahasohen dhe të vihen përballë koncepteve që hera-herës janë të ngjashme dhe plotësuese, kështu që janë përcaktuar qartë duke i marrë në shqyrtim në raport me nevojat, personalitetin, besimin dhe normat, elemente edhe këto të rëndësishme për moralin, për mënyrën e të sjellurit të individit në shoqëri. Po ashtu jepet një sqarim midis ndarjes së konceptit të vlerave demokratike, parimeve demokratike dhe shprehive demokratike. Në lidhje me vlerat ka disa klasifikime, tipologji dhe teori të ngritura, të cilat ne i marrim në shqyrtim, pavarësisht zgjedhjes sonë të modelit teorik. Gjejmë autorë si Parsons, Hofstede, Spranger, Triandis, Hall dhe Tonna, Rokeach, Schwartz, Inglehart etj.

Teorinë e Inglehart-it, që është edhe e përzgjedhura jonë, e vëmë edhe përballë kritikave dhe kundërpërgjigjeve për ta kuptuar më qartësisht punën e tij dhe rëndësinë e studimeve. E gjykojmë me vend që kishim edhe një pjesë në mënyrë që të sqaronte lidhjen e vlerave me sjelljen, edhe pse lidhja e tyre nuk është vënë në dyshim nga asnjë studiues, aq më tepër po të marrim parasysh që anketimet, të cilat masin vlerat, i pyesin njerëzit sesi do të silleshin përballë zgjedhjeve të ndryshme. Pra duke nënkuptuar lidhjen e tyre të pashmangshme, megjithatë ne e sqaruam edhe teorikisht. Pjesa tjetër e këtij kapitulli lidhet me demokracinë, për të kuptuar fillimisht çfarë është ajo, pse konsiderohet si sistemi më i mirë politik deri tani, si shprehen studiuesit për rëndësinë dhe vlerën e saj. Më pas një sqarim për konceptin e demokracisë efektive, se çfarë kuptojmë konkretisht dhe pse është plotësisht i lidhur me atë çfarë përfaqëson demokracia si sistem. Nëse vlerat i masim me anë të anketimit, këtu sqarojmë sesi do ta masim demokracinë efektive, cila është metoda, formulat, burimet e

referencës, dhe të dhënat që nxjerrim si konsiderohen ky koncept nga vetë ata që e kanë krijuar. Edhe në këtë rast kemi paraqitur gjithashtu të gjitha kritikën dhe kundërpërgjigjet në lidhje me matjen dhe me konceptin e demokracisë efektive. Së fundmi marrim në shqyrtim teorikisht atë që duam ta studiojmë më pas empirikisht nëse qëndron ose jo dhe që është thelbi i hipotezës kryesore, pra studiojmë lidhjen teorike midis nivelit të vlerave të vetafirmimit në një shoqëri dhe nivelit të demokracisë efektive.

Kapitulli i katërt është ndërtuar për të kuptuar terrenin që jemi duke studiuar, sepse studimi bën fjalë për terrenin shqiptar në vitin 2013, por nuk lind nga asgjëja dhe nuk shkon drejt asgjësë. Lind nga një terren me studime dhe shkon për t'ju shtuar këtij terreni. Kështu që vlerat dhe demokracia janë gjykuar në këndvështrim historik për të krijuar panoramën e mjedisit që jemi duke punuar. Fillimisht trajtohen në bllok me disa dinamika të përbashkëta vendet e Europës Juglindore, që merren në analizë falë karakteristikës së të qenurit nën regjime komuniste me gjithë reflektimet që sjell ky fakt në çdo fushë të jetës. Shumë autorë, përmendim si më autoritarët, Inglehart-in dhe Huntington-in; ata gjykojnë që kjo karakteristikë i bashkon këto vende, për të parin në drejtimin e vlerave që do të gjendeshin dhe për të dytin në drejtim të vështirësive që hasin në procesin e demokratizimit. Të dyja proceset janë të lidhura fort me aspektet e zhvillimit ekonomik. Pasi krijohet një kuadër i përgjithshëm, kalojmë te Shqipëria për ta parë atë historikisht në lidhje me vlerat dhe demokracinë. Udhëtimin me vlerat e nisnin që nga dy kanunet, që shërbenin si kode sjelljesh morale në vendin tonë dhe konkretisht Kanunin e Lek Dukagjinit dhe Kanunin e Labërisë. Duke krijuar një pasqyrë të tyre demonstrojmë edhe njëherë që vlerat nuk janë statike në një shoqëri, por ato ndryshojnë. Më pas trajtojmë dinamikën e komunizmit në

lidhje me vlerat dhe me konceptimet për demokracinë. Pasojat që la, sepse kështu mund të kuptojmë se çfarë mund të gjejmë në terren. Këtu merren në shqyrtim punimet e studiuesve më të rëndësishëm shqiptarë në fushën e shkencave sociale.

Kapitulli i pestë ngrihet për të marrë në analizë rezultatet e nxjerra nga punimi empirik në terren, me anketën sipas modelit të Inglehart-it. Duke qenë se Inglehart-i bën ndarjen e vlerave në tri boshte kryesore, boshtin e vlerave tradicionale përballë atyre shekullare, boshtin e vlerave të mbijetesës përballë atyre të vetafirmimit, boshtin e vlerave materialiste përballë atyre postmaterialiste, të njëjtën ndarje ruajmë edhe ne në shqyrtimin e rezultateve të dala nga anketimi. Fillimisht japim rezultatet demografike të anketimit dhe më pas rezultatet e secilit nga boshtet. Rezultatet janë nxjerrë duke përdorur programin statistikor SPSS. Edhe pse për hipotezën e ngritur neve na duhet për analiza të mëtejshme vetëm boshti i vlerave të mbijetesës përballë atyre të vetafirmimit, ne i kemi marrë të gjitha në shqyrtim sepse shërbejnë për të kuptuar në mënyrë plotë profilin vleror të shoqërisë dhe jo vetëm një aspekt të caktuar të vlerave, sepse kështu do të ishim shumë të kufizuar në analiza.

Kapitulli i gjashtë është menduar vetëm për shqyrtimin e hipotezave. Fillimisht hipotezën përshkruese, që lidhet me pritshmëritë tona, për të gjetur një profil vleror me vlera tradicionale, të mbijetesës dhe materialiste, nisur nga “hipoteza e vlerave të mungesës” që e gjejmë tek Inglehart-i. Mbasi kuptojmë profilin, na duhet të masim nivelin e demokracisë efektive për Shqipërinë, në mënyrë të tillë nëse mund të vërtetojmë ose hedhim poshtë hipotezën e ngritur mbi një lidhje korrelacioni të drejtë mes tyre. Nëse niveli i ulët (siç e

presim ne nisur nga hipoteza përshkruese) i vlerave të vetafirmimit shoqërohet me nivel të ulët të demokracisë efektive, atëherë ka të ngjarë që hipoteza e Inglehart-it dhe e jona në këtë studim të qëndrojnë, në të kundërt hipoteza nuk qëndron në këtë test empirik. Në fund do të marrin në konsideratë një hipotezë që lidhet me parashikimin e së ardhmes në lidhje me vlerat e brezit të ri dhe detyrimisht nëse na konfirmohet hipoteza qendrore edhe në lidhje me nivelin e demokracisë efektive në vendin tonë.

Kapitulli i shtatë është kapitulli ku sqarojmë konceptet mbi të cilat kemi punuar, dhe si na dolën hipotezat e ngritura në kuadër të studimit. Më pas do të jenë rekomandimet që lidhen me politikëbërjen, me studiuesit e tjerë, dhe me lëmin e vlerave dhe demokracisë për të ardhmen.

Me një bibliografi të pasur, gati shteruese të llojit të vet, me devotshmërinë për të marrë parasysh çdo lloj kritike, kundërpërgjigje, që autorët kanë bërë me njëri-tjetrin, ky studim synon të jetë pjesë e koleksionit të studimeve të arrira shqiptare dhe mund të referohet për ndihmesën e tij sado modeste.

KAPITULLI II: METODOLOGJIA

Nuk mund të flitet për studim shkencor, aq më pak ndonjëherë për punim doktoral, pa i dhënë mundësinë studiuesve të tjerë dhe çdo të interesuari të kuptojë “metodën e punës” që ke ndjekur për të arritur në konkluzionet e tua, për të hedhur poshtë apo për të konfirmuar një hipotezë të ngritur. E rëndësishme në këtë pjesë është të japësh linjën logjike metodologjike, që të dhënat që ke mbledhur, qasjet që ke zgjedhur, rezultatet që jep, mos mbesin thjesht të dhëna që mund të interpretohen sipas dëshirave personale, por kanë një ngrehinë logjike dhe një rezultat që do të vijë pikërisht nga kjo. Një matematicien francez, Poincare, thoshte “një grumbull të dhënash është shkencë po aq sa dhe një grumbull gurësh është shtëpi”. Metodologjia mund të themi është diferenca mes një opinion, një sprove personale nga një punim shkencor.

Si fillim duhet thënë se ky punim ka limitimin e tij territorial, që lidhet me rastin studimor të popullsisë mbi 15 vjeç të Tiranës, pra çdo ndihmesë e kësaj teze mbështetet në realitetin shqiptar dhe ka për qëllim që të jetë e përdorshme, e vlefshme për realitetin pro shqiptar. Kjo nuk e bën tezën të panevojshme për qasje më të gjera, sepse mund të shërbejë fare mirë në punime krahasimore, me vende të tjera dhe në kohë të ndryshme. Metodologjia e përzgjedhur për të punuar tezen është ajo mikse, ku do të ndërthuren metodat cilësore me metodat sasiore, gjithnjë në shërbim të kërkimit tonë.

Pyetja jonë kërkimore: Cila është lidhja midis vlerave dhe demokracisë efektive në realitetin e sotëm të Shqipërisë? Gjen një përgjigje me anë të hipotezës që do të ngremë dhe shkon në linjë të drejtë me modelin e Inglehart-it, sipas të cilit vlerat e vetafirmimit janë të lidhura fort dhe ngushtësisht me ekzistencën e demokracisë efektive. (Modelin e Inglehart

do ta sqarojmë me gjithë detajet e veta gjatë studimit teorik, për të kuptuar më shumë mbi ndarjen e tij të vlerave, në tri grupe të mëdha, 1. tradicionale-shekullare, 2. të mbijetesës-vetafirmimit, 3. materialiste-postmaterialiste)

Hipoteza jonë, e huazuar nga rezultatet e punës së Inglehartit, të cilën do të kërkojmë ta shqyrtojmë në këtë punim është: “Niveli i vlerave të vetafirmimit në Shqipëri shkon në proporcion të drejtë me nivelin e demokracisë efektive” Dy implikimet që rrjedhin nga kjo hipotezë pune janë: 1: Sa më i madh të jetë niveli i vlerave të vetafirmimit në Shqipëri aq më e madhe do të jetë shkalla e demokracisë efektive. 2: Sa më i vogël të jetë niveli i vlerave të vetafirmimit në Shqipëri aq më e vogël do të jetë shkalla e demokracisë efektive. Është e qartë që në këtë punim variabli i pavarur është: profili vleror, pra vlerat që ka shoqëria dhe variabli i varur është: demokracia efektive.

Sipas Welzel-it dhe Inglehart-it lidhja mes tyre është e njëanshme, që do të thotë se pasja e vlerave vetafirmuese ndikon drejtpërdrejt në nivelin e demokracisë efektive, nëse pasja e një sistemi demokratik nuk ndikon në krijimin apo rritjen e nivelit të vlerave të vetafirmimit (Welzel, Inglehart, 2008). Domethënë për të kuptuar nivelin e demokracisë efektive, qoftë diku i lartë apo i ulët, është e mundshme dhe shumë realiste të kuptosh sistemin e vlerave të një shoqërie. Kjo është arsyeja pse vlerave ju është dhënë më shumë rëndësi në këtë studim sesa studimit të demokracisë në vetvete me mjete të tjera matëse. Kjo është edhe arsyeja pse tentohet nga ne të kuptohet në totalitet profili vleror i shoqërisë sipas gjithë panoramës dhe treguesve që ka vendosur teoria e vlerave të Inglehart-it. Pra jo vetëm vlerat e mbijetesës versus vetafirmim, por edhe vlerat tradicionale versus shekullare dhe

materializmi versus postmaterializmit. Sepse të gjitha formojnë qytetarin shqiptar, e nxjerrin atë në tërësinë e tij dhe pikërisht është qytetari, me vlerat dhe sjelljen e tij, në thelb të demokracisë efektive.

Që të mund të testojmë një hipotezë nëse qëndron ose jo, pra nëse mund ta marrim të mirëqenë për sa kohë nuk është vërtetuar e kundërta, duhet të operacionalizojmë konceptet duke bërë të mundur që, për secilin nga variablat, ta përkthejmë në tregues të matshëm. Duke nënvizuar faktin që secili nga konceptet do të ketë përshkrimin e detajuar teorik dhe asaj që kuptohet me të në pjesën teorike të studimit, pra ndarja në tregues është bërë sipas asaj që konceptojnë studiuesit e World Values Survey si vlera të vetafirmimit dhe si demokraci efektive.

Konceptet operacionale janë si më poshtë:

Vlera tradicionale janë vlerat që na tregojnë një lidhje të fortë me fenë, nivel të ulët të tolerancës për divorc, abort, që i japim rëndësi të madhe familjes dhe respektojnë çdo lloj autoriteti, familjar, fetar, shoqëror (Inglehart, Baker, 2000).

Vlera shekullare janë vlerat që na tregojnë mungesën e një lidhjeje të fortë me fenë, nivel relativisht të lartë të tolerancës kundrejt fenomeneve sociale si divorci, aborti, që gjykojnë me kritikizëm dhe me mosbesim çdo lloj autoriteti; familjar, fetar apo shoqëror (Inglehart, Baker, 2000).

Vlerat materialiste lidhen me vlerat që shprehin se qeverisja e vendit duhet të ketë si parësore çdo gjë që lidhet me mirëqenien ekonomike, sigurinë fizike, rendin, luftën kundër çdo rreziku ekonomik dhe fizik për shoqërinë (Inglehart, 1977).

Vlerat postmaterialiste lidhen me vlerat që shprehin se qeverisja e vendit duhet të ketë si parësore çdo gjë që lidhet me garantimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve, në prosperitetin e tyre moral, intelektual, njerëzor, me ndjenja të ekologjisë, por edhe të shoqërisë së ideve e jo të parave (Inglehart, 1977).

Vlerat e vetafirmimit lidhen me vlera që shprehin sindromën e besimit, të tolerancës, mirëqenien subjektive, aktivizimin politik, pranimin e diversitetit, të të huajt dhe të ndryshimit, duke ndjerë edhe një nivel të lartë sigurie (Inglehart, Baker, 2000).

Vlerat e mbijetesës lidhen me vlera që i japin më shumë rëndësi sigurisë ekonomike dhe fizike në raport me qëllimet e tjera dhe ndihen të kërcënuar nga të huajt, nga diversiteti etnik dhe ndryshimi kulturor (Inglehart, Baker, 2000).

Demokracia efektive përkufizohet si mundësia reale dhe konkrete që ka brenda një vendi që të fuqizohen dhe të funksionojnë realisht të drejtat e qytetarit të zakonshëm, zëri i tij në vendimmarrje, roli i tij në qeverisje dhe trajtimi i tij si i barabartë dhe i rëndësishëm (Welzel, Inglehart, 2008).

Treguesit që masin vlerat e mbijetesës përkundrejt vlerave të afirmimit janë si më poshtë (po paraqesim ato të vetafirmimit dhe të kundërtat e këtyre tregojnë ato të mbijetesës) (Inglehart, Baker, 2000:27).

1. I japin rëndësi miqve në jetën e tyre.
2. I japin rëndësi kohës së lirë në jetën e tyre.
3. I japin rëndësi politikës.
4. E konsiderojnë veten të lumtur.
5. E konsiderojnë veten me një gjendje të mirë shëndetësore.

6. Mendojnë se nuk kemi për detyrë të respektojnë dhe të duam prindërit, ata duhet ta meritojnë.
7. Mendojnë se mund t'i besohet shumicës së njerëzve.
8. Shprehen se i pranojnë si komshinj kategori të caktuara njerëzit të mënjanuar shpesh nga shoqëria si: pijanecë, prostituta, homoseksuale etj.
9. Mendojnë se të drejtat për punë janë të barabarta mes meshkujve dhe femrave, mes grup-moshave të ndryshme, dhe mes vendasve dhe të ardhurave nga jashtë vendit.
10. Janë të kënaqur me gjendjen financiare.
11. Janë të kënaqur nga jeta.
12. Nuk kanë frikë se mund të humbasin punën e tyre.
13. Mendojnë se kanë lirinë për të zgjedhur dhe se kanë kontrollin e jetës tyre.
14. Vlerësojnë më shumë kohën e lirë në raport me punën.
15. E vlerësojnë punën më shumë për sa i përket elementeve të tjera sesa nga paga, siguria për ta mbajtur dhe përgjegjësia.
16. Përshihen në veprimtari politike si peticion, bojkot, manifestim, grevë.
17. I shikojnë me besim institucionet si shtypin, tv-të, sindikatat, partitë dhe organizatat ndërkombëtare si edhe lëvizjet (ndërkohë në këtë rast nuk është thjesht e kundërta për vlerat e mbijetesës, por është edhe besimi që shprehin për institucione të tilla si ushtria, policia, qeveria, parlamenti, administrata).
18. Besojnë se nuk duhet të kemi një udhëheqës të fortë që nuk shqetësohet për parlamentin dhe zgjedhjet.
19. Besojnë se është mirë t'ju lihet gjykimi mbi të mirën e vendit specialistëve sesa thjesht qeverisë.

20. Besojnë se nuk duhet të lëmë ushtrinë të marrë vendimet.
21. Besojnë se është mirë të kesh një sistem demokratik.
22. Besojnë se një drejtues partie duhet të jetë i gatshëm të bashkëpunojë me grupe që vënë në pikëpyetje pikëpamjet e tij.
23. Nuk kënaqen me mënyrën sesi qeveritarët qeverisin vendin.

Treguesit që masin vlerat tradicionale përkundrejt vlerave shekullare janë: (po paraqesim ato që i përkasin vlerave tradicionale dhe të kundërtat e tyre që shprehin vlerat shekullare) (Inglehart, Baker, 2000:26).

1. I japin rëndësi familjes në jetën e tyre.
2. I japin rëndësi fesë në jetën e tyre.
3. Besojnë në ruajtjen e vlerave që mund t'i konsiderojnë si tipike të vendit të tyre (si p.sh. te ne besa, toleranca fetare etj).
4. Dënojnë si të pamoralshëm çdo veprim kriminal dhe mjetet e paligjshme.
5. Besojnë te martesat si institucion i rëndësishëm.
6. Besojmë te familja e konsoliduar me fëmijë.
7. Do të preferonin djalë si fëmijë të parë.
8. Do të luftonin për vendin e tyre në rast nevojë.
9. Besojnë se është gjë e mirë të respektohet autoriteti.
10. Besojnë se është gjë e mirë t'i kushtohet rëndësi jetës familjare.
11. Besojnë tek institucionet fetare.
12. I përkasin një besimi fetar.
13. Jetojnë një atmosferë fetare edhe në familje.
14. Kryejnë në mënyrë të rregullt shërbimet fetare.

15. E konsiderojnë veten si një nga fetarët.
16. Besojnë se zoti është i rëndësishëm në jetën e tyre.
17. Nuk pranojnë abortin..
18. Nuk pranojnë divorcin
19. Nuk pranojnë eutanazinë.
20. Nuk pranojnë vetëvrasjen.
21. Nuk pranojnë homoseksualitetin.
22. Janë krenar për përkatësinë e tyre kombëtare.

Treguesit, që masin vlerat materialiste dhe postmaterialiste në shoqëri, janë të lidhur me qëllimet që mendon individi si duhet të ndjek si parësore një qeveri kur e vihet përballë zgjedhjeve mes tyre. Treguesit e vlerave materialiste janë: kur njerëzit besojnë se qeveria duhet të ketë si parësore (Inglehart, 1977:439) :

1. Një nivel të lartë rritje ekonomike.
2. Sigurimi në vend të një ushtrie të fortë për mbrojtje.
3. Mbajtjen e rendit në vend.
4. Luftën ndaj rritjes së çmimeve.
5. Të paturit e një ekonomie të qëndrueshme.
6. Luftën kundër kriminalitetit.

Treguesit e vlerave postmaterialiste janë: kur njerëzit besojnë se qeveria duhet të ketë parësore (Inglehart, 1977:439):

1. Që njerëzit të thonë fjalën e tyre në punë, në lagje, në komunë etj.
2. Përpjekjen për t'i bërë qytetet dhe fshatrat më të bukura.
3. Përmirësimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimet e qeverisë.

4. Garantimin e lirisë së shprehjes.
5. Progresin drejt një shoqërie më pak jo personale dhe më shumë humane.
6. Progresin drejt një shoqërie ku idetë vlerësohen më shumë se paratë.

Matja e nivelit të demokracisë efektive del si shumë e dy treguesve, që janë edhe treguesit matës për të. Indekset që masin demokracinë efektive janë sipas: (Alexander, Inglehart, Welzel, 2012):

1. Indeksi i të drejtave demokratike (DRI= Democratic Rights Index)
2. Indeksi i shtetit të së drejtës (RLI=Rule of Law Index)

Sipas Inglehart dhe Welzel mbështetja që kanë qytetarët për sistemin demokratik nuk ka lidhje me demokracinë e vërtetë si proces që i përfshin ata brenda. Ata shprehen : “Në këtë pikë të historisë mbivlerësimi dhe mbimbështetja për demokracinë është përhapur në mënyrë ekstreme, dhe qytetarët e Shqipërisë ose të Azerbajxhanit kanë shprehur të njëjtin opinion të favorshëm në drejtim të demokracisë se edhe qytetarët e Suedisë apo të Zvicrës. Por këto opinione të favorshme shpesh janë sipërfaqësore, vetëm nëse ato shoqërohen me orientimin drejt tolerancës, besimit dhe pjesëmarrjes, ndryshe shanset janë të vogla që demokracia efektive të shfaqet në nivel shoqëror” (Inglehart, Welzel, 2003:14).

Po të vëmë re ne përdorim konceptin demokraci efektive dhe jo konceptin thjesht demokraci apo togfjalëshat si demokraci elektorale, demokraci liberale, demokraci hidride e të tjera, të cilët gjenden në literaturën që flet dhe shqyrton demokracinë dhe demokratizimin. Pikërisht sepse është koncept i ndryshëm, prandaj edhe sqarimi i tij në studim do të ketë rëndësinë e vet.

Përpos hipotezës sonë, të ngritur sipas një hipoteze që Ronald Inglehart e ka mbështetur dhe e ka vërtetuar me anë të World Values Survey ku ishte president, janë marrë parasysh edhe disa të dhëna të tjera, po nga ky autor dhe nga ky grup studimi që na qartëson më shumë mbi rrugën që jemi duke ndjekur dhe çfarë pritet që të gjejmë.

Një hipotezë e tij quhet “hipoteza e vlerave të mungesës”; sipas saj rezulton se përparësitë vlerore të një individi reflektojnë mjedisin socioekonomik, që do të thotë se vihet më shumë vlerë subjektive në ato gjëra që janë relativisht më të pakta (Inglehart, 2000:220). Kuptohet se në Shqipëri, si një ndër vendet ish -komuniste më pak të zhvilluara, sot një vend me një ekonomi që nuk mundi kurrë, deri tani, të kapte majat, ose të paktën një qëndrueshmëri dhe një formalitet, mirëqenia materiale e individëve është relativisht e ulët. Prandaj mendojmë se është e pritshme që individët shqiptarë të aspirojnë më shumë për një mirëqenie ekonomike më të lartë, sidomos për pagë më të lartë, stabilitet të çmimeve dhe siguri e zhvillim ekonomik. Pra, tendenca e dinamikës së profilit vleror të shoqërisë shqiptare të jetë drejt përvijimit të të ashtuquajturit “sistem i vlerave të mbijetesës” sesa drejt “sistemit të vlerave të vetafirmimit”, më shumë drejt “sistemi të vlerave tradicionale” sesa drejt “sistemit të vlerave shekullare”. Po ashtu e një profili materialist sesa të atij postmaterialist. Pra ne presim që të gjejmë në profilin vleror të shqiptarëve në vitin 2013, nivel të ulët të vlerave të vetafirmimit. Që hipoteza të konfirmohet duhet të gjejmë edhe nivel të ulët të demokracisë efektive, në të kundërt do të hedhim poshtë hipotezën e ngritur.

Autor të World Values Survey, me në krye Ronald Inglehart, kanë bërë studime vlerash për më shumë se 80 shoqëri dhe kanë nxjerrë herë pas here në hartë (në vite të ndryshme para

vitit që ne kemi në studim) edhe Shqipërinë, të pikëzuar në radhët e shoqërive me vlera të mbijetesës si dhe me vlera materialiste. Por në interesin e tij si studiues nuk është një studim i thellë mbi Shqipërinë, por ky studim është në interesin tonë. Nëse konfirmohet hipoteza e mësipërme, siç ne presim, do të marrim në shqyrtim, dhe po në këtë punim, mundësinë që jep Ingleharti si ndikuese në ndryshimin e vlerave. Sepse interesi ynë për vlerat dhe për demokracinë nuk është për të bërë panoramën e gjendjen së sotme (gjë patjetër mund të konsiderohet si i rëndësishëm edhe ky), por edhe për të bërë të mundur një parashikim për të ardhmen e demokracisë shqiptare dhe në një farë mënyrë të jetës së shqiptarëve, të paktën në aspektin e tyre social-politik. Pra është e rëndësishme që ne të shikojmë se çfarë thotë teoria e tij si mund të ndryshojnë vlerat nga ato të mbijetesës drejt atyre të vetafirmimit. Ata tregues që dedektojnë ndryshimin për të ardhmen, kur të bëjnë analizën e të dhënave me qëllim që të kuptojmë nëse kemi shanse të mira dhe mundësi që t'i ndryshojmë në këtë drejtim (gjithmonë nëse gjejmë, siç presim, që niveli i vlerave të vetafirmimit është i ulët në shoqërinë shqiptare, në të kundërtën kjo analizë e shanseve për t'i rritur vlerat nuk do të ketë më kuptim që të bëhet).

Sipas Inglehart-it një nga shpresat e ndryshimit të vlerave të mbijetesës në raport me ato të vetafirmimit dhe nga ato materialiste në post-materialiste është ndryshimi i brezave. Siç përcakton Inglehart (Inglehart, 1990) do të pritet diferenca mes grup-moshave të ndryshme sepse këto grupe kanë jetuar përvoja të ndryshme formuese. Ekziston, sipas tij, një vonesë kohore mes ndryshime në kontekstin ekonomik dhe më pas pasojat politike duke u ndjekur nga logjika e zëvendësimit të brezave që ndodh te vlerat. Kështu që për të është shumë e

rëndësishme efekti i brezit, nëpërmjet zëvendësimeve të gjeneratave dhe jo thjesht efekti i kohës, se çfarë ndodh nëpër botë në këtë kohë.

Duke u nisur nga këto premisa të Inglehart-it, ne në fund marrim në shqyrtim që të shikojmë atë që mund të quhet shpresa për demokracisë efektive: ndryshimin e vlerave mes grup-moshave të ndryshme e sidomos midis brezave që qëndrojnë në skajet e studimit, pra midis të rinjve të moshës 15-24 vjeç dhe të atyre mbi 65 vjeç. Nëse qëndrojmë në logjikën e sipërmendur presim që të gjejmë profil vleror me vlera të vetafirmimit të të rinjtë dhe më shumë profil vleror me vlera të mbijetesës të të moshuarit. Pra duhet të kërkojmë se a ka diferencë nga brezi në brez, siç supozon hipoteza e Inglehart, dhe nëse ka a janë ato sinjifikative. Ndryshimet gjithmonë priten në drejtimin drejt vlerave të vetafirmimit. Pra edhe pse profili vleror në fillim do ndërtohet i plotë me të gjitha boshtet e Inglehart-it, testimi i kësaj hipoteze do të lidhet vetëm me boshtin mbijetesë-vetafirmin dhe kryqëzimi i tij me grup-moshën. Pikërisht sepse vetëm ky bosht është i lidhur me demokracinë efektive dhe është në funksion të kërimit tonë. Në rast se gjejmë ndryshime dhe këto ndryshime janë sinjifikative, siç thotë hipoteza, mund të gjejmë se në Shqipëri ka shpresë për nivelin e demokracisë efektive.

Për të arritur qëllimet, që i kemi vendosur vetes me anë të pyetjes kërkimore dhe hipotezave të ngritura në shqyrtim, ky punim ka nevojë për kombinimin e burimeve dhe për një metodë kërkimore rigoroze me standardet shkencore.

Shqyrtimi i literaturës dhe përdorimi i burimeve dytësore

Vlerat janë koncepti bazë mbi të cilin ngrihet ky punim doktoral. Me gjithë vështirësitë që hasim për ta përcaktuar dhe për ta ndarë këtë koncept nga ngatërime të zakonshme, që vijnë në shkencë, por edhe në përdorimin e përditshëm, me normat, me qëndrimet, me moralin etj, na del si detyrë, dhe para së gjithash, përcaktimi i këtij koncepti. Koncepti vlerë është parë nga këndvështrim filozofik, sociologjik, psikologjik, por të mos harrojmë edhe atë ekonomik. Neve na intereson aspekti sociologjik dhe deri diku edhe ai filozofik. Do të shqyrtojmë literaturën e shkruar mbi vlerat, ç'janë ato, pse duhet të studiohen nga autorë si Parsons, Williams, Maslow, Scheler, Hartman, Giddens, Hernandez, Gonzalez Lucini, Adler, Morra, Schwartz, Spranger etj.

Përveç konceptit autorët kanë trajtuar teori të ndryshme të vlerave, ne marrim në shqyrtim më të rëndësishmet për të kuptuar si i trajtojnë ato, edhe pse kemi zgjedhur si teorinë shpjeguese më bindëse atë të Inglehart-it por kjo ka qenë zgjedhje në funksion të kërkimit tonë dhe nëse fokusi do të ishte i ndryshëm teoritë e tjera mund të ishin më të vlefshme. Patjetër, që këtë zgjedhje teorike ne e sqarojmë pasi shqyrtojmë teoritë më të rëndësishme, për të cilat janë marrë në shqyrtim autorë si Inglehart, Welzel, Rokeach, Hall dhe Tonna, Triandis, Hofstede, Schwartz. Duke parë se si e ndajnë tipologjitë e vlerave, hierarkinë e tyre, lidhjen e tyre, si shpjegojnë ndryshimin e tyre dhe vlerën e vlerave në një farë mënyrë. Në studimin tonë vlerat i vëzhgojmë më pas si të demonstruara nga sjellje. Sepse, pa dyshim, që është pikërisht bindja dhe njohja e faktit që vlerat ndikojnë në sjellje dhe kjo i çon studiuesit e tjerë, ashtu si edhe ne, për t'i studiuar në mënyrë që ta kryejmë punimin e nisur. Kjo është e rëndësishme sepse mund ta shpjegojmë teorikisht edhe këtë pjesë. Vetë Ingleharti i mat vlerat, faktikisht, duke pyetur njerëzit mbi sjelljet e tyre, si do të silleshin

në rast se i paraqitej një zgjedhje e caktuar. Në këtë këndvështrim edhe matja e tyre bëhet me anë të sjelljes, se përndryshe do ishte një fenomen psikologjik me të cilin do të merrej vetëm shkenca e psikologjisë. Por pavarësisht këtij arsytimi logjik ne kemi shqyrtuar autorët; si e paraqesin këtë lidhje dhe si e argumentojnë. Sepse patjetër kjo është e lidhur edhe me tezën tonë, që lidh vlerat me demokracinë, në fakt me sjelljen demokratike të qytetarëve dhe në këtë mënyrë me zhvillimin e demokracisë. Këtu merren në shqyrtim përsëri autoritetet e fushës si Inglehart, Welzel, Schwartz, Klingerman, Homer dhe Kahle etj. Po ashtu në studimin teorik sqarohet koncepti i Inglehart-it dhe i autorëve të tjerë të World Values Survey mbi demokracinë efektive si edhe lidhja teorike mes vlerave të vetafirmimit dhe demokracisë efektive.

Sigurisht, punimi do të bazohet mbi punimet që janë bërë në kontekstin shqiptar nga sociologë dhe politologë shqiptarë që, herë pas herë me metoda të ndryshme dhe për qëllimet e tyre studimore, kanë folur mbi vlerat e shqiptarëve ose mbi elemente të caktuara të tyre, qoftë edhe mbi sjellje të caktuara vlerore. Në shqyrtim merren emra të rëndësishëm të shkencës sonë si: Aleksandër Kocani, Gjergj Sinani, Artan Fuga, Zyhdi Dervishi etj. Shqyrtimi i literaturës në përgjithësi është instrumenti bazë për kryerjen e pjesës së studimit teorik, të qasjeve teorike, të sqarimit të koncepteve sipas atyre që autorët i kanë vendosur para nesh.

Përdorimi i burimeve dytësore do të na vijë në ndihmë për të kuptuar Indeksin e Demokracisë Efektive, i cili del si shumë e Indeksit të së Drejtave Demokratike dhe Indeksit të Shtetit së Drejtës (Alexander, Inglehart, Welzel, 2012). Të dy këta Indekse nuk

maten nga ne në terren, por dalin nga studimi i dy raporteve të rëndësishme e të përvitshme nga dy institucione prestigjioze, me anë të formulave efiçente që i kanë vendosur autorët. Këto dy raporte janë konkretisht raporti i Freedom House për liritë civile, politike, nga përpunimi i të cilit do të nxjerrim Indeksin e të Drejtave Demokratike, dhe raporti e Bankës Botërore për Indeksin e Kontrollit të Korrupsionit, përpunimi i të cilit na nxjerr Indeksin e Shtetit të së Drejtës. Në shqyrtimin e këtyre raporteve dhe gjatë përpunimit të tyre sipas formulave të paracaktuara ne do të nxjerrim Indeksin e Demokracisë Efektive dhe për rrjedhojë do të kuptojmë nivelin e saj, i cili na duhet në kuadër të hipotezës së ngritur.

Metoda e kërkimit

Për të krijuar profilin vleror sipas parametrave të profilit vleror që përcakton Ingleharti, normalisht ishte e nevojshme që të mund ta matnin terrenin shqiptar për ta kuptuar atë dhe për ta shqyrtuar më pas me të dhënat në hipotezën e ngritur. Për këtë arsye u mendua si e përshtatshme kryerja e së njëjtës anketë, që Ingleharti përdor në mbi 80 shoqëri të botës, për të matur vlerat dhe që autor të tjerë shqiptarë e kanë përdor kur i është dashur të masnin vlerat në shoqëri. Siç sugjeron edhe Kocani: “Nëse realizoni një anketim të ngjashëm me dikë tjetër (i cili natyrisht i ka kaluar sprovat e veta dhe është pranuar nga bashkësia shkencore), është e rekomandueshme që të huazohet pyetësi i tij dhe t’i bëhen atij modifikimet e nevojshme që lidhen me veçorinë e vendit dhe të kohës së anketimit” (Kocani, 2006:82) Pikërisht kjo ishte edhe një zgjidhje që ne e menduam të përshtatshme për të matur profilin e vlerave të shoqërisë shqiptare.

Anketës iu bënë disa modifikime, që nuk cenonin absolutisht tërësinë e ndërtimit të saj, në varësi të kërkimit që po zhvillonim. Fillimisht iu lidh një paragraf hyrës që shpjegonte se anketimi po kryej në kuadër të një doktoraturë dhe për çfarë do të pyeteshin. Kjo u pa më vend që të mund të siguronim përgjigje më të sinqerta nga të anketuarit, duke qenë se ishte një anketim që nuk bëhej nga institucione qeveritare që nesër mund edhe “të hakmerreshin” ndaj tyre për përgjigje të caktuara. Për këtë gjë u instruktuan edhe anketuesit që ta thoshin natyrshëm me gojë në fillimin e takimit me të anketuarin. Më pas në listën e vlerave që ne do t’i pyesnim nëse do të donin t’i ruanin apo jo, i shtohen listën së Inglehart-it edhe vlera që mendohet se gjenden në shoqërinë shqiptare. Këto vlera që i shtuam listës janë : besa e dhënë, atdhedashuria, tolerance fetare. Po ashtu kemi shtuar dy pyetje në lidhje me bashkimin kombëtar, që është çështje tërësisht shqiptare, për të parë nëse fuqizimin e vendit e lidhin apo jo edhe me bashkimin kombëtar. Kemi vendosur të pyetjet, një pyetje e cila pyet se në cilin rreth keni lindur, kjo na shërben për të konfirmuar ose jo idenë tonë fillestare që, duke anketuar Tiranën, kemi kapur shumë subkultura (ide që sqarohet më poshtë përse anketojmë vetëm Tiranën). Edhe së fundmi fashat e ndarjes së të ardhurave mujore, e bëmë në lek dhe duke reflektuar realitetin shqiptar të të ardhurave që na jepet nga CENSUSI i fundit. Këto janë të gjithë modifikimet që nuk prekin aspak pyetjet tregues të nevojshëm për përcaktimin e boshteve vlerore.

Ishte e domosdoshme të vendosej se ku do të kryhej anketimi, që më pas të vendosim masën e tij, kohën dhe llojin e kampionimit. Ideja është që punimi mundësisht të flasë për shoqërinë shqiptare, por mundësia për ta kryer në të gjithë Shqipërinë ishte e pamundur në kuadër të nevojave të shumta për burime njerëzore, për burime financiare, për burime

materiale të cilat janë kufizime objektive dhe që nuk mund të zgjidheshin pavarësisht vullnetit apo dëshirës sonë. Zgjidhja u mendua të ishte Tirana dhe kjo zgjidhje u mendua jo pse mund të quhet më e afërta falë punësimit dhe jetesën këtu, por sepse ne besojmë që një studim i kryer sipas rregullave të metodave kërkimore në Tiranë mund të na japë rezultate që mund të kemi të drejtë që t'i përgjithësojmë më pas për gjithë shoqërinë. Arsytet pse mendojmë që Tirana mund të shërbejë me rezultatet e saj për shoqërinë shqiptare janë: Së pari, sepse duke u bazuar te Censusi i fundit, i bërë në vendin tonë nga INSTAT, në Tiranë jetojnë 1/3 e popullsisë së vendit tonë (Census, 2012: 134). Së dyti, parë nga pikëpamja demografike dhe duke u nisur nga migrimi i brendshëm i këtyre viteve të demokracisë, Tirana përfaqëson një lloj konglomerati që i përket subkulturave të ndryshme nisur nga zonat në të cilat kanë jetuar dhe së fundmi Tirana është e vetmja që të ofron akses të lehtë infrastrukturor, që mundëson lëvizjen dhe të jep mundësinë për të ndaluar njerëzit në rrugë dhe për të marrë përgjigje prej tyre. Pavarësisht se punimi jonë empirik është *case study* mbi Tiranën, fatmirësisht në testimin e hipotezën do të na vlejë edhe metodat cilësore, çka do të thotë rezultatet e nxjerra ndër vite nga anketimet për vlerat, prej studiuesit shqiptar, Aleksandër Kocani.

Kampionimi i përdorur është kampionimi me kuota. Sipas metodave kërkimore, “një kampionim me kuota është një lloj tepër i përdorshëm i kampionimit me strate, në të cilin ne përzgjedhim njësitë në renditjen në të cilën ato ndodhen në popullsi, por që imponon shtrëngesën që vetëm një farë numri, nga çdo prej nëngrupeve të specifikuar, të jetë përzgjedhur” (Kocani,2006:63) Pikërisht ajo që mund të quhet si shtrëngesë është e domosdoshme për punimin tonë, sepse ne na intereson të jenë të përfaqësuar në raporte të

njëjta me realitetin e grup-moshave dhe gjinisë së popullatës. Ne nuk kemi një listë emërore të saktë të banorëve të këtij qyteti, kështu që metoda të tjera bëhen të pamundura. Falë Censurit të fundit kishim saktësisht numrin e popullsisë së Tiranës, jo vetëm kaq, por edhe të ndara sipas grup-moshës dhe gjinisë. Neve na binte detyra metodologjike që të ruanim proporcionet ashtu si e kërkon kampionimi me kuota.

Nisur nga Censuri Tirana ka një popullsi prej 749365, por kjo është popullsia në total duke përfshirë edhe fëmijët të cilët nuk mund të jenë objekt anketimi në këtë punim. Për këtë arsye veçuam popullsinë e Tiranës nga 15 vjeç e lart duke parë edhe ndarjen mashkull-femër, duke bërë tabelën 1 si më poshtë. Nga këto të dhëna na del që Tiranë ka 599175 banorë mbi moshën 15 vjeç.

	Popullsia	M	F
15-24	142875	69695	73180
25-34	109773	53194	56579
35-44	96968	47232	49736
45-54	97296	48161	49135
55-64	75558	37587	37971
mbi 64	76705	36550	40155
Total	599175	292419	306756

Tabela 2: Popullsia e qytetit të Tiranës

Duke u nisur nga kjo madhësi e zonës që ne kemi në studimin, duhet të vendosnim madhësinë e kampionimit që të mund të ishte përfaqësues. Zgjedhja e kampionimit i takon studiuesit, por normalisht nuk mund të dalë nga marzhet e zgjedhjes që i lejon teoria. “Një raport mbi disa qindra studime nga Saymour Sudman tregon që kampione në nivel kombëtar të individëve zakonisht përfshijnë 1000 deri në 2500 e më shumë njerëz. Kampione të individëve, në zona të vogla, zakonisht bazohen në 200 deri në 1000 persona. Kampione të grupeve të njerëzve (qyteteve, institucioneve etj) zakonisht përfshijnë 200 deri në 1000 e më shumë grupe në nivel kombëtar dhe 50 deri në 500 grupe në nivele më të ulëta” (Kocani, 2006:55) Nisur nga kjo ne kemi anketim me individ në zona të veçanta siç është Tirana dhe jo anketim kombëtar, dhe për këtë u gjykua që madhësia e anketimit të ishte 250 të anketuar. Nisur nga proporcionet e tabelës 1 për popullsinë e Tiranës, ne bëmë kampionimin tonë prej 250 të anketuarish, siç paraqitet në tabelën 2.

	Kampionimi	M	F
15-24	60	29	31
25-34	46	22	24
35-44	40	19	21
45-54	41	20	21
55-64	32	16	16
mbi 64	31	15	16
Total	250	121	129

Tabela 3: Kampionimi për qytetin e Tiranës

Tirana përbëhet nga 11 njësi minibashkiake, të cilat kanë madhësi të ndryshme popullsie që jetojnë në të. Nuk mund të anashkalohej ky fakt nga ne dhe të bënim vetëm një kampionim të bazuar në numra që ruajnë proporcionet dhe jo të bazuar në zonat si është shpërndarë popullsia. Kjo gjë është e nevojshme sepse duke e shtrirë në çdo cep të Tiranës mund të kapnin shumë nga ata që janë bërë pjesë e Tiranës falë migrimit të brendshëm që përmendëm më lart. Pikërisht kjo për nevojën tonë që Tirana, në një farë mënyre, të na shërbejë si përfaqësuese e Shqipërisë. Për këtë arsye, brenda anketës është vendosur një pyetje, e cila i kërkon të anketuarit vendlindjen për të kuptuar nëse është nga Tirana ose jo. Ideja e kësaj pyetje nuk ishte të nxirrnim diferenca mes qyteteve dhe vlerave; kjo është e pamundur dhe nuk ishte qëllimi ynë; pse-ja e kësaj pyetje mund të na vërtetonte ose në të kundërt, të na hidhte poshtë, (kjo varet nga rezultatet) idenë tonë se në kryeqytet i gjejmë të gjitha subkulturat dhe në një farë mënyre na tregon se jemi duke folur për shoqërinë shqiptare dhe jo thjesht për Tiranën, gjë që do të dalë edhe nga rezultatet e anketimit.

Shpërndarjen sipas minibashkive e morëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në Tiranë. Duke parë shifrat, që na u vunë në dispozicion nga DPGJC, vumë re që numrat nuk përputheshin; sipas Censusit Tirana kishte më shumë banorë, kjo mund të ketë arsye objektive. Por diferenca nuk ishte e madhe dhe ne nuk na interesonin më shifrat, por proporcionet e njësive me njëra-tjetrën për t'i renditur ato dhe për të ruajtur në anketim. Në tabelën 3 ne paraqesim proporcionet e popullsisë në % sipas njësive bashkiake dhe numrin e të anketuarve të parashikuar prej nesh në secilën njësi.

Njësia	Renditja nga e madhi te më i vogli %	Numri i kampionimit ekzakt	Numri i kampionimit tek të anketuarit
5	13	32.5	33
2	12	30	30
4	10	25	25
6	10	25	25
7	10	25	25
11	10	25	25
9	9	22.5	22
1	8	20	20
3	8	20	20
8	6	15	15
10	4	10	10

Tabela 4: Proporcionet e minibashkive dhe numri i të anketuarve për secilën minibashki

Atëherë na mbetet që, për secilën njësi të bëjmë tabelën e saj të anketimit, duke bërë ndarjen në grup-mosha dhe në gjini dhe duke ruajtur këtu proporcionet që na jep Censusi për marrëdhënien mes grup-moshave dhe mes gjinive.

	Njësia 1, Total	M	F
15-24	5	2	3
25-34	4	2	2

35-44	3	1	2
45-54	3	2	1
55-64	3	2	1
mbi 64	2	1	1
Total	20	10	10

	Njësia 2, Total	M	F
15-24	7	3	4
25-34	5	2	3
35-44	5	2	3
45-54	5	3	2
55-64	4	2	2
mbi 64	4	2	2
Total	30	14	16

	Njësia 3, Total	M	F
15-24	5	2	3
25-34	4	2	2
35-44	3	1	2
45-54	3	2	1
55-64	3	2	1
mbi 64	2	1	1

Total	20	10	10
--------------	-----------	----	----

	Njësia 4, Total	M	F
15-24	6	3	3
25-34	5	2	3
35-44	4	2	2
45-54	4	2	2
55-64	3	1	2
mbi 64	3	2	1
Total	25	12	13

	Njësia 5, Total	M	F
15-24	8	4	4
25-34	6	3	3
35-44	5	2	3
45-54	6	3	3
55-64	4	2	2
mbi 64	4	2	2
Total	33	16	17

	Njësia 6, Total	M	F
15-24	6	3	3
25-34	5	2	3

35-44	4	2	2
45-54	4	2	2
55-64	3	1	2
mbi 64	3	2	1
Total	25	12	13

	Njësia 7, Total	M	F
15-24	6	3	3
25-34	5	2	3
35-44	4	2	2
45-54	4	2	2
55-64	3	1	2
mbi 64	3	2	1
Total	25	12	13

	Njësia 8, Total	M	F
15-24	4	2	2
25-34	3	1	2
35-44	2	1	1
45-54	2	1	1
55-64	2	1	1
mbi 64	2	1	1
Total	15	7	8

	Njësia 9, Total	M	F
15-24	5	2	3
25-34	4	2	2
35-44	3	1	2
45-54	4	2	2
55-64	3	2	1
mbi 64	3	2	1
Total	22	11	11

	Njësia 10, Total	M	F
15-24	2	1	1
25-34	2	1	1
35-44	2	1	1
45-54	2	1	1
55-64	1		1
mbi 64	1	1	
Total	10	5	5

	Njësia 11, Total	M	F
15-24	6	3	3
25-34	5	2	3

35-44	4	2	2
45-54	4	2	2
55-64	3	1	2
mbi 64	3	2	1
Total	25	12	13

Duke gjykuar mbi mënyrën e formulimit të pyetjeve që kishte anketa dhe duke gjykuar mbi gjatësinë e saj, u vendos që kjo mund të kryhej vetëm me anketues, të cilin duhet të dilnin në terren. Aq më tepër që edhe vetë Inglehart zgjodhi këtë metodë për anketimet e tij në shtetet që ka marrë në analizë. Zgjedhja e të anketuarve do të ishte rastësore në rrugë, por duke ruajtur grup-moshën dhe gjininë sipas asaj që ishte vendosur nga ne. Një proces i tërë trajnimi është zhvilluar me anketuesit që do dilnin të bënin anketën në terren. Nisur nga madhësia e anketimit, pra nga numri i anketave që do bëheshin dhe nga zonat në të cilat do të bëheshin u vendos që të përdreshin 50 anketues në terren.

Sipas shpërndarjes fillestare si më poshtë tabela 5:

Njësitë	Numri i anketuesve	Numri i anketave për secilin	Total
1	4	5	20
2	6	5	30
3	4	5	20
4	5	5	25
5	7	5	35

6	5	5	25
7	5	5	25
8	3	5	15
9	4	5	20
10	2	5	10
11	5	5	25
Total	50	5	250

Tabela 5: Shpërndarja e anketuesve dhe anketave

Duke qenë se duhet ta ruanim kriterin e shpërndarjes zonale, të grup-moshës dhe të gjinisë, nuk mund t'i lihej dorë e lirë që të pyetesh kush mund të dilte përpara në rrugë. Kështu, që për çdo anketues u përgatit tabela e tij e anketimit, duke i caktuar secilit, sa femra e sa meshkujt dhe se të cilës grup-moshë duhet të ishin. Më pas iu dha një hartë me zonën e tyre duke iu treguar rrugën që duhet të mbulonin anketuesit dhe kështu vetëm në atë hapësirë duhet ta kryenin anketimin. Trajnimi me grupet u bë në dy faza, duke shpjeguar gjithë detajet, duke ndarë kodet e anketuesve për secilin prej tyre dhe duke bërë prova të anketimit, ku ata u bënë në mënyrë të stimuluar dhe anketues dhe të anketuar duke kuptuar gjithë dinamikën që mund të hasnin në terren. Anketuesit u udhëzuan në trajnim, që të garantonin konfidencialitetin e të dhënave, faktin që ishin anonime, që kryenin në kuadër të një studimi universitar dhe nuk kishin lidhje me partitë politike. Për të shmangur sa më shumë mundësinë që njerëzit të gënjehen nga ndonjë frikë e mundshme.

Puna në terren vendosej nga ne dhe anketuesit duhet të dilnin ditën dhe në orën e caktuar, në këtë mënyrë grupi i kontrollit dilte dhe verifikonte në terren nëse ishin duke kryer anketën për të shmangur çdo lloj tundimi, për ta plotësuar vetë ose për të bërë truke të tjera që do të dëmtonin rëndë gjithë punimin tonë.

Pas punës në terren, puna jonë ishte hedhja e të dhënave në një sistem statistikor, që të ofron analizën për të cilën ne kemi nevojë. Për këtë arsye zgjodhën që programi ynë do të ishte SPSS që të ofron mundësinë e një analize shumë të mirë duke përdorur mjetin e frekuencës për të gjykuar profilin e shoqërisë për vlerat. Më pas në lidhjen që duhet të shqyrtojmë nëse ka ndryshim mes grup-moshave dhe vlerave mbijetesë- vetafirmim, përdorim instrumentin e tabelave të kryqëzuara. Kur ky instrument na nxjerr shoqërim mes dy variablave atëherë për të parë nëse ky shoqërim është sinjifikativ dhe jo thjesht rastësor, SPSS na ofron dy tabela me koeficientet *Chi square* (chi square tests) dhe *Phi and Cramers'V* (symmetric measures). Të gjitha këto instrumente janë mjete statistikore në shërbim të kërimit tonë.

Mbas hedhjes së të dhënave në këtë program, ishte me vend që të bëhej një proces check-in nëse të dhënat ishin hedhur të sakta apo mund të na ketë shpëtuar ndonjë gabim gjatë punës. Sistemi u kontrollua dhe çdo gabim i mundshëm u korrigjua duke bërë të mundur që hedhja e të dhënave të ishte tërësisht në respekt të asaj për të cilën ishin përgjigjur të anketuarit.

Pikërisht është kjo metoda ku ne bazojmë punimin tonë empirik, të cilin do ta testojmë edhe hipotezat e ngritura për studim. Mund të themi që metodologjia na jep mundësitë që të besojmë se kërkimi dhe punimi ynë do të jetë ngritur mbi baza të mira shkencore.

KAPITULLI III: STUDIMI TEORIK

3.1. Ç'janë vlerat?

Të flasësh për vlerat sot, është njëlloj sikur të flasësh për njerëzimin. Njerëzit në shoqëri, gjenden më shumë se kurrë më parë, përballë vetes së tyre, që do të thotë, me më shumë liri

në shumë aspekte, por mbi të gjitha në aspektin moral, të vlerave, të pambrojtur nga një ideologji e vetme (si ideologjia komuniste p.sh.) mund të gjenden para një oferte shumë të shumëllojshme. Njerëzit i kërkojnë vetë këto pikareference: këto janë vlerat (Vila Abadal, 1998:145). Është e rëndësishme të dalë në pah karakteri pozitiv që kanë vlerat (Camps, 1993:28) sepse ndihmon burrat dhe gratë të humanizohen.

Vlerat mund t'i quash vlera kur ato janë të vlerësuara, kur janë të lidhura me realizimin e asaj që quhet “ajo që duhet të jesh” (zu sein); “Ajo që duhet të jesh” perfeksionohet, dhe “realizohet” përmes disa aktiviteteve që lidhen me vlera të caktuara (Luypen,1967:252). Sipas Kluckhohnde vlerat rregullojnë “plotësimin e impulseve në përputhje me një seri objektivash hierarkikë dhe të qëndrueshëm të personalitetit, me kërkesën për rregullsi si nga ana e personalitetit, ashtu edhe nga sistemi socio-kulturor dhe nga nevoja për të respektuar interesat e të tjerëve dhe të grupit në lidhje e tyre me jetën sociale”(Sills, 1977:607)

Vlerat përfaqësojnë “përse” njerëzit jetojnë dhe tentojnë të orientojnë ekzistencën e tyre. Pa referenca të vlerat nuk ka gjëra të mëdha në të cilat qenia njerëzore mund të identifikohet. Natyra e vlerave, që identifikon njerëzit, ndryshon përherë në kohë dhe në hapësirë. Bëhet fjalë për vlera në një shoqëri të dhënë. Vlerat janë shenjat që japin dimension të plotë të realitetit dhe të situatave. Ato tregojnë mbi ekzistencën njerëzore në natyralitetin e tyre, me shoqërinë dhe kulturën. Vlerat ndërtojnë një ekuilibër për njerëzit, janë baza organizative dhe thelbësore për çdo shoqëri (Passet,1983:9-20). Vlerat nuk bazohen në konceptin

abstrakt të qenies, por në realitetin konkret të individit, si i ndërgjegjshëm, inteligjent dhe i lirë, për rrjedhojë për të qenë qëllimi i veprimeve të tyre në botë (Alfora, 1988:226).

Një vlerë është një marrje pozicioni e lidhur me çdo gjë, e eksperimentuar përmes sjelljes, ndjenjave, dijeve dhe veprimeve (Poletti, 1983:76). Taylor e përcakton si një besim personal që vepron si një normë për të ruajtur sjelljen (Taylor, 1989:59). Koncepti “vlerë” mund të përcaktohet si një mënyrë të qeni dhe të vepruari, që një person ose një komunitet e gjykojnë si ideale, që bëhet e dëshirueshme dhe e vlerësuar nga njerëzit ose nga sjelljet që i atribuohen një vlere të caktuar.

Koncepti vlerë ka bashkuar brenda vetes një sërë karakteristikash; vlera është një vendim ideal, në objekte dhe dije, që shërbejnë si frymëzim dhe referencë për një vend të caktuar moral, estetik ose intelektual; vlera përcakton cilësinë e të qenit, të asaj që aspirohet dhe të asaj që duhet të aspirohet; vlera është në brendësi të shoqërisë, duke u bërë pjesë e saj (Rocher, 1973:70). Vlerat janë në shërbim të jetës dhe jo jeta në shërbim të vlerave (Torralba, 2001:10). Sipas teorisë scheleriane vlerat janë esenca të dhëna apriori, të menjëhershme dhe intuitive të ndjenjave/ ndjesive shpirtërore dhe jo të inteligjencës. Janë fakte ose realitete të ofruara nga vetvetja, pra të vetofruara, pa deduktim ose arsyetim, prej intuitës së ndjenjave shpirtërore. Bëhet fjalë për realitete të pavarura: janë ato dhe asgjë më shumë se ato, pa asgjë nën ose përmbi veten (Derisi, Butz, 1975:57). Shelerit i përket pikëpamja se krahas rolit të arsyes, në përcaktimin e përparësisë së vlerave nga individi, një rol të rëndësishëm luajnë dhe emocionet. Kjo ndodh sepse sado të rëndësishme të jenë vlerat e grupit, vlera e një personi, e jetës së tij dhe përcaktueshmëria që i bën ai vetvetes

është e papërsëritshme në shoqëri, dhe vetë personi krijon një gjykim deri diku të vetin për rëndësinë ose parëndësinë e vlerave të veçanta, pavarësisht nga përkatësia e tij grupore. Pra jo në çdo rast ai përputhet me hierarkinë e vlerave të grupit të tij, megjithëse në parime kryesore vlerore mund të jetë i njëmendje me të. E këtu rolin kryesor, që krijon këtë ndryshueshmëri, e luajnë emocionet dhe ndjenjat, të cilat përjetohen krejt ndryshe në individë të ndryshëm (karakteret të ndryshme, pasione të ndryshme etj).

Njeriu është vendi ku lindin vlerat. Të gjithë njerëzit kanë disa vlera që i udhëheqin në mënyrë të vetëdijshme ose jo, dhe projekti individual ose kolektiv i jetës, dizenjohej përmes këtyre vlerave. Vlerat janë të lidhura me aspekte kulturore dhe me përvoja personale, megjithëse trajektoret e ndryshme personale, sociale ose profesionale dhe diferencat në informacionin e marrë nga gjithsecili, ndër të tjera çojnë në mospasjen e të njëjtit perceptim për botën. Një vlerë thelbësore është që njerëzit të njihen si pafundësisht njerëzorë (human) dhe ky është rezultati i shumës së vlerave autentike (Passet, 1983:24). Parsons mbështet atë që vlerat janë komponenti thelbësor i çdo sistemi social. Të vëzhgueshme ose jo, mund të ndërhyjnë në situatat dhe në përmbajtjen specifike që mund të dedukohen nga një studiues i kujdesshëm (Parsons, 1951).

Maslow vëren që vlerat janë parë si manifestime të tendencës së qenies njerëzore për të shprehur dhe realizuar potencialin e tij. Shton që koncepti i vlerave ka thelbin dhe vlefshmërinë e vet në natyrën e brendshme të qenies njerëzore dhe për më tepër vlerat mund të kuptohen vetëm duke marrë parasysh përvojën dhe ekzistencën që individët kanë për ndërveprimin me të tjerët dhe me veten e tyre (Maslow, 1958).

Një tjetër studiues, Williams paralajmëron që vlerat shërbejnë si kritere për të seleksionuar veprimet dhe përmbajnë elemente njohëse dhe një farë komponenti afektiv të karakterit seleksionues dhe drejtues (William, 1968). “Vlerat janë ato ‘gjëra’ për të cilat njerëzit janë të interesuar- gjëra të cilat ata i duan, dëshirojnë të jenë ose të bëhen, i ndiejnë si detyrime, i adhurojnë apo i kënaqin” (William, 1958:375) Marin i përcakton vlerat si një cilësi reale, e dëshirueshme për mirësinë e saj, që forca e tyre stimuluese orienton jetën njerëzore (Marin, 1976). Fierro dhe Carvajal nga ana e tyre i konsiderojnë që vlerat janë preferenca që i referohen mënyrave të sjelljes të dëshirueshme të bazuar tek zakonet (Fierro&Carvajal, 2003:18).

Gonzalez Lucini përcakton vlerat si një projekt ideal i sjelljes dhe i ekzistencës, që qenia njerëzore dëshiron dhe kërkon; janë mundësi individuale që përfitohen nga mundësitë aktive të vullnetit; janë besime që integrohen në strukturën e njohjes dhe janë karakteristika të veprimit njerëzor që lëvizin drejt sjelljes, orientojnë jetën dhe shënjojnë personalitetin (Gonzalez Lucini, 1990).

Për Carrerën esenca e vlerave është të jenë të vlefshme dhe të jenë të anuara nga ana objektive, pavarësisht nga vlerësimet subjektive individuale. Për këtë studiues vlerat janë të lidhura me vetë ekzistencën e njerëzve, ndikojnë sjelljen, konfigurojnë dhe modelojnë idetë e tyre dhe kushtëzojnë ndjenjat e tyre. Është diçka e ndryshueshme, dinamike që në dukje e kemi zgjedhur lirisht ndër alternativa të ndryshme (Carreras, 1997) .

Hernandez, i përcakton vlerat si preferencë për realitete-qëllime ose drejt sjelljeve që e kanë rrënjët në vlerësimin ose besimin e lidhur me shumicën ose disa nga llojet e efektivitetit. Sipas këtij autori vlerat përvetësohen dhe zhvillohen nga individët përmes procesit edukativ sidomos në rrethin familjar edhe shkollor, por edhe përmes grupit të shokëve dhe të influencës së mjeteve të komunikimit masiv. Shton që këto vlera ndërtojnë sistemin e përgjithshëm të vlerave të subjektit dhe që kanë një karakter situacional dhe dinamik që riinterpretohen në varësi të rrethanave. Na vë në dukje që çdo njeri dhe çdo shoqëri në një moment të caktuar tregohen autokritik ndaj sistemit të vet të vlerave dhe kjo lejon ndryshimin dhe perfeksionimin(Hernandez, 2009).

Nga ana e tij Villoro, në trajtimet e tij për vlerat, thotë që mund të kuptojmë për “vlerë” karakteristikat që një objekt ose një situatë mund të konsiderohet si një qëndrim i pëlqyeshëm. Dhe mbështetet që qëndrimi shtohet nga besimi i një elementi afektiv si pëlqimi ose mospëlqimi. Ky teoricien konsideron që tendenca afektive drejt një objekti i konsideruar me vlerë mund të përmbaj forma të ndryshme që nga një puls që të shtyn drejt objektit dhe nga kënaqësia pasive e prezencës së tij. Ai sintetizon që një vlerë është ajo që për çdo njërin i përgjigjet interesit të tij. Ky autor konsideron që një vlerë është një ndërtim multifaktorial, një besim që prodhon një sjellje të favorshme drejt një objekti ose situate me vlerë (Villoro, 1997).

Kurse një filozof tjetër i shekullit XX, nga më të rëndësishmit në këtë fushë, që bëri objekt refleksioni vlerat, Nikollai Hartman thotë: “Njeriu është një qenie që i përket njëkohësisht dy botëve, asaj reale, me ligjet e saj ontologjike dhe botës së vlerave që përbëhet nga

kërkesat për të bërë diçka. Te kjo e fundit një sjellje mund të konsiderohet e mirë apo e keqe vetëm kur ajo buron nga liria e mendimit dhe e veprimit" (Hartmann, 1965:267). Ka dy ide që duhen marrë në konsideratë në këtë thënie të Hartmanit së pari pohimi se vlerat në fakt përbëjnë një botë po aq të rëndësishme për jetën njerëzore sa dhe bota ontologjike, domethënë e qenies njerëzore me anën e saj materiale, me trupin, marrëdhëniet me mjedisin rrethues etj. Ashtu sikurse njeriu rritet brenda një bote sendesh, natyre e marrëdhëniesh me to, si dhe njerëzish të tjerë prezentë me qenien e tyre fizike, ai rritet edhe brenda një bote vlerash, që është jo më pak e rëndësishme sesa e para, dhe që formon shpirtin e tij po aq sa bota fizike. Në kuptimin e gjerë në këto vlera përfshihen traditat, kultura, gjuha, edukimi familjar, edukimi zyrtar, modelet e shoqërisë të ndikuara fuqimisht nga mediet etj. I gjithë ky konglomerat vlerash lë gjurmë në një mënyrë ose në një tjetër, në formimin e idealeve vlerore të tij. Së dyti në thënien e mësipërme të Hartmanit, por edhe në shumë pjesë të veprës së tij gjejmë të theksuar idenë se nuk mund të kemi vlera absolute përderisa vetë vlera është një formë e shfaqur e lirisë njerëzore, ne kemi të drejtë të zgjedhim atë çka përbën vlerë për ne. Në këtë kuptim mund të themi që nuk bëjmë dot gjykim vleror mbi individin ose shoqërinë, në rast se subjektit të gjykuar i mungon liria e mendimit dhe e veprimit.

Për Reimon Bachikën vlerat janë një nga dy komponentët kryesorë të kulturës, që sipas tij kishte si element simbolizmin dhe vlerat. Vlera sipas tij, është një përbërës ose një aspekt i veprimit individual ose kolektiv. Ai shprehet "Vlerat sociale janë produkt kryesor i përvojës së grupit. Ato janë të vlerësuara për kuptimin që i japin gjërave, veprimeve dhe lidhjeve të menduara si të domosdoshme dhe jetësore në përmbushjen e nevojave individuale dhe sociale të grupeve njerëzore" (Bachika, Schulz, 2011:114).

Sipas Adlerit koncepti i vlerave, edhe pse kompleks, mund të reduktohet në 4 tipologji bazike (Adler, 1956:272):

1. Vlerat konsiderohen si absolute, që ekzistojnë në mendjen e Zotit , si ide të brendshme, si vlefshmëri të pavarura etj.
2. Vlerat konsiderohen si qenie në objekt, materiale ose jo materiale.
3. Vlerat janë të parat të vendosura te njerëzit, dhe të lindura nga nevojat e tij biologjike ose nga mendja e tij. Njeriu me veten e tij ose njeriu i bashkuar me të tjerë, këtu kuptojmë si grup, shoqëri, kulturë, shtet, klasë, duket se është “mbartës” i vlerave.
4. Vlerat janë barazuar me veprimin.

Dhe për më shumë mund të gjejmë disa lloje mikse.

Lloji i parë, ai i absolutizmit, gjendet mes mendimtarëve universalist ose realist, dhe së pari tek sociologjikët katolikë dhe në punimet e Pitirim A. Sorokin. Ashtu si Furfey që përcakton vlerat: “Cilësia e njohur si e dëshiruar që gjendet te mirësia”. Mirësia është absolute. Sidomos njerëzit mund ta njohin atë (Adler, 1956:272). Një shembull i llojit të dytë mund të shërbejë përcaktimi i dhënë nga Park dhe Burgess: “Çdo gjë që na jep mundësinë për të qenë e dëshiruar është një “vlerë”. Pra që ka një farë cilësie që ndonjëherë, në ndonjë vend, disi mund të dëshirohet nga dikush (Adler, 1956:273). Vlerat e llojit të tretë janë të paaksesueshme nga metodat e shkencave natyrore, janë si gjendje dijesh të lidhura me fenomene mendore dhe emocionale (Adler, 1956:275). Sipas këndvështrimit të llojit të 4-ërt vlerat barazohen me veprimin, kjo mbështetet nga mendimi që, çfarëdolloj gjëje që një person bën është çfarë ai do, dëshiron, të bëjë nën rrethana të

dhëna, në një kohë të dhënë. Çfarë ai nuk bën është ose sepse ai nuk dëshiron që ta bëjë ose që nuk e do aq fuqishëm që ta bëjë sa të motivohet mjaftueshëm për ta bërë në një rrethanë të dhënë, në një kohë të dhënë (Adler, 1956:276).

Një nga autorët më të rëndësishëm, të cilin do ta marrin në shqyrtim edhe për teorinë e tij të vlerave është Shalom Schwartz. Tek ai gjejmë idenë se secili nga ne mbart një numër vlerash (p.sh. siguria, arritja, mirësia) me ndryshim mase dhe rëndësie. Një vlerë e veçantë mund të jetë shumë e rëndësishme për një njeri, por e parëndësishme për dikë tjetër (Schwartz, 2006). Ai përshtat një konceptim të vlerave në 6 parime kryesore që gjenden edhe te shkrimet e shumë teoricienëve të tjerë :

1. Vlerat janë besime të dizenuara në mënyrë të pashmangshme për të ndikuar personin. Kur vlerat aktivizohen, ato ndërthuren edhe me ndjenjat. Dhe bëhen shumë formëzuese të sjelljeve tona. Njerëzit për të cilët pavarësia është një vlerë e rëndësishme ndihen të bezdisur kur pavarësia e tyre mund të kërcënohet, zhduken në rast se nuk arrijnë ta mbrojnë dot dhe janë të lumtur në rast se e gëzojnë atë.
2. Vlerat i referohen qëllimeve të dëshiruara të cilat më pas motivojnë veprimin. Njerëzit për të cilët drejtësia, e vërteta, janë vlera të rëndësishme janë të motivuar që t'i ndjekin këto edhe si objektiva.
3. Vlerat tejkalojnë veprime dhe situata specifike. Bindja dhe ndershmëria, për shembull, janë vlera që mund të jenë rëndësishme në punë, në shkollë, në sport, në biznes, në politikë, me familjen, me shokët, me të huajt. Kjo veçanti e dallon vlerën nga koncepte të tjera si norma apo sjellja që zakonisht i referohen veprimeve, objekteve dhe situatave specifike.

4. Vlerat shërbejnë si standarde ose si kritere. Vlerat drejtojnë seleksionimin dhe vlerësimin e veprimeve, politikave, njerëzve dhe ngjarjeve. Njerëzit vendosin çfarë është e mirë ose e keqe, e pranueshme dhe jo e pranueshme, të bazuar në ndërgjegjen e vlerave të tyre të dëshiruara. Por impakti i vlerave në vendimet e jetës së përditshme rrallë është i ndërgjegjshëm sepse vijnë natyrshëm. Vlerat dallohen qartësisht kur veprimet ose gjykimet, që individi duhet të ndër marrë, paraqesin implikime konfliktuale mes vlerave të ndryshme që ai përkrah.
5. Vlerat janë të renditura në bazë të rëndësisë që kanë njëra me tjetrën, në bazë të subjektit gjykues. Vlerat e njeriut formojnë një sistem të rregulluar me përparësi vlerash që e karakterizojnë atë si individ. A i japin ata më shumë rëndësi arritjeve apo drejtësisë, risisë apo traditës? Kjo hierarki përcakton gjithashtu një dallim tjetër mes vlerave dhe normave apo qëndrimeve.
6. Rëndësia relative që vendosim mes shumësisë së vlerave që udhëheqin veprimet. Çdo qëndrim apo sjellje tipikisht implikon më shumë sesa një vlerë. Për shembull, ndjekja e shërbimeve kishtare mund të shprehë disa vlera: traditën, konformitetin, sigurinë, apo hedonismen etj. (Schwartz, 2006:3-4).

3.2. Vlerat sipas aksiologjisë filozofike

Kush janë karakteristikat esenciale të vlerave sipas një refleksioni filozofik? Jose Ferrater Mora, që ka hartuar enciklopedinë filozofike, duke e quajtur fjalor filozofik, na jep një përcaktim që “ka qarkulluar shumë” dhe që, në një farë mënyre, tregon se ka gëzuar më shumë konsensus se të tjerat dhe është edhe përcaktimi që ne më poshtë do ta shpjegojmë

sipas 6 karakteristikave bazike. Vlerat do të kishin këto karakteristika që ne edhe i trajtojmë në formën tonë të të konceptuarit:

1. Vlefshmërinë. Filozofët kanë dashur të përcaktojnë çfarë lloj realiteti i përkasin “cilësitë e vlerave”. Duke qenë cilësi, nuk janë “objekt i një ekzistence fizike” (të quajtura objekte reale në gjuhën filozofike). Por ato dallohen po ashtu edhe nga objektet abstrakte, që i vishen botës së ideve (objekte të ekzistencës ideale të ashtuquajtura objekte ideale). A do të jenë atëherë objekte të lidhura me ndjeshmëri dhe ekzistenca emocionale? Shumë filozofë besojnë se jo; sipas tyre janë entitete që gëzojnë një lloj tjetër ekzistence “vlefshmërinë”. “Mirësia, bukuria, shenjtëria, nuk janë gjëra reale, por edhe më pak entitete ideale. Objektet reale arrijnë të përcaktohen nga shumë faktorë që lidhen me hapësirën, kohën, shkakësinë etj. Objektet ideale janë të pakohshme. Vlerat po ashtu nuk kanë një parametër kohor të përcaktuar dhe për këtë arsye ndonjëherë janë ngatërruar me idealizmat, por forma e tyre e realitetit nuk është qenia ideale, as qenia reale, por qenia e vlefshme. Realiteti i vlerave është vlefshmëria” (Ferrater Mora, 1964:290).

2. Objektiviteti. Vlerat janë realitete objektive apo subjektive? Ky ka qenë diskutimi që ka ndarë refleksionet filozofike dhe që ende nuk është zgjidhur. Ky diskutim është kthyer tashmë në diskutim universal, siç është ndarja mes realistëve dhe nominalistëve edhe pse kësaj herë i aplikuar për vlerat dhe jo për idetë. Ferrater Mora na tregon që kjo çështje edhe pse e vjetër në diskutime nuk rezulton e zgjidhur. Kemi dy polet ekstreme mes “realizmit” (objektiviteti) dhe “relativizmit” (subjektiviteti) i vlerave. Njëri që mbron realizmin ekstrem të vlerave, që i shikon si entitete platonike që ekzistojnë brenda sferës metafizike të realitetit. Vlerat janë më shumë sesa thjesht një reagim thjeshtësisht subjektiv. Reagimi vleror i një subjekti i përgjigjet diçkaje që është e jashtme nga ai vetë

dhe që ekziston pavarësisht personit të tij. Ndërsa tjetri ai i relativizmit të vlerave, beson se vlerat janë një fenomen që varen nga subjektiviteti i njerëzve. Ky subjektivitet apo faktor personal nëse duam ta quajmë, manifestohet në reagimet pozitive apo negative përballë një objekti: pranim ose mospranim, tërheqje ose shtyrje, dëshirim ose refuzim. Teoria relativiste e vlerave “mbështet që veprimet e pëlqimit ose të mospëlqimit janë thelbësore për vlerat” (Ferrater Mora, 1964:290). Që do të thotë që vlerat gjykohen si pasojë e këtij perceptimi afektiv.

3. Jopavarësia. Kjo karakteristikë është shumë interesante. Vlerat janë një cilësi e një objekti, një përcaktues, ose një atribut i tij. Por çfarë lloj cilësie apo atributi? Nuk e dimë, por tentojmë ta nxjerrim thotë Mora, nga gjithë karakteristikat e tjera që i japim vlerave (Ferrater Mora, 1964:290).

4. Polariteti. Vlerat na shfaqen përherë ndërmjet polaritetit. Ka një ekzistencë të çdo gjeje si në aspektin pozitiv ashtu dhe në atë negativ: “Vlera e bukurisë vihet përballë shëmtisë, ajo e mirësisë me keqdashjen, e shenjtja me profanen” (Ferrater Mora, 1964:290) Pra vlera është një cilësi që ka karakteristika, të cilat mund të shfaqen vetëm në formën polare, që do të thotë një formë pozitive dhe një formë negative. Çdo vlerë pozitive do t’i korrespondonte një vlere negative ose një mosvlere. Karakteristikë kjo që nuk e gjejmë dot tek entitetit e tjera të ndryshme nga vlerat.

5. Cilësi e mirëfilltë. Mora pohon që vlerat janë tërësisht të pavarura nga sasia dhe se nuk mund të përcaktojmë marrëdhënie sasiore midis vlerave (Ferrater Mora, 1964:290). Megjithatë nuk mund të lëmë pa përmendur që ndryshe nga filozofia, në aspektin sociologjik, sociologu Tarde nuk bie dakord me këtë qëndrim. Me të drejtë për sociologun karakteristikë kyçe e vlerave është që mund të krahasohen me njëra-tjetrën si në shkallë

cilësore apo sasiore, duke qenë motor i krahasimit për rëndësinë që i japin njerëzit në jetën e tyre të përditshme, në sjelljet e tyre (Tarde, 2010). Vlerat atëherë mund të krahasohen mes tyre dhe të vihen në një rend shkallëzues për nga rëndësia. Ka situata më të drejta sesa të tjerat, ka njerëz më zemërgjerë sesa të tjerët, ka teori më të vërteta sesa të tjerat. Pra, në një farë mënyre, për çdo vlerë të zgjedhur mund ta krahasojmë atë rast pas rasti, person pas personi, shtet pas shteti. Mendoj se ky këndvështrim shkon më përshtat edhe me idenë që na paraqitet filozofikisht për polaritetin e vlerave, që do të thotë, në një farë mënyre, që ekziston një shkallë lineare e cila kalon nga pozitivja te negativja.

6. Hierarkia e tyre. Në logjikën e shpërmendur të krahasimit të vlerave mund të kuptohet fare mirë edhe pozicionimi hierarkik i tyre. Pra vlerat mund të jenë mes të të njëjtave kategori të krahasuara që do të thotë njeri më besnik, njeri më pak besnik, shoqëri e besës së dhënë, shoqëri më pak e besës së dhënë. Por mund të jenë edhe objekt i hierarkisë së vlerave të ndryshme, që do të thotë kush qëndron më lart në një konflikt vleror midis së vërtetës dhe mirësisë? Duke ndërtuar kështu një shkallë vlerash ose një hierarki vlerash. “Mbështetësit e pozicionit objektivist të vlerave (realistët) kanë dashur të ndërtojnë shkallë hierarkike vlerash të pandryshueshme që duhet të njihen dhe të respektohen. Ndërsa ata që mbështesin pozicionin subjektivist e shohin këtë shkallë hierarkike si karakteristike tërësisht personale të çdo individi dhe që kanë një ndryshueshmëri nga individi në individ” (Ferrater Mora, 1964:290). Megjithatë e rëndësishme, pavarësisht nga dyja pozicionimet, është se bihen dakord që vlerat kanë një hierarki përzgjedhëse mes lloje të ndryshme dhe brenda llojit.


3.3. Vlerat përballë nevojave, normave, personalitetit, besimeve.

Përpara se të mund të përmbledhim karakteristikat e vlerave nisur nga ato çfarë studiuesit më të rëndësishëm na ofrojnë si koncepti vlerë, është mirë që të mund të themi nga dallon dhe ku mund të ngjajë me koncepte të tjera të ngjashme që po ashtu lidhen me moralin dhe me sjelljen e njeriut.

Le ta fillojmë me marrëdhënien midis vlerave dhe nevojave në shoqëri. Masllow zhvilloi idenë e tij që motivet bazike njerëzore formojnë një hierarki, dhe tregon që nevojat e çdo niveli duhet të plotësohen para se të plotësohen ato të nivelit pasardhës të çdo individ.

Në këtë hierarki, nevojat shkojnë që nga ato biologjike dhe deri tek ato për vetrealizim-zhvillim i kapaciteteve. Teoria e Masllow-it është ndërtuar përreth një piramide në të cilën duhen plotësuar nevojat bazë përpara se të plotësohen nevojat e tjera. Për te njeriu ka që në lindjen e tij forca për t'u zhvilluar, që do të thotë tendencën për vetrealizim. Ai paraqet kështu edhe strukturën e shkallëzuar të vlerave. Mbështet që vlerat dhe nevojat ruajnë një marrëdhënie evolutive dhe hierarkike. Në përputhje me një renditje të forcës së përparësisë vlerat renditen në mënyrë hierarkike dhe shkojnë nga më baziket te më të elaboruat. Ky autor vë në bazë të piramidës nevojat dhe motivimin e njeriut për të mbijetuar, të cilat përfshijnë nevojat fiziologjike si edhe ato të sigurisë.

Në shkallën tjetër vë nevojën për përkatësi “të jesh i pranuar dhe të të duan” dhe vetëvlerësimi “të marrësh pranim dhe njohje”. Në shkallën më lartë vë nevojën për rritje personale dhe vlerësimin estetik “shijimi i rregullit dhe i bukurisë”, më pas nevojat për vetërealizim që është shprehja e potencialit të gjithsecilit dhe e potencialit të identitetit.



Skema 1: Piramida e nevojave, Masllow

Sipas Inglehart-it njeriu përqafton vlerat e ndryshme në bazë se në cilën fazë të piramidës së Masllow ndodhet individi dhe shoqëria. Pra na paraqet në këtë mënyrë një lidhje mes vlerave dhe nevojave. Ashtu siç do ta sqarojmë edhe më gjerësisht më vonë teorinë e tij, Inglehart, i inspiruar nga kjo ide e Masllow, në fillimet e teorisë së tij mbi vlerat, ku zhvilloi idenë që mirëqenia ekonomike pas Luftës së Dytë Botërore në shoqëritë industriale do të prodhonte edhe një ndryshim progresiv në lidhje me përparësitë vlerore, që do kishin njerëzit, duke i bërë ata që të kalonin në vlera më postmaterialiste, të vetafirmimit dhe të

vetërealizimit personal. Ai shprehet: “fakti që nevojat fiziologjike të paplotësuara marrin përparësi përpara nevoja sociale, intelektuale, estetike është demonstruar shumë shpesh në historinë njerëzore: njerëzit që vuajnë urinë do të bëjnë gjithçka për të garantuar ushqimin” (Inglehart, 1997:33)

Vlerat dhe personaliteti janë dy gjëra të ndryshme dhe në të njëjtën kohë edhe të ndërlydhura (Lewis, 1998:34). Vlerat mund t’i quajmë si mjete ideale të ekzistencës drejt së cilës drejtohet përzgjedhja njerëzore dhe për rrjedhojë edhe ajo për të cilën besohet. Pra futen në fushën e ndërtimit të personalitetit të individit, në atë që beson që është e drejtë, e padrejtë, e mirë apo e keqe. Nga ana tjetër mbasi formohet personaliteti, ky i fundit ndikon individin në mënyrën sesi i zgjedh vlerat, sesi vendos hierarkinë e tyre në përdorim që ju bëjnë në situata të ndryshme në të cilën ndodhen gjatë jetës.

Mes vlerave përfshihen përparësitë, interesat ose shqetësimet që influencojnë në sjelljen individuale dhe kolektive, jo vetëm ato që verbalisht njihen si vlera. Brenda kësaj qasjeje vlerave u takon që të kenë një kuptim shumë të ndryshueshëm sepse përparësitë, interesat dhe shqetësimet ndryshojnë shumë shpejt, çdo moment mund të themi. Po a ndryshojnë vlerat kaq shpejt? Jo absolutisht, ato nuk ndryshojnë kaq shpejt. Vetëm në afatgjatë interesat, përparësitë dhe shqetësimet mund të influencojnë mbi vlerat. Pra nuk duhet t’i mendojmë si shqetësime të tilla si: nëse do të ndizet makina nesër në mëngjes apo jo, se ka bërë ftohtë gjatë natës, e të tjera, por si shqetësime më afatgjata që shoqërojnë ekzistencën e njeriut.

Po ashtu ia vlen të diskutojmë lidhjen mes vlerave dhe normave, ku mendohet se kemi një marrëdhënie shumë të ngushtë. Ka autorë që i barazojnë ato, siç mund të përmendim Sorokin që shprehet: “Çdo kuptim në një farë mënyre është një vlerë. Çdo vlerë presupozon një normë drejtimi që i referohet realizimin të saj ose mospranimi. Nga ana tjetër çdo normë është domosdoshmërisht një kuptim dhe një vlerë pozitive ose negative. Prandaj termi “kuptim”, “vlerë”, “normë” mund të përdoret në mënyrë të shkëmbyeshme me njëra -tjetrën për të shënuar një klasë të përgjithshme të të dhënies kuptim fenomeneve, dhe mbivendosjes së pasurisë biofizike të njerëzve dhe objektet, veprimet dhe ngjarjet” (Sorokin, 1947: 47) Por në fakt normat dhe vlerat dallojnë nga njëra-tjetra dhe e shohim me vend që ta sqarojmë këtë ndryshim. Normat konkretizojnë vlerat tona në terma praktikë; dhe këto vlera nga ana e tyre justifikojnë këto norma. Normat procedojnë nga zakonet, traditat dhe sistemi i vlerave të elaboruara në mënyrë progresive brenda një grupi social të caktuar. Nëse do të na mungonin vlerat do ta kishim shumë të vështirë të vendosnim norma në shoqëri. Një person nuk mund të pranojë dhe të zbatojë normën “kurrë mos gënje” nëse për të gënjeshtër nuk është vlerë negative, por përkundrazi për të është vlerë pozitive.

Vlerat janë besime që integrohen në strukturën e njohjes. Janë diçka e përfituar, që kërkon procesin e të mësuarit të bazuar në njohjen dhe në refleksionin, deri në pikën sa kthehet në një zakon, diçka të dëshiruar për vullnetin, që përfundon duke qenë vetë objekt i dëshirave. Ky dimension i vlerave, që lidhet me besimin na paraqet një element esencial: që besimi (për t’u mos u ngatërruar me fenë) nuk është rezultat i një verbërie ose mungesë refleksioni, por krejt e kundërta, besueshmëria dhe besimi drejt asaj që beson themelohet dhe mbështetet në njohje.

Nëse vlerat do të transmetoheshin përmes një procesi të manipuluar dhe jorefektiv, mund të qëndrojnë në dukje të pranuar nga personi që i thith- një pranueshmëri e nënshtruar ose jo e ndërgjegjshme- por prania e tyre do të jetë thjesht epidemike, jo e qëndrueshme dhe nuk do të implikojë modifikimin e sjelljes. Që vlerat të bëhen pjesë e personalitetit është e nevojshme që të na paraqiten dhe të na zbulohen përmes një procesi dinamik të perceptimit, brendësimit dhe analizimit; proces nga i cili do të vijë në mënyrë të lirë dhe të ndërgjegjshme pranimi i vlerave si besim ose refuzimi i tyre. Njohje, refleksion, mendim, besime dhe vlerat janë elemente të një realiteti që nuk mund të ndahen nga njeri- tjetri dhe që shkrihen në zhvillimin e dinamikës së sjelljes.

Një dallim interesant në lidhje me vlerat dhe posaçërisht me vlerat demokratike, na vjen nga Theodore Kaltsounis, që e shqyrton atë duke i vënë përballë konceptet parime demokratike dhe shprehi demokratike. Ai bën një listë të parime demokratike, të shprehive demokratike dhe të vlerave demokratike. Parime demokratike liston, udhëheqje e shumicës duke mbrojtur pakicën, miratimi i atyre që na qeverisin, qeverisja është e kufizuar, shoqëri e hapur, dinjiteti njerëzor dhe paprekshmëria e individit, sundimi i ligjit dhe procesi i drejtë gjyqësor (Kaltsounis,2013:67-68). Te shprehjet demokratike liston dialogu racional, peshimi i pozicioneve dhe zgjidhjeve alternative, kompromisi, përshtatja me situatat e reja dhe qytetaria (Kaltsounis, 2013:72-73). Ndërsa te vlerat e demokracisë ai liston të drejtat e njeriut për çdo individ, e mira e përbashkët, drejtësia, barazia, diversiteti, e vërteta dhe transparenca, patriotizmi i arsyeshëm (Kaltsounis, 2013:69-70). Edhe këtu dallohet qartë që

vlerat përbëjnë në vetvete besime dhe synime madhore dhe jo procedura të thjeshta të një sjelljeje korrekte, qoftë kjo edhe sjellja demokratike.

3.4. Vendosja hierarkike e vlerave

Ekzistojnë shkallë në një hierarki të vlerave: ekzistojnë vlera superiore dhe të tjera, që herë pas herë mund të sakrifikohen për të plotësuar të parat. Përherë një nga perspektivat e filozofisë ka qenë përqendrimi në arritjen dhe në domethënien e vlerave; kjo ishte aksiologjia. E gjejmë gjatë gjithë historisë së mendimit, por Max Scheler (1916) e ka trajtuar në formën specifike. Në fakt aksiologjia është një teori metafizike dhe morale që merret me investigimin e natyrës së vlerave ashtu si dhe me ndërlidhjen e saj me mendimin dhe me sjelljen njerëzore, duke vendosur një hierarki mes tipave të ndryshëm të vlerave dhe duke tentuar të fiksojnë kriteret për këtë diferencim.

Duke lexuar mendimin e Parsons-it (1951), por edhe të Kluckhohn-it (1951) bihet dakord në pohimin se çdo individ apo shoqëri ka një perceptim hierarkik të botës, që manifestohet në mënyrat e ndryshme të të vepruarit. Për Kohlberg-un (1984) gjithmonë është më e dëshiruar që individ të arrijë një etapë superiore dhe për këtë vendos një hierarki të arsytimit moral. Por hierarkia e vlerave lëviz edhe ndryshon në funksion të kontekstit dhe të momentit, që mund ta themi me një shprehje të perifrazuar nga Frondizi (1992), i cili thotë se është më e lehtë të pohosh ekzistencën e një rendi hierarkik të vlerave sesa të shenjosh konkretisht kush është ky rend apo të tregosh kriteret e vlefshme që të lejojnë ta përcaktosh.

Duke pasur në ndërgjegje se ekziston një hierarki vlerash dhe që personat veprojnë konform saj ne mund të kuptojmë se kur ekziston një situatë konflikti mes vlerash, ai do të për zgjedhë atë që e konsideron më superiore. Ashtu siç duhet të jemi të bindur që zgjedhja e vlerave bëhet rast pas rasti, sa herë që njeriu vepron dhe ndërvepron me botën.

3.5. Karakteristika të vlerave.

3.5.1. Vlera si “projekte ideale”

Fjala “vlerë” ka marrë një përdorim të gjerë dhe një lloj prestigji, aq shumë sa nuk mund të mos vëmë re sesa edhe në televizionet shqiptare, por edhe në medime të ndryshme flitet herë pas herë për “krizë vlerash” dhe për “ndryshim vlerash”. Kujtojmë që Kushtetuta jonë në preambulën e saj flet për vlerat dhe niset nga premisa e këtyre vlerave për të ngritur ligjshmërinë në një vend dhe bazën e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve. Preambula e Kushtetutës sonë thotë: “Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet

kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit” (Ligji Nr.8417, datë 21.10.1998). Nga sa më lart ne kuptojmë qartësisht që mbi vlerat është formëzuar një projekt ideal sesi e duam Shqipërinë, dhe më pas janë vendosur nenet e Kushtetutës në frymën dhe plotësimin e këtyre vlerave.

Në rastin e shoqërisë projekti ideal është më i lehtë të formulohet dhe të jetë aty në trajtën e vlerave siç folëm për Kushtetutën tonë. Por në rrafshin personal është e rëndësishme të ndash lidhjen e ngushtë që ekziston midis “vlerave” dhe “projektit të jetës”. Për qenien njerëzore vlen (për rrjedhojë është një vlerë) ajo që ai dëshiron dhe kërkon në funksion të nevojave të tij, që do të thotë, në funksion të asaj që është dhe të asaj që ëndërron ose dëshiron të jetë. Kjo na çon në logjikën që vlerat dhe identiteti janë dy realitete të pandashme.

Duke u nisur nga ajo që personi është dhe mbi të gjitha edhe nga ajo që njeriu projekton si të ardhmen e tij të dëshiruar, ai vlerëson dhe përthith në mënyrë objektive ose subjektive ato vlera që lehtësojnë ose lejojnë realizimin e projektit të tij për jetën. Në të njëjtën mënyrë, ky njeri do të zhvlerësojë dhe do të refuzojë si vlera ato që i konsideron në mënyrë objektive ose subjektive si pengesa ose ndalesa të impulseve të nevojave dhe dëshirave të tij.

Nëse rrënjët bazike të identitetit dhe po ashtu të vullnetit të një qenie njerëzore drejtohen drejt një projekti, për shembull, dëshirës dhe kërkesës për “të pasur më shumë” si bazë e lumturisë, kjo do të bëjë që te ai të formësohen si vlera, që qëndrojnë mbi të tjerat, paraja,

ndenja e pronësisë, konsumi, pagesa e punës, etj. Në të kundërt do të jenë objekt i refuzimit të tij, ose të paktën të vlerësimit si vlera të dorës së dytë: bujaria, solidariteti, e mira e përbashkët, etj.

Nëse nga ana tjetër qenia njerëzore drejtohet drejt projektit, që lidhet për shembull me dëshirën dhe me kërkesën për të “qenë më shumë”, në takimin dhe në lidhjen afektive me botën dhe me njerëzit e tjerë si bazë e lumturisë njerëzore, do të bëjnë që të formësohen tek ai si vlera: vëllazëria, komunikimi ndërpersonal, paqja, t’iu jepej të tjerëve, solidariteti etj. Për rrjedhojë do të jenë objekt i refuzimit të tyre vlera të tilla si: individualizmi, egoizmi dhe mungesa e solidaritetit.

Nëse jeta për dikë është realitet i dhënë, që lidhet me vazhdimësinë e kohës, pa asnjë mundësi surprizimi, të papriture, transformimi apo aventure, alternativa se kush do të jenë vlerat e tij është e qartë: është kapja mbas materializmit, si e vetmja rrugë për lumturinë. Nëse në të kundërt, zbulon dhe e ndien jetën si një hapje e përditshme dhe e përhershme drejt horizonteve të palimituara dhe të mbushur me mundësi gjithmonë të reja, nëse për të jeta është të “jepesh me iluzion dhe pa rezerva për lindje dhe rilindje të përhershme” në këtë rast do të jetë i lumtur në masën që ndihet protagonist dhe krijues i historisë së tij- i së ardhmes së tij- dhe gjithmonë do të besojë më shumë shpresën. Shpresa sjell me vete vlera të tilla si : mundimi dhe sforcimi, besimi, përgjegjshmëria, dhe deri te sakrificat nëse do të ishte e nevojshme.

Për këto arsye, një nga çelësat e zgjedhjes personale drejt vlerave gjendet te projekti i vetërealizimit individual, që çdo qenie njerëzore e bën për veten e tij dhe për jetën e tij, që lidhet gjithfarësoj me mënyrën me përgjigjen që gjithsecili i jep pyetjes : “Kush është rruga drejt lumturisë sime?” Lumturia, identiteti, projekti i jetës, idealet dhe vlerat janë për rrjedhojë realitete të ndërlidhura dhe të pandashme.

3.5.2.Vlera si mundësi zgjedhjeje

Vlerat janë elemente strukturore të njohjes njerëzore që individi i përdor në përditshmërinë e tij si pikëreferimi në ndërveprimin e tij me të tjerët. Për më tepër, janë zgjedhje personale që përfitohen nga mundësitë aktive që ka vullneti njerëzor.

Vlerat ashtu siç kemi thënë, janë shprehje të disa idealeve, të disa dëshirave që jetojnë dhe mbështeten te vullneti; prej kësaj mund t'i përcaktojmë po ashtu si rezultat i një zgjedhjeje të lirë, personale ndër format e ndryshme të jetesës dhe të veprimit. Janë një zgjedhje e qartë drejt asaj që na intereson më shumë, që implikon nga ana e saj, refuzimin e ndërgjegjshëm të alternativave të tjera. Ky perceptim i vlerave, ose i përshkallëzimit të vlerave, si rezultat i një zgjedhjeje të lirë dhe personale, na çon në paraqitjen e dy çështjeve thelbësore.

E para: Të përzgjedhësh do të thotë të kesh mundësi të zgjedhësh një rrugë ndër shumë të ndryshme. Që kupton se aftësia për të zgjedhur rritet me masën që individi zotëron alternativa dhe rrugë të reja për të zgjedhur. Kjo nënkupton që vlerë mund të klasifikojnë kur njeriu ka pasur mundësinë të bëjë një përzgjedhje dhe nuk mund të gjykojmë mbi vlera

vetëm kur është një zgjedhje e mundshme për jetë a vdekje e njeriut që gjykon (prandaj është gjithnjë e domosdoshme të ndajmë vlerën nga nevoja, sjelljen e motivuar dhe të bazuar në vlera personale dhe sjelljen e motivuar nga nevoja për të mbijetuar).

E dyta: Të përzgjedhësh është gjithashtu të dish të zgjedhësh rrugën më koherente me atë që njeriu pret dhe dëshiron të arrijë si qëllim; të rrezikosh të jetosh dhe të sillesh në një formë të caktuar duke hequr dorë nga forma të tjera të të jetuarit dhe të sjelljes.

Vlerat, si rrjedhojë, duke qenë disa zgjedhje preferenciale, hyjnë plotësisht në dinamikat e lirisë dhe të riskut, të hapjes së vazhdueshme të horizonteve të reja dhe të mospranimi të atyre hapësirave që limitojnë lirinë. Që do të thotë gjykimi mbi vlerat, ngrihet vetëm në masën që individët gëzojnë lirinë e tyre për të vepruar dhe për zgjedhur vetë brenda mundësive që u paraqiten. Një shoqëri ku individët nuk kanë mundësi për të përzgjedhur dhe nuk kanë lirinë për të vepruar është e pamundur të flasësh për vlera. Atë shoqëri mund ta gjykosh si me vlera të imponuara nga lart, por njëkohësisht e ke të pamundur të flasësh nëse ato mund të quhen vërtet vlera. Sepse vlerat janë zgjedhje preferenciale personale. Për këtë arsye mund të themi se shoqëritë totalitare promovojnë dhe flitet për antivlera sepse bëjnë të kundërtat e asaj që supozojnë vlerat në shoqëri, siç ishte komunizmi te ne.

Fakti që i përcaktojmë vlerat si zgjedhje personale nuk do të thotë që nuk flasim dot për vlerat e një shoqërie. Preferencat për një gjë apo një tjetër, për të ndjekur një qëllim a një tjetër, për të ndërtuar profilin jetësor, që dëshirojnë, vijnë si rezultat i një përzierje faktorësh të cilët ndikojnë në marrjen e vendimit. Nga këta faktorë mund të përmendim: familjen,

sistemin e edukimit shkollor, miqtë, traditën, figura të rëndësishme me prestigj, informacionin, përvojat personale, interesat, nevojat dhe temperamentin personal etj.

3.5.3. Vlera si “karakteristikë të veprimit njerëzor”

Për sa i përket perspektiva morale, vlerat shërbejnë për të çuar në përfundim një aktivitet ose një gjykim. Vlerat janë ndërvepruese në veprimin njerëzor dhe mobilizuese të sjelljes, orientojnë jetën dhe shenjojnë personalitetin. Jeta e secilit prej nesh përcaktohet në funksion të vlerave që zgjedhim. Aristoteli thoshte se shkaku final është shkaku i parë i të gjitha shkaqeve. Janë objektivat tonë që duam të arrijmë, qëllimet tona ato që përcaktojnë jetën tonë.

Vlerat nuk janë abstraksione ose spekulime shpirtërore dhe teorike, në të cilat njerëzit besojnë në periferi ose në paralele me përvojën e tyre të përditshme; aq më pak nuk janë utopi të përealizueshme që ndërkohë vazhdojnë si të tilla, justifikojnë ekzistencën. “Vlerat sociale janë produkt kryesor i përvojës së grupit. Ato janë të vlerësuara për kuptimin që i japin gjërave, veprimeve dhe lidhjeve të menduara si të domosdoshme dhe jetësore në përmbushjen e nevojave individuale dhe sociale të grupeve njerëzore” (Hertzler, 1946:310). Vlerat janë instrumente ose realitete të prekshme, referenciale dhe të rëndësishme për jetën.

Të gjitha vlerat kanë disa elemente njohëse; ato kanë një karakter selektiv dhe drejtues-sjelljesh, sipas Rokeach (1973) që implikon edhe disa elemente afektive. Njerëzit përkrahin disa gjëra në vend të disa të tjerave, zgjedhin një tip veprimi në vend të një tjetri dhe

gjykojnë vlerat e veprimeve të tjerëve (Sills, 1977:607). Njeriu zgjedh një vlerë, që mbështetet në mënyrë ekzistenciale me një sistemi vlerash konkrete, tenton të jetojë dhe të ndërtojë të tashmen dhe të ardhmen e tij të mbështetur në këto vlera. Mund të themi që këto vlera bëhen motori ose impulsi i përhershëm që dinamizon dhe orienton qëndrimet dhe sjelljet e njeriut në raport me të tjerët, me botën në përgjithësi, por edhe kundrejt vetes. “Vlerat janë ideale, ato që i japin kuptim jetës sonë, duke u shprehur nëpërmjet përparësive që kanë reflektimin e tyre në sjelljen njerëzore, janë baza që formon kuptimet, që drejton dhe që motivon njeriun”(Bunes&Elempuru,1994:120-121)

Nëse kemi vënë dashurinë si projektin tonë të lumturisë, do të kërkojmë të gjitha rastet dhe do të harxhojmë të gjithë mundimin tonë për të arritur që të jetojmë përvoja të cilat lidhen me nevojën tonë për t’u ndjerë të dashur nga të tjerët. Do të jemi të ëmbël, të butë, të sjellshëm, besnikë, të dashur; do të na duket e mirë të ndajmë atë që kemi, edhe sikur ajo të përfaqësojë një “heqje dorë” dhe deri do të tentojmë të përmirësojnë identitetin tonë për të tërhequr me në intensitet afeksionin e njerëzve me të cilët ndajmë ekzistencën tonë.

Por për më tepër kjo zgjedhje drejt dashurisë do të na çojë, po ashtu, në nevojën për të dashur: si nevojë për të dashur veten tonë, që na çon në pozitivizëm etik drejt shkëlqimit dhe perfeksionet ashtu edhe nevojën për të dashur të tjerët duke e drejtuar sjelljen tonë dhe qëndrimet tona drejt gjesteve të dhënies, të bujarisë, të solidaritetit. Në këtë formë dëshira për të dashur dhe për të qenë i dashur si vlerë do të motivojë dhe të projektojë personalitetin tonë si edhe praninë tonë në realitetin e përditshëm dhe do të orientojë veprimin tonë në botë me një profil që i përshtatet vlerave tona.

Në këtë linjë arsyetimi mund të themi që vlerat janë një pikë e rëndësishme referimi për jetën dhe për veprimin njerëzor, duke ndërtuar një sistem interpretimi dhe shpërndarjeje të kuptimit të fakteve dhe ngjarjeve që në çdo rrethana na ofron jeta. Nga këndvështrimi i vlerave mund të bëhet një lexim kritik i asaj që ndodh dhe për rrjedhojë orientohet sjellja dhe prania e njeriut në histori, në shoqëri dhe në botë në përgjithësi.

Nëse kemi kthyer dashurinë, siç thamë më lart, në një zgjedhje në të cilën të bazojnë ekzistencën tonë, do të na vështiroset dhuna dhe ndjenjat tona do të tronditen përballë një lajmi për një konflikt të mundshëm, përballë një atentati të çfarëdolloj tipi; do të refuzonim çdo manifestim të marxhinalizimit social, do të na prekë prania e një lypësi apo e një plake të braktisur, nuk do të durojmë padrejtësinë dhe do të ndiejmë nevojën në rritje për të qenë më shumë solidarë dhe do t'i mëshojmë një bote më shumë vëllazërore, një bote ku lumturia mund të jetë një mundësi reale për të gjithë. Dhe në këto rrethane nuk do të shikojmë kurrë një limit ose një pengesë në rrugën tonë për të përmbushur këtë detyrim që na vjen natyrshëm e ndoshta në këtë moment mund të kuptojmë më mirë një shprehje të filozofit Fernando Savater (1991): “ nëse ëndërrojmë që po fluturojmë është atëherë kur do të fluturojmë dhe që duhet të fluturojmë”.

Vlerat përveçse impulse dhe motivim, që drejtojnë dhe orientojnë sjelljen, mendimin dhe veprimin njerëzor janë realitete që përbëjnë në vetvete një shkallë të lartë të vlefshmërisë për një person. Vlerat i dhurojnë kuptueshmëri veprimeve të eksperimentuara dhe fakteve të jetuara; vlerat kur janë rezultat i zgjedhje të lira të jetuara në të tashmen, por edhe në

rrugën për të ardhmen, prodhojnë lumturi dhe janë thelbësisht shpërblyese. Siç thotë Featherstone: “Vlerat varen nga jeta, megjithëse një zhvillim i shëndetshëm nuk është asnjëherë i garantuar dhe cilësia e jetës duket gjithmonë në rrezik për rënie” Veprimi social formëson vlerat në rrugë të ndryshme (Featherstone,1991).

3.5.4. Karakteri sociokulturor i vlerave

Çdo shoqëri ka sistemin e vet të vlerave dhe të idealeve, në të cilin bashkëlidhen dijet e saj, teknikat, sjelljet etj. Në të gjithë këtë bashkëlidhje, sistemi sociokulturor profilizohet si pararendës thelbësor i sistemit të vlerave. Kur ne flasim për shoqëri amerikane dhe për vlera amerikane profilizojmë shoqërinë nisur nga vlerat. Identifikojmë vlerat duke u nisur nga shoqëria ku jemi dhe në këtë kuadër për ilustrim mund të themi disa nga vlerat e shoqërisë amerikane sipas R.Williams-it (1974) siç janë: liria, barazia, demokracia si të drejta politike, mirëqenia materiale, individualizmi etj. Shoqëria shqiptare ka vlerat e veta, të cilat do të tentojmë t'i zbërthejmë në punimin empirik, por mund të përmendim edhe vlerat e gjendura qysh në kanunet shqiptare siç është: besa, miqësia, nderi, bujaria që lidhen thellësisht, me atë që njihet edhe nga të tjerët, shoqëria shqiptare.

3.5.5.Karakter i vlerave i lidhur me përditshmërinë.

Vlerat nuk janë ekskluzivisht të një grupi të caktuar njerëzish dhe nuk janë detyrimisht të lidhura me projekte të mëdha ose me realizime personale; ato shfaqen tek të gjithë njerëzit meqenëse jemi qenie të vlerave. Qëndrimet që ne mbajmë për çdo gjë që na ndodh ose që

shikojmë tek ndodh, janë shprehje e kësaj përditshmërie teksa na tregojnë një predispozicion relativisht të qëndrueshëm të sjelljes sonë që mund të vijë nga përvoja jonë personale dhe nga integrimi te ne i modeleve sociale, kulturore dhe morale të grupit.

Qëndrimet pra i referohen, sjelljes individuale. Aristoteli kur fliste për virtytet morale, siç i quante ai, si miqësia, ndershmëria, drejtësia ose guximi, sugjeronte që individët mund të përzgjedhin një linjë veprimi duke i konsideruar ekstremet e të dyja qëndrimeve apo veprimeve si për shembull: ndershmërinë dhe mosndershmërinë, guximin dhe frikën etj. Duke marrë parasysh dy ekstremet e secilës nga zgjedhjet sipas Aristotelit do të zgjidhte linjën e drejtë nëse do të qëndronte në mes. Pra e rëndësishme është që çdo ditë është vetë individi që vendos sesi të sillet, duke kërkuar ose jo koherencën e kriterëve të tij personale me normat dhe parimet sociale. Që do të thotë është e pamundur të kuptosh formimin dhe sjelljen e një njeriu nëse ti nuk ke asnjë njohuri mbi ato çfarë janë vlerat e tij.

3.5.6. Karakteri dualist i vlerave

Çdo vlere i korrespondon një antivlerë, duke i dhënë vend unitetit dialektik të të kundërtave për shembull, besim-mosbesim, altruizëm-egoizëm. Por vlerat pozitive dhe ato negative janë larg së qenit komplementare me njëra-tjetrën, kanë ekzistencën e tyre, që do të thotë vlerat negative jo vetëm që supozojnë mungesën e korrespondenteve të tyre pozitive, por edhe kanë përfaqësimin e vet në sjellje dhe në qëndrime me domethënie pozitive ose negative për dinjitetin njerëzor. Çdo vlerë ka të kundërtën e vet ose “kundravlerën” që ngjall po aq përgjigje sa ajo që mund të jetë vlere në vetvete.

Por fakti që vlerat janë dualiste nga natyra nuk do të thotë që janë kategorisht të përcaktuara se kush janë vlerat dhe antivlerat, vlerat pozitive apo vlerat negative. Çdo individ zgjedh vlerat e tij që mund të jetë, për shembull egoizmi mund të jetë vlerë për një person, kjo mund të gjykohet si pozitive ose negative në varësi të situatave me të cilat ai do të përballet. Nëse antivlera në këtë rast është ndjenja e altruizmit dhe nëse ka zgjedhur altruizmin si vlerë, atëherë antivlerë do të jetë egoizmi. E njëjta logjikë vlen edhe kur flasim për vlerat e një shoqërie; vlerë është ajo që shoqëria e ka zgjedhur për ta ndjekur dhe antivlerë e kundërta e saj. Për shembull mund të kujtojmë që shoqëria amerikane individualizmin e sheh si vlerë, ndërsa shoqëria japoneze e shikon atë si antivlerë.

3.5.7. Vlerat formohen gjatë jetës dhe ndryshojnë.

Vlerat nuk janë të lindura me njeriun, ato janë të mësuara, janë gjithmonë në proces formimi gjatë gjithë jetës. Për aq kohë sa vijmë nga përzgjedhja jonë, nga gjykimi atëherë si çdo zgjedhje tjetër ka faktorë që e ndikojnë dhe nuk është e lindur. Përndryshe nuk do të flisnim dot për zgjedhje dhe qëndrim personal ose për profile të caktuara vlerore të çdo shoqërie. Do të ishte i njëjti profil nëse do të ishte e lindur sepse çdo shoqëri përbëhet nga njerëz me tipare të njëjta biologjike që në lindje.

Mund të themi që në procesin e formimit të vlerave, që kur jemi ende fëmijë, fillimisht është familja faktor i rëndësishëm. Është e qartë që në një mënyrë ose në një tjetër, përvojat e një fëmije në shtëpinë e tij, ku lind, kanë një lidhje të fortë me përmbajtjen e vlerave ashtu si edhe me rëndësinë që do të kenë ato për të. Fëmija pranon fillimisht atë që prindërit i

tregojnë, që është e mirë, korrekte ose e justifikuar, duke qenë se fëmija nuk njihet alternativa të tjerë, ka arsye të mira për të konsideruar që prindërit e tij janë një burim i besueshëm informacioni dhe nuk ka motiv që të supozojë se ekzistojnë probleme të veçanta epistemologjike mbi çështjen etike.

Kjo do të thotë që me rritjen e aftësive për të vetëgjykuar fillojnë dhe ndryshojnë ose përforcohen vlerat e mësuara nga familja. Nga kjo kuptojmë më pas diferencat në vlera që mund t'i gjejmë mes vëllezërve të moshave të ndryshme, ose edhe mes prindërve dhe fëmijëve. Me rritjen moshore dhe me rritjen e ndërveprimit me të tjerët, fillojnë edhe njihen gjykimet e të tjerëve mbi vlerat, gjë që fillon dhe prodhon, në një farë mënyre, një ndjenjë konformiteti me vlerat që përcakton grupi tek i cili bën pjesë, shoqëria në të cilën jeton.

Masa e influencës së vlerave nga të tjerët, nga grupi shoqëror dhe nga shoqëria në përgjithësi duket që varet nga shumë faktorë, të tillë si: pozicioni i personit brenda grupit, forca e unitetit të tij me grupit, por edhe me ato jashtë tij, njohja personale me dëshmi të caktuara të rëndësishme që lidhen me vlera të caktuara, nga struktura e vlerave që zotëron tashmë njeriu nëse janë relativisht të shpëtuara nga vënia në pikëpyetje e tyre dhe nga struktura e qëndrueshme ose jo e interesave të caktuara personale.

Vlen të thuhet, po ashtu, që opinionet personale janë, në një masë të mirë, një plagjiaturë i atyre të të tjerëve, në një farë mënyre kjo mund të thuhet edhe për vlerat. Por duhet pasur parasysh që krahasimi nuk është tërësisht i plotë, sepse vlerat kanë një proces më të gjatë dhe më të ndërlikuar përthithjeje dhe bërje pjesë e sjelljes, si dhe po ashtu një proces më të

gjatë dhe të ndërlikuar mendor për t'u ndryshuar. Ndryshe nga opinionet personale, që krijohen edhe ndryshohen edhe brenda ditës. Të gjithë njerëzit kanë shumë besime faktike dhe shumë bindje etike. Këto besime mbajnë marrëdhënie koherence mes njëra-tjetrës. Nëse një person vëren që ka një inkoherencë logjike midis atyre që beson, mes njëra-tjetrës, ose mes atyre dhe realitetit që jeton, atëherë ai ka tendencën të ndryshojë besimet e tij. Në të kundërt, njerëzit do të rezistojnë të braktisin besimet e tyre nëse lidhjet logjike janë të forta dhe i shërbejnë në jetë. Atëherë ata nuk ndryshojnë vlerat e tyre.

Po ashtu, që vlerat dhe në përgjithësi gjykimet etike e shikojnë veten të ndikuar edhe nga interesat personale, pavarësisht se njerëzit tentojnë përherë të mbrojnë gjykimet e tyre vlerore duke u bazuar te parimet, principet. Të qartësosh sistemin e vlerave është një përvojë e rritjes personale (Poletti, 1983:78). Shoqëritë dhe kulturat jo të gjitha kanë të njëjtat vlera, çdo shoqëri jep më shumë përparësi dhe vë në dukje disa vlera specifike, por edhe këto të ndryshueshme përgjatë historisë, në masën e ngjarjeve dhe të rrethanave që ndodhin në jetën e njerëzve. Të zhvillimeve pozitive ose negative, që ndodhin në një fushë të caktuar të jetës, qofshin këto teknologjike, shkencore, biologjike, hapësinore, ekonomike etj. Faktorët e ndryshimit të vlerat ndodhin në një interval më të madh kohor (me një avashtësi më të madhe) krahasuar me fushat e tjera, në ndryshim nga modelet sociale që reflektojnë më shpejt ndryshimin (Rocher, 1973:74).

Autorët i kanë lidhur dhe studiuar vlerat duke tentuar t'i lidhin me fenomene të tjera të shoqërisë njerëzore. Kjo do të thotë që vlerat ndryshojnë, sepse kjo kuptohet nëse arrijmë të

faktojnë që ndikohen dhe ndikojnë fenomene të tjera. Ja disa shembuj: (Bachika, Schulz, 2011).

Tan Chee Beng mori në shqyrtim Malazinë Lindore dhe një pjesë jugore të Kinës post Mao dhe tregoi sesi vlerat tradicionale janë hedhur tej nga globalizimi i tregjeve kapitaliste të ekonomisë dhe me fjalë të tjera tregon sesi vlerat kanë bazë politike dhe mjedisore.

Scott North merr në shqyrtim kulturën e punës të japonezët dhe na tregoi se sipas tij lidhja midis vlerave kulturore korporative, forcave të tregut ndërkombëtar dhe rrjedhëve në shëndetin individual është e dukshme.


Lynne Ciochetto shpjegoi që, ndërkohë që reklamat bashkëkohore të bizneseve përbëjnë një nga shtyllat mbajtëse të ekonomisë kapitaliste, në të njëjtën kohë është duke promovuar materializmin dhe shkakton një zhvendosje të vlerave kulturore, siç është një theksim i vetë-kënaqësisë tek individët nëpërmjet zgjerimit të konsumit, përdorimit të imazheve seksuale për shitjeve të produkteve, fiksimin mbas rinisë dhe pas paraqitjes fizike dhe ngjitjen pas mjeteve të teknologjisë së fundit.

David Graeber në artikullin e tij mori në shqyrtim si debati ideologjik i diskursit politik në SHBA reflektoi në ndërgjegjen klasore dhe në kuptimin e vlerës dhe vlerave. Graeber nisët nga shumë vëzhgime që ai i përshkroi si një puzzle: fakti që në vitin 2004 një pjesë e rëndësishme e klasës punëtore amerikane votoi kundër interesave të saj ekonomike, por në linjë me atë që ata perceptonin se ishin vlerat e tyre social-kulturore. Kamlesh Mohan

reflektoi mbi modernizmin në Indi që ai e quajti perëndimizim. Idealet e modernitetit perëndimor patën tendencën që të zëvendësonin vlerat dhe kulturën indiane, që duket te përdorimi i grave si objekt dhe marrëdhëniet gjinore.

Inglehart shpjegon që ndryshimi i vlerave vjen si rezultat i zhvillimit më të madh ekonomik, duke qenë në të njëjtën linjë me atë që thamë më lart në lidhje me piramidën e nevojave të Masllow-t. Një zhvillim ekonomik ndikon që të plotësohen kërkesat bazike dhe të kërkohet një orientim tjetër vleror. Në kuadër edhe të studimit tonë, mund të shpjegojmë sesi kalohet në rritjen dhe mbizotërimin e vlerave, në tërësinë e ndryshimit të vlerave. Më lehtësisht për t'u kuptuar po e paraqesim skematikisht, që kështu mund ta gjejmë tek Welzel dhe Inglehart: (Welzel&Inglehart, 2008a:184).

RRITJA E BURIMEVE PËR VEPRIM		
⇓		
Rritja ekonomike dhe e mirëqenies sociale shton mjetet materiale te njerëzit	Shtimi i nivelit të edukimit, ekspansioni i komunikimit me masat dhe puna që kërkon më shumë dije shtojnë aftësitë intelektuale te njerëzit	Rritja e kompleksitetit social që çon në zgjerimin dhe difersifikimin të mundësive sociale te njerëzit
⇓		
Autonomia materiale	Autonomia intelektuale	Autonomia sociale



Skema 2 : Procesi i ndryshimit të vlerave

3.6. Klasifikimi dhe teoritë mbi vlerat.

3.6.1 Klasifikime për vlerat

Scheler mbron idenë se tipologjia dhe hierarkia e vlerave është faktor jopërcaktues në vetë ekzistencën e tyre. Ky autor përcakton kritere të vlerat që janë në: jetëgjatësinë, pjesëtueshmërinë, themelet morale, thellësi, kënaqësi dhe relativitet dhe mbështet që këto kritere i japin karakteristikat e stabilitetit të vlerave në kohë, i bëjnë unitare dhe jo të fragmentarizuara, duke prodhuar vlera të tjera të varura siç është vlera fetare (Scheler, 2000).

Po sipas Scheler-it vlerat ndahen në dy fusha paralele, në vlera të personit dhe në vlera të gjërave në vetvete, në vlera vetjake dhe në vlera të huaja (individit, grupit përfaqësues dhe të tjerëve), në vlera të veprimit e të kundërveprimit, të suksesit e të qëllimeve të tjera. Sheleri përpiqet madje të ndërtojë edhe një hierarki vlerash, meqë sipas tij “në çdo situatë

në të cilën gjendet ose e përfytyron individi, ai duhet të vendosi se cila është vlera kryesore që duhet ta drejtojë në veprimin e tij të tashëm apo të mëvonshëm” (Scheler, 2000: 49-50). Për më tepër ai ofron edhe disa kriterë të përgjithshme për të dalluar vlerat me status më të lartë në këtë hierarki nga ato më të ulëta, që vlejnë jo vetëm për individin, por edhe për një grup individësh, hierarki e cila do të identifikohet edhe në këtë studim. P.sh vlerat janë më të rëndësishme, pra qëndrojnë më lart në hierarki, sa më shpesh që të shfaqet nevoja për t’u orientuar tek ato, kur ato janë më pak të ndashme me të tjerët (individë ose grupe), sa më e thellë të jetë kënaqësia e përmbushjes ose e arritjes së tyre etj. Kjo domosdoshmëri e përcaktimit të rëndësisë së vlerave dhe e vendosjes së tyre në hierarki, lidhet edhe me faktin se sipas Schelerit në rastet e konflikteve, duhet parë pozita e vlerës që mban pikën më të lartë në këtë konflikt, për të kuptuar pse ka lindur konflikti dhe tendencën e ndryshimit të tij mbi bazën e ndryshimit të kësaj vlere (Scheler, 2000). Në këtë mënyrë ne kemi mundësi të orientojemi mirë në konfliktin përkatës dhe në pasojat e tij.

Duke u bazuar në këto kriterë prezanton tipologjinë dhe hierarkinë e vlerave ku thekson inferiore deri tek ato më të ndjeshmet dhe shkon nga ata të pëlqyeshmet deri tek të papëlqyeshmet, po ashtu tregon vlerat vitale si modalitet të ndjenjave jetësore, më pas vijnë vlerat shpirtërore që përfshijnë estetikën, të bukurën, të shëmtuarën, të drejtën, të padrejtën dhe njohjen e së vërtetës dhe falsitetit. Në nivelin superior vendos vlerat trashendentale që janë më të thjeshtat dhe përmbushin karakteristikat e idealeve dhe të shpirtërores.

Ky autor prezanton një konceptim ideologjik të vlerave që mohon autonominë e atyre përderisa ai vetë përshkruan si kriter themelet morale të vlerave, gjithçka që varet ose

mbështetet në një nivel suprem që është themeluar nga shpirtërorja ose nga fetarja si qendrore e krijimit të njeriut. Scheler vë në dukje konceptin e personit nga pikëpamja etike dhe jo nga pikëpamja ontologjike dhe as si person i veprimit.

Parsons (1951) prezanton tipologjinë e vlerave duke e shpalosur atë në 5 kategori që shpalosen në çdo lloj veprimi njerëzor. Kriteret janë: aktivizimi i impulseve dhe disiplina, interes privat, interes kolektiv, transhendenca versus inmanencës dhe modaliteti i objekteve. Por te individët veprojnë në nivel personal, motivuar nga nevojat e tyre dhe kërkimi për vetëkënaqësi.

Spranger (1928) prezanton 6 mundësi tipash bazikë të njerëzve: njeriu teorik, njeriu ekonomik, njeriu estetik, njeriu social, njeriu politik dhe njeriu fetar. Këto karaktere janë të konformuara me vlerat e polizuara në një nga kategoritë, që drejton jetën e tij dhe të cilat janë në qendër të motivimit të tij. Çdo person sillet sipas idealeve të tij.

3.6.2. Teoria aksiologjike e Hofstede-s

Hofstede ishte nga të parët kërkues që realizoi një kërkim që lidhej me vlerat në 40 vende të botës. Ai gjeti 4 dimensione dihotomike në shoqëritë që studioi, këto janë: (Hofstede, 1984)

1. Dimensioni i distancës me pushtetin, i cili përshkruan sesi gjendet i shpërndarë pushteti në nivelet e ndryshme të organizatës dhe gradën në të cilën anëtarët e një shoqërie e pranojnë si legjitim. Që pushteti në institucione dhe në organizatë është i shpërndarë në mënyrë të pabarabartë.

2. Dimensi i shmangies së pasigurisë, që përshkruan masën në të cilën do të pranohej devijimi nga normat dhe nga vlerat e përcaktuara.

3. Dimensi i mashkullores-femërores, që parashikon preferencën për arritjen, për heroizmit, për këmbënguljen, për suksesin material si të kundërtat e një referimi për marrëdhëniet personale, për modestinë, për përkujdesjen e më të dobëtëve dhe cilësinë e jetës.

4. Dimensi i individualizmit-kolektivizmit, që paraqet masën në të cilën kultura inkurajon pavarësinë dhe besimin në vetvete në të kundërt kohezionin e grupit.

Nga dimensionet e përshkruara më lart, që na vijnë nga ky autor, më shumë interes për trajtesën tonë paraqet dimensi individualizëm-kolektivizëm sepse është një dimension vleror me dy pole, që përfaqëson pavarësinë emocionale dhe autonominë e individëve përkundër grupit dhe organizimeve të tjera. Poli i kundërt përfaqëson varësinë emocionale dhe ndërvarësinë.

3.6.3. Teoria aksiologjike e Triandis-it

Triandis, Bontempo, Villareal, Assai dhe Luça (1988) morën si referencë modelin teorik të Hofstede-s, pikërisht patën preferencë për idetë në lidhje me individualizmin dhe kolektivizmin. Kjo u realizua duke i dhënë më shumë rëndësi procesit psikologjik dhe duke kërkuar ndihmë shpeshherë në konceptet si uni, dhe identiteti i grupit.

Zhvilluan dimensionin e ideocentrizmit-alocentrizmin për të shprehur organizimin e vlerave të njerëzimit, duke përshkruar që ideocentrizmi ekziston si një predominim i vlerave

të autonomisë dhe pavarësisë së njerëzve përballë grupit, ndërsa alocentrizmi i aspekteve personale, si nevojat dhe interesat, janë në planin dytësor përballë atyre të grupit.

Triandis përshkruan që shumica e sjelljeve të individëve ndodhin kur personi është vetëm ose në çift (i shoqëruar me një tjetër) ndërkohë që sjelljet kolektive jepen në grupe, që do të thotë që sjellja më bashkëpunuese do të ishte më e përshtatshme për strukturat kolektive, duke qenë se personat janë të socializuar për të ndihmuar anëtarët e grupit ku ata bëjnë pjesë (Triandis, etc. 1988). Ekzistenca atje e lidhjeve të forta mes individëve dhe endogrupeve, që mbetet pavarësisht sesa të mëdha mund të jenë presionet për nënshtrim e objektivave individuale ndaj atyre kolektivë. Ndërkohë që konkurrenca duket të jetë më e shpeshtë në kulturat e tipit individualiste duke marrë shkas nga theksimi i ndjenjës së vetafirmimit të njerëzve përmes suksesit sipas kriterit social.

3.6.4. Teoria e Hall & Tonna

Modeli i strukturimit të vlerave i Hall-it dhe Tonna-s, lidh vlerat me etapa të caktuara të zhvillimit, duke shenjuar vlerat përparësore të çdo etape. Këta dy studiues konsiderojnë që vlerat janë përparësi të rëndësishme që reflektojnë botën e brendshme dhe që manifestohen në sjelljen e jashtme. Taksonomia e propozuar nga këta autorë identifikon 125 vlera ose togfjalësja që shprehin vlera që janë të përbashkëta për kultura të ndryshme. Që i ndajnë në dy tipa kryesorë: vlerat e synuara që përshkruajnë idealet dhe qëllimet dhe vlerat mjete që përshkruajnë shkathtësitë, aftësitë dhe kompetencat. Kombinimi i këtyre vlerave dhe dhënia përparësi njëres apo tjetres, sipas këtij modeli, përcakton sjelljen njerëzore.

“Vlerat janë dizenuar nga një kodifikim special fjalësh në gjuhën e shkruar, e folur dhe që eksperimentohen nëpërmjet ndjenjave tona dhe imagjinatës dhe janë të perceptuara nga individët, nga institucionet; janë produkt i përpjekjeve njerëzore, të tilla si puna apo arti” (Hall, 1995:39)

Mbështesin që nuk ka vlera të mira ose të këqija, por kombinime të veçanta të vlerave reflektojnë formën e kuptimit të botës së individëve dhe të institucioneve. (Bunes&Elexpuru, 1994:117). Kjo nuk do të thotë që të gjitha vlerat dhe të gjitha kombinimet i çojnë njerëzit dhe organizatat apo shoqëritë drejt linjës së zhvillimit, përkundrazi gjenden kombinacione vlerash, që sjellin përparim, dhe të tjera, që çojnë në kthim mbrapa, në fazat dhe në etapat e mëparshme të zhvillimit personal ose institucional.

Ata propozojnë një model për shpjegimin e vlerave në 4 fazave, që po t'i vëresh me vëmendje mund të gjejmë paralelizma të fortë me piramidën e ndërtuar nga Masllow.

Vlerat sipas katër fazave (Hall & Tonna,2006) :

1. Vlerat në fazën 1 përfaqësojnë një realitet të jashtëm kërcënues dhe armiqësor, nga i cili duhet të mbrohesh. Individët ndiejnë që nuk kanë kontroll mbi jetën e tyre dhe përgjegjësinë për veprimet e tyre e varin te rrethanat e jashtme. Vlerat që i përgjigjen kësaj faze janë të gjitha ato që kanë të bëjnë me mbijetesën fizike, me vetëkontrollin dhe me sigurinë.

2. Në fazën e dytë vlerat përfaqësojnë një botë të organizuar në mënyrë hierarkike, sipas normave dhe rregullave konkrete, ndjekja e të cilave është matësi i pranimi dhe i njohjes në shoqëri, si edhe nevojë për të funksionuar në mënyrë të përshtatshme brenda institucioneve sociale. Marrëdhëniet me botën vendosen përmes grupeve të cilit personi i përket. Individu percepton se jeta e tij është e kontrolluar nga jashtë, nga autoriteti. Vlerat që i përgjigjen kësaj faze janë vetëvlerësimi, familja, përkatësia, afirmimi social, miqësia, mbështetja nga të ngjashmit, kompetenca personale, puna, konkurrenca, detyra, komunikimi, suksesi, efikasiteti etj.

3. Vlerat e fazës së tretë përfaqësojnë një vizion të botës, si një realitet pak i strukturuar; në ndërtimin e tij është e nevojshme pjesëmarrja; pra bëhet fjalë për një projekt ku të gjithë jemi të implikuar. Në këtë fazë ka një nivel zhvillimi që pretendon drejt vetafirmimit dhe pavarësisë për të evoluar drejt bashkëpunimit ndërpersonal dhe ndërinstitutional. Kontrolli dhe autoriteti janë të brendshme dhe nuk procedojnë së jashtmi. Zhvillohet një ndjenjë personale pushteti dhe autoriteti që zëvendëson kontrollin institucional të sjelljes. Kësaj faze i përgjigjen vlerat si: vetrealizimi, barazia, integriteti, drejtësia, të jesh vetvetja, pranimi, fleksibiliteti, vetëvlerësimi, autoriteti personal, bashkëpunimi, komuniteti, rritja profesionale etj.

4. Faza e katërt bazohet në një vizion të botës që shqetësohet për çështjet globale dhe universale. Shkohet te vlera që lidhet me: barazinë, të vërtetën, të drejtat e njeriut, mjedisi etj.

3.6.5. Taksonomia e Rokeach

Rokeach, që mund të cilësohet një nga baballarët themelues të studimeve moderne të vlerave, me ndarjen e tij në vlera finale dhe vlera instrumentale, përcakton vlerat si preferenca të qëndrueshme për një sjellje në veçanti ose për një gjendje përfundimtare të të qenurit, e cila përmban një komponent njohës (besime) dhe një komponent ndjesor (vlerësime).

Ky autor tregon që vlerat janë nga njëra anë guidë, por dhe vendimtare, të qëndrimeve sociale dhe ideologjive dhe nga ana tjetër i sjelljeve sociale nga ku kuptohet edhe fakti që vlerat drejtojnë qëndrimet në nivel individual dhe social.

Rokeach(1973) konsideron dy tipa vlerash:

1. Vlerat finale, që tregojnë qëllimet e njerëzve, reflektojnë mënyrën ideale të ekzistencës dhe kështu gjenerojnë vetëkonceptime më domethënëse dhe të qëndrueshme në sistemin konjitiv të njerëzve. Të cilat mund të jenë: vlera personale “lumturia, harmonia e brendshme” ose vlera sociale “paqja, barazia, drejtësia”.
2. Vlerat instrumentale që, në farë mënyrë, mund të themi se janë mjetet për të arritur vlerat finale dhe i referohen mënyrave të idealizuara të sjelljes. Këto mund të jenë: vlera të kompetencave “racionaliteti, të jesh i aftë, kurioziteti, imagjinata” ose vlera morale “ndershmëria, përgjegjshmëria, mirësia”.

Sipas Rokeach-it, sistemi i vlerave të një subjekti është si një plan për të evoluuar, për të zgjidhur konflikte dhe për të marrë vendime (Rokeach, 1973:12) Mendoj që kur flitet për

subjekt mund të jetë individ, një grup, apo e tërë shoqëria në lidhje me sistemin e vet vleror. Funksionet e vlerave në modelin e këtij autori janë që vlerat shërbejnë si udhëheqëse të cilat orientojnë çdo aktivitet njerëzor në situata konkrete të jetës. Vlerat si: bindja, mirësjellja, vetëkontrolli, kanë si funksion kryesor pranimin e subjektit nga të tjerët dhe lehtësojnë pozicionimin personal në shoqëri.

Vlerat shërbejnë për të mbajtur dhe për të ekzaltuar vetëvlerësimin. Ndërmjetësojnë perceptimin që kemi, po ashtu edhe gjykimin për të tjerët dhe për veten tonë. Në këtë funksion të mbrojtjes së unit, vlerat promovojnë një bazë racionale të vetëjustifikimit që plotësimi i disa nevojave të caktuara të mos prekë vetëkuptimin e njeriut. Disa vlera për këtë autor, lehtësojnë vetëkuptimin e dijes dhe të njohjes personale, që supozon të kërlesh sensin e gjërave, nevojën për të mirëkuptuar, vëmendjen për një organizim të lidhur gjithmonë me perceptimin dhe me kërkimin e qartësisë dhe koherencës së mendimit (Rokeach, 1973).

3.6.6. Teoria e vlerave e Schwartz-it

Shalom Schwartz, propozoi një teori për një konceptualizim psikologjik të vlerave. Qysh nga ky këndvështrim teorik vlerat janë konsideruar si entitete njohëse, besime ose koncepte që i referohen disa objekteve të caktuara të cilat shërbejnë si kritere përzgjedhjeje dhe vlerësimi për sjelljen.

Ky autor mbështet te kjo teori sepse sipas tij kjo teori lehtëson lehtëson kuptimin e dinamikave të vlerave; i lidh ato me motivimin dhe i jep një kuptim përmbajtjes së vlerave si psikologjike ashtu edhe sociale. Ky model i strukturon vlerat në dy tipa: nga njëra anë ato me orientim individualist dhe nga ana tjetër vlerat me orientim kolektivist, duke treguar një hapësirë të ndërmjetme mes tyre që lejon të evidentohet konflikti mes vlerave.

Gjithashtu ai thotë se kjo teori konfirmon një model rrethor për studimin e vlerave ky dimension shfaqen nga nevojat bazike dhe universale njerëzore. Kjo teori na jep një përcaktim përshkrues të vlerave dhe mund të shërbejë si model, vendos një marrëdhënie mes vlerave dhe motivimit dhe i përcakton si vlerat finale dhe instrumentale që gjejmë te Rokeach si elemente që drejtojnë sjelljen e subjekteve.

Schwartz (1992) për dy tipat e vlerave jep një nëndarje mes dy nëntipash. 1. Vlerat individuale i ndan në: a) vlera që i japin përparësi vlerave të promovimit personale dhe b) ato që i japin përparësi hapjes ndaj ndryshimeve. 2. Vlerat kolektiviste i ndan në a) ato që i japin përparësi dashamirësisë dhe favorizojnë endogrupet dhe b) vlerat që i japin përparësi traditës dhe konformitetit.


Pas këtyre ndarjeve të madhe ai thotë që është edhe një tip miks- individualiste dhe kolektiviste- që përfshin vlera të sigurisë dhe universalizmit. Mospërputhshmëria mes këtyre vlerave sugjeron konflikt në nivel individual, grupor dhe social, duke qenë se edhe veprimet që ndërmerren për të realizuar ose për të arritur çdo njëren prej tyre kanë pasoja psikologjike dhe sociale.

Në studim Schwartz dhe Bilsky (1990), thonë se mund të flasim për 7 lloje të mëdha vlerash kulturore dhe sipas tyre mund të klasifikohen në mënyrën e mëposhtme:

1. Konservim. Lidhet me vlera që i mëshojnë ruajtjen e status-quos, me prirjen për të limituar veprimet e individëve ose grupeve që mund të tronditin rendin tradicional (bindje, respekt ndaj traditës, rendi social, siguria familjare, autodisiplina, në këtë model uni e humb rëndësinë e vet dhe ka kuptim vetëm si pjesë e kolektivitetit).
2. Hierarkia. Që lidhet me vlera që i mëshojnë legjitimitetit të përshkrimit hierarkik të roleve dhe të pozicioneve fikse (pushtet social, nënshtrim, pasuri). Flitet për promovimin dhe mbrojtjen e ideve dhe të drejtave të pavarura të individëve autonomë për të arritur qëllimet e veta intelektuale (kurioz, me mendje të hapur dhe kreative).
3. Autonomia afektiv. I mëshojnë promovimit dhe mbrojtjes së arritjeve nga përvoja afektive pozitive (kënaqësi, jetë e ekzaltuar, jetë me përvoja të ndryshme). Po ashtu autonomisë intelektuale duke ndërtuar një bërthamë të vlerave të njohura, koncepte të përgjithshme të individualizmit.
4. Kompetenca. I mëshojnë vlerave që kërkojnë ndryshimin aktiv të atyre që ke përqark dhe të dalësh përpara përmes vetafirmimit (ambicie, sukses, risk).
5. Harmonia. I mëshojnë vlerave që t'i lidhin në mënyrë harmonike me natyrën dhe me mjedisin (uniteti me natyrën, mbrojtësi i mjedisit, bota e bukurisë).
6. Kompromis barazimtar. I mëshojnë vlerave që tentojnë drejt kompromisit vullnetar për të promovuar mirëqenien e të tjerëve (barazia, drejtësia sociale, ndihma, përgjegjësi sociale).

Tek Schwartz (1992,45) gjejmë edhe një model lidhjeje dinamike mes vlerave dhe tipave të motivimit të vlerave. Ai prezanton 4 poet:

1. Vetëtrashendenda që përfshin: universalizmin dhe mirësinë.
2. Intensifikimi i unit që përfshin: arritjen dhe pushtetin.
3. Konservimi që përfshin: traditën, konformitetin dhe sigurinë.
4. Hapja ndaj ndryshimit që përfshin: vetëdrejtimin, stimulimin dhe hedonizmin.



Skema 3: Skematizimi e vlerave sipas Schwartz (Schwartz,1992:45)

3.6.7. Teoria e vlerave të Inglehart-it

“Me kulturë kuptojmë një sistem qëndrimesh, vlerash dhe sjelljesh që i ndan mes vetes në një masë të madhe një shoqëri dhe që i transmeton nga brezi në brez. Ndërkohë që natyra njerëzore është biologjikisht e lindur dhe universale, kultura është e mësuar dhe ndryshon nga një shoqëri në një tjetër” (Inglehart,1997:18)

Vëzhgimi Botëror i Vlerave, organizëm të cilit i përket dhe ku zhvillon kërkimet edhe Inglehart, ka kryer 6 valë studimesh vlerore, duke arritur të përfshirë 80 shoqëri të anketuara dhe të vendosura në hartën vlerore sipas boshteve vlerore. Konkretisht 6 valët e studimeve i përkasin viteve: 1981, 1990, 1995, 2000, 2005, 2010 dhe vala e gjashtë që i përket vitit 2014 rezultatet e së cilës nuk kanë dalë ende në web-site zyrtar. Analiza e bërë nga ai nxori në pah sipas tij fillimisht: ekzistencën e dy dimensione thelbësore të profilit vleror: Materializmi dhe Postmaterializmi. Këto ishin dy dimensionet e para me të cilat u muar, por më vonë u shtua teoria me dy boshte të tjera vlerore.

Ai përcaktoi si kultura materialiste, ato kultura që u japin më shumë rëndësi vlerave të tilla si: “të mbështesësh forcat e armatosura”, “të luftosh rritjen e çmimeve”, “të luftosh kundër kriminalitetit”, “të mbash rendin në shoqëri”, “të mbash një ekonomi të qëndrueshme”. Ndërsa si kultura postmaterialiste, ato kultura që u japin më shumë rëndësi vlera të tilla si “të kesh një shoqëri më impersonale”, “më shumë pjesëmarrje në punë”, “më shumë pjesëmarrje në qeverisje”, “idetë vlejnë më shumë se paratë”, “liria e shprehjes”, dhe “qytete më të bukura”.

Inglehart transporton në rendin social, hierarkinë e motivimit dhe të nevojave të Masllow që e paraqet atë në nivel personal, dhe thotë që shoqëritë do të kenë motivacion të rendit superior kur do të kenë të zgjidhura nevojat e rendit inferior, pra ato bazë. Për këtë sipas tij, kushtet ekonomike të një shoqërie janë përgjegjëse për orientimin vleror të saj. Mungesat ekonomike gjenerojnë në shoqëri pasiguri dhe për ta tejkaluar këtë është më funksionale të kesh përparësi materialiste. Ndërkohë që mirëqenia ekonomike gjeneron siguri dhe për këtë do të kontribuoj në zhvillimin e orientimit vleror postmaterialist. Ndryshimi i vlerave në shoqëri nga materialiste në postmaterialiste është rezultat i ndryshimit të kushteve ekonomike të një shoqërie, nga mirëqenie më e pakët te mirëqenie më e madhe.

Në 1997 Inglehart shton edhe dimensione të reja të këtij modeli bazik, nisur edhe nga teoritë e Weber-it dhe nga psikologjia sociale e Inkeles dhe Smith-it që shërbejnë për të analizuar kalimin e shoqërive nga tradicionale në shoqëri moderne. E quan këtë proces modernizim, që implikon sipas tij ndryshimin nga autoriteti fetar drejt autoritetit shtetëror përmes një procesi të shekullarizimit dhe burokratizimit. Kështu mund të studiojmë dy dimensione të reja që janë: 1. Tradicionale versus shekullare-rationale dhe 2. Mbijetesë versus vetafirmim. Teoria e Modernizimit e Inglehart-it propozon që zhvillimi ekonomik është i lidhur në mënyrë të pashmangshme me ndryshime në kulturë, në jetën sociale dhe në politikë. Këto ndryshime, duke u bashkuar edhe me industrializimin, ndërtojmë një sindromë që konsiston në: specializimin e punës, burokratizimin, qendërzimin, urbanizimin, edukimin formal të masave, zhvillimin e mjeteve të komunikimit masiv, shekullarizimin, rritje të biznesmenëve dhe të prirjeje për të bërë biznes, rrjeti i prodhimit

masiv dhe lindja e shtetit modern, kështu edhe besime dhe vlera që mbështesin nivelet e larta të rritjes ekonomike.

Për këtë, duke zgjeruar teorinë klasike të modernizimit Inglehart (2000) sugjeron që zhvillimi ekonomik i jep vend dy dimensioneve psiko-sociale të diferencave transkulturore: një dimension i parë i lidhur me industrializimin e hershëm dhe daljen në pah të klasës punëtore dhe një dimension i dytë që reflekton mirëqenien ekonomike të shoqërive industriale të avancuara në rritjen e sektorit të shërbimeve dhe të dijes. Ndërkohë që shoqëritë paraindustriale karakterizohen nga vlera të traditës (respekt për hierarkinë, bindje, krenari kombëtare) dhe të sigurisë (ekonomike dhe fizike, mosbesimin ndaj të tjerëve) shoqëritë industriale diferencohen sepse tek ato ndryshon tradita për racionalitetin, ruhet siguria dhe del në pah shekullarizmi. Dhe së fundmi shoqëritë post-industriale kanë tendencën që të kenë vlera të kundërta nga këto, dhe kështu i mëshojnë më tepër vlerave shekulare dhe racionale dhe vlerave të vetafirmimit dhe vihet në pikëpyetje racionaliteti i modernitetit si vlerë absolute.

Po ashtu tek ai gjejmë një ndërlidhje të qëndrimeve dhe sjelljeve që lidhen me këto dy dimensionë, të cilat i përmendëm më lart. Shoqëritë që i mëshojnë vlerave të mbijetesës ose vlerave materialiste tregojnë: “një nivel të ulët të mirëqenies subjektive, kanë gjendje të keqe shëndetësore, nivel të ulët të besimit ndërpersonal, një intolerancë me ekzogrupet, mbështetje të ulët për barazinë në përgjithësi, nivel të lartë besimi te shkenca dhe teknologjia, nivel të ulët të aktivizimit mjedisor dhe relativisht janë në favor të qeverive me prirje autoritare” (Inglehart, 2000:28). Shoqëritë që i mëshojnë vlerave postmaterialiste dhe

atyre të vetafirmimit demonstrojnë një profil të ndryshëm: “më shumë mirëqenie subjektive, më shumë interes për mbrojtjen e mjedisit, më shumë mbështetje për lëvizjet në favor të barazisë së të drejtave të grave, lesbikeve, homoseksualëve dhe të huajve, ashtu si më shumë pjesëmarrje në vendimet ekonomike dhe politike” (Inglehart, 2000:27).

Mund të themi që Inglehart sugjeron një modifikim të teorisë klasike të modernizimit, në kuptimin që në këtë teori ka një lidhje lineare mes rritjes ekonomike, gjatë procesit industrial dhe sjelljes së shoqërisë siç thonë edhe Inkeles dhe Smith (1974), që do të thotë forcim të vlerave materialiste, pra ndërkohë që rritja ekonomike ecën në mënyrë lineare forcohet edhe ky profil. Ndërsa sipas Inglehart-it kjo gjë qëndron derisa njerëzit kanë plotësuar nevojat e tyre parësore që nga ky moment e më pas, vlerat që sjell me vete modernizimi siç është profili materialist ndalojnë së forcuari dhe fillojnë edhe lindin e forcohen vlerat postmaterialiste.

Veç teorisë së mësipërme, tek Inglehart gjejmë edhe dy shtylla të tjera, që lidhen me të njëjtën logjikë që përshkruam më lart, që tenton të jetë shpjeguese për vlerat edhe në vende me dinamika pak më të ndryshme për shembull: siç mund të jenë vendet e Europës Lindore që ndryshe nga të tjerat kanë edhe një trashëgimi që lidhet me diktaturën. Këto dy shtylla të teorisë së tij janë: hipoteza e vlerave të mungesës dhe hipoteza e vlerave të socializimit. Sipas së parës, pra hipotezës së vlerave të mungesës (e cila është edhe hipoteza që ngrihet në këtë punim doktoral për shoqërinë shqiptare) përparësitë e njerëzve reflektojnë mjedisin e tij ekonomik. Ky konceptim, siç e përmendem edhe pak më lart, mbështetet po ashtu te hierarkia e nevojave të Masllow-t. Qeniet njerëzore pra tentojnë të përmbushin nevojat, që i

konsiderojnë si më urgjente, dhe vetëm atëherë kur ato janë të plotësuara shqetësohen për të tjera. Kur kanë mbushur nevojat thelbësore, njerëzit tentojnë të përmbushin gjëra të tjera më pak materialiste dhe më shumë simbolike dhe shprehëse, por shumë të lidhura me marrëdhëniet sociale, me cilësinë e jetës dhe vetrealizimin. Në realitet sipas kësaj hipoteze të Inglehart-it, vlerat e njerëzve nuk reflektojnë direkt sigurinë e tyre materiale, por perceptimin subjektiv që ata kanë në lidhje me të. Ky perceptim qenka i lidhur fort me kushtet që kanë pasur në socializimin pre-adulte, duke ndjekur në një farë mënyre modelin e “viteve të paharruara” për ta. Këtë ne e kemi lidhur, siç e kemi thënë, me vitet e komunizmit në Shqipëri, që në fakt ishin vitet e paharruara për njerëzit që jetuan atë periudhë dhe vuajtën nga mungesat e forta ekonomike, nga mungesa e sigurisë materiale. Dhe nisur nga kjo mund të jetë e pritshme, që pavarësisht se tani mund të kenë arritur kushtet e sigurisë ekonomike, ata të ruajnë një profil vleror tërësisht materialist, që lidhet me shpjegimin e mësipërm, por që sjell hipoteza e vlerave të mungesës së Inglehart-it.

Hipoteza e vlerave të socializimit vë në dukje që njerëzit, që kanë hequr mbi vete privimin material dhe pasigurinë ekonomike në etapën pre-adulte, janë të kushtëzuar nga kjo mungesë e provuar edhe gjatë ciklit të tyre jetësor. Edhe pse kushtet e jetës përmirësohen më vonë, ata do të vazhdojnë të vlerësojnë aspektet materiale që ju kanë munguar gjatë rinisë së tyre. Në formë të ngjashme njerëzit, që provojnë mirëqenien materiale gjatë “viteve të paharruara”, nuk fokusohen vetëm në ndjekjen e nevojave materiale sepse i quajnë në një farë mënyrë të mirëqena. Duke ndjekur hipotezën e socializimit Inglehart mbështet idenë që përhapja e vlerave postmaterialiste nuk prodhohen automatikisht, por në një mënyrë graduale, bazike, si një pasojë e zëvendësimit të brezave. Brezat e vjetër, që

përgjithësisht kanë dominancë të vlerave materialiste, janë të zëvendësuar me brezat e rinj që kanë orientim drejt postmaterializmit.

Ashtu siç përcakton edhe Inglehart (1990), pas një periudhe të rritjes drastike të sigurisë ekonomike dhe fizike, do të prisnim që diferencat midis grupmoshave të vazhdojnë, sepse këto grupe kanë jetuar përvoja formuese të ndryshme. Kuptohet që e njëjta gjë pritet të ndodhë edhe në fusha të tjera, do të ekzistojë një vonesë kohore mes ndryshimeve në kontekstin ekonomik dhe pasojave të tyre politike duke ndjekur logjikën e zëvendësimit të brezave. Për Inglehart-in ajo që realisht ka rëndësi janë efektet që vijnë nga ndryshimi i brezave dhe jo nga koha vetë.

Inglehart përfaqëson me tezat e tij edhe një lloj të veçantë të socializimit kulturor në të cilin ndryshimi progresiv ka vend si pasojë e një procesi të transformimit social: modernizimi. Çdo brez i ri provon një kontekst deri diku të ndryshëm nga ai paraardhës si rrjedhojë e këtij transformimi makrosocial që është në vazhdimësi. Në këtë skemë, burimi përfundimtar i ndryshimit të vlerave supozohet që është zhvillimi ekonomik dhe rritja e mirëqenies materiale të individëve dhe të shoqërive. Teoria thotë që vendet që provojnë një periudhë mjaftueshëm të prosperitetit ekonomik shohin të rritet niveli i postmaterializimit në ritmin e lidhur me zëvendësimin e brezave. Në këto vende, që sipas tij mund të jetë profile i shumë shteteve të BE-së, shfaqen diferenca mes brezave të qëndrueshme dhe monotone në vlerat që iu përgjigjen çdo harku kohor që ata kanë provuar në vitet e tyre formuese.

Ai identifikoi diferenca të qarta mes niveleve të postmaterializmit të grup-moshave të ndryshme në një seri pyetjesh që i bëhen shoqërisë transversalisht: sa më i ri të jetë grup-mosha aq më postmaterialist është. (Inglehart, 1971) U gjenerua një debat rreth origjinës së këtyre diferencave: nëse këto duhet t'i atribuoheshin efektit të ciklit të jetës. Me këtë duhet të kuptojmë që brezat më të vërtetë kanë ndryshim midis tyre, por gjithmonë do ta kenë këtë ndryshim për aq kohë sa do të jenë breza të ndryshëm (Shively, 1991; Sciarini&Fingers, 1991) Më thjesht ideja e ciklit të jetës është që të rinjtë kanë vërtet vlera më postmaterialiste dhe më drejt vetafirmimit, ndërsa të moshuarit kanë më shumë vlera materialiste dhe të mbijetesës. Po kur këta të rinj të jenë të moshuar ata do të kenë të njëjtat vlera, por në proporcion me të rinjtë që do jenë në atë kohë, do kenë më shumë vlera materialiste dhe të mbijetesës kundrejt këtyre të rinjve që do jenë më shumë me vlerave postmaterialiste dhe të vetafirmimit.

Inglehart i kushtoi rëndësi këtij qëndrimi për ta hedhur poshtë atë që quhet efekti i ciklit të jetës. Nëse diferencat që ai, që në fillimet e veta, i kishte gjetur mes grup-moshave të ndryshme një lidhje mes vlerave materialiste & mbijetesë nga njëra anë dhe vlerave postmaterialiste & vetafirmim nga ana tjetër do të ishin thjesht efekt i ciklit të jetës, mundësitë që të ndodhte një ndryshim real makrosocial ishin të papërfillshme. Po të mendojmë edhe një situatë të stabilizuar demografike, efekti i ciklit të jetës do të kishte ndikim nulë në nivelin total të ndryshimit të vlerave në një shoqëri, në krah të vlerave të postmaterializmit dhe të vetafirmimit. Ai argumenton që në fillimet e tezës së tij që efekti moshë nuk ka një efekt ndryshues te vlerat që përkrah individit, aq më tepër për faktin se ato janë të qëndrueshme dhe të brendësuar (Inglehart, 2008).

Tezën e tij mundi edhe ta vërtetonte empirikisht, pas shumë vite anketimesh dhe të dhënash mbi vlerat, të bëra nën kujdesin e Shkollës Botërore të Vlerave. Në artikullin e tij të vitit 2008 “Ndryshimi i vlerave të publiku perëndimor, 1970-2006”, Inglehart merr në analizë 6 shoqëri, Italinë, Francën, Britaninë, Belgjikën, Gjermaninë dhe Holandën dhe vërteton me shifra spostimin që kishin pasur këto shoqëri, në rritjen e nivelit të vlerave postmaterialiste kundrejt atyre materialiste, dhe vlerave të vetafirmimit kundrejt atyre të mbijetesës (Inglehart, 2008). Kështu hodhi poshtë idenë e ciklit të jetës, duke konfirmuar që vlerat që formohen në rini, në një drejtim nisur nga socializimi dhe kushtet e ndryshme ekonomike dhe sociale, qëndrojnë ashtu edhe kur individi plakët. Me këtë ai konfirmoi edhe njëherë hipotezën e tij, që na e bën edhe neve më të legjitimuar që ta kemi si hipotezë përfundimtare për të parashikuar një lloj ardhmërie në Shqipëri në lidhje me vlerat dhe më pas me demokracinë efektive.

Flanagan (1979) kritikoi ndarjen e boshteve vlerore që bën Inglehart mes materializmit dhe postmaterializmit, ai thotë që kjo ndarje nuk kap të gjitha ndryshimet e rëndësishme që po ndodhin në shoqërinë moderne. Për të më shumë do të kishte kuptim një ndarje mes vlerave tradicionale përballë atyre liberale dhe këtë e justifikon duke studiuar shoqërinë japoneze, për të cilën është burimi kryesor i të dhënave parësore për analizë. Në kritikën e tij ai arrin në përfundimin që “edukimi ka një efekt shumë të rëndësishëm në formimin e vlerave dhe të sjelljeve sidomos në dimensionin e vlerave që merr Inglehart në analizë” (Flanagan, 1979:265). Gjykojmë që kjo lloj kritike nuk dëmton aspak teorinë për arsye të një ndarje të ndryshme të boshteve që, në fakt ndryshojnë në emërtime dhe jo në substancë të asaj që

janë, duke matur normalisht që emërtimi është në një farë mënyrë tagër i atij që e krijon teorinë dhe nuk dëmton thelbin. Aq më tepër që ndarja materialiste dhe postmaterialiste nuk është e vetmja që ofron Inglehart, ai e kap ndarjen tradicionale në një bosht tjetër siç është ai i vlerave tradicionale versus shekullare. Ndërsa për sa i përket rolit të edukimit, por jo vetëm edhe faktorëve të tjerë që bëjnë që të mësohen vlerat në një shoqëri, nuk mohohet nga Inglehart dhe aq më tepër analiza faktoriale sesi mësohen vlerat nuk ka qenë objekt i studimit.

Po në lidhje me edukimin u bënë kritika nga Dutch dhe Taylor (1993) të cilët argumentojnë që edukimi është faktor kryesor që ndikon në nivelin e postmaterializmit. Inglehart dhe Abramson (1994) i përgjigjen vetë duke bërë një artikull ku tregojnë që faktin që përmendin socializmin e hershëm në aspektet që çon në ndryshimin e vlerave nga njëri brez në tjetrin nuk e përjashton edukimin. Gjykohet që vlerat ndryshojnë edhe pasi individ ka dalë nga cikli i edukimit dhe e ka mbaruar këtë proces. Megjithatë Abramson dhe Inglehart ndërmorën një hap tjetër për të hedhur poshtë këtë kritikë: morën 5 studime vendesh (Holandë, Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani dhe Austri) për të parë nëse kishte ndonjë korrelacion të më shumë edukim dhe më shumë vlera postmaterialiste dhe kjo gjë nuk u gjet nga të dhënat. (Abramson, Inglehart, 1995).

Një gjykim tjetër, në lidhje me teorinë e Inglehart-it, përsëri për boshtin materialist-postmaterialist nga Clarke dhe Dutt (1991), është gjykimi që arsyeton se kjo ndarje nuk merr parasysh ndikimin e madh që ka papunësia. Sipas tyre respondentit i papunë është më shumë i shqetësuar për papunësinë e tij dhe duke qenë se atë nuk e gjen si mundësi

përgjigjeje te lista që përcakton materializëm apo postmaterializëm, atëherë është më i predispozuar për të zgjedhur “t’i japë njerëzve më shumë zë në vendimet e qeverisjes”, si për t’i dhënë zë çështjes së tyre të papunësisë (Clarke, Dutt, 1991). Dhe kjo çon në mënyrë fallso në një dukje sikur ka spostim drejt vlerave postmaterialiste. Fillimisht është e kuptueshme që ky lloj faktori nuk mund të ketë ndikim afatgjatë për vetë faktin se papunësia nuk është status i përhershëm dhe i pandryshueshëm. Megjithatë përveç këtij fakti një analizë ka ardhur nga Abramson, Ellis dhe Inglehart (1997), të cilët shprehin tri argumente: i pari, lidhet me faktin që jo detyrimisht çdo i papunë do të prirët që të zgjidhte më shumë zë në qeverisje, përballë luftës së qeverisë për rritjen e çmimeve, përballë punës së qeverisë për rritje ekonomike; i dyti, shpjegon se lidhja mes papunësisë dhe faktorit vleror është e kapur dhe matet nga boshti i vlerave të mbijetesës përkundrejt atyre të vetafirmimit; grupi i treguesve, që mat vlerat e materializmit apo postmaterializmit, nuk mund të çmontohet edhe nëse një përgjigje del në bazë të një gjykimi jo të saktë apo të ndikuar nga variabla të tjerë në momentin e pyetjes.

Shqetësimi i fundit, që përfaqëson edhe një debat në shkencat sociale, jo vetëm në kuadrin e teorisë së vlerave që kemi nga Inglehart, por edhe me gjerë, lidhet me rolin e kulturës politike. Jackman dhe Miller janë të shqetësuar në lidhje me rritjen e interesit në studimin edhe rëndësinë e kulturës politike, e cila sipas tyre po i çon politologët që të ulin dhe të anashkalojnë rëndësinë e faktorëve institucionalë si për shpjegimin dhe studimin e demokratizimit, ashtu edhe për rritjen ekonomike (Jackman, Miller, 1996). Rolin e kulturës politike e mbështesin Almond dhe Verba (1963), Putnam (1993) dhe vetë Inglehart (1990,

1996, 1997) të gjithë autorët besojnë te ndikimi i madh që ka kultura politike në demokratizimin dhe demokracinë.

3.7.Ndikimi i vlerave te sjellja

Vlerat dhe sjellja janë shumë të lidhura me njëra–tjetrën, vlerat në një farë mënyre janë një lloj manuali nga të cilat njerëzit nisen për të vendosur mbi mënyrën e tyre të së sjellurit. Po t'i referohemi Parsons-it, funksion bazik i vlerave është që të motivojë dhe të kontrollojë sjelljen e anëtarëve të një grupi social (Parsons, 1951). Në një farë mënyre ne duke njohur edhe duke ekzaminuar vlerat e një grupi shoqëror, jemi në gjendje që më pas të bëjmë edhe një parashikim dhe të kemi një pritshmëri sesi do të sillen ata në një situatë të caktuar. Në këtë mënyrë shoqëria vetë priret të pranojë më lehtësisht sjellje që janë konform vlerave që mbart si shoqëri dhe të qortojë e të mos pranojë, por edhe të dënojë në raste të caktuara, sjellje që nuk janë konform vlerave.

Sipas Schwartz-it dhe Bardi-t ky mekanizëm i lidhjes së pashmangshme të vlerave me sjelljen është i domosdoshëm dhe i rëndësishme për dy arsye: “ E para, aktorët socialë (për shembull, liderët, partnerët e ndërveprimit) thërrasin dhe mbështeten te vlerat, kjo për të përcaktuar një sjellje të caktuar si shoqërisht të përshtatshme apo për të arsyetuar kërkesat e tyre ndaj të tjerëve; për të vendosur mbi sjelljet e dëshiruara. E dyta, dhe njëlloj e rëndësishme, vlerat shërbejnë si guida të brendësuar për individët; ato lehtësojnë grupin nga nevoja për kontroll social të vazhdueshëm. Vetë nga përcaktimi, vlerat janë diçka e dëshiruar shoqërisht” (Schwartz, Bardi, 2001:280)

Feather sugjeron që vlerat ndikojnë sjelljes duke influencuar në gjykimin që bëjmë për të vlerësuar pasojat e mundshme të çdo veprimi, përpara se ta kryejmë atë (Feather, 1990). Në këtë aspekt është më se e kuptueshme që nëse individ beson se ndershmëria është një vlerë e rëndësishme, ai do të sillet në mënyrë të ndershme. Nëse beson se virgjëria është një vlerë dhe që martesë është e shenjtë, atëherë do të kemi një sjellje mohuese për kryerjen e marrëdhënieve seksuale përpara martesës. Pa dyshim, që në sistemin vleror, individ ka një hierarki vlerash, duke i konsideruar disa më parësore dhe disa më dytësore, në këtë aspekt përpara se të marrë përsipër një sjellje të caktuar ai është i shtyrë që të bëjë një reflektim mbi vlerat, në mënyrë të natyrshme dhe pa e kuptuar që po e bën sidomos kur situata mund të jetë delikate dhe mund të paraqesë një lloj konflikti mes vlerave tek të cilat ai beson.

3.8.Demokracia efektive

3.8.1. Çfarë është demokracia dhe demokracia efektive

Fjala demokraci vjen nga greqishtja e lashtë ku fjala demos (popull i thjeshtë) bashkohet me fjalën kratien (të sundosh). Për arsyen se këta njerëz formojnë shumicën e popullsisë, demokracia është barazuar me sundimin e shumicës (Ball, Dagger, 2000:20). Nga një perspektivë normative mendimtarët kanë argumentuar se ne duhet të mbështesin demokracinë sepse ajo prodhon pasoja të dëshiruara: siç është respekti për të drejtat themelore, vetë-vendosjen, autonominë morale, zhvillimin njerëzor dhe barazinë politike (Dahl, 1998:45). Ka shumë konceptime mbi demokracinë, mbi llojet e saj, mbi mënyrën e ndërtimit dhe të funksionimit të saj. Por duket si i bashkon fakti që: mençuria kolektive e

një trupi të gjerë njerëzit të mirinformuar prodhon më seriozisht një vendim më të mirë. Prandaj një konsensusi, që arrihet me qëllim nga një grup i madh njerëzish të ndryshëm, duhet t'i besohet më shumë sesa konkluzioneve apo komandave nga një grup i vogël njerëzish homogjenë apo edhe nga një individ i vetëm (Boyer, 1992:1-11).

Demokracia është një sistem politik, në të cilin të gjithë njerëzit (populli) marrin ose kanë të drejtë të marrin vendime mbi çështje të rëndësishme të politikës publike (Holden, 1974:8). Konceptimi që ne zgjedhim është ai i demokracisë efektive, që ka si parim bazë pikërisht që të gjykojë edhe të masë aftësinë reale të këtij sistemi për të fuqizuar qytetarët e zakonshëm. Pra në linjën që gjejmë edhe te Holden kur thotë: përkufizimi i demokracisë si pushtet që ndodhet në duart e popullit nënkupton se në duart e çdo personi ndodhet pushtet i barabartë (të paktën pushteti i votës); kjo nënkupton barazinë politike të individëve (Holden, 1974:19).

Por për mendimtarët e demokracisë efektive, koncepti lidhet me mundësinë që ka brenda një vendi që të fuqizohen dhe të funksionojnë realisht të drejtat e qytetarit të zakonshëm, zëri i tij në vendimmarrje, roli i tij në qeverisje dhe trajtimi i tij si i barabartë dhe i rëndësishëm. Por fakti i thjeshtë, që ekzistojnë zgjedhjet, ku qytetarët vendosin dhe zgjedhin qeverinë e tyre bashkë me programin përkatës, nuk e arrin këtë qëllim. Po ashtu vetëm aprovimi i ligjeve, që vendosi formalisht të drejtat politike dhe civile, nuk është e mjaftueshme për të fuqizuar qytetarin. “Demokracitë e suksesshme ndërtohen me shtetas që janë të mirinformuar rreth çështjeve dhe alternativave të politikës publike dhe që, si të tillë,

do të kërcënojnë jetëgjatësinë në pushtet të çdo elite që nuk qeveris në interesin racional të shumicës së publikut” (Mayer, 2003:40)

Welzel dhe Inglehart shprehen: “Zhvillimi i ‘demokracisë efektive’ tregon përvetësimin nga ana e njerëzve të thjeshtë të burimeve dhe të vlerave që u lejojnë atyre t’u bëjnë presion me efektshmëri elitave” (Welzel&Inglehart, 2008b:138). Pikërisht kjo bën që t’ia vlejë të studiojmë nivelin e demokracisë efektive në një shoqëri, për të kuptuar sesa e kanë vërtet fuqinë njerëzit dhe sa demokracia po e plotëson misionin e vet si “pushtet i popullit”. Barney e quante se ekzistonte demokracia “atje ku qytetarët e kanë të mundur të marrin pjesë si të barabartë në vendime mbi kushtet, përparësitë; sesi e mira e përbashkët do të shpërndahet dhe mbi përmbajtjen dhe përforcimin e interesit publik” (Barney, 2005:152). Të gjitha demokracitë presupozojmë që kanë në qendër qytetarin, popullin e thjeshtë apo sovranin popullor. Siç thotë Carol Gould: “Qeverisja në një demokraci është në fakt vetëqeverisje nëpërmjet pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në procesin e marrjes së vendimeve” (Gould, 1996:176). Të njëjtin mendim ndan edhe Huntington kur fut në kriteret e demokracisë së vërtetë, siç e quan ai kontrollin efektiv të qytetarit mbi politikën : “demokraci e vërtetë” do të thotë liri, barazi, vëllazërim, kontroll efektiv i qytetarëve mbi politikën, qeverisje e përgjegjshme, ndershmëri dhe sinjeritet të politikës, diskutim racional dhe të frymëzuar, pjesëmarrje dhe pushtet të barabartë dhe një sërë virtytesh të tjera qytetare” (Huntington, 2011:27-28).

Por situata ndryshon shumë kur analizohen realisht kushtet e atyre që quhen demokraci dhe a janë ato brenda kuadrit të demokracisë efektive ku qytetari është në qendër. Sot shtete me

sisteme demokratike, sidomos demokracitë e reja, shikohen si të pushtuara nga korrupsioni në masë të madhe dhe nuk kanë një mirëfunksionim të shtetit të së drejtës, që është kusht i nevojshëm për demokracinë efektive. Prandaj ne në literaturë gjejmë të flitet çdo herë e më shumë për mosmjafgueshmëri të demokracisë elektorale, për demokraci hibride, për demokraci autoritariane dhe forma të tjera false të demokracisë. Sipas Welzel dhe Inglehart këto forma false bëjnë që preferencat e masës të injorohen në masë të madhe nga elita politike në vend që të kenë një influencë vendimmarrëse te qeverisja, siç supozon teoria demokratike, dhe për këtë arsye është e nevojshme ndarja e konceptit të demokracisë efektive dhe nxjerrja e parametrave matës të saj. (Welzel, Inglehart, 2008).

Sipas Dahl arsyeja se përse sistemi demokratik performon më mirë sesa forma të tjera të qeverisjes është sepse merren vendime më të mira për njerëzit dhe sepse ato mund të kontrollohen nga njerëzit; prodhojnë pasoja më të dëshirueshme dhe janë më pak tiranike për qytetarët e tyre (Dahl, 1998:45). Për Held demokracia u lejon qytetarëve një pjesëmarrje më të madhe sesa thjesht votimi; ajo mundëson pjesëmarrjen nëpërmjet anëtarësisë në parti politike, grupe presioni, sindikata, protesta etj (Held, 1993:64). Pra kur qytetari është realisht në qendër të sistemit atëherë mund të flasim për demokraci efektive. Huntington thotë që “demokraci nuk do të thotë se problemet do të zgjidhen; por do të thotë se qeveritarët mund të hiqen dhe se thelbi i sjelljes demokratike qëndron në realizimin e kësaj të fundit, sepse e para është e pamundur që të realizohet” (Huntington, 2011:289).

3.8.2. Si e masim demokracinë efektive?

Për të matur demokracinë efektive sipas Alexander-it, Inglehart-it dhe Welzel-it është e nevojshme të kuptojmë Indeksin e të Drejtave Demokratike (DRI, do t'i referohemi duke ruajtur simbolikën ndërkombëtare si The Democratic Rights Index) në një vend të caktuar dhe Indeksin e Shtetit të së Drejtës (RLI, si Rule of Law Index). Për të kuptuar ne Indeksin e Demokracisë Efektive (EDI, si Effective Democracy Index) na shërben bashkimi i masës së të drejtave demokratike dhe i shtetit të së drejtës, pra $EDI = DRI + RLI$ (Alexander, Inglehart, Welzel, 2012).

Për këtë sistem nuk ka preferencë midis të drejtave demokratike dhe shtetit të së drejtës, të dyja trajtohen si të barabarta dhe ndikojnë njëllor në shumatoren finale dhe në klasifikimin final të nivelit të demokracisë efektive në një vend të caktuar të marrë në analizë. Indeksi i Demokracisë Efektive mund të jetë në minimum 0 kur mungojnë totalisht të drejtat demokratike (pra $DRI=0$) ose kur ato janë, por është në minimum shteti të së drejtës ($RLI=0$) që do të thotë që bëhen totalisht inefektive. Dhe ekstremi i kundërt është kur EDI është 100 në maksimum kur janë të dyja në 100, kur të drejtat demokratike janë plotësisht prezente ($DRI=100$) dhe maksimumi i shtetit të së drejtës ($RLI=1.0$) që i bën ato totalisht efektive.

Operacionalizimi i demokracisë efektive kërkon tregues të të drejtave demokratike dhe të shtetit të së drejtës. Për të matur të drejtat demokratike, Alexander dhe Welzel përdorin klasifikimin e lirive të bëra nga Freedom House (Alexander, Welzel, 2008, 2011). Edhe pse ky klasifikim është kritikuar për mungesën e transparencës në rregullat e kodifikimit

(Munck, Verkuilen, 2002), por klasifikimi shërben fare mirë për të matur liritë sesa tregues të tjerë (Bollen, Paxton, 2000; Casper, Tufis, 2002). Klasifikimi i lirive na vjen në dy tregues nga Freedom House. E para, sipas renditjes së “lirive civile”, të cilat tregojnë më së shumti liritë private që përfaqësojnë të drejtat e autonomisë. E dyta sipas renditjes së “lirive politike”, të cilat tregojnë liritë publike që reflektohen në të drejtat e pjesëmarrjes.

Tabela e mëposhtme tregon transformimin e renditjes së Freedom House në Indeksin e të Drejtave Demokratike. (Alexander, et al, 2012: 7)

Klasifikimi Freedom House	Liritë Civile (CLR)	Liritë Politike (PRR)	Bashkimi CLR + PRR	Inversion and zero-basing: – (CLR 14 PRR) + (CLR + PRR)	Percent standardizati on (DRI): (14 – (CLR + PRR))/0.12
Të lira	1	1	2	12	100.00
	1 (2)	2 (1)	3	11	91.66
	2	2	4	10	83.33
	2 (3)	3 (2)	5	9	75.00
Pjesërisht të lira	3	3	6	8	66.66
	3 (4)	4 (3)	7	7	58.33
	4	4	8	6	50.00
	4 (5)	5 (4)	9	5	41.66
	5	5	10	4	33.33
Pa liri	5 (6)	6 (5)	11	3	25.00
	6	6	12	2	16.66
	6 (7)	7 (6)	13	1	8.33
	7	7	14	0	0.00

Tabela 6 : Transformimi i renditjes Freedom House në DRI

Nisur nga ky klasifikim, ata kanë përpiluar skemën e demokracisë si përqindje e të drejtave demokratike të garantuara nga shteti (Alexander, et al, 2012: 8)




Tabela 7 : Klasifikimi i shteteve sipas të drejtave të garantuara

Matja më e mirë, e ofruar deri më sot, për shtetin e së drejtës është Indeksi i Shtetit të së drejtës të Bankës Botërore. Duke përdorur gjykimet e ekspertëve dhe sondazhet e popullsisë, ata mbështesin që ky indeks mat sa në mënyrë strikte zbatojnë dhe nisen nga ligjet agjentët e qeverisë në një vend (Kaufmann, Kraay, Mastruzzi, 2007). Alexander dhe Welzel i përpjesëtuuan këta dy tregues për të nxjerr atë që ata e quajnë Indeksi i Shtetit të së Drejtës RLI. Ata transformuan shkallën matëse të Bankës Botërore në një interval nga 0, për nivelin më të ulët të shtetit të së drejtës, që nga 1996 kur u themelua ky indeks deri në 1.0 për nivelin më të lartë të shtetit të së drejtës vëzhguar ndonjëherë. Pikët midis këtyre dy ekstremeve mund të jetë çdo fraksion i 1.0. Për të nxjerr RLI-në nga të dhënat e Bankës Botërore midis minimumit 0 dhe maksimumit 1.0 përdoret formula e mëposhtme: $RLI = (COS - LOS) / (HOS - LOS)$. Ku COS është pikët e vendit që është duke u vëzhguar, LOS është pikët më të dobëta të vëzhguara ndonjëherë nga Banka Botërore, dhe HOS është pikët më të forta të vëzhguara ndonjëherë nga Banka Botërore.

Duke shumëzuar DRI, Indeksën e të Drejtave Demokratike nga 0 në 100, me RLI, Indeksën e Shtetit të së Drejtës nga 0 në 1.0, ne përfitojmë Indeksën e Demokracisë Efektive, EDI.

3.8.3. A matet dot demokracia efektive? Kritikrat dhe kundërpërgjigjet

Matjes, që ne e paraqitem më lart si përcaktuese të demokracisë efektive, i janë bërë disa kritika nga studiuesi Knutsen që jepte shpjegimet e veta në lidhje me problematikën që kishte kjo matje. Ndërkohë në një artikull të mëvonshëm, duke sqaruar edhe njëherë metodën e matjes, Alexandër, Inglehart dhe Welzel kanë kundërgjigjetuar për secilën nga kritikrat e nxjerra në pah nga Knutsen. Kjo gjë që do të behët në këtë pjesë duke thënë kritikën e Knutsen (Knutsen, 2010) dhe më pas kundërpërgjigjen e tre studiuesve (Alexander, et al, 2012) që për ne është shumë e saktë dhe domethënëse dhe prandaj vazhdojmë ta zgjedhim atë metodë matëse.

Kritika e parë, që vjen nga Knutsen, është për përdorimin e matjeve ordinale për përlogaritjen e EDI-së. Argumenti i tij është që të dy komponentët si RLI dhe DRI janë në një shkallë ordinale në vend që të ishin të një shkallë intervali dhe në këtë mënyrë kodet nuk kanë një kuptim natyror numerik. Kështu procedura multiplikative, që është përdorur për të ndërtuar EDI-në, është me të meta, sepse ky operacion matematikor presupozon kode me skema kodimi numerikisht të interpretueshme.

Tre studiuesit e kësaj kritike i janë përgjigjur duke marrë në shqyrtim veç e veç RLI-në dhe DRI-në, që janë komponentët që ndërtojnë EDI-në. Për sa i përket RLI-së, ata thonë që indeksi rrjedh nga dhjetëra burime të dhënash të mbledhura në një shkallë faktoriale ku kanë brenda më shumë se njëqind vlera diskrete. Për ndërtimin e EDI-së, të dhënat për

shtetin të së drejtës janë “normalizuar” me fraksione nga shteti i së drejtës më i fortë i matur ndonjëherë, në mënyrë të tillë që shteti i së drejtës më i dobët i matur, të vendosej me 0. Skema e kodifikuar që na del, ka qartësisht kuptime numerike, duke na treguar neve distancës midis shtetit të së drejtës më të dobët dhe atij më të fortë që është vështruar. Në mbi njëqind vlera diskrete, RLI është shumë afër që të marrë formën e një shkallë intervali.

Ndërsa për sa i përket DRI-së, duke marrë në shqyrtim të dyja liritë, si liritë politike ashtu edhe liritë civile, sigurojnë një indeks të ndërtuar prej 7 pikësh. Të marra së bashku ato prodhojnë një indeks 13 pikësh, siç mund ta vëmë re edhe te tabela jonë nr.6. Ideja e Knutsen-it, që kjo është thjesht renditje dhe nuk na jep shkallë intervali për interpretim, është e gabuar. Freedom House përdor një listë prej 25 pyetjesh, ku secila nga këto është e renditur në një shkallë prej 5 pikësh. Në kombinim, 25 pyetjet prodhojnë një skemë pikëzimi me 100 pikë. Indeksi i kombinuar prej 13 pikësh është thjesht një version i përpunuar i skemës 100 pikëshe. Kjo do të thotë që kjo skemë 13 pikëshe ka brenda madhësinë e intervaleve për secilën kategori. Prandaj, indeksi nuk përmban vetëm informacion ordinal dhe të renditur, por edhe informacion në formë intervali. Më pas përpunimi që bëhet për të nxjerrë DRI-në, siç e tregon edhe tabela 6, i rikthehet një klasifikimi me interval nga 1 deri në 100, ku klasifikon llojin e regjimit (Alexander, etc, 2012).Për sa më lart hidhet poshtë kritika e Knutsen-it se fakti që EDI është në shkallë ordinale, të mos jap mundësinë e interpretimeve numerike dhe ndërtimin e vlerave në interval.

Kritika tjetër e Knutsen-it ka qenë që, sipas tij, EDI nuk ishte i ndërtuar në mënyrë të barabartë nga të dy komponentët DRI dhe RLI, por llogaritja i jepte më shumë peshë DRI-së sesa RLI-së duke e lidhur me pikëzimet që bëhen nga autorët. Autorët përgjigjen që kjo është empirikisht e pasaktë, mjaftojmë të kuptojmë faktin që cilido nga dy komponentët, qoftë në masën 0, bën që sado të jetë vlera e tjetrit mos të vlejë në llogaritjen e EDI-së, dhe shteti të dalë në nivel 0 për sa i përket Indeksit të Demokracisë Efektive(Alexander, etc, 2012).

Kritika kryesore lidhet me atë që Knutsen e quan trajtim të dyfishtë, që nuk lidhet drejtpërdrejt me multiplikimin e dy komponentëve në fund, por me atë që përmbajnë brenda këta komponentë. Konkreisht Knutsen akuzon se në matjen e EDI-së llogaritet dy herë shteti të së drejtës sepse brenda DRI gjejmë edhe sundimin e ligjit (Knutsen, 2010). Ai nisët nga vetëdeklarimi që bën Freedom House, në lidhje me qëllimin e saj, që jo thjesht të masë sesa formalisht janë të garantuara të drejtat, por edhe sesa ato realisht respektohen në praktikë. Ky qëllim i saj implikon që sundimi i ligjit dhe funksionimi i shtetit të së drejtës të jenë tashmë të absorbuara brenda DRI-së. Kështu sipas tij kur autorët llogarisin EDI-në duke i shtuar DRI-së edhe RLI-në janë duke bërë trajtim të dyfishtë të shtetit të së drejtës.

Autorët përpara se të hedhin poshtë idenë e mbivendosjes së dy faktorëve, fillimisht bëjnë një ushtrim duke e llogaritur mbivendosjen e sundimit të ligjit dhe nxjerrin rezultatin e njëjtë me renditjen e EDI-së përpara se të llogaritej DRI në katror, pjesëtim 100 (që është llogaritja që bëhet duke dashur të heqësh mbivendosjen e sundimit të ligjit te DRI) rezultatet e vendeve nuk ndryshojnë nga klasifikimi i tyre sepse nuk ka asnjë ndryshim mes

vendeve që e kanë EDI-në 20.8 nga ato që e kanë 20.3, pra ndryshimi nuk është thelbësor për të kuptuar nivelin e vërtetë të demokracisë efektive në një vend. (Alexander, etc, 2012:51-52)

Kjo vjen edhe si arsye që në fakt të flasësh për mbivendosje të sundimit të ligjit tek të dy komponentët nuk ka sens logjik. E para, sepse mënyra sesi i merr informatat dhe si i nxjerr rezultatet Freedom House nuk është e njëjta me atë që përdor Banka Botërore, por dhe nuk kemi hasur asnjëherë një deklaratë apo qëndrim të Freedom House që të pretendojë se na jep informacionin të mirë mbi shtetin të së drejtës dhe sundimin e ligjit në një vend. E dyta, duke dashur realisht që të shpjegojnë sesa klasifikimi i Freedom House mund ta përfshijë sundimin e ligjit ata sqarojnë se: nga 25 pyetje që ngrihen nga Freedom House, vetëm 4 prej tyre kanë lidhje me sundimin e ligjit, por edhe këto nuk janë pyetje të drejtpërdrejta mbi sundimin e ligjit. Këto 4 pyetje llogariten me gjashtëmbëdhjetë pikë në skemën 100 pikëshe që ndërton Freedom House. Kjo na tregon që sundimi i ligjit vlerësohet më pak se një e gjashta në të gjithë rankimin që i bëhet lirive nga Freedom House. Ky proporcion nuk është thjesht arbitrar dhe shumë i vogël, por edhe thjeshtëzohet në një mesatare brenda tërësisë së skemës së pikëzimit. Kjo e bën një aspekt dytësor dhe shtesë në llogaritjen e të drejtave demokratike.

Një tjetër kritikë përsëri nga Knutsen bëhet duke zgjedhur disa shtete dhe duke arsyetuar që në aspektin e demokracisë ato duhet të qëndrojnë më lart sesa renditjet po të llogaritet thjesht EDI. Rastet sipas tij janë: Argjentina, India, Benini dhe Singapori, që në analizën e tij meritojnë më shumë konsideratë në drejtim të demokracisë (Knutsen, 2010). Tre autorët

argumentojnë që rastet duken të sakta nëse shikohen vetëm nga pikëpamje elektorale. Argumenti që Knutsen përdor për të vënë në dukje renditjen sesa një shtet është më demokratik në raport me një vend tjetër nuk është e dhëna që del nga EDI, por janë të gjitha kriteret e regjimit elektoral si: ekzistenca e zgjedhjeve të ndershme, ndryshimi i qeverive, dhe zhvillimi i fushatave në mënyrë të papenguar. Në këtë mënyrë Knutsen ka përdor kriteret e një lloji demokracie, siç është demokracia elektorale për të gjykuar pikëzimin dhe renditjen e EDI-së, ku në fakt EDI ngrihet jashtë konceptimit të demokracisë thjesht elektorale. Që do të thotë që kritika nuk vlen sepse EDI nuk po gjykohet mbi premisën për të cilën ngrihet si indeksi i institucionalizimit efektiv të pushtetit të njerëzve në një vend demokratik.

Kritika e fundit lidhet me vlefshmërinë e EDI-së. Knutsen hedh idenë se ky sistem është i krijuar për të favorizuar vendet e pasura, sepse në analizën që bën midis nivelit të GDP-së për frymë të shteteve dhe pozicionimin e tyre në Indeksin e Demokracisë Efektive shikon një lidhje mes tyre, duke qëndruar më lart vendet që kanë edhe nivel më të lart të GDP-së për frymë. Por autorët përgjigjen që EDI nuk është ndërtuar për të favorizuar ose jo vendet në bazë të GDP-së për frymë sepse nuk e merr fare këtë në treguesit e vet. Nëse ndodh diçka e tillë, kjo konfirmon edhe një herë teorinë e Inglehart-it mbi ndryshimin e vlerave, që rritja e nivelit ekonomik të një vendi çon në përkrahjen, por dhe në bërjen pjesë të tyre të vlerave të vetafirmimit nga qytetarët dhe për rrjedhojë rrit nivelin e demokracisë efektive. Vështirë që niveli i demokracisë efektive të lulëzojë në vendet me vështirësi ekonomike, kjo edhe nëse kemi parasysh piramidën e nevojave që ndërton Masllow, që në fillim priren

të plotësojnë nevojat e tyre bazike dhe më pas, në një fazë të dytë, të merren me sistemin politik, me idetë, me drejtësinë sociale etj.

Për sa më lart dallohet që pavarësisht kritikave EDI është një instrument shumë konkret dhe i mirëndërtuar për të matur atë që është thelbi i kësaj matjeje: fuqinë reale të qytetarit në sistemin e tij politik, social, ekonomik. Gjë që e bën një vend demokratik ose jo.

3.9.Vlerat e vetafirmimit dhe demokracia efektive

Inglehart dhe Welzel argumentojmë se vlerat shekullare nuk kanë të bëjnë fare me demokracinë: një kulturë shekullare është e përputhshme me komunizmin dhe fashizmit, ashtu si edhe me demokracinë. Por tendenca kulturore që vërtet ia vlen për t'u marrë në studim në lidhje me demokracinë është niveli i vlerave të vetafirmimit. Ka edhe një lidhje logjike midis të paturit një numër të madh, një proporcion të madh njerëzish që kanë vlera të vetafirmimit, të cilët ndihen ekonomikisht të sigurt, të pavarur nga dominimi i elitave dhe kërkojnë e besojnë në “aftësinë për të marrë vendime dhe për të kryer veprime të bazuara në autonominë e zgjedhjeve të tyre” dhe mundësisë për të pasur një sistem demokratik në të cilin përfaqësuesit respektojnë kërkesat e qytetarëve (Inglehart, Welzel, 2005:47).

Të dy argumentojmë kundër idesë që shprehin Linz-O'Donnell-Schmitter se mjafton të kuptojmë kornizën e funksionimit dhe të ndërtimit të elitave për të kuptuar ndryshimin e regjimit duke nënvlerësuar impaktin e kulturës politike: “Demokracia nuk është thjesht një rezultat i vullnetit të elitave dhe ndërtimit konstitucional. Ajo varet nga lloji i orientimit që

kanë njerëzit ndërmjet tyre. Këto orientime i motivojnë ata të kërkojnë për liri, për të drejta efektive civile dhe politike dhe një qeverisje të përgjegjshme dhe të kërkojnë në vazhdimësi me anë të një vigilance që të sigurojnë se elitat qeverisëse do t'iu përgjigjen atyre” (Inglehart, Welzel, 2005:300).

Siç e argumentuam më lart ata dallojnë midis demokracisë formale dhe asaj që ata e quajnë demokraci efektive, e cila inkorporon brenda vetes edhe informacion mbi integritetin e elitave. Ata thonë që “tranzicioni drejt demokracisë ndodh kur dhe ku vlerat e vetafirmimit janë të përqafuar nga shumica e njerëzve dhe kjo çon në rritjen e numrit të aktivistëve të së drejtave dhe disidentëve. Ky ndryshim çon edhe në modifikimin e numrit dhe të intensitetit të lëvizjeve sociale, që luftojnë për të drejta të caktuara, duke pasur edhe më shumë mbështetje nga opinioni publik që ndan ato vlera; bën që elitat të shndërrohen në pro ndryshimeve të regjimit. Kur aktivistët prodemokraci eventualisht marrin iniciativën, këto elita janë më pak të prirura drejt idesë që t'i shtypin ato”. (Inglehart, Welzel, 2005:224-228)

Pra mund të themi që sa më shumë qytetarë të kenë vlera të vetafirmimit, më shumë aktivistë të lëvizjeve sociale ata janë, më shumë legjitimitetin i japin edhe ata jo-aktivist dhe më shumë priren elitat për t'iu përgjigjur kërkesave. Argumentimi sesi lëvizjet sociale mund të ndikojnë drejtpërdrejt në demokraci dhe në demokratizim na vjen nga Diamond, i cili rendit rrugët sesi lëvizjet sociale mund të ndikojnë në demokraci (Diamond, 1999):

E para, dhe më e rëndësishmja është se ai hedh bazat për kufizimin e fuqisë së shtetit, si kontrolli i shtetit nga shoqëria dhe nga institucione politike më demokratike që janë më të

hapura për të ushtruar këtë lloj kontrolli. Ky funksion ka dy dimensione: të monitorojë dhe të kufizojë pushtetin në shtetin demokratik dhe të demokratizojë shtetet autoritariane.

E dyta, një jetë aktive, e pasur e shoqërisë civile dhe e qytetarëve i jep ndihmesë edhe rolit të partive politike për të stimuluar së bashku pjesëmarrjen politike, duke rritur efikasitetin politik dhe aftësinë për qytetarë demokratikë, duke promovuar një vlerësim për të drejtat dhe detyrimet të një qytetarie aktive demokratike.

E treta, shoqëria civile mund të jetë një arenë kyçe për zhvillimin e disa vlerave demokratike siç janë toleranca, moderimi, dëshira për kompromis dhe respekti për këndvështrimet ndryshe dhe të kundërta. Pikërisht kjo lidhet drejtpërdrejt me vlerat e vetafirmimit, për të cilat flet Inglehart dhe që lidhen drejtpërdrejt me zhvillimin e shoqërisë civile dhe më pas ekzistenca e kësaj shoqërie çon në forcimin dhe në ruajtjen e tyre si dhe në shërbimin drejt demokracisë.

E katërta, rruga sipas së cilës shoqëria civile mund t'i shërbejë demokracisë është duke krijuar kanale të tjera veç partive politike për artikullimin, agregimin dhe përfaqësimin e interesave. Kjo lidhet fort edhe me grupe të caktuara, që mund të ndihen të diskriminuara brenda një shoqërie, qofshin këto minoritete etnike, fetare etj. Shoqëria civile mund t'i shërbejë më shumë demokracisë sidomos kur mund të gjenerojë mundësi për pjesëmarrje dhe ndikim në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe jo vetëm në atë lokal.

E pesta, një shoqëri civile e pasur dhe pluraliste, mund të gjenerojë një shumësi interesash të pritshme mes tyre në moment të caktuara, por sidomos po të jetë edhe një ekonomi e qëndrueshme kjo bën që të ulët niveli i polaritetit dhe i konfliktit politik.

Mënyra e gjashtë, që çon drejt demokratizimit, është rekrutimi dhe trajnimi i liderëve të rinj politikë dhe në një farë mënyrë kjo ndikon në shtimin e ofertës demokratike. E shtata, lidhet me qëllimin që kanë shumë organizata të shoqërisë civile që të shërbejnë për procesin e ndërtimit të demokracisë në mënyrë sa më drejtpërdrejtë. Janë organizata që punojnë për ndërtimin dhe reformat e sistemeve elektorale, monitorimit të zgjedhjeve, monitorimin e të drejtave të njeriut, për të drejtat dhe liritë e minoriteteve, për të përmirësuar kushtet e të burgosurve etj.

E teta, na shpjegon se një shoqëri civile aktive mund të shpërndajë më shumë informacion për qytetarët duke dhënë informacion mbi ato që ndodhin, duke i ndihmuar kështu qytetarët që ta kanë më të lehtë, që në mënyrë kolektive dhe më të informuar të mbrojnë dhe të ndjekin interesat dhe vlerat e tyre. Shpërndarja e ideve të reja, që mund të bëjë shoqëria civile është thelbësore për arritjen e një reforme ekonomike në demokraci, e cila është edhe mënyra tjetër sesi mund t'i shërbejë demokracisë. Një reformë e suksesshme ekonomike kërkon mbështetjen e koalicioneve politike, e shoqërisë dhe të legjislaturës. Mënyra e fundit mund të lidhet me të gjitha ato që përmendëm: me përmirësimin e llogaridhënies, e përgjegjshmërisë, përfshirjes, efektivitetit qeverisës dhe me legjitimitetin e sistemit politik, një shoqëri civile i jep qytetarëve mundësi për të pasur respekt për shtetin dhe një angazhim pozitiv brenda tij.

Vlerat e vetafirmimit reflektojnë një sintezë të besimit më të madh ndërpersonal, tolerancës dhe aktivizimit politik, që luajnë një rol thelbësor në lindjen dhe mbijetesën e demokracisë në përgjithësi dhe jo vetëm të asaj që e quajmë demokraci efektive. Shoqëritë që theksojnë vlerat e vetafirmimit kanë një orientim më pjesëmarrës në shoqëri dhe në politikë, mbështetësin barazinë gjinore, janë relativisht tolerantë ndaj të huajve, homoseksualëve dhe grupeve të tjera të marginalizuara (Welzel, Inglehart, 2008:128). Nga ana tjetër shoqëritë që theksojnë vlerat e mbijetesës kanë tendencën e preferencave të kundërta në cilëndo nga këto fusha të mësipërme. Në theksim në rritje i vlerave të vetafirmimit sjell një rritje të kërkesës për liri civile dhe politike, për barazi gjinore, për qeveri perceptuese dhe pranuese të nevojave të qytetarëve që ndihmon në vendosjen dhe mbajtjen e institucioneve demokratike (Welzel, Inglehart, 2008:128).

Këtu kemi një paraqitje skematike që na shpjegon shumë thjesht sesi mundën vlerat e vetafirmimit të ndikojnë dhe të jenë faktor i rëndësishëm për demokracinë në një vend.

RRITJA E VLERAVE TË VET-AFIRMIMIT				
Në regjimet jodemokratike			Në regjimet demokratike	
↓	↓	↓	↓	↓

Rritje të numrit të aktivistëve për të drejtat civile dhe politike	Rritje të mbështetjes së masës për lëvizjet për të drejta civile dhe politike	Rritje e numrit të reformatorëve liberalë mes elitës	Rritje e numrit të aktivistëve për barazinë e mundësive	Rritje të mbështetjes së masës për lëvizjet për barazinë e mundësive	Rritje të sensibilitetit të elitave në përgjigje të masave
⇓	⇓	⇓	⇓	⇓	⇓
Adoptim formal i institucioneve demokratike			Rritje të efikasitetit të institucioneve demokratike		
⇓			⇓		
FORTËSIM I INSTITUCIONEVE DEMOKRATIKE					

Skema 4: Influencimi i vlerave të vetafirmimit në forcimin e institucioneve demokratike (Welzel, Inglehart, 2008a, 184)

KAPITULLI IV : KONTEKSI HISTORIK


4.1. Vlerat dhe demokracia në vendet ish- komuniste të Europës Juglindore

Nuk mund të marrim në gjykim secilën nga vendet ish -komuniste në Europën Juglindore, por mund të gjykojmë për disa pika të përbashkëta dhe për disa elemente dalluese të procesit të tyre të demokratizimit, të lidhura me aspekte kulturore dhe thelbësisht vlerore. Këtu do të veçonim dy autorët më të rëndësishëm, Samuel Huntington-in dhe Ronald Inglehart-in, ky i fundit si lider i studimeve bashkë me teoricienë të tjerë të Vëzhgimit Botëror të Vlerave, përpos gjithë të tjerëve, që mund të merren në konsideratë në lidhje me studimet mbi vlerat dhe demokratizimin në këto vende.

Studiuesit Inglehart, Baker, Welzel, në studimet e tyre në lidhje me vlerat, të ndara sipas boshteve tradicionale vs shekullare dhe boshteve mbijetesë vs vetafirmim, vendet ish-komuniste i grupojnë së bashku. Duke pasur pak a shumë të njëjtin profil vleror, që anon me vlera të forta të mbijetesës dhe me vlera shekullare. Duke ndarë zonat kulturore autorët gjykuan që: “zhvillimi ekonomik duket sikur i lëviz shoqëritë në drejtim të njëjtë, pa marrë parasysh trashëgiminë kulturore. Sidoqoftë zona të ndryshme kulturore vazhdojnë edhe pas dy shekujsh nga revolucioni industrial” (Inglehart, Baker, 2000:30).

Ne e dimë çfarë ndodhi ekonomikisht me vendet komuniste të Europës Juglindore dhe në vendin tonë gjithashtu. Centralizimi i ekonomisë, planifikimi i saj, përdorimi më shumë me fokus industrial dhe niveli i ulët i përmbushjes së nevojave ekonomike të qytetarëve të këtyre

vendeve janë të përbashkëta të komunizmit. Mungesat e theksuara ekonomike ishin ato që dhanë edhe shtysën më të fortë për rënien e regjimit komunist. Në këtë drejtim është e logjikshme që vendet e Europës Juglindore të përngjajnë dhe të grupohen në vlera dhe me kulturë demokratike të ngjashme. Këtu kemi një paraqitje të hartës së vlerave të përpunuar nga Inglehart dhe Welzel, në serinë e hartave që kanë përpunuar pas çdo vale anketimi. Zgjedhëm këtë hartë sepse është në ato valë ku del edhe Shqipëria. Siç vihet re sipas studimit të tyre është e pozicionuar si një shoqëri me vlera shekullare dhe me vlera të mbijetesës.



Harta 1: Harta kulturore e Botës, Inglehart dhe Welzel 1999-2004

(marrë

http://www.worldvaluessurvey.org/wvs/articles/folder_published/article_base_54,
kontrolluar më 17 qershor 2013)

nga

Huntington është një autorët më me influencë në studimet për demokratizimin. Sipas tij ekzistojnë disa faktorë, arsye, variabla që ndikojnë drejtpërdrejt në demokraci dhe për demokratizimin. Në literaturën e tij gjejmë 27 të tillë, të cilët i kemi renditur në tabelën e mëposhtme (Huntington, 2011:55-56)

Nr	Variabla të rëndësishëm që kontribuojnë për demokracinë dhe demokratizimin
1	Një nivel i përgjithshëm i lartë i mirëqenies ekonomike
2	Shpërndarja relativisht e barabartë e të ardhurave dhe/ose pasurisë
3	Ekonomia e tregut
4	Zhvillimi ekonomik dhe modernizimi social
5	Aristokracia feudale në një moment të caktuar të historisë së shoqërisë
6	Mungesa e feudalizmit në shoqëri
7	Një borgjezi e fortë
8	Një klasë e mesme e fuqishme
9	Nivele të larta edukimi dhe arsimit
10	Një kulturë të dobishme sesa konsumatore
11	Protestantizmi
12	Pluralizmi social dhe grupet e fuqishme ndërmjetësuese
13	Zhvillimi i konkurrencës politik para zgjerimit të pjesëmarrjes politike
14	Struktura, autoriteti demokratik, brenda grupeve shoqërore, sidomos të atyre të lidhura ngushtë me politikën
15	Nivele të ulëta të dhunës civile
16	Nivele të ulëta të polarizimit politik dhe ekstremizmit
17	Udhëheqës politikë të përkushtuar ndaj demokracisë
18	Përvoja si koloni britanike
19	Traditat e tolerancës dhe kompromisit
20	Pushtimi nga një fuqi e huaj prodemokratike
21	Influenca e një fuqi të huaj prodemokratike
22	Dëshira e elitës për t'u matur me kombet demokratike
23	Tradita e respektit ndaj ligjit dhe të drejtave të individit
24	Homogjeniteti shoqëror (etnik, racor, fetar)
25	Heterogjeniteti shoqëror (etnik, racor, fetar)
26	Konsensusi mbi vlerat politike dhe shoqërore
27	Mungesa e konsensusit mbi vlerat politike dhe shoqërore

Tabela 8: Variablat e demokratizimit

Nga kjo listë vëmë re se Huntingtoni ndryshimin e shpejtë dhe të suksesshëm drejt demokracisë e lidh me ekonominë dhe me sjelljen qytetare. Ai ka përpunuar edhe një skemë të thjeshtëzuar, që flet për ekonominë, vlerat dhe demokratizimin, e cila ngjan, por edhe përputhet në logjikë me skemën që jep Inglehart për rritjen e vlerave të vetafirmimit dhe më pas rritjes së nivelit të demokracisë. Të dy autorët e lidhin këtë ndryshim me zhvillimin ekonomik.

	Popull shumë më i arsimuar		
Nivel më i lartë i zhvillimit ekonomik		Sjellje të kulturës qytetare-besim, kënaqësim, kompetencë	Mbështetje për demokratizimin
	Klasa e mesme më e madhe		

Skema 5 : Zhvillimi ekonomik si faktor i demokratizimit, (Huntington, 2011:88)

“Zhvillimi ekonomik nxit zgjerimin e klasës së mesme. Në një farë mase demokracia mbështetet te rregulli i shumicës, ndaj demokracia është e vështirë në një situatë kur kemi shtim të pabarazive, në të cilën një shumicë e madhe, e varfëruar, përballet me një oligarki të pasur, të vogël” (Huntington, 2011:86). Të njëjtën lidhje e shprehin edhe studiuesit Kapstein dhe Converse kur thonë se: “përfshirja ekonomike është e lidhur ngushtë me përfshirjen politike, pra edhe me forcimin e demokracisë” (Kapstein&Converse, 2008:61).

Pikërisht fakti që diktaturat dështuan në arritjen e suksesit ekonomik në vendet e Europës Juglindore, duke qenë edhe faktori kryesor që i çoi në rënie, ne presim një pasqyrë pak a shumë të ngjashme të tyre për sa i përket vlerave që mbështesin nivelin dhe cilësinë e demokracisë që kanë instaluar në vend. Po ashtu ekonomia lidhet fort jo vetëm me

trashëgiminë e saj në kulturën politike dhe qytetare që ia la komunizmi, por edhe me të ardhmen e demokracisë, “vendet me transformimet më të përparuara dhe të suksesshme ekonomike kanë qenë në një njëjtën kohë sistemet me të sigurtat dhe efektive demokratike dhe me arritjet më të mëdha në të drejtat politike dhe qytetare” (Krasniqi, 2012:29).

Pavarësisht impaktit shumë të rëndësishme të faktorit ekonomik në klasifikimin e përbashkët të vendeve ish- komuniste, një rol të pamohueshme ka vetë mënyra sesi është i ndërtuar komunizmi dhe si është realizuar ai në këto vende, në të gjitha metodat dhe mjetet e tij për të ndërtuar jetën sociale, morale dhe politike të qytetarëve të vet. Inglehart dhe Baker shprehen se “komunizmi la gjurmë të qartë në sistemin e vlerave të atyre që jetuan në atë sistem” (Inglehart, Baker, 2000:31). Në një studim për tranzicionin politik në Europën Qendrore dhe Lindore, studiuesja Tafili shprehet në lidhje me ndikimin e trashëgimisë perandorake dhe komuniste të këtyre vendeve duke thënë se: “natyra e trashëgimisë perandorake ka ndikim te natyra dhe aftësia e shtetit, ndërsa natyra e trashëgimisë totalitariste ka ndikim tek aftësia e shoqërisë civile. Pra një shtet i efektshëm dhe një shoqëri e gjallë civile janë thelbi i konsolidimit të një autoriteti të qëndrueshëm demokratik” (Tafili, 2008:35).

Tashmë është një fakt i padiskutueshëm se komunizmi i atomizojë shoqëritë europiano lindore, duke shkatërruar pothuajse të gjitha institucionet autonome të veprimtarisë kolektive, të cilave shpesh u referohemi si “ shoqëri civile” duke lejuar fare pak hapësirë në sferën publike për çdo lloj forme të iniciativës së lirë private apo të grupit të kishte sukses (Tarifa, 2009:100). Në një analizë që bën për sistemit partiake dhe qeverisëse në Europën

Juglindore, studiuesi Krasniqi vë në dukje se: “aspekte të kulturës politike siç janë respekti për tjetrin dhe votën kundër, dialogu konstant e produktiv politik, bashkëpunimi politik parlamentar, pavarësisht raporteve të përfaqësimit, nevoja për institucione të forta në vend, të liderëve të fortë, pjesëmarrja e lartë në zgjedhje apo zgjerimi i rrethit të vendimmarrjes politike- janë dukuri ende të brishta në të gjitha vendet e Europës Juglindore” (Krasniqi, 2012:19).

Aspektet, që përmenden më lart, lidhen në mënyrë të pashmangshme me sistemet e vlerave që kanë qytetarët e këtyre vende dhe detyrimisht edhe elita politike që ka jetuar në një njëjtin mjedis ekonomik dhe social gjatë komunizmit. Të gjitha elementet e mësipërme janë të lidhura me vlerat e vëtafirmimit: tolerancë dhe besim tek tjetri, pjesëmarrje aktive, llogaridhënia dhe kërkimi i llogarisë, marrja pjesë në punët publike. Dëshira për të marrë pjesë në punët publike u mishërua vetëm në elementin e partive politike në këto vende dhe jo në aspekte të tjera të të bërit politikë dhe të të qenurit zë pa qenë në politikë. Në përgjithësi, sipas pikëpamjes së studiuesit Atilla Agh: “procesi i formimit të partive në vendet e Europës Lindore dhe Qendrore ka kaluar nga “partitë-lëvizje”, si një organizim-ombrellë në fillimet e veta (solidarnost në Poloni, Forumi Demokratik në Hungari dhe i ngjashëm me këtë të fundit edhe në vende të tjera të Europës Lindore e Qendrore: Forumi Civil në ish Çekosllovakinë, Aleanca e Forcave Demokratike në Bullgari) në parti të plota ose siç është përshkuar më ky proces në “overparticization” (Kekezi, 2008:46). Po ashtu edhe Shqipërinë mund ta rendisim këtu sepse Partia Demokratike është një parti që rrjedh nga një lëvizje studentësh dhe intelektualësh për liri dhe demokraci, për më shumë të drejta

në vitet 90' dhe më vonë partitë u shumëfishuan duke kapur shifra rekord për sa i përket raportit parti dhe elektorat, zgjedhës të mundshëm.

Por pavarësisht organizimit në parti politike nga lëvizjet e popullsisë por jo vetëm edhe nga faktorë të tjerë, kjo nuk bëri që qytetari të ishte më në qendër të sistemit dhe të mund të realizonte kërkesat dhe nevojat e tij përmes partive dhe organizimeve politike. “Demokracia u shoqërua me prirjen politike të aktorëve vendimmarrës (sidomos liderëve të partive, shënimi jonë) për ta përdorur lirinë demokratike në funksion të projekteve dhe axhendave të tyre personale” (Krasniqi, 2012:19)

4.2. Vlerat dhe demokracia në Shqipëri

Në këtë pjesë zgjedhim që të marrim në shqyrtim atë çfarë mund të gjejmë në fushën e vlerave të shoqërisë shqiptare dhe pas viteve 90' me vendosjen e sistemit demokratik dhe disa pikëpamje të studiuesve në lidhje me këto fenomene

Ne do marrim të mirëqenë që një pasqyrë të vlerave tradicionale shqiptare mund ta gjejmë duke marrë në shqyrtim kanunet: kanunin e Lek Dukagjinit dhe kanunin e Labërisë. Kanunet janë kode të sjelljes të cilat janë zbatuar në Shqipërinë e hershme si të ishin ligje të sanksionuara në forcën detyruese të një shteti të fuqishëm. Në analizë përmbajtësore të tyre vëmë re që janë disa vlera të përbashkëta që gjenden të shkruara në të dyja kanunet dhe të zbatuara nga të dyja krahinat, ajo jugore dhe veriore e vendit. Shtyllë bazë që e gjejmë tek të dyja kanunet është familja. Një familja e madhe, me një strukturë të mbyllur dhe të qartë

hierarkike, ku figura qendrore është kryefamiljari, burri i shtëpisë, ai më i moshuari. E vendosin të dy kanunet, në qendër të shoqërisë si një pikë shumë e rëndësishme e ndërtimit të vetë strukturave të tjera të shoqërisë. Sepse familja në një farë mënyre vendoste edhe për fatin në martesë të të rinjve, për punën e tyre, për marrëdhëniet me të tjerët, miq apo armiq qofshin ata. Duke hequr dorë nga autonomia individuale, për shqiptarët e rëndësishme ishte kohezioni familjar. Secili në familje i gjen në shprehura në kanun rolin e tij, me të drejtat dhe detyrat e përcaktuara dhe të gjithë duhet ti respektojnë ato dhe ti binden atyre.

Nderi është një vlerë shoqërore për çdo njeri të pasur apo të varfër, ai fitohet dhe mbrohet, në familje, në vëllazëri, farefis dhe krejt bashkësinë njerëzore, shkruhet në nenin 24 të kanunit të Labërisë (Elezi, 2006:39) duke e theksuar atje si një vlerë të rëndësishme të një shoqërie të mirë. Të njëjtën rëndësi për nderin e gjejmë edhe tek kanuni i Lek Dukagjinit, ku vendoset se nderi personal është i paprekshëm dhe kush e cenon nuk mund të falet dhe ndahet larë më gjak (Gjecovi, 2005:64). Po ashtu të dyja kanunet flasim për besën, që mund ta konsiderojmë në listën e vlerave, në kuptimin e saj si shenjë respekti ndaj marrëveshjes së bërë me gojë dhe zbatimi i saj me seriozitet sikur të ishte marrëveshje para një noteri sot, me fuqi detyruese. Në kanunin e Labërisë gjejmë në nenin 29 pika 4 që besa e dhënë nuk shkelet kurrë nga askush (Elezi, 2006:42). Në kanunin e Lek Dukagjinit thuhet se besa një vatër lirie dhe siguri (Gjecovi, 2005:82). Kjo shpjegon fare mirë sesa e rëndësishme është kjo në shoqërinë shqiptare që të garanton lirinë dhe sigurinë, sepse nëse je në besën e dikujt, ose të jepet besa për diçka nuk ekziston asnjë mundësi që ai që jep besën ta shkel atë.

Mikpritja dhe koncepti që kanunet ndërtuan mbi mikun, janë ndër shtyllat parimore të tyre dhe po ashtu njihen si vlera tradicionale shqiptare. Mikpritja flet për një shoqëri solidare, për një shoqëri e cila mbështetet fort te njeri-tjetrin, shumë e lidhur me tjetrin dhe e ndikuar prej tij. Bile nga kanunet del qartë që respekti i shoqërisë ndaj një individi varej shumë nga masa që ai e respekton këtë vlerë siç është mikpritja. Për shembull në kanunit e Labërisë gjejmë shprehimisht në nenin 42, pika 6, që “ai që ka miq më shumë, vlerësohet më tepër në bashkësi” (Elezi, 2006:47), ndërsa në atë të Lek Dukagjinit mund të thuhet që “për çdo mik jepet buka që ha vetë” (Gjecovi, 2005:65). Kjo e fundit tregon një trajtim të mikut si të barabartë me veten, dhe bile sanksionohet një mbrojtje nga i zoti i shtëpisë kur miku ndodhet në shtëpinë e tij.

Te kanunet gjejmë të reflektuar një shoqëri që beson, një shoqëri që i njeh fetë, i respekton ato, por edhe kryen rituale fetare. Objektet fetare janë të shenjta, nuk preken, kanë tokat e tyre dhe rëndësinë e tyre në shoqëri. Në kanunin e Labërisë për sa i përket lirisë së besimit gjejmë të sanksionuar në nenin 14 “kujtdo dhe të gjithëve u lejohet dhe u sigurohet e drejta e besimit fetar; askush nuk mund të cenojë, të pengojë ose të prishë ushtrimin e lirë së veprimtarisë fetare; kundër shkelësve bashkësia e njësisë vendore përkatëse ka të drejtë të marrë masa ndëshkimore deri në dëbimin e tij nga bashkësia” (Elezi, 2006:37) Në kanunin e Lek Dukagjinit flitet për kishën si institucion i paprekshëm për arsye se besimi fetar katolik ishte praktikuar në pjesën veriore të vendit. Kisha kishte status të veçantë, si edhe ligjet e veta; ajo nuk zbatonte ligjet e kanunit (Gjecovi, 2005:1-2). Nga rëndësia, të cilën e gjejmë të shprehur në kanune, besoj se besimi fetar ka qenë pjesë e vlerave tradicionale

shqiptare edhe pse gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri është ndaluar praktikimi fetar.

Mbas kësaj që gjejmë te kanunet si një pasqyrë vlerore për shqiptarët, momenti tjetër ku mund të gjykohet për vlerat apo për antivlerat në shoqërinë tonë është periudha e komunizmit. “Gjatë viteve të regjimit totalitar “mbretëronte” udhëheqja dhe fjala e një individi që shihej si “idhull” nga shqiptarët, falë propagandës ideologjike apo edhe diktatit të vetë shtetit” (Dhima, 2010:198). Studiuesja, Edlira Gjuraj, në punimin e saj në lidhje me kulturën kombëtare në kulturën organizative thotë që: “gjatë viteve të diktaturës mund të themi që pati një theksim të homogjenitetit në termat e përpjekjeve për të njëtrajtësuar punonjësit (qytetarët, shënimi ynë) me figurën e “njeriut të ri”- vepër e partisë së punës dhe për shkatërrimin e besimeve fetare, që nga shkatërrimi i institucioneve të kultit deri në përndjekjen e rreptë të praktikantëve të saj” (Gjuraj, 2013:17).

Në kushtet e një mungese lirie të fesë dhe të jetës kulturore mononokultuore, sistemi i vlerave ishte i komanduar dhe i kontrolluar nga një strukturë tepër e përpunuar, kështu shprehet studiuesi Gjergj Sinani, në një vështrim që bën në lidhje me fenë (Sinani, 1999:74). Gjatë komunizmit indoktrimi ishte aspekti kryesor i gërshetuar me jetën sociale të individëve sidomos në aspekte të egalitarizmit, të vullnetarizmit, të rolit të gruas, të mungesës së besimit në institucionet fetare, prirjen drejt progresit industrial dhe më pak shqetësim për mjedisin. “Komunizmi u premtoi njerëzve një parajsë, por jo një parajsë në qiell, por një parajsë në tokë. Shpëtimtari, gati mesiatik, ishte partia, ose për të qenë më të saktë sekretari i parë i Komitetit Qendror të Partisë. Vendin e librave të shenjtë fetarë në

Shqipëri e zunë veprat e Enver Hoxhës, që ishte diktatori i shqiptarëve” (Sinani, 1999:74). Studiuesi dhe sociologu i njohur, Fatos Tarifa, na jep një konkluzion shumë të saktë në lidhje me këtë. Ja si shprehet ai “simboli i fundit i shoqërisë civile në Shqipëri u shkatërrua me ndalimin e plotë të fesë, më 1967 dhe me shpalljen antikushtetuese të saj, më 1976” (Tarifa, 2009:103). Sjellim këtu edhe njëherë në vëmendje që për Inglehart-it dhe Baker-in, vlerat fetare përbëjnë bërthamën themelore të boshtit vleror që konsiderohet tradicional. Krasniqi kur bën tabelën, në të cilën klasifikon partitë politike sipas bazës sociale dhe ideologjisë mbështetëse elektorale, vë në dukje që Bosnja, Bullgaria, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedoni dhe Serbia kanë si faktor të bazës sociale edhe fenë, ndërsa te Shqipëria nuk gjendet ky si faktor i organizimit partiak (Krasniqi, 2012:115).

Lamentovic në studimit e tij për komunizmin në vendet e Europës Juglindore, ku përfshihet edhe Shqipëria, shprehet se “Një temë e preferuar e literaturës komuniste ishte ëndrra utopike për një unitet shoqëror të drejtpërdrejtë... Nuk duhej të kishte asnjë fushë jetësore të ndarë, meqenëse të gjitha interesat vetjake do të shndërroheshin në të përgjithshme dhe vlerat individuale në të mira të përgjithshme; nuk duhej të kishte asnjë ndryshim në kushtet e jetesës dhe për pasojë asnjë përplasje interesash. Toleranca në një shoqëri të tillë, të emancipuar, do të ishte virtyt i panevojshëm” (Lamentovic, 1999:64). Nga sa mund të kuptojmë pikërisht ky ishte edhe qëllimi i komunizmit në Shqipëri duke mos lejuar që individi të mund të besonte te disa vlera të tijat, të familjes, të asaj që gjykonte, por duke iu imponuar nga lart vlerat e përgjithshme tek të cilat ata duhet të besonin. Pikërisht kjo bën që ato të quheshin “antivlera” pavarësisht se çfarë predikonin apo çfarë kishin në përmbajtje, sepse vlerat janë të brendësuar, janë kritere gjykimi personale mbi të mirën

dhe të keqen, patjetër siç e pamë edhe në studimin teorik të ndikuar nga shoqëria, nga familja etj. Por që individi duhet t'i ketë si guida të vetat personale dhe jo të imponuara dhe të detyruara me frikë nga pushteti, që i kthen ato në “antivlera”.

Është me vend gjykimi që bën studiuesi, antropologu Dhima, kur shprehet që “Censura ishte në shkallë të lartë dhe shpesh herë liberalizmi dënohej me masa ekstreme. Për fatkeqësinë tonë, diktatura komuniste na çoi në falsifikimin dhe rrënimin e shumë vlerave origjinale, duke i fshirë ato nga “memoria” e historisë, kulturës së qytetërimit tonë”. (Dhima, 2010:198)

E gjitha kjo do të ndikonte në mënyrë të dukshme në atë që do të ndodhte më pas me Shqipërinë, me përkrahjen e saj për vlerat e demokracisë, por edhe me profilin e saj vleror si një tërësi. Nuk duhet të harrojmë që “Shqipëria ishte dhe mbeti i vetmi vend i Europës Lindore që evitoi çdo lloj mendimi revizionist dhe u qëndroi presioneve për hapjen dhe liberalizimin e shoqërisë, përshirë edhe ato të tipit gllasnost apo perestrojka në gjysmën e dytë të viteve 1980, të cilat ndikuan në zhvillimin e vendeve të tjera ish-komuniste” (Tarifa, 2009:103).

Vendosja e sistemit demokratik në vend do të na bënte që të përballeshim me atë që Lamentovic e rendit si një nga paradokset e vendeve që kanë trashëgimi komuniste, paradoksi i nihilizmit të dyfishtë: “Nihilizmi kundër vlerave të hedhura poshtë, i cili duhet të përgatisë rrugën për modernizim, kthehet në nihilizëm kundër normave, parimeve dhe vlerave të dëshiruara” (Lamentovic, 1999:65). Ashtu siç e ka thënë në studimet e para për

vlerat me ardhjen e demokracisë studiuesi Kocani ku “konflikti normativ konsiston në ndeshjen midis modeleve vlerore të “instaluar” në korpusin e “ndërgjegjes kolektive” nga regjimi totalitar komunist dhe modeleve të reja vlerore që ai “huazon” nga shoqëritë demokratike (Kocani, 1999:4). Kështu për shembull studiuesi, Roça, shkruan pikërisht për këtë gjendje: “Nga njëra anë kritikohet regjimi i vjetër, nga ana tjetër njerëzit kanë mall për barazimtarizmin e tij. Nga njëra anë dëshirohet tregu i lirë, nga ana tjetër dënohet luhata e çmimeve. Krahas dëshirës për kufij më të hapur ekziston gatishmëria për të hapur luftë, në rast se rrezikohet sadopak sovraniteti. Dëshirohen sa më s’ka investimet e huaja, por pastaj dënohet shfrytëzimi i pasurive të vendit nga ana e të huajve. Ngrihet lart demokracia pluraliste, por kur një parti vjen në pushtet sillen me të si në kohën e partisë së dikurshme, të vetme, komuniste, duke e konsideruar si të vetmen mënyrë, për të siguruar një punë dhe një pozitë shoqërore” (Rocca, 2000:64).

Studiuesi Dervishi flet për mundësinë se ka shumë të ngjarë që vlerat tona në demokraci të jenë thelbësisht materialiste, ai shprehet: “Në kuadër të kalimin nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut ... u shoqërua me dëshirën për t’u pasuruar shpejt. Kjo nxiti edhe mjaft shqiptarë të zhvendosen në spektrin e vlerave nga ato me përmbajtje më të spikatur humanizuese e deri altruiste, te vlerat me natyrë më të theksuar ekonomike dhe pragmatike, të largohen nga idealizmat dhe të afrohen me botën e interesave materialist, herë-herë vulgare.” (Dervishi, 2005:88). Vetë demokracia ka probleme e saj në funksionimin si e plotë dhe në funksionim me sjellje dhe vlera demokratike të vetë qytetarëve shqiptarë, pjesëmarrja në politikë dhe angazhimi në “punët” e përgjithshme që mund të jenë të nevojshme për të ndërhyrë në publikun e një shteti janë shumë larg realitetit

të këtyre viteve të demokracisë në vendin tonë. Arsye e rëndësishme për këtë fakt, sipas Biberajt, është se “për afro gjysmë shekulli Shqipëria kishte qenë e izoluar nga bota e jashtme dhe nga vlerat dhe parimet demokratike. Ky izolim, bashkë me mungesën e traditave demokratike, kishte ngulitur dhe rrënjosur vlera dhe qëndrime që nuk ishin shumë të favorshme për zhvillimin e demokracisë” (Biberaj, 2011:117).

Regjimi komunist kishte rrënjosur te qytetari shqiptar, ndjenjën e frikës, sepse në çdo moment ti ishe i dëgjuar dhe i parë nga sistemi (sytë dhe veshët e të cilit mund të ishin kushdo, edhe njeri më i afërt), i cili të ndëshkonte në mënyrë shumë të rreptë në rast se ti mund të mendoje dhe jo më të veproje kundër asaj që kishte vendosur sistemi për ty. Kjo bëri që ndjenja e frikës të ndalonte çdo lloj vlere që mund të kishte qytetari, që përkthej në sjellje normale demokratike, sepse frika nuk ishte vetëm ndaj shtetit, por ishte edhe si mungesë besimi ndaj tjetrit, ndaj qytetarit. Kjo e bën gati të pamundur që, në fillimet e demokracisë, por edhe në vitet më pas, nuk është se ka ndryshuar shumë, qytetarët të bashkëpunojnë dhe të mbështeten te njëri-tjetri për të shprehur në çdo lloj forme kërkesat apo ankesat që mund të kenë për vendimin e një autoriteti, qoftë ku edhe shtetëror. Kjo çon në mungesën e krijimit të një force qytetare e cila mund të ushtrojë presion si një identitet i përbashkët kundrejt shtetit.

Këtë mangësi e vë në dukje dhe studiuesja italiane, Del Rey që shprehet se: “kalimi nga një sistem i bazuar në interesat e kolektivitetit, në mungesën e sistemit -në periudhën e tranzicionit- në të cilën individ i sheh interesat e veta si parësore, solli një kontrast mes interesit personal dhe pjesëmarrjes në kolektivitet, duke penguar formimin e një identiteti të

ri kolektiv” (Del Rey, 2000:114). Elez Biberaj shkruan: “Ndoshta pengesa më e madhe për krijimin e organizatave dhe grupeve qytetare të qëndrueshme ishte mungesa e autonomisë së vërtetë nga shteti ose partitë politike. ...Një hendek i thellë vazhdonte të ndante sferën publike nga ajo private dhe krijimi i një shoqërie qytetare të fortë mbetej një qëllim i largët (Biberaj, 2011:307). Theodore Kaltsounis një studiues që ka qenë drejtues edhe i një projekti për demokratizimin e Shqipërisë, në librin e tij të botuar pas mbarimit të këtij projekti numëron disa nga faktorët kyç që çojnë në problemet dhe dështimet e demokracisë në vendin tonë, nisur edhe nga çka kishin shkruar dhe botuar më parë studiuesit shqiptarë. Ai numëron këta faktorë: “Mungesën e traditës demokratike; autoritarizmit dhe pushtetit të pakufizuar; ndjenjës së njerëzve që vota e tyre është shkelur; mungesës së aftësive në zgjidhjen e konflikteve; mungesës së transparencës në qeveri; mungesës së infrastrukturës; mungesës së një sistemi të qëndrueshëm ekonomik” (Kaltsounis, 2013:111).

“Në këto vite të demokracisë në asnjë rast nuk është përdorur e drejta qytetare e “revokimit” apo e tërheqjes së organizuar të mendimit të tij politik. Nuk është normale, ndërkaq që demokracia jonë nuk ka tentuar deri tani, të bëjë qoftë edhe një eksperiment të vetëm me demokracinë qytetare me të “drejtën e ndërmjetme” politike të qytetarit. Kjo nuk është gjë e mirë. Ajo flet për formalizim të demokracisë, plogështim të qëndrimit politik të qytetarit. Dhe ky rrezik nuk duhet neglizhuar për të ardhmen e demokracisë tonë” (Tushi, 2010:395). Kjo mungesë, por edhe të tjera që përmendëm më lart lidhen fortësisht me praninë ose jo të atyre që klasifikohen si vlera të vetafirmimit. Vetëm qytetarët me vlera afirmimi mund të pasqyrojnë kulturë politike dhe të kërkojnë të jenë në qendër të sistemit

politik dhe ekonomik të vendit, ashtu siç është e drejta e tyre legjitime për aq kohë sa kanë zgjedhur të jetojnë në një demokraci.

KAPITULLI V: PUNIMI EMPIRIK

5.1. Rezultatet demografike të anketimit

Siç u paraqit në pjesën e metodologjisë është zgjedhur një kampionim me kuota, që të mund të merrej përfaqësueshmëri nga të gjitha grup-moshat dhe nga të dyja gjinitë sipas zonave të Tiranës. Anketa është kryer në muajin dhjetor 2013, në tre ditë rresht në mënyrë të tillë që grupi i monitoruesve të kishte mundësi të kontrollonte të gjithë anketuesit në terren, përgjatë procesit të kryerjes së anketës. Përfaqësimi i grupmoshave është shumë i rëndësishëm për pjesën e fundit të studimit, që lidhet me ndryshimet që pritet të vërehen mes të rinjve të moshës 15-24 vjeç nga njëra anë dhe atyre mbi 60 vjeç në anën tjetër. Pas bërjes së anketës kemi këtë situatë demografike të studimit, mbi të cilin do të jenë edhe rezultatet për të tre boshtet kryesore vlerore.

Përsa i përket gjinisë edhe grupmoshave kemi situatën e mëposhtme që lidhet edhe me llojin e kampionimit që kemi bërë. Pra 121 Meshkuj dhe 129 Femra, të ndara si më poshtë sipas grupmoshave.

Mosha	Total	Meshkuj	Femra
15-24	60	29	31
25-34	46	22	24
35-44	40	19	21
45-54	41	20	21
55-64	32	16	16

mbi 64	31	15	16
Total	250	121	129

Të anketuarit u pyetën : Kush është shkolla e fundit që keni ndjekur?”

1. Asnjë formim shkollor/profesional; 2. Shkollë e detyruar (fillore, 8 ose 9 vjeçare); 3. Shkollë profesionale dyvjeçare; 4. Shkollë e mesme e përgjithshme; 5. Shkollë e mesme teknike; 6. Universitet. Shkollë e lartë; 7. Shkollë pasuniversitare/Gradë, Titull shkencor; 99.Pa përgjigje

Nga të dhënat na rezulton në lidhje me shkollimin që:

1. Asnjë formim,	2.1%
2. Shkollë e detyruar	7.8%
3. Shkollë profesionale dyvjeçare	5.8%
4. Shkollë e mesme e përgjithshme	29.6%
5. Shkollë e mesme teknike	6.6%
6. Universitet. Shkollë e lartë	41.2%
7. Pas universitar	6.6%
8. Pa përgjigje	0.4%

Bie në sy që vetëm 0.1% nuk kanë asnjë formim të lidhur me institucione formale siç është shkolla.

Po ashtu u pyetën: A e keni ndjekur këtë shkollë/formim deri në fund dhe keni siguruar diplomën përfundimtare?” 1. Po, ndjekur deri në fund e siguruar diplomën; 2. Jo; 99.Pa përgjigje

Përgjigjet ishin:

- | | |
|--|-------|
| 1. Po, e kam ndjekur dhe kam siguruar diplomën | 74.3% |
| 2. Jo | 24.8% |
| 3. Pa përgjigje | 0.9% |

Punësimi i tyre ishte një pyetje tjetër që i drejtohej në mënyrë të drejtëpërdrejtë: A keni aktualisht një vend pune? Ata janë përgjigjur:

- | | |
|-------|-------|
| 1. Po | 61.2% |
| 2. Jo | 38.8% |

Nëse përgjigjeshin po, atëherë pyeteshin: “A keni ju: 1. Vend pune me kohë të plotë (≥ 30 orë në javë); 2. Vend pune me kohë të pjesshme (< 30 orë në javë); 3. I pavarur me kohë të plotë; 4. I pavarur me kohë të pjesshme. Nga përgjigjet na rezulton që:

- | | |
|-------------------------------------|-------|
| 1. Me vend pune me kohë të plotë | 61.1% |
| 2. Me vend pune me kohë të pjesshme | 10.7% |
| 3. I pavarur me kohë të plotë | 21.5% |
| 4. I pavarur me kohë të pjesshme | 6.0% |
| 5. Pa përgjigje | 0.7% |

Nëse përgjigjeshin jo, atëherë pyeteshin: Nëse Jo: A jeni ju: 1. Në pension i/e tërhequr nga puna; 2. Grua/burrë shtëpiak (e); 3. Student (e); 4. Pa vend pune; 5. Tjetër, specifikojeni.

Nga përgjigjet na ka dalë që:

- | | |
|------------------------------------|-------|
| 1. Në pension, i tërhequr nga puna | 26.7% |
| 2. Shtëpiak/e | 12.2% |
| 3. Student/e | 36.7% |

4. Pa vend pune	22.2%
5. Tjetër (pamundësi shëndetësore)	2.2%

Pyetja e rradhës ju drejtohet atyre që janë përgjigjur që punojnë, dhe atyre që janë aktualisht pa punë ose në pension në lidhje me vendin e tyre të mëparshëm të punës “A punoni (a keni punuar [për personat pa punë apo në pension])në sektorin privat, apo në sektorin publik?” 1. Sektori privat; 2. Sektori publik. Nga përgjigjet na doli mbizotërimi i punës në sektorin privat, konkretisht siç mund të shikohen në rezultate:

1. Sektori privat	73.4%
2. Sektori publik	23.9%
3. Pa përgjigje	2.7%

Duke qënë se faktori ekonomik është kyç për të kuptuar trajektoren që do të mund të kenë vlerat në një shoqëri, u munduam të kuptonim diçka më shumë në lidhje me këtë duke i drejtuar tre pyetje të ndryshme të anketuarve, një që lidhej me mundësinë për të kursyer dhe për të mbledhur para apo thjesht mund të jetojnë me të ardhurat që kanë, një që i kërkon në një shkallë të na përcaktojnë të ardhurat e tyre, dhe një tjetër ku vetëpërcaktoheshin si një klasë sociale.

Pyetja e parë e kësaj liste ishte: “Gjatë këtyre viteve, familja juaj a ka:”: 1. Kursyer para; 2. Në përgjithësi, vetëm ia ka dalë të jetojë; 3. Nuk ka mundur fare të kursejë; 4. Nuk ka mundur të kursejë dhe ka marrë borxh; Të anketuarit u përgjigjen në këtë mënyrë:

1. Kursyer para	45.3%
2. Vetëm ja dalim të jetojmë	35.0%
3. Nuk kemi mundur të kursejmë	12.8%

- | | |
|-----------------------------------|------|
| 4. Skemi kursyer, kemi edhe borxh | 6.6% |
| 5. Pa përgjigje | 0.4% |

Më pas vetëpërcaktimi i klasës sociale, ashtu si ata e perceptojnë veten, ju kërkua me anë të pyetjes: “Cilës klasë sociale i do ta percaktonit veten?” 1. Klasës së lartë; 2. Klasës mesatare të lartë; 3. Klasës mesatare të ulët; 4. Klasës punëtore; 5. Klasës së ulët; 88.Nuk e di; 99.Pa përgjigje. Respondetët dhanë këto vetëpërcaktime:

- | | |
|---------------------------|-------|
| 1. Klasës së lartë | 1.7% |
| 2. Klasa mesatare e lartë | 39.2% |
| 3. Klasa mesatare e ulët | 40.4% |
| 4. Klasës punëtore | 15.4% |
| 5. Klasës së ulët | 2.9% |
| 6. Pa përgjigje | 0.4% |

Vihet re që njerëzit vetëpërcaktohen në shumicën e tyre në klasën e mesme, qoftë kjo e mesme e lartë, qoftë kjo e mesme e ulët. Një përqindje shumë e ulët janë përgjigjur që i përkasin klasës së lartë 1.7% e të gjithë respondentëve.

Pyetja tjetër kërkonte që të jepnin një të dhënë mbi të ardhurat e tyre, qoftë këto personale apo të çiftit, ose që i jepte familja në rastin se ata nuk ishin vetë në marrëdhënie pune. Pyetja e drejtuar ishte: “Na duhet një e dhënë mbi të ardhurat tuaja (të çiftit) mujore. Të jeni i sigurt se ajo do të mbetet midis nesh (konfidenciale). Në listën e mëposhtme keni disa kategori pagash e të ardhurash të shënuara me gërma. Zgjidhni njërën prej tyre: 1. më pak se 10 000 lekë; 2. midis 10 001 dhe 20 000 lekë; 3. midis 20 001 dhe 30 000 lekë; 4. midis 30 001 dhe 50 000 lekë; 5. midis 50 001 dhe 60 000 lekë; 6. midis 60 001 dhe 70 000 lekë;

7. midis 70 001 dhe 90 000 lekë; 8. midis 90 001 dhe 100 000 lekë; 9. më shumë se 100 000 lekë; 88.Nuk e di; 99.Pa përgjigje.

Duke parë përgjigjet e të anketuarve, fillimisht llogaritem një nivel mesatar pagash duke përdorur komandën mean që na jep mundësi spss, duke qënë se në spss është modeli statistikor i punës. Nga kjo na doli që mesatarisht pagat ishin në nivelin 30 001 deri në 50 000 lekë. Ndërsa rezultatet konkrete janë si poshtë:

1. me pak 10000 lek	3.3%
2. mes 10001 dhe 20000 lek	8.2%
3. mes 20001 dhe 30000 lek	14.4%
4. mes 30001 dhe 50000 lek	22.2%
5. mes 50001 dhe 60000 lek	13.6%
6. mes 60001 dhe 70000 lek	9.1%
7. mes 70001 dhe 90000 lek	4.9%
8. mes 90001 dhe 100000 lek	7.4%
9. me shume se 100000 lek	8.6%
10. nuk e di	1.2%
11. pa përgjigje	7.0%

Po ti referohemi të dhënave që na jep INSTAT në lidhje me pagat, për vitin 2013, që është edhe viti i zhvillimit të anketës na tregon që paga mesatare është në nivelin 52150 lekë dhe paga minimale në nivelin 22 000 lekë, që përputhen me rezultatet që na japin të anketuarit e qytetit të Tiranës dhe në një farë mënyrë edhe vetëperceptimit të tyre si klasë e mesme.

(<http://ëëë.instat.gov.al/al/themes/pagat-dhe-kosto-e-pun%C3%ABs.aspx> parë për herë të fundit më 30 Prill 2014)

Së fundmi një nga pyetjet e rëndësishme edhe në kuadër të aludimit metodologjik që lidhet me faktin që në Tiranë gjejmë përfaqësim të subkulturave për arsye se të ardhurit përbejnë tashmë një pjesë të konsiderueshme të kryeqytetit dhe mbartin me vete vlerat e qytetit, vendin nga i cili kanë ardhur. Pyetja ishte: A keni lindur në Shqipëri?” 1. Po, 2. Jo. Nëse Po : Në cilin rreth?

Fillimisht, ajo që bie në sy është që 0.8% nuk kanë lindur në Shqipëri por kanë ardhur të jetojnë këtu, që do të thotë një përqindje shumë e vogël. Ndërsa 23% e të anketuarve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje, përqindja më e lartë e mospërgjigjeve të hasura ndonjëherë në këtë anketim. Kjo mund të shpjegohet me faktin që shumë prej të ardhurave në Tiranë kanë hasur një lloj paragjykimi nga qytetarët e hershëm të Tiranës dhe ndoshta kjo lloj ndjesie i ka ndaluar ata që të thonë nga vijnë, nga një lloj kompleksi ndoshta se mos të paragjykoreshin nga të anketuesit. Gjithsesi ngelet në kuadër të aludimit sepse arsyet e vërteta nuk mund të dihen me siguri. Të anketuarit na tregojnë këtë pamje, që është edhe panorama nga e cila ne do të nxjerrim rezultatet e boshteve vlerore të hedhura në publik:

Qyteti i lindjes	%
Tirana	16.9
Lezhë	1.2
Dibër	3.2

Librazhd	1.2
Fier	3.6
Durrës	4.4
Korcë	6.9
Tropojë	2.8
Berat	3.6
Elbasan	1.6
Kavajë	0.8
Gjirokastrë	1.6
Skrapar	2.0
Shkodër	1.2
Lushnjë	2.4
Çamëri	0.4
Vlorë	4.0
Ersekë	0.8
Kukës	2.4
Fushë-Krujë	0.4
Tepelenë	1.6
Përmet	2.8
Pogradec	1.2
Gramsh	0.8
Sarandë	1.6

Mallakastër	0.8
Cërrik	0.4
Has	0.8
Kuçovë	0.4
Burrel	1.2
Pukë	0.8
Pa përgjigje	23.0

Nga sa më lart duket qartë shumëllojshmërie e njërëzve që jetojnë në Tiranë, vetëm 16.9% janë të lindur në Tiranë, por edhe këta jo domosdoshëmrish kulturash të lidhur vite pas vitesh me kryeqytetin sepse mund të kenë lindur këtu edhe prindërit dhe familja e tyre të kishte shumë pak kohë që kishte ardhur në Tiranë. Kjo na jep përsëri shpresë dhe një lloj të drejtë që rezultatet tona të nxjerra mbi një kampionim mbi Tiranën të na japin, të na japin një panoramë të përgjithme për shqiptarët, jo për tiranasit.

5.2.Rezultatet empirike për boshtin e vlerave, tradicionale përkundrejt shekullare

Siç u paraqit në pjesën teorike kur u sqarua modeli i Inglehart-it një nga kuptimet e vlerave lidhej me ndarjen e tyre në boshte që priten me njëra-tjetrën, pra nuk mund ti kesh të dyja ose do jesh në një mënyrë ose në tjetër, një nga boshtet është ai i vlerave tradicionale përkundrejt atyre shekullare. Më poshtë do merret në shqyrtim secili nga indikatorët që janë paraqitur se masin nivelin e vlerave tradicionale dhe atyre shekullare. Një nga elementët më të rëndësishëm dhe thelbësor në këtë përcaktim lidhet me fenë, me institucionet e saj, rolin e saj etj. Pavarësisht se pyetjet kanë qënë të shpërndara nëpër anketë nga fillimi në fund si një mënyrë edhe kontrolli për të anketuarit por edhe për të ruajtur modelin origjinal të Inglehart-it, pjesa që lidhet me fenë do trajtohet në fund e gjitha në bllok. Për arsye se besohet që Shqipëria ka disa specifika në lidhje me shumëllojshmërinë e saj fetare, në lidhje me historinë e saj fetare, në lidhje me vitet e komunizmit e ndalimit të fesë dhe përsëri ruajtjen e vlerave fetare, në lidhje me një tolerancë dhe bashkëjetesë fetare që na ka karakterizuar ndryshe nga vende të tjera. Për arsye të këtyre veçantive modeli i Inglehartit do të merret në fund me pikëzimet e nevojshme për të kuptuar peshën që mund të luaj faktori fe në përcaktimin në boshtin e vlerave tradicionale dhe atyre shekullare. Duke përfshirë aty edhe disa të dhëna dhe përshkrime historike sesa thjesht përqindje dhe interpretim të tyre nga anketimi i bërë të terren në kuadër të këtij studimi.

Pyetje e parë që ju drejtohet të anketuarve që fillon dedektimin e vlerave në boshtin tradicional- shekullar është: Për secilën nga gjërat e mëposhtme, a mundeni të më thoni sa e rëndësishme është për ju nga 1 tek 5. Ku 1 është Aspak e rëndësishme, 2 pak e

rëndësishme, 3 deri diku e rëndësishme, 4 e rëndësishme dhe 5 është shumë e rëndësishme. Bashkë me mundësinë e përhershme të dy opsioneve nuk e di dhe pa përgjigje të cilat janë në çdo pyetje por nuk u lexohen të anketuarve thjesht shënohen nëse janë përgjigje spontane të tyre. Pyetja e parë lidhej me familjen, pikërisht ta klasifikonin në këtë bosht përgjigjesh nga 1 deri tek 5. Përgjigja aspak e rëndësishme dhe pak e rëndësishme shkon për vlerat shekullare. Përgjigja deri diku e rëndësishme është në mes të dyja vlerave. Përgjigja e rëndësishme dhe shumë e rëndësishme shkon për vlerat tradicionale.

Të anketuarit janë përgjigjur në këtë mënyrë përse i përket familjes ata janë shprehur në masën 96% që ajo është shumë e rëndësishme për ta, që gjë nuk të lë mundësi të shikosh edhe shifrat e tjera të kësaj përgjigje sepse janë qartësisht në vlerat tradicionale. Përkatësisht përgjigjet e kësaj pyetje janë:

Rëndësia e familjes	Aspak e rëndësishme	Pak e rëndësishme	Deri diku e rëndësishme	E rëndësishme	Shumë e rëndësishme	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	0	0	0.4	3.6	96.0	0	0

Të anketuarve u është paraqitur një listë me vlera që në retorikën e përditshme duken sikur janë ato që përfaqësojnë dhe kanë përfaqësuar me kohë shqiptarët. Për të kuptuar se sa të lidhur janë ata me këto vlera, duke ja u parashtruar në pyetjen: A jeni apo jo dakort me ruajtjen e këtyre vlerave. Përgjigjet përsëri qëndrojnë në përcaktimin tek boshti tradicional-

shekullar nëse do të ishin dakort dhe shumë dakort përcaktohen tek tradicional, nëse do të ishin aspak dakort dhe jo dakort do të përcaktoheshin tek shekullar dhe disi dakort do ishte mes të dy vlerave.

Pyetja që ju drejtua ishte: “Lidhur me ruajtjen e vlerave të poshtëshënuara thoni sa jeni dakort nga 1-5, ku 1 është aspak dakort, 2 është jo dakort, 3 disi dakort, 4 dakort dhe 5 shumë dakort?” me 88. Nuk e di dhe 99. Pa përgjigje. Vlerat ju lexuan një nga një dhe për secilën u morr përgjigje e veçantë në boshtin nga 1 deri tek 5. Lista e vlerave ishte:

- a. Atdhedashurisë
- b. Përgjegjësisë ndaj detyrës
- c. Mirëkuptimit me bashkëqytetarët apo bashkëfshatarët
- d. Besës së dhënë
- e. Tolerancës fetare
- f. Identitetit personal
- g. Identiteti krahinor
- h. Identiteti kombëtar
- i. Familjes së konsoliduar
- j. Kulturës kombëtare

Përsa i përket atdhedashurisë të anketuarit u përgjigjen në masën 68.2% që janë shumë dakort dhe në masën 14.7% që janë dakort, që në total shkon në 82.9% drejt vlerave tradicionale. Tabela e mëposhtme jep përqindjet për secilën nga alternativat ku dallohen qartë diferencat mes përqindjeve:

Atdhedashuria	Aspak dakort	Jo dakort	Disi dakort	Dakort	Shume dakort	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	0.8	3.3	13.1	14.7	68.2	0	0

Vlera e dytë e pyetur është përgjegjësia ndaj detyrës, duke mos i përcaktuar të anketuarve se çfarë lloj detyre, pra detyra si prind, detyra në punë, detyra në komunitet. Sepse kur i përket vlerave tradicionale njeriu beson se ka disa detyra që duhet ti kryej me përgjegjësi. Në këtë pyetje sipas anketuesve nuk ju vinte pyetja mbrapsh se përgjegjësi ndaj cilës detyrës, por përgjigjeshin menjëherë. Vetem 4 të anketuar kanë pyetur se cila detyrë dhe të udhëzuar anketuesin u janë përgjigjur ndaj çdo lloj detyrë që mund të kishin ose kanë në çdo fushë të jetës. Në këtë pikë të anketuarit janë përgjigjur shumë dakort në masën 76.3% dhe dakort 15.9% që në total shkon 92.2% drejt vlerave tradicionale.

Tabela e mëposhtme jep përqindjet për secilën nga alternativat ku dallohet qartë diferenca mes përqindjeve:

Përgjegjësia ndaj detyrës	Aspak dakort	Jo dakort	Disi dakort	Dakort	Shumë dakort	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	0.8	0.4	6.5	15.9	76.3	0	0

Mirëkuptimi është një nga vlerat që të anketuarit u përgjigjen në masën 83.3% që ishin plotësisht dakort dhe dakort, dmth në anën e boshtit të vlerave tradicionale. Konkretisht:

Mirëkuptimi	Aspak dakort	Jo dakort	Disi dakort	Dakort	Shumë dakort	Nuk e di	Pa përgjigje
-------------	-----------------	--------------	----------------	--------	-----------------	-------------	-----------------

Përqindja	0.8	4.1	11.8	17.8	65.7	0	0
-----------	-----	-----	------	------	------	---	---

Pika tjetër lidhet me besën, vlerë shumë e përfolur shqiptare, që mund ta lidhësh shumë edhe me narracionet popullore dhe mëshimit të saj në qarqet tona kulturore, sociale, shkollore. Një vlerë që e gjejmë të parashkruar tek kanuni i Labërisë dhe kanuni i Lek Dukagjinit, që mund të merren si bazë për të kuptuar shoqërinë e dikurshme shqiptare, në aspektin e vlerave, normave, sjelljeve në komunitet. Të dyja kanunet flasim për besën, që mund ta konsiderojmë në listën e vlerave në kuptimin e saj si shenjë respekti ndaj marrëveshjes së bërë me gojë dhe zbatimi i saj me seriozitet sikur të ishte marrëveshje para një noteri sot, me fuqi detyruese. Në kanunin e labërisë gjendet në nenin 29 pika 4 që besa e dhënë nuk shkelet kurrë nga askush. Në kanunin e Lek Dukagjinit thuhet se besa është një vatër lirie dhe siguri (faqe 82). Kjo shpjegon fare mirë sesa e rëndësishme ishte kjo në shoqërinë shqiptare që të garantonte lirinë dhe sigurinë, sepse nëse je në besën e dikujt, ose të jepet besa për diçka nuk ekziston asnjë mundësi që ai që jep besën ta shkel atë.

Të anketuarit sot për besën, janë shprehur në masën 84.1 % në favor të ruajtjes së saj, si një nga vlerat e kulturës shqiptare. Tabela e mëposhtme tregon rezultatet:

Besa	Aspak dakort	Jo dakort	Disi dakort	Dakort	Shume dakort	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	3.7	3.7	8.2	14.3	69.8	0	0.4

Duke e kaluar pyetjen e tolerencës fetare, e cila do merret në shqyrtim më poshtë kur të trajtohet feja si një nga komponentët që përcakton boshtin vleror tradicional-shekullar por të trajtuar në bllok për hir të specifikave që lidhen me historinë shqiptare.

Pika tjetër lidhet me identitetin, duke e ndarë atë në 3 lloje: në atë personal, krahinor dhe kombëtar. Të anketuarit ju përgjigjen vecmas për secilin prej tyre dhe nuk kishin për kërkesë që të mund ti klasifikonin nga rëndësia. Megjithatë mund të themi që të trejave u japin rëndësi, por nëse do bënim një renditje, u japin më shumë rëndësi identitetin personal me 91.4% dakort dhe plotësisht dakort, më pas identitetin kombëtar me 86.6% dakort dhe plotësisht dakort, në fund gjejmë identitetin krahinor me 69%, që përsëri është i rëndësishëm. Ndoshta me identitetin krahinor kanë pasur më shumë idenë e ndasive që mund të krijoj, midis ndarjes veri dhe jug dhe për këtë arsye përqindja është më e ulët.

Tabelat e mëposhtme tregojnë rezultatet për secilën nga llojet e identiteteve:

Identiteti personal	Aspak dakort	Jo dakort	Disi dakort	Dakort	Shume dakort	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	0.8	2.0	5.7	10.7	80.7	0	0

Identiteti krahinor	Aspak dakort	Jo dakort	Disi dakort	Dakort	Shume dakort	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	4.5	9.0	17.1	22.9	46.1	0.4	0

Identiteti kombëtar	Aspak dakort	Jo dakort	Disi dakort	Dakort	Shume dakort	Nuk e di	Pa përgjigje

Përqindja	0.8	3.7	9.0	13.5	73.1	0	0
-----------	-----	-----	-----	------	------	---	---

Pyetja tjetër lidhet me familjen e konsoliduar, si një vlerë e shoqërisë shqiptare që klasifikohet po ashtu në boshtin e vlerave tradicionale nëse shprehesh pro asaj dhe atyre shekullare në rast se nuk je dakort me të. Ashtu siç u tha më lart tek kanunet mund të shikohet për të ndërtuar idenë e vlerave të shoqërisë tonë. Shtyllë bazë që e gjejmë tek të dyja kanunet është familja. Një familja e madhe, e konsoliduar, me një strukturë të mbyllur dhe të qartë hierarkike, ku figura qendrore është kryefamiljari, burri i shtëpisë, ai më i moshuari. E vendosin të dy kanunet në qendër të shoqërisë si një pikë shumë e rëndësishme e ndërtimit të vetë strukturave të tjera të shoqërisë. Sepse familja në një farë mënyre vendoste edhe për fatin në martesë të të rinjve, për punën e tyre, për marrëdhëniet me të tjerët, miq apo armiq qofshin ata. Duke hequr dorë nga autonomia individuale, për shqiptarët e rëndësishme ishte kohezioni familjar. Secili në familje e gjente të shprehur në kanun rolin e tij, me të drejtat dhe detyrat e përcaktuara dhe të gjithë duhet t'i respektonin dhe ti bindeshin atyre rregullave.

Sipas përgjigjeve të të anketuarve del përsëri një tendencë e fortë drejt familjes së konsoliduar që shprehen në masën prej 94.3% si shumë dakort dhe si dakort dmth fortësisht në krahun e vlerave tradicionale, ndërsa 1.6% janë shprehur aspak dakort dhe jo dakort në krahun e vlerave shekullare. Tabela e mëposhtme tregon rezultatet e dala:

Familja e konsoliduar	Aspak dakort	Jo dakort	Disi dakort	Dakort	Shume dakort	Nuk e di	Pa përgjigje
-----------------------	--------------	-----------	-------------	--------	--------------	----------	--------------

Përqindja	1.2	0.4	3.7	9.4	84.9	0.4	0
-----------	-----	-----	-----	-----	------	-----	---

Së fundmi kjo pyetje ka si pjesë të saj edhe vetëpërcaktimin me dakortësinë në lidhje me kulturën kombëtare, duke e konsideruar përgjigjen dakort dhe shumë dakort në krahun e vlerave tradicionale dhe përgjigjen aspak dakort dhe jo dakort në krahun e vlerave shekullare. Nga përgjigjet na rezulton që 83.3% janë dakort dhe shumë dakort me ruajtjen e kulturës kombëtare ndërsa 3.7% janë aspak dakort dhe jo dakort. Konkretisht, të anketuarit janë përgjigjur në këtë mënyrë:

Kultura kombëtare	Aspak dakort	Jo dakort	Disi dakort	Dakort	Shumë dakort	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	0.4	3.3	11.4	20.0	63.3	1.2	0.4

Përsëri në kuadër të familjes së madhe dhe të konsoliduar i është drejtuar pyetja se cili do të ishte numri ideal i fëmijëve për t'u patur kur krijoni familje, ose edhe nëse e kanë krijuar kush është numri ideal. Nga përgjigjet e të anketuarve gjejmë një variacion nga 0 deri në 6 por megjithatë përgjigjet më të mëdha me gati një mazhorancë absolute prej 49.2% e mori numri dy si numër ideal për të patur fëmijë. Që lidhet shumë me numrin ideal për familjet e mëdha që përshkruhen në kanunet shqiptare dhe në konceptin e familjeve të mëdha tradicionale. Të anketuarit dhanë këto përgjigje:

Nr	0	1	2	3	4	5	6	Nuk e di	Pa përgjigje
%	0.4	2.9	49.2	27.1	12.5	3.8	1.3	2.1	0.8

Martesa është parë si institucioni bazë dhe më i rëndësishëm mbi të cilin ndërtohet familja e konsoliduar në shoqërinë shqiptare. Ende ligji në vendin tonë i jep martesës dhe bashkëshorteve më shumë të drejta dhe detyrime kundrejt njeri-tjetrit sesa çdo lloj institucioni tjetër social. Në këtë kuadër ruajtja e këtij institucioni, besimi në këtë formë të organizimit social është në krahun e vlerave tradicionale ndërsa ideja e mos ruajtjes dhe mos besimi në këtë formë është në krahun e vlerave shekullare. Të anketuarve ju drejtua pyetja: “A jeni ju dakord me opinionin se “Martesa është një institucion i kapërcyer?” Duke i dhënë këto mundësi përgjigjesh:

1. Aspak dakort; 2. Jo dakort; 3. Deri diku dakort; 4.Dakord; 5. Shume dakort; 88.Nuk e di; 99.Pa përgjigje.

Kësaj pyetje 64.2% e të anketuarve janë përgjigjuar që janë aspak dakort ose jo dakort, dmth që nuk besojnë se është një institucion i kapërcyer. Kjo i tregon ata në krahun e vlerave tradicionale përkundëjt atyre shekullare që janë përgjigjur 14.8% e të anketuarve.

Konkretisht të anketuarit janë përgjigjur në këtë mënyrë:

Martesa e kapërcyer	Aspak dakort	Jo dakort	Disi dakort	Dakort	Shume dakort	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	46.9	17.3	20.2	9.5	5.3	0	0.8

Në kuadër të asaj që gjejmë të sanksionuar në dy kanunet që morrëm në shqyrtim, duke i konsideruar si burim i vlerave tradicionale shqiptare, më shumë rëndësi dhe të drejta i jepet burrit sesa gruas, djalit sesa vajzës. Duke i dhënë një rol pak a shumë të nënshtruar femrës

dhe duke preferuar për ti dhënë rol më superior mashkullit. Në këtë kuadër u gjykua që ata që i përkasin boshtit të vlerave tradicionale do të preferonin që nëse do të kishin mundësinë për të pasur vetëm një fëmijë, ky fëmijë të ishte djalë. Ndërsa ata që i përkasin boshtit të vlerave shekullare do të preferonin që nëse do të kishin mundësinë për të zgjedhur çfarë fëmijë të bënin, do të kishin vetëm një fëmijë do të zgjidhnin vajzë. Ndërsa si përherë mes tyre është edhe mundësia që mos kenë preferencë as djalë as vajzë, në këtë rast kur thonë njëlloj është, lidhet më shumë me boshtin e vlerave shekullare sesa qëndron në neutralitet si në pyetjet e tjerave mes dy boshteve. Kësaj pyetje të anketuarit ju përgjigjen pothuaj në një barazi të plotë ku përgjigjet rrotullohen tek 30% me plus minuse për secilën nga përgjigjet. Duke mbledhur vajzë dhe njëlloj si përgjigje të vlerave shekullare atëherë ato arrijnë në 61.7% që e mund boshtin tradicional me preferencë djalin me 38.3%. Tabela më poshtë jep rezultatet konkrete:

Preferenca e fëmijës	Djalë	Vajzë	Njëlloj është	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	38.1	30.0	31.7	0	0

Boshti i vlerave tradicionale përmban në vetvete edhe respektin për autoritetin, i cili do lloj qoftë ky: fetar, shoqëror, shpirtëror, familjar etj po ashtu sicc u tha më lart duan ti kushtohet shumë rëndësi jetës familjare. Një nga pyetjet e drejtuara të anketuarve kishte në vetvete edhe elementë të tjerë që lidhen me boshtin tjetër vleror mbijetëse dhe vetafirmim por do të merren vetëm këto dy pika në shqyrtim në këtë pjesë. Pyetja e bërë ishte: “Po ju përmendim disa ndryshime në mënyrën e të jetuarit që mund të ndodhin në të ardhmen. A mund të na

thoni për secilën prej tyre nëse do të ishte një gjë e mirë, e keqe, apo për ju s'ka rëndësi, jeni indiferent?" Dhe dy pikat e fundit ishin: Do të respektohet më tepër autoriteti (duhet të jepnin një përgjigje nga të sipërpërmendurat) dhe do t'i kushtohet më tepër rëndësi jetës familjare (përsëri një përgjigje nga të sipërpërmendurat). Përgjigjet që do të thoshin një gjë e mirë klasifikohen në krahun e vlerave tradicionale, ndërsa përgjigjet një gjë e keqe në krahun e vlerave shekullare. Pyetjes në lidhje me, më tepër respekt për autoritetin i janë përgjigjur 69.2% si gjë e mirë dhe 10.5 % si gjë e keqe. Në tabelën më poshtë përgjigjet:

Më shumë respekt autoritetit	Gjë e keqe	Indiferent	Gjë e mirë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	10.5	17.3	69.2	2.5	0.4

Ndërsa pikës në lidhje me më tepër rëndësi jetës familjare, të anketuarit janë përgjigjur në masën 90.1% si gjë e mirë dhe në masën 6.6% si gjë e keqe, duke anuar në mënyrë tejet të dukshme në anën e boshtit të vlerave tradicionale. Konkretisht të anketuarit janë përgjigjur:

Më shumë rëndësi jetës familjare	Gjë e keqe	Indiferent	Gjë e mirë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	6.6	2.9	90.1	0	0.4

Për modelin që jep Inglehart mbi vlerat në përcaktimin e tyre si tradicionale apo shekullare, një nga parametrat dallues ka të bëjë më lidhjen që njerëzit kanë me vendin e tyre. Lidhja

me vendin, krenaria për historinë, për vendin e tyre, gaditshmëria për të luftuar për të, bëjnë pjesë tek boshti i vlerave tradicionale ndërsa e kundërta e tyre bëjnë pjesë në boshtin e vlerave shekullare. Të anketuarit u pyetën: “Nese gjendemi në situatën e një lufte, a jeni gati të luftoni për vendin tuaj?”¹. Po; 2. Jo; 88.Nuk e di ; 99.Pa përgjigje. Në një mazhorancë prej 59.4% përgjigjen që janë të gatshëm të luftojnë për Shqipërinë në rast të një situatë lufte dhe kjo përgjigje shkon në krahun e vlerave tradicionale ndërsa 29.9% janë në krahun e vlerave të vetafirmimit.

Kësaj pyetje të anketuarit i janë përgjigjur kështu:

Luftë për vendin	Po	Jo	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	59.4	29.9	7.8	2.9

Pyetja tjetër lidhet me krenarinë e të qënurit shqiptar. Të anketuarve ju drejtua ishte: “Deri në ç’masë jeni krenar që jeni shqiptar?”Dhe përgjigjet midis të cilave duhet të zgjidhnin një, ishin: 1. Aspak krenar; 2. Jo shumë krenar; 3.Krenar; 4. Mjaft krenar; 5. Shumë krenar; 88. Nuk e di; 99. Pa përgjigje. Me boshtin e vlerave shekullare lidheshin përgjigjet aspak krenar dhe jo shumë krenar, të cilat morën 7.8% nga të anketuarit ndërsa përgjigja krenar kësaj rradhe nuk ishte neutrale por mund të konsiderohej në anën e vlerave tradicionale bashkë me përgjigjet mjaft krenar dhe shumë krenar. Të cilat morën 98.5 % të përgjigjeve ku përqindja më e madhe dhe drastike ishte kategoria sipërore e krenarisë dmth shumë krenar me 45.7%. Përgjigjet gjenden të ilustruara në tabelën më poshtë:

Krenar për	Aspak	Jo shumë	Krenar	Mjaft	Shumë	Nuk e	Pa
------------	-------	----------	--------	-------	-------	-------	----

vendin	krenar	krenar		krenar	krenar	di	përgjigje
Përqindja	2.5	5.3	29.2	17.3	45.7	0	0

Duke e lidhur me kontekstin shqiptar dhe me historinë e vendit tonë bashkimi kombëtar është një nga matësit e idesë së atdheut të forcuar, të plotë dhe të fuqishëm në arenën ndërkombëtare. Jo në çdo shtet që ka bërë anketimit Inglehart mund të përdorej kjo pyetje si matëse e vlerave tradicionale versus atyre shekulare por në kontekstin tonë mund të përdoret. Për këtë arsye u janë drejtuar dy pyetje në lidhje me bashkimin kombëtar. E para ishte: “Në qoftë se bashkimi kombëtar (Shqipëri, Kosovë, Çamëri) është i mundur ju personalisht jeni : 1. Krejtësisht pro; 2. Pro; 3. Kundër; 4. Krejtësisht kundër; 88. Nuk e di; 99. Pa përgjigje. Përgjigjet që ishin krejtësisht pro dhe pro do të klasifikohen në boshtin e vlerave tradicionale ndërsa ato kundër dhe krejtësisht kundër në boshtin e vlerave shekulare. Kështu në anën e boshtit të vlerave tradicionale u përgjigjen 86.1%, ndërsa në anën e boshtit të vlerave shekulare u përgjigjen 12.7% e të anketuarve. Konkretisht përqindjen e kësaj pyetje gjenden në tabelën më poshtë:

Bashkimi Kombëtar	Krejtësisht pro	Pro	Kundër	Krejtësisht kundër	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	46.3	39.8	5.7	7.0	0.4	0.8

Ndërsa pyetje e dytë me të njëjtin qëllim, por për të gjykuar nëse thjesht e donin bashkimin kombëtar për hir të asaj që lidhet me historinë apo me një padrejtësi historike apo nëse e lidhnin atë me përfitime dhe dobi të vlefshme të vendit tonë. Në një farë mënyre kjo pyetje

nuk lidhet drejtpërdrejtë me ndarjen e boshteve vlerore por me mënyrën se si e perceptojnë këtë çështje të veçantë shqiptare të anketuarit. Pyetja që ju drejtua ishte: “A mendoni se bashkimi kombëtar do të ishte një ndryshim :1. Shumë i dobishëm; 2. Disi i dobishëm; 3. Pak i dobishëm; 4. Aspak i dobishëm; 5. I dëmshëm; 88.Nuk e di; 99. Pa përgjigje. Duke gjykuar se një vlerësim mbi shumë i dobishëm dhe disi i dobishëm do qëndronte në anën e vlerave tradicionale ndërsa një vlerësim si aspak i dobishëm dhe biles i dëmshëm do të qëndronte në anën e vlerave shekullare. Të anketuarit u përgjigjen në masën 74.5% duke e konsideruar si shumë të dobishëm dhe disi të dobishëm ndërsa vetëm 12.3% e konsiderojnë si aspak të dobishëm, madje edhe të dëmshëm.

Në tabelën e mëposhtme gjenden të ndara përgjigjet sipas secilit opsion të paraqitur:

Dobia e bashkimi kombëtar	Shumë i dobishëm	Disi i dobishëm	Pak i dobishëm	Aspak i dobishëm	I dëmshëm	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	45.3	29.2	7.8	7.0	5.3	4.5	0.8

Për ti qëndruar besnik modelit të Inglehartit që kemi marrë si bazë duhet të thuhet që sipas tij përcaktimi i individëve në lidhje me politikën si të majtë ose të djadhtë lidhet me ndarjen e vlerave tradicionale ose vlerave shekullare. Duke thënë që ata që janë në të djadhtë të boshtit politik besojnë në vlerat tradicionale dhe ata që janë në të majtë të boshtit politik besojnë në vlerat shekullare. Por ky përcaktim lidhet me ideologjinë e të majtës dhe të djadhtës, ku e djadhta lidhet me konservatoren, me mbështetjen në parimet e institucioneve

fetare kryesisht kishës, me ruajtjen e traditës etj. Ndërsa në vendin tonë nuk mund të themi se kemi ndarje të tillë ideologjike midis të majtës dhe të djadhtës, kur i fton njerëzit të vetëpërcaktohen në këtë bosht ato e lidhin përgjigjen e tyre me dy partitë e mëdha PD dhe PS, përkatësisht sipas tyre e djadhta dhe e majta. Përgjigjet e dala do të paraqiten në tabelën më poshtë por nuk besohet se duhet të hyj si një faktor në analizën se sa tradicional apo shekullar janë në vlerat e tyre shqiptarët.

Pyetja e drejtuar për ta ishte: “Në lidhje me politikën, thuhet se ka të majtë dhe të djathtë. Ju ku e fusni veten në përgjithësi në këtë shkallë?” Shkalla ishte nga 1 deri në 10 ku 1 ishte e majta dhe 10 ishte e djadhta. Duke pasur edhe opsionet nuk e di dhe pa përgjigje si në çdo pyetje tjetër. Gjatë anketimeve na u shtua edhe një 0, përgjigje e cila u kërkua me ngulm nga i anketuari për të treguar që ishte kundër të gjithëve dhe kjo përgjigje ka marrë 0.4%. Të anketuarit e tjerë u përgjigjen në këtë mënyrë siç tregon tabela e mëposhtme në ndarjen e tyre politike nga e majta në të djadhtë:

Politikisht	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	13.8	5.8	10.4	5.4	20.8	8.3	4.2	5.0	3.3	9.6	4.2	8.8

Feja është një nga komponentët e rëndësishëm që Inglehart ka vendosur për të matur boshtin vleror midis vlerave tradicionale dhe shekullare. Pluraliteti fetar në Shqipëri ka ekzistuar para atij politik dhe historikisht ky pluralitet nuk ka rrezikuar ekzistencën e identitetit fetar. Mund të thuhet se ky pluralitet është një rezultat historik dhe kulturor mjaft

i rëndësishëm, i cili meriton të respektohet, siç edhe e përmendëm marrëdhënien tonë me fenë në pjesën e kontekstit historik.

Përsa i përket vlerave tradicionale në shoqërinë aktuale duhet thënë se është i pakontestueshëm ndikimi i tyre në shoqërinë shqiptare, sidomos i asaj pjese të vlerave që u mbështetën edhe nga regjimi totalitar për interesa të caktuara. Duke u ballafaquar me vlera të reja të modelit perëndimor këto vlera pësuan një krizë, por pavarësia e tyre nga sistemi ekonomik (pavarësi që e pretendojnë edhe Veber edhe Huntington) u shfaq si një ripërtëritje e tyre ose si veshje e tyre me terma të rinj. Një shndërrim institucional, pavarësisht nga dobësitë e tij, nuk u shoqërua me një shndërrim të shpejtë të mentalitetit, apo një parapërgatitje të mentalitetit në tranzicionin shqiptar.

Për disa kultura, feja ka përfaqësuar aspiratat më të larta të ekzistencës njerëzore. Në kultura të tjera fetë kanë qënë institucione që pohonin se sillnin përsosjen. Për shkak të faktorëve historikë dhe politikë, feja në Shqipëri nuk u ngrit kurrë në të tilla nivele. Në Shqipëri aktualisht janë të zyrtarizuara 5 besime fetare, myslimanët sunitë, bektashinjtë, katolikët, ortodoksët dhe protestanët. Kushtetuta e Shqipërisë në preambulën e vet shkruan: “Ne, Populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë, me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti dhe/ose te vlera të tjera universale, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare...” (Kushtetuta, 1998:1). Duke kuptuar qartë në këto fjalë dy koncepte themelore: 1. Që lejohet dhe kushdo

është i lirë të besoj në zot ose në çdo vlerë tjetër universale dhe 2. Fryma e tolerancës dhe bashkëjetësës fetare që i ka karakterizuar përherë shqiptarët.

Liria e besimit fetar, e ushtrimit të besimit fetar dhe e shfaqjes së tij është totalisht e plotë, e pakufizuar në shoqërinë shqiptare sot. Ndërkohë tendenca historike qëkur populli shqiptar është gjendur përballë kërcënimeve për ekzistencën kombëtare të tij, ka qënë që përkatësia fetare të vihej në shërbim të kësaj ekzistence kombëtare. Sot sipas rezultatit të fundit të CENSUSIT, kjo është gjendja e përkatësisë fetare në vendin tonë, pyetja ka qënë e lirë dhe popullatë ka qënë e lire të përgjigjej ose jo. (Censusi, 2012:75)

Perkatesia fetare Religious affiliation	Popullsia banuese Resident population	Perqindja e popullsisë banuese Percentage of resident population
Gjithsej Total	2800138	100
Myslimane Muslims	1 587 608	56,70
Bektashinj Bektashi	58 628	2,09
Katolike Catholics	280 921	10,03
Ortodoks Orthodox	188 992	6,75
Unqillore Evangelists	3 797	0,14
Te tjere te krishtere Other Christians	1 919	0,07
Besimtare te pacilesuar* Believers without denomination*	153630	5,49
Ateist Atheists	69 995	2,50
Tieter Others	602	0,02
Preferojne te mos pergjigjem Prefer not to answer	386 024	13,79

Tabela 9: Përkatësia fetare e shqiptarëve sipas CENSUSIT-it

Pyetjes se “Deri në ç’masë zoti është i rëndësishëm në jetën tuaj” duke i dhënë një shkallë nga 1 deri tek 10, ku 1 është aspak i rëndësishëm dhe 10 është shumë i rëndësishëm.

Qytetarët janë përgjigjur në këtë mënyrë:

Shkalla	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
%	5.0	0.8	4.6	3.3	10.4	6.6	8.7	7.7	6.9	42.9

Nuk e di 1.2% dhe Pa përgjigje 0.8%

Nga rezultatet e mësipërme vihet re që automatikisht si shumë të rëndësishëm në jetën e tyre duke i vënë shkallën 10 përgjigjen 42.9%. Nëse bëjmë rezultatin final duke u nisur nga logjika që mbi shkallën 5 tregon se zoti është i rëndësishëm në jetën e tyre janë 73.9 e të anketuarve. Vetëm 10.4% mund të konsiderohen në dilemë në lidhje me rëndësinë e zotit dhe i japin një rol të mesëm. Ndërsa 13.7 e të anketuarve mund të thuhet që nuk e konsiderojnë të rëndësishëm. Ç’mund të kuptojmë nga këto përgjigje?

Fillimisht kuptohet që ata që e konsiderojnë të rëndësishëm në jetën e tyre: së pari kanë shprehur pranimin e ekzistencën së zotit, së dyti kanë shprehur pranimin e ekzistencës së fuqive hyjnore të zotit për të drejtuar jetën e tyre, së treti besojnë se zoti (fuqi hyjnore) mund të ndikoj në jetën e tyre, mësimet e tij të dhëna nga cilado fe mund të jenë të domosdoshme për të udhëhequr jetën e tyre. Pra përgjigja e 73.9% se zoti është i rëndësishëm tregon një shoqëri që përkon me vlerat e fetare dhe ekzistencën e një forcë

hyjnore. Këtu nuk ka pasur interes në anketë për ti pyetur që të vënë emrat e dërguesve të zotit në tokë, të flitej për mësimet e tij përmes biblës apo kuranit ose cilido libër të shenjtë. Pra nuk ka dallime mes njërës fe dhe një feje tjetër për analizën e bërë këtu.

Një tjetër çështje që ju ngrit të anketuarve ishte se si e pëcaktonin ata veten: “Pavarësisht nga fakti nëse shkoni në kishë apo në xhami a do të thoni se ju jeni: 1.një nga fetarët, 2. Një nga jo fetarët, 3. Ateist i bindur.

Të pyeturit janë përgjigjur në këtë mënyrë:

Vetëpërcaktimi	Një nga fetarët	Një nga jo fetarët	Ateist i bindur	Nuk e di	Pa përgjigje
%	60.8	19.4	10.5	3.0	6.3

Mund të themi që në vetëpërcaktimin që i bëjnë vetes dominon me 60.8% konsiderimi si fetar. Që në fakt shkon në linjë të njëjtë me rezultatet që na vijnë në lidhje me rolin e zotit në jetën e tyre, duke e konsideruar atë shumë të rëndësishëm. Pra si fetar duhet ta konsiderojnë veten nëse besojnë se mbartin në vete vlerat që propagandon feja apo zoti.

Të anketuarit përveç rëndësinë që duhet ti jepnin zotit në jetën e tyre, ju kërkua që ti jepnin rëndësi edhe fesë. Në këtë pyetje merret përqindje që anon nga krahu i shekullares por jo me një diferencë drastike mbi 50%. Vihet përqindje të lartë të atyre që mund të quhen të pavendosur, në mes të dyjave boshteve të vlerave që përcakton Inglehart ku 20.1%

shprehen deri diku e rëndësishme. Ndërsa në krahun e vlerave shekullare janë 48.5% duke dhënë përgjigjet aspak e rëndësishme dhe pak e rëndësishme, ndërsa 30.6% shprehen që është e rëndësishme ose shumë e rëndësishme feja në jetën e tyre. Nuk e di dhe pa përgjigje janë të papërfillshme duke marrë secila nga 0.4% të përgjigjeve të të anketuarve. Tabela më poshtë tregon ndarjen e saktë në përqindje të përgjigjeve të marra për këtë pyetje:

Rëndësia e fesë	Aspak e rëndësishme	Pak e rëndësishme	Deri diku e rëndësishme	E rëndësishme	Shumë e rëndësishme	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	27.2	21.3	20.1	17.6	13.0	0.4	0.4

Pyetja tjetër që ju drejtohet të anketuarve ka lidhje me atmosferën fetare, që do të thotë me ritet, me simbolet, me sjelljen fetare brenda ambjentit të tyre familjar. Pyetja është binare duke thënë mundësinë e përgjigjes me po ose jo. A jeni rritur në një atmosferën fetare në shtëpi? 1.Po, 2.Jo. dhe Nuk e di, Pa përgjigje.

Të anketuarit janë përgjigjur kështu:

Atmosfera fetare	PO	JO	Nuk e di	Pa përgjigje
%	35.8	61.7	0.4	2.1

Ky rezultat vlen të diskutohet sepse mungesa e atmosferës fetare në shtëpi si ambjenti kryesor i edukimit të vlerave dhe zakoneve nuk shpjegon vetëkonceptimin e tyre si fetar që doli nga anketimi. Një shpjegim mund të jetë i lidhur me vitet e komunizmit në Shqipëri gjatë të cilave e kishin të ndaluar çdo lloj shfaqje të vlerave fetare në cilido ambjent dhe frika e përgjithshme që gjithçka kontrollohej nga shteti ka bërë që të mos krijohet një atmosferë fetare në shtëpi por pavarësisht kësaj besimi fetar ekzistonte. Megjithatë nuk është e thënë që ku është shpjegimi i vetëm i kësaj gjendje, për të kuptuar më shumë do shikohen edhe përgjigjet e pyetjeve të tjera.

Të anketuarve ju drejtua pyetja: “Sa besim keni në institucionet fetare” Shkalla ishte nga 1 deri tek 5 ku përkatësisht për secilën shkallë korrespondonin: 1- aspak besim, 2-jo shumë besim, 3-deri diku besim, 4-mjaftueshëm besim, 5-shumë besim dhe opsionet nuk e di dhe pa përgjigje.

Të anketuarit u përgjigjen kështu:

Besimi	1	2	3	4	5	Nuk e di	Pa pergj.
%	34.4	19.3	19.7	10.2	15.6	0	0.8

Këtu vihet re nga përgjigjet që mungon besimi tek institucionet fetare. Shikohet nga njëra anë besim në zot në masë të madhe dhe nga ana tjetër mos besim në institucionet fetare. Arsye pse nuk kanë besim tek këto institucione nuk ka qënë objekt i studimit por ajo që mund të supozohet është që mesa duket nuk e lidhin besimin në fe dhe vlerat fetare me besimin në institucionet fetare. Ndoshta shqiptarët preferojnë një lidhje shpirtërore më të

drejtpërdrejtë me zotin dhe jo nëpërmjet institucionet fetare. Por kjo ngelet në kuadër të një aludimi për të shqyrtuar në punime të tjera, ku merren përsipër shqyrtime të kësaj natyre.

Në të njëjtën linjë për të kuptuar se sa praktikantë janë shqiptarët është edhe pyetja tjetër e drejtuar atyre: “Sa shpesh keni marrë pjesë në shërbimet fetare kohët e fundit?”

1. Më shumë se një herë në javë, 2. Një herë në javë, 3. Një herë në muaj, 4. Vetëm gjatë festave fetare të veçanta, 5. Një herë në vit, 6. Më pak se një herë në vit, 7. Kurrë, praktikisht kurrë

Shërbimet fetare	1	2	3	4	5	6	7	Nuk e di	Pa përgjigje
%	2.9	4.2	3.8	40.0	7.1	10.8	28.8	0	2.5

Kjo përgjigje në një farë mënyrë shkon në linjë të drejtë me faktin që nuk besojnë në institucionet fetare për këtë arsye nuk gjenden përqindje të larta në shpeshhtësinë e kryerjes së shërbimeve fetare, të cilat kryhen pikërisht në këto institucioneve. Mund të lidhet po ashtu me mungesën e atmosferës fetare në shtëpitë e tyre, që nuk ka kultivuar një mendim për të kryer shërbime fetare, për aq kohë sa edhe brenda shtëpisë nuk kryejnë rite fetare.

Pyetja e fundit lidhet me përkatësinë fetare: “A i përkisni një feje?” Duke i dhënë mundësinë që të përgjigjeshin jo dhe po, por nëse përgjigjeshin po atëherë ju kërkohet që të specifikonin se cilës fe i përkisnin. Nga rezultatet na doli kjo pamje:

Feja	Asnje	Myslim ane	Ortodokse	Katolike	Bektashia ne	Evagjelis te	Tje tër	Pa përgjigje
%	9.1	52.3	11.6	8.3	13.7	1.2	1.2	2.5

Ky rezultat na tregon që shqiptarët nuk besojnë thjesht në zot por kanë një besim fetar që shoqëron bindjen e tyre në ekzistencën e të përtëjshmes. Propocioni i përqindjeve sipas besimeve fetare të të anketuarve shkon në të njëjtën linjë me përqindjen e propocionit që është pamja e shoqërisë shqiptare sipas Censusi që u paraqitën edhe më lart. Që do të thotë në një farë mënyre na rikonformohet bindja që u shpreh në prezantimin e metodologjisë: se një anketim mbi qytetarët e Tiranës mund të konsiderohet si përfaqësues i qytetarëve të Shqipërisë. Kjo na jep një farë legjitimitimi të mendohet se rezultatet e mësipërme përfaqësojnë panoramën e shoqërisë shqiptare.

Në këtë shumëllojshmëri të feve të cilat njerëzit i kanë vetëdeklaruar që i përkasin, e rëndësishme është të kuptojmë se çfarë mendojnë njerëzit për vlerën e tolerancës fetare. Kjo ishte në serinë e vlerave që u përmendën pak më lart, që i pyetëm në mënyrë të njëpasnjëshme për të thënë se sa dakort ishin me ruajtjen e tyre. Për tolerancën fetare të anketuarit janë shprehur 72.1% dakort dhe shumë dakort, ndërsa 9.4% janë aspak dakort dhe jo dakort. Duket një mazhorancë absolute në ruajtjen e kësaj vlerë. Tabela na tregon rezultatet konkrete:

Toleranca fetare	Aspak dakort	Jo dakort	Disi dakort	Dakort	Shume dakort	Nuk e di	Pa përgjigje
---------------------	-----------------	--------------	----------------	--------	-----------------	-------------	-----------------

Përqindja	4.5	4.9	18.0	13.5	58.6	0.4	0
-----------	-----	-----	------	------	------	-----	---

Përgjigja e kësaj pyetje shkon në linjë llogjike me kombinimin e përgjigjeve që kanë thënë të anketuarit në lidhje me mos qenit praktikant të devotshme të besimeve fetare dhe mos pasjes së atmosferës fetare në shtëpitë e tyre po ashtu edhe me faktin që fenë nuk e mendojnë si shumë të rëndësishme. Këto mund të jenë shpjegime logjike pse jemi kaq tolerant fetar, sepse besojmë më shumë në një zot që është i përbashkët për të gjithë sesa në ndasitë midis feve të ndryshme.

Pikërisht në kuadër të parimeve dhe mësimave fetare Inglehart klasifikon që qëndrimi që njerëzit do të mbajnë ndaj fenomeneve të tilla si aborti, divorci, eutanazia dhe vetëvrasja lidhen me boshtet e tyre vlerore në ndarjen midis të qenurit tradicional apo shekullar. Këto fenomene shihen si të papranueshme nga institucionet fetare dhe nga vullneti madhor i zotit, që ato besojnë. Kështu që të anketuarve ju vunë edhe këto në një liste me ngjarje që mund të hasnin në jetën e tyre për të thënë nëse nuk e justifikojnë kurrë një veprim të tillë që e klasifikuam me shkallën 1, në një shkallë nga 1 deri tek 10, ku me shkallën 10 për të thënë nëse e justifikojnë përherë një veprim të tillë. Përgjigjet që jepeshin nga shkalla 1 deri në shkallën 4 klasifikohen si tërësisht në anën e vlerave tradicionale dhe përgjigjet që jepeshin nga shkalla 7 deri në shkallën 10 klasifikohen si tërësisht në anën e vlerave shekullare. Le të marrim një nga një, për shkak se perceptimi i tyre ndryshon nga njëri tek tjetri.

I pari në listë është aborti, për të cilin 70.9% e të anketuarve u përgjigjen në anën e boshtit të vlerave tradicionale, nga kjo përqindja 48.5% u shprehën që nuk është kurrë e justifikuar dmth në shkallën 1 të renditjes sonë. Ndërsa 16.1% e të anketuarve u përgjigjen në anën e boshtit të vlerave shekullare. Ku në fakt për këtë pyetje pritshmëritë do ishin më të larta në krahun e boshtit të vlerave shekullare, për arsye se ligji shqiptar e lejon abortin me disa specifika të caktuara por e lejon. Gjë që mund të kishte ndikuar tek njerëzit për ta bërë më të justifikueshëm por mesa duket një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Kjo na jep një indikator të qartë që vlerat nuk kanë të bëjnë thelbësisht me atë që lejon ose nuk lejon ligji, me të ligjshme dhe më të paligjshmen në një shoqëri. Konkretikisht kësaj pyetje janë përgjigjur në këtë formë, sicc tregon tabela si mëposhtë:

Justifikimi i abortit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10 (gjith një)	Nu k e di	Pa përgjigj e
Përqindja	48.5	8.0	8.9	5.5	9.3	3.4	6.3	3.0	1.7	5.1	0	0.4

Tjetri është divorci, për të cilin të anketuarit janë shprehur 46.4% në krahun e vlerave tradicionale ndërsa 31.4% në krahun e vlerave shekullare. Këtu mesa duket ka ndikuar më shumë fakti që përmendëm edhe pak më lart që divorci është i pranuar përherë nga ligji si një mundësi që u jepet bashkëshorteve në rast se mosmarrëveshjet e tyre nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim. Në këtë aspekt mendohet se mund të ketë ndikuar por gjithsesi janë akoma shumë në krahun e vlerave tradicionale pavarësisht një shoqërie që është

përditë e më hapur ndaj formave të ndryshme të të qënurit në çift. Konkretisht në këtë pyetje, të anketuarit janë përgjigjur:

Justifikimi i divorcit	1 (kurrë)	2	3	4	5	6	7	8	9	10 (gjithnjë)	Nu k e di	Pa përgjigj e
Përqindja	27.4	7. 2	3. 8	8. 0	16. 5	5. 5	8. 0	7. 6	5. 9	9.7	0.4	0

Element tjetër i shtruar si pyetje është justifikimi i eutanazisë, për të cilën në disa raste është dashur nga anketuesit të sqaronin të anketuarit për konceptin, dhe ata ishin trajtuar paraprakisht që një gjë e tillë mund t'ju ndodhte. Kjo sepse në vendin tonë nuk është diskutuar mjaftueshëm për eutanazinë, qoftë edhe falë fatit që nuk kemi patur shumë raste të dukshme shëndetësore për të cilat opinioni publik mund të ishte thirrur në gjykim sicc ka ndodhur në shoqëritë e tjera, edhe fqinje. Në këtë pyetje janë përgjigjur 71.6% në krahun e vlerave tradicionale dhe 15.7% në krahun e vlerave shekullare. Tabela e mëposhtme ilustron përqindjet e sakta të përgjigjeve të së anketuarve:

Justifikimi i divorcit	1 (kurrë)	2	3	4	5	6	7	8	9	10 (gjithnjë)	Nu k e di	Pa përgjigj e
Përqindja	56.8	7. 2	5. 9	1.7	3.8	2.5	4.7	3.8	1.7	5.5	4.7	1.7

E fundit është vetëvrasja, fenomen i njohur për shoqërinë edhe e folur dhe përfolur në mediumet e ndryshme. Të anketuarit janë përgjigjur 93.7% në krahun e vlerave tradicionale ku nga kjo përqindje duhet thënë që 83.9% janë të qëndrimit që nuk është kurrë e justifikuar, ndërsa në anën tjetër që qëndrojnë vlerat shekullare janë shprehur vetëm 1.5% e të anketuarit. Kjo përqindje kaq drastike mendohet se mund të ketë lidhje fort edhe me faktin që jeta është e dhënë nga zoti dhe shkon në vijë të drejtë me përgjigjen e të anketuarve që zoti është shumë i rëndësishëm në jetën e tyre. Duke i dhënë rëndësi zotit, pritej një qëndrim i tillë kundrejt asaj që konsiderohet vepra e zotit, dhënia e jetës për njerëzit.

Këto janë të gjithë indikatorët, të shprehur me anë të pyetjeve në anketë për të gjykuar mbi profilin vleror në boshtin tradicional apo shekullar. Nga totaliteti i përgjigjeve të dhëna më lart por edhe rëndësinë që i japim secilës prej tyre duke konsideruar historinë, politikën, ligjin në Shqipëri mund të gjykojmë që: Duke përmbyllur kështu serinë tonë të pyetje që lidhen me indikatorët e përcaktuar nga Inglehart dhe Baker si matës të llojit të vlerave, midis atyre tradicionale dhe shekullare, nga përgjigjet e mësipërme duket qartë që qytetarët e Tiranës (në këtë rast mund edhe të përgjithësohet nga të anketuarit për të gjithë Shqipërinë) kanë një profil të qartë tradicional përkundrejt atij shekullar.

5.3 Rezultatet empirike për boshtin e vlerave, materialiste përkundrejt postmaterialiste

Indikatorët që masin vlerat materialiste dhe postmaterialiste në shoqëri janë të lidhura me qëllimet që mendon individi se duhet të ndjek si parësore një qeveri kur e vë përballë zgjedhjes. Indikatorët e vlerave materialiste janë: kur njerëzit besojnë se qeveria duhet të ketë parësore:

1. Një nivel të lartë rritje ekonomike
2. Sigurimi në vend i një ushtrie të fortë për t'u mbrojtur
3. Mbajtja e rendit në vend
4. Lufta ndaj rritjes së çmimeve
5. Të paturit e një ekonomie të qëndrueshme
6. Lufta kundër kriminalitetit.

(Inglehart, 1977:439)

Indikatorët e vlerave postmaterialiste janë: kur njerëzit besojnë se qeveria duhet të ketë parësore:

1. Që njerëzit të thonë fjalën e tyre në punë, në lagje, në komunë etj
2. Përpjekja për të bërë qytetet dhe fshatrat më të bukura
3. Përmirësimi i pjesmarrjes së qytetarve në vendimet e qeverisë
4. Garantimi i lirisë së shprehjes
5. Progresi drejt një shoqërie më pak jo personale dhe më shumë humane
6. Progresi drejt një shoqërien ku idetë vlerësohen më shumë se paratë. (Inglehart, 1977:439)

Pyetja e parë që fillon përcaktimin në dy boshtet është: “Këtu keni të renditura disa qëllime që Shqipëria duhet të përcaktojë për dhjetë vitet e ardhshme. Cili nga ato ju duket më i rëndësishmi?” [vetëm një përgjigje] “Dhe kush është që vjen pas tij [vetëm një përgjigje]

- Një nivel të lartë të rritjes ekonomike
- Sigurimi në vend i një ushtrie të fortë për t’u mbrojtur
- Të bëhet që njerëzit të thonë fjalën e tyre në punë, në lagje, në komunë
- Përpjekja për t’i bërë qytetet e fshatrat tona më të bukura

Përsa i përket qëllimit të parë, atij më të rëndësishmit që duhet të ndjek Shqipëria për të anketuarit ishte në shumicë absolute prej 84.5% një nivel të lartë të rritjes ekonomike. Në total në drejtim të vlerave materialiste si parësore janë përgjigjur në masën 86.6% e të anketuarve ndërsa në drejtim të vlerave postmaterialsitë janë përgjigjur në masën 13.3% si parësore.

Tabela tregon përqindjet e saktë sipas secilës përgjigje që kanë dhënë të anketuarit:

Qëllim 1	Rritja ekonomike	Ushtria e fortë	Njerëzit të thonë fjalën e tyre	Vendi më i bukur	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	84.5	2.1	10.3	3.0	0	0

Të njëjtës pyetje të anketuarit duhet të jepnin edhe një qëllim të dytë, pasi përcaktonin qëllimin e parë, kuptohet nga e njëjta liste me 4 indikatorë që kemi paracaktuar në pyetje.

Si qëllim dytësor janë përgjigjur që më i rëndësishmi është që njerëzit të mund të thonë fjalën e tyre por kjo në masën 38.8% që nuk është një mazhorancë aq absolute sa gjendet tek përcaktimi i qëllimit parësor. Dhe në vend të dytë është përpjekja për të pasur qytete dhe fshatra më të bukura në masën 28.6%. Për t'u vënë në dukje është fakti që ishin shumë më të qartë tek qëllimi parësor, duke shmangur edhe përgjigjet nuk e di dhe pa përgjigje, ndërsa tek qëllimi i dytë janë më të shpërndarë në përgjigje si edhe zgjedhjen edhe opsionin nuk e di dhe pa përgjigje. Vlerat postmaterialiste i kanë zgjedhur si qëllim dytësor në masën 67.4%, ndërsa vlerat materialiste i kanë zgjedhur si qëllim dytësor në masën 30%.

Konkretisht të anketuarit janë përgjigjur kështu:

Qëllim 2	Rritja ekonomike	Ushtria e fortë	Njerëzit të thonë fjalën e tyre	Vendi më i bukur	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	11.9	18.1	38.8	28.6	1.3	1.3

Një listë tjetër e miksuar midis prirjeve vlerore materialiste dhe atyre postmaterialiste ju paraqit të anketuarve në pyetjen e radhës: “Midis qëllimeve të paraqitura më poshtë a mund të tregoni se cili ju duket më i rëndësishëm ?” [vetëm një përgjigje] “Dhe cili vjen më pas?” [vetëm një përgjigje]

- Mbajtja e rendit në vend
- Përmirësimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimet e qeverisjes
- Lufta ndaj rritjes së çmimeve

-Garantimi i lirisë së shprehjes

Të anketuarit si qëllim parësor zgjodhën si më të rëndësishëm mbajtjen e rendit në vend duke i dhënë 52.4% të përgjigjeve të tyre. Më pas në vend të dytë gjejmë luftën ndaj rritjes së çmimeve duke i dhënë 19.5% të rëndësisë. Të dyja janë përgjigje në krahun e vlerave materialiste të një shoqërie duke bërë që në total të jetë në masën 71.9%, ndërsa përgjigjet që vendosin si parësore një qëllim që lidhet me vlerat postmaterialiste janë në masën 28.1%. Duke mos thënë asnjëri si përgjigje nuk e di ose ta linte pa përgjigje. Tabela më poshtë na paraqet me rezultatet:

Qëllim 1	Mbajtja e rendit në vend	Përmirësimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimet e qeverisjes	Lufta ndaj rritjes së çmimeve	Garantimi i lirisë së shprehjes	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	52.4	16.4	19.5	11.7	0	0

Ndërsa në qëllim dytësor e marr nga e njëjta pyetje dhe kuptohet nga e njëjta liste e mësipërme, të anketuarit janë përgjigjur duke i dhënë 34.1 % garantimit të lirisë së shprehjes dhe 32.5% luftës ndaj rritjes së çmimeve, që mund të konsiderohen njëloj po të kemi parasysh edhe marshin e gabimit që mbajnë anketime të tilla. Që do të thotë që edhe si qëllim dytësor anojnë fort nga vlerat materialiste përkundrajt atyre postmaterialiste. Pra

edhe si qëllim dytësor zgjedhin vlerat materialiste në masën 51% që është përsëri mazhorancë përkundrejt 48.8% që zgjedhin në drejtim të vlerave postmaterialiste.

Përkatesisht janë përgjigjur kështu për qëllimin dytësor në listën e dhënë:

Qëllim 2	Mbajtja e rendit në vend	Përmirësimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimet e qeverisjes	Lufta ndaj rritjes së çmimeve	Garantimi i lirisë së shprehjes	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	18.8	14.3	32.3	34.1	0	0.4

Pyetja tjetër përsëri kërkon që të anketuarit të caktojnë qëllimin parësor dhe një tjetër në vend dytësor midis një liste të caktuar. I është thënë: Këtu kemi një listë tjetër që: Sipas jush cili është më i rëndësishëm?” [vetëm një përgjigje] “Dhe cili vjen më pas?” [vetëm një përgjigje]

- Të paturit e një ekonomie të qëndrueshme
- Progresi drejt një shoqërie më pak jo personale dhe më humane
- Progresi drejt një shoqërie ku idetë vlerësohen më shumë se sa paratë
- Lufta kundër kriminalitetit

Të anketuarit janë përgjigjur se qëllim parësor është të paturit e një ekonomie të qëndrueshme në masën 61.2% edhe në masën 23.3% duke e renditur direkt si të dytën në

listën e qëllimeve parësore kanë dhënë luftën kundër kriminalitetit. Të dyja janë përgjigje që korrespondojnë me indikatorët që na tregojnë vlerat materialiste që në këtë rast të anketuarit janë përgjigjur në masën 84.5% në krahun e tyre. Duke treguar një mazhorancë absolute dhe të qartë në preferencat e tyre. Kështu në krahun e boshtit të vlerave postmaterialiste është përgjigjur vetëm 15.5% e të anketuarve duke zgjedhur si qëllim parësor ose progresin drejt një shoqërie pak jo personale dhe më humane, ose progresin drejt një shoqërie ku idetë vlerësohen më shumë se sa paratë.

Tabela na tregon përqindjen e saktë për secilën nga përgjigjet:

Qëllim 1	Të paturit e një ekonomie të qëndrueshme	Progresi drejt një shoqërie më pak jo personale dhe më humane	Progresi drejt një shoqërie ku idetë vlerësohen më shumë se sa paratë	Lufta kundër kriminalitetit	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	61.2	6.9	8.6	23.3	0	0

Edhe kur nga e njëjta liste ju kërkohet që të zgjedhin qëllimin e dytë që duhet të ndjekim ne si vend përsëri të anketuarit i mëshojnë anës materialiste duke zgjedhur në vend të parë tanimë luftën kundër kriminalitetin në masën 46.2%. Kështu në këtë pyetje gjejmë

përgjigjet në krahun e vlerave materialiste në masën 64.9%, ndërsa në krahun e vlerave postmaterialiste përgjigjen vetëm 33.8%. Duke i dhënë progresit drejt një shoqërie pak jo personale dhe më humane 18.2% dhe progresit drejt një shoqërie ku idetë vlerësohen më shumë se sa paratë 15.6%. Tabela e mëposhtme tregon rezultatet e marra nga të anketuarit:

Qëllim 2	Të paturit e një ekonomie të qëndrueshme	Progresi drejt një shoqërie më pak jo personale dhe më humane	Progresi drejt një shoqërie ku idetë vlerësohen më shumë se sa paratë	Lufta kundër kriminalitetit	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	18.7	18.2	15.6	46.2	0.9	0.4

Si për të kontrolluar edhe përgjigjet e mëparshme si edhe për të bërë një ndarje të fundit midis vlerave materialiste dhe atyre postmaterialiste, të anketuarve ju paraqit një pyetje, të cilën kishin dy opsione: njëra që i korrespondonte vlerave materialiste dhe tjetra vlerave postmaterialiste. Duhet të zgjidhnin njëren mes dy opsioneve. Pyetja ishte: “Sipas jush cila është përgjegjësia më e rëndësishme e qeverisë?” 1. Të sigurojë rendin në shoqëri Apo:2. Të respektojë lirinë individuale. 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje.

68% e të anketuarve janë përgjigjur që përgjegjësia më e rëndësishme e qeverisë është të sigurojë rendin në shoqëri, një përgjigje kjo që korrespondon me profilin e vlerave materialiste. Ndërsa 31.6% e të anketuarve janë përgjigjur që përgjegjësia më e rëndësishme e qeverisë është të respektojë liritë individuale, një përgjigje kjo që korrespondon me profilin e vlerave postmaterialiste. Tabela ja jep rezultatet e përgjigjeve:

Përgjegjësia më e madhe e qeverisë	Të sigurojë rendin në shoqëri	Të respektojë lirinë individuale	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	68.0	31.6	0.4	0

Duke përmbyllur kështu serinë e pyetjeve që lidhen me indikatorët e përcaktuar nga Inglehart dhe Eelzel si matës të llojit të vlerave, midis atyre materialiste dhe atyre postmaterialiste. Nga përgjigjet e mësipërme duket qartë që qytetarët e Tiranës (në këtë rast mund edhe të përgjithësohet nga të anketuarit për të gjithë Shqipërinë) kanë një profil të qartë materialist përkundrejt atij postmaterialist.

5.4 Rezultatet empirike për boshtin e vlerave, mbijetesë përkundrejt vetafirmim

Boshti mbijetesë-vetafirmim lidhet me një sindromë të besimit, të tolerancës, mirëqënien subjektive, aktivizmin politik dhe vetafirmimi që del në pah në shoqëritë postindustriale me një nivel të lartë të sigurisë, ndërsa ekstremi tjetër i mbijetësës del në pah në shoqëri me pasiguri dhe me nivel të ulët të mirëqënies këtu njerëzit i japin më shumë rëndësi sigurisë ekonomike dhe fizike përmbi qëllimeve të tjera dhe ndjehen të kërcënuar nga të huajt, nga diversiteti etnik dhe ndryshimi kulturor. (Inglehart, Baker, 2000:26).

Indikatorët që tregojnë se njerëzit kanë një profil vleror me vlera të vetafirmimit janë në listën e mëposhtme e marrë nga Inglehart dhe Baker dhe të kundërtat e tyre tregojnë një profil vleror me vlera të mbijetësës (Inglehart, Baker, 2000)

- 24. I japin rëndësi miqve në jetën e tyre
- 25. I japin rëndësi kohës së lirë në jetën e tyre
- 26. I japin rëndësi politikës
- 27. E konsiderojnë veten të lumtur
- 28. E konsiderojnë veten me një gjendje të mirë shëndetësore
- 29. Mendojnë se nuk kanë për detyrë të respektojnë dhe duan prindërit, ata duhet ta meritojnë.
- 30. Mendojnë se mund ti besohet shumicës së njerëzve
- 31. Shprehen se i pranojnë si komshinj kategori të caktuara njerëzit të mënjanuar shpesh nga shoqëria si: pijanecë, prostituta, homoseksuale etj

32. Mendojnë se të drejtat për punë janë të barabarta mes meshkujve dhe femrave, mes grup-moshave të ndryshme, dhe mes vendasve dhe të ardhurave nga jashtë vendit,
33. Janë të kënaqur nga gjendja financiare
34. Janë të kënaqur nga jeta
35. Nuk kanë frikë se mund të humbin punën e tyre
36. Mendojnë se kanë lirinë për të zgjedhur dhe kontrollin e jetës tyre
37. Vlerësojnë më shumë kohën e lirë në raport me punën
38. E vlerësojnë punën nga elemente të tjerë sesa nga paga, siguria për ta mbajtur dhe përgjegjësia.
39. Përshihen në veprimtari politike si peticion, bojkot, manifestim, greve
40. I shikojnë me besim institucionet si shtypi, tv, sindikatat, partitë dhe organizatat ndërkombëtare apo edhe lëvizjet (ndërkohë në këtë rast nuk është thjesht e kundërta për vlerat e mbijetësesës, është edhe besimi që shprehin për institucione të tilla si ushtria, policia, qeveria, parlamenti, administrata)
41. Besojnë se nuk duhet të kemi një udhëheqës të fortë që nuk shqetësohet për parlamentin dhe zgjedhjet
42. Besojnë se është mirë tju lihet gjykimi mbi të mirën e vendit specialistëve sesa thjesht qeverisë
43. Besojnë se nuk duhet të lëmë ushtrinë të marr vendimet
44. Besojnë se është mirë të kesh një sistem demokratik
45. Besojnë se një drejtues partie duhet të jetë i gatshëm të bashkëpunoj me grupe që vënë në pikëpyetje pikëpamjet e tij
46. Kanë vështrim miqësor dhe shprehin simpati për popujt e tjerë

47. Nuk kënaqen me mënyrën se si qeveritarët qeverisin vendin

Pyetjet në anketë janë të miksuara mes boshteve të ndryshme vlerore në mënyrë të tillë që të mund të përfitojmë edhe kontroll të përgjigjeve dhe jo një përgjigje për inerci të gjërave të ngjashme që pyeten rresht. Të anketuarve ju drejtua pyetja ku duhet të shpreheshin se sa të rëndësishme ishin për ta disa gjëra, në këtë bosht na interesojnë miqtë, koha e lirë, politika dhe puna, duke ju thënë mundësinë nga 1 deri në 5, ku 1 është aspak e rëndësishme dhe 5 është shumë e rëndësishme.

Sa të rëndësishëm janë miqtë, ishte pyetja e parë që i përkiste këtij boshti. Të anketuarit janë përgjigjur në masën 78.6% në anën e rëndësishme dhe shumë e rëndësishme që janë përgjigje që tregojnë vlera të vetafirmimit, përkundrajt 4.9% të tyre që janë përgjigjur si aspak të rëndësishëm dhe pak të rëndësishme që tregojnë vlera të mbijetesës. Pavarësisht se ky indikator është vendosur nga Inglehart dhe Baker si pjesë e përcaktimit të profilit vleror mes mbijetesës dhe vetafirmimit për vendin tonë duhet të merret me rezerva. Për arsye se po ti kthehemi vlerave tradicionale shqiptare, të paktën të tilla janë konsideruar ato që gjenden në dy kanunet më të rëndësishme që u përmend më lart si kode sjellje në Shqipëri, aty gjendet e specifikuar roli i mikut për shoqërinë, respektin ndaj tij, begenisjen dhe kujdesin maksimal ndaj tij. Dhe kjo gjë në vendin tonë mund të lidhet me tradicionalen më shumë, me kalimin e kësaj vlere nga një brez në tjetrin sesa me përkatësinë në boshtin mbijetesë-vetafirmim.

Gjithsesi konsiderohet si indikator në këtë pjesë, pavarësisht sqarimit për rezervave kur të bëhet analizën përfundimtare e llojit të profilit që gjendet tek të anketuarit. Konkretisht kësaj pyetje, i janë përgjigjur si në tabelën mëposhtë:

Miqtë	Aspak i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Deri diku i rëndësishëm	I rëndësishëm	Shumë i rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	0.8	4.1	16.5	38.7	39.9	0	0

Koha e lirë është subjekti i dytë për të cilin duhet të gjykonin rëndësinë në jetën e tyre, të anketuarit janë përgjigjur në masën 51.3% në krahun e përgjigjeve që i korrespondojnë vlerave të vetafirmimit dhe në masën 20.5% në krahun e përgjigjeve që i korrespondojnë vlerave të mbijetesës. Tabela e mëposhtme tregon përqindjet e përgjigjeve të tyre:

Koha e lire	Aspak i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Deri diku i rëndësishëm	I rëndësishëm	Shumë i rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	6.7	13.8	28.3	29.2	22.1	0	0

Politika, çështja që ne shqiptarët në jetën tonë të përditshme shprehemi shumë për të, që është çështja jonë e parë e bisedave dhe e ajo që e mbizotëron. Megjithatë sa të rëndësishme e mendojnë politikën në jetën e tyre të anketuarit? Kësaj pyetje ata i janë përgjigjur në masën 17.4% që është e rëndësishme dhe shumë e rëndësishme në jetën e tyre dmth në krahun e vlerave të vetafirmimit. Krejt e kundërta e asaj që është krijuar si ide për

imazhin tone, se për shqiptarët merren nga mëngjesi deri në darkë vetëm me politikë. Mund të aludohet që ky është thjesht perceptim që na vjen nga mediat dhe nga fakti se në ato mbizotëron një informacion dhe kohë televizive më shumë për politikën dhe këtë e marrin të mirëqënë që duhet ti përgjigjet një realiteti të shqiptarëve. Ose mund të jetë që diskutimi për politikën të jetë në kuadër të një shoqërie “sehirdashëse” që duket qënë politika e mbushur me thashetheme, me sharje dhe me jetë personale brenda saj, ne jemi më të tërhequr nga këto, sesa besojmë që politika është e rëndësishme për jetën tonë. Në krahun e atyre që janë përgjigjur aspak e rëndësishme, dhe pak e rëndësishme janë 65.3% e të anketuarve që qëndrojnë në këtë mënyrë në anën e vlerave të mbijetesës. Përqindjet që na dolën nga kjo pyetje janë:

Politika	Aspak i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Deri diku i rëndësishëm	I rëndësishëm	Shumë i rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	44.2	21.1	16.5	8.7	8.7	0.4	0.4

Puna një nga indikatorët më të rëndësishëm, të cilën do ta hasim edhe në pyetje të tjera për ta kuptuar më mirë tendencën vlerore të shqiptarëve. Në këtë pyetje ishte rëndësia që i jepnin në jetën e tyre. Të anketuarit janë shprehur në masën 74.5% që ajo është shumë e rëndësishme, dhe 14.2% si e rëndësishme, gjë që e bën që të jenë në krahun e vlerave të mbijetesës në masën 88.7% duke i dhënë rol parësor punës. Ndërsa në krahun e kundërtët që i përgjigjet vetëafimimit qëndrojnë 5.8% e të anketuarve. Sipas përgjigjeve të mëposhtme shohim rëndësinë që i japin të anketuarit:

Rëndësia e punës	Aspak e rëndësishme	Pak e rëndësishme	Deri diku e rëndësishme	E rëndësishme	Shumë e rëndësishme	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	2.5	3.3	5.4	14.2	74.5	0	0

Nga përgjigjet e mësipërme duke llogaritur mesataret e secilës në boshtin 1 deri 5, mund të krijojmë një renditje mes tyre, që secila veç e veç mund të jetë e rëndësishme por sa është madhësia e rëndësisë për secilën:

Nr.	Kategoria	Rëndësia (1-5) për të gjithë të anketuarit	Vlera që mbështet rezultati
1	Puna	4.55	Mbijetesë
2	Miq të	4.13	vetafirmim (sinjifikanca e vogël për traditën që thamë më lart)
3	Koha e lirë	3.4	Është në mes vlerave që nuk na flet për një drejtim
4	Politika	2.91	Mbijetesë

Duke marrë parasysh gjithë rezultatet e nxjerrë nga kjo pyetje vihet re që të anketuarit anojnë në anën e vlerave të mbijetesës përkundrejt vlerave të vetafirmimit.

Pyetja tjetër ishte: “Duke marrë parasysh gjithçka, a do të thoni se jeni: 1. Aspak i lumtur; 2. Jo shumë i lumtur; 3. Deri diku i lumtur; 4. Mjaftueshëm i lumtur; 5. Shumë i lumtur; 88. Nuk e di; 99. Pa përgjigje. Sipas Inglehart dhe Baker kur njerëzit e shikojnë veten si të

lumtur, si të kënaqur, si mirë nga gjëndja shëndetësore, që lidhen me mirëqënien subjektive janë në krahun e vlerave të vetafirmimit (Inglehart, Baker, 2000).

Lidhur me lumturinë në jetën e tyre të anketuarit janë përgjigjur si aspak të lumtur dhe jo shumë të lumtur në masën 10.1% që shkon në drejtim të vlerave të mbijetesës, ndërsa 55.9% janë përgjigjur që janë mjaftueshëm të lumtur ose shumë të lumtur që shkon në drejtim të vlerave të vetafirmimit. Konkretisht tabela na jep të dhënat e marra nga të anketuarit:

Lumturia	Aspak i lumtur	Jo shumë i lumtur	Deri diku i lumtur	Mjaftueshëm i lumtur	Shumë i lumtur	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	2.0	8.1	34.0	40.5	15.4	0	0

Pyetja tjetër ishte: “Në tërësi, si do ta paraqitni gjendjen tuaj shëndetësore në këtë çast? A do të thonit se ajo është: 1. Shumë e keqe; 2. E keqe; 3. E pranueshme; 4. E mirë 5. Shumë e mirë?” 88. Nuk e di; 99. Pa përgjigje. Kjo përgjigje shkon pothuaj në vijë të drejtë me lumturinë që shprehin të anketuarit, dmth që anon nga pjesa mirë dhe shumë mirë. Të anketuarit përgjigjen që janë mirë dhe shumë mirë në masën 69.8%, që përsëri është në anën e vetafirmimit. Ndërsa si shumë të keqe dhe të keqe e klasifikuan shëndetin e tyre 6.9% e të anketuarin, që na drejtojnë nga vlerat e mbijetesës. Gjendja shëndetësore klasifikohet më mirë se sa lumturia, që është e kuptueshme, që do të thotë ato korrelojnë me

njëra tjetrën, por shëndeti nuk është i vetmi faktor nga i cili del dhe prodhohet lumturia.

Konkretisht mund ti referohemi tabelës:

Shëndeti	Shumë e keqe	E keqe	E pranueshme	E mire	Shumë e mirë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	1.2	5.7	23.3	43.3	26.5	0	0

Njerëzit që mbartin vlera të vetafirmimit mendojnë se nuk kemi për detyrë të respektojmë dhe të duam prindërit tanë kur ata nuk e kanë merituar me sjelljen dhe qëndrimin e tyre, ndërsa ata që mbartin vlera të mbijetesës mendojnë se duhen dashur dhe respektuar gjithnjë prindërit tanë, pavarësisht nga cilësitë dhe të metat e tyre. Kjo ishte një pyetje që ju drejtua të anketuarve duke i thënë se me kë nga opinionet ishin dakort, duke ja lexuar të dyja dhe mundësinë e zgjedhjes së njërit nga opinionet me të cilin identifikoheshin. Këtu ata janë përgjigjur 93.5% që prindërit duhen dashur dhe respektuar gjithmonë pavarësisht nga cilësitë dhe të metat e tyre, qartësisht drejt vlerave të mbijetesës. Ndërsa 6.1% që prindërit nuk e kemi për detyrë të respektojmë dhe të duam nëse ata nuk e kanë merituar me sjelljen dhe qëndrimet e tyre. Vetëm 0.4% u përgjigjen nuk e di.

Respekti ndaj prindërve	Duhet gjithmonë	Duhet ta meritojnë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	93.5	6.1	0.4	0

Përsëri në kuadër të vetëperceptimit dhe mënyrës së si njerëzit e shikojnë veten e tyre dhe jetën që janë duke bërë, ju drejtuan edhe pyetje në lidhje me kënaqësinë njëherë nga të

ardhurat dhe njëherë nga jeta që bënë, duke ju dhënë mundësinë që të përgjigjeshin në një shkallë më të gjërë nga 1 deri në 10. “Në ç’masë jeni i kënaqur ose jo nga gjëndja financiare e familjes tuaj? Nëse jeni krejt i pakënaqur zgjidhni 1 ose një numër afër 1, nëse jeni krejt i kënaqur zgjidhni 10 ose një numër afër 10. Ju mund të zgjidhni numrat e ndërmjetëm për të nuancuar opinionin tuaj”

Aspak i kënaqur

Shumë i kënaqur

01 02 03 04 05 06 07 08 09 10

Përgjigjet 1 deri në 4 i klasifikojmë në krahun atyre që mbartin vlerat e mbijetesës, ndërsa përgjigjet nga 7 deri në 10 i klasifikojmë në krahun e atyre që mbartin vlerat e vetafirmimit. Të anketuarit janë përgjigjur në krahun e mbijetesës në masën 26.2% dhe në krahun e vetafirmimit në masën 41%. Për secilën mundësi përgjigje në tabelë gjejmë përqindjet e sakta:

kënaqësi nga të ardhurat	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	3.7	3.7	6.1	12.7	15.6	17.2	15.6	12.3	6.1	7.0	0	0

Në lidhje me kënaqësinë pyetje tjetër ishte: “Në përgjithësi në ç’masë jeni i kënaqur apo i pakënaqur nga jeta që bëni në këtë çast?”

Aspak i kënaqur

Shumë i kënaqur

01 02 03 04 05 06 07 08 09 10

E njëjta llogjikë e dekriptimit të përgjigjeve vlen edhe në këtë pyetje në lidhje me klasifikimin në një bosht vleror ashtu si në kënaqësinë nga të ardhurat. Këtu gjejmë që 19.2% janë përgjigjur në krah të vlerave të mbijetesës dhe 54.2% në krah të vlerave të vetafirmimit. Tabela na njeh me të gjitha variacionet në përqindje të përgjigjeve të së anketuarve:

kënaqësi nga jeta	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	2.9	2.9	4.1	9.9	15.7	10.3	17.8	20.7	7.0	8.7	0	0

“Në përgjithësi, a do të thonit që mund t’i besohet shumicës së njerëzve apo që duhet të jesh i kujdesshëm kur ke të bësh me të tjerët? 1. Mund t’i besohet shumicës së njerëzve; 2. Duhet të jesh i kujdesshëm; 88. Nuk e di; 99. Pa përgjigje. Kjo ishte pyetja tjetër, që dedekton vlerat, nëse përgjigjet janë se mund ti besohet shumicës së njerëzve kemi vlera të vetë afirmimit, ndërsa duhet të jesh i kujdesshëm kemi vlera të mbijetesës. Tabela na jep përqindjen e sakta duke na treguar se 93% kanë vlera të mbijetesës.

Besimi	Mund ti besosh shumicës	Duhet të jesh i kujdesshëm	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	5.8	93.0	0.8	0.4

Vlerat e vetafirmimit siç u tha më lart lidhen edhe me tolerimin dhe me pranimin e grupeve të ndryshme, të veçanta në shoqëri pavarësisht ndonjë karakteristike të tyre që i bën jo të ngjashëm me shumicën e pjesës tjetër të shoqërisë. Për këtë arsye të anketuarve ju bëhet një

liste me njerëz të kategorive të ndryshme të cilët mund ti kishin komshinj të tyre, të jetonin pranë e pranë, do të thotë edhe kontakt i përditshëm. Opsionet ishin i dua, nuk i dua apo jam indiferent, ku i dua korrespondon me vlerat e vërtetëafirmimit, ndërsa nuk i dua i korrespondon me vlerat e mbijetesës. Për secdo kategori duhej një përgjigje me vete, dhe jo një përgjigje totale për të gjithë listën.

“Do ju them një listë me kategori të ndryshme njerëzish. A mund të na thoni se ndër to ka nga ata që nuk do të dëshironit t’i kishit si komshinj? Cilët?” Nuk i dua (1); I dua(2); Indiferent (88) Pa përgjigje(99).

Lista ishte:

1. Njerëz që kanë një detyrë gjyqësore;
2. Njerëz të një race tjetër
3. Ekstremistë politikë
4. Pijanecë
5. Njerëz jo të qëndrueshëm emocionalisht
6. Prostituta
7. Njerëz të sëmurë nga SIDA
8. Të droguar
9. Homoseksualët

Në këtë ndarje dyshe ose i do ose nuk i do, vështrimi për nga vlerat është shumë i thjeshtë për tu kuptuar dhe do paraqitet me tabelën përkatëse për secilën nga kategoritë. Ajo që bie në sy është se të anketuarit shprehin i dua, vetëm për njerëzit me një detyrë gjyqësore dhe njerëzit e një race tjetër, përgjigje këto që shkojnë në drejtim të vlerave të vetëafirmimit.

Ndërsa për 7 kategoritë e tjera në variacione përqindjesh që do i shikojmë më poshtë, mbështesin fuqishëm idenë që nuk i duan për komshin, një qëndrim ky që shkon në drejtim të vlerave të mbijetesës.

Si mund të shpjegohet ndryshimi me dy kategoritë e para? Përsa i përket njerëzit me një detyrë gjyqësore, ata nuk kanë ndonjë element të ndryshëm nga shoqëria veç profesionit që është i ndryshëm për të tërë edhe nuk është ndonjë faktor që lidhet me diskrimimin. Arsyeja pse vendosen në listë lidhet me rrezikun që mund të perceptohet për faktin që trajtojnë me kriminel dhe mund të jenë të rrezikuar nga kërcënime apo atentate. Por këta njerëz në vendin tonë shikohen edhe si njerëz të pushtetshëm dhe pushtetin është më mirë ta kesh afër se sa larg. Ndërsa për njerëzit e një race tjetër, besoj se në perceptimin tonë lidhet me romët, të cilët nuk kanë shkaktuar në vend asnjë dëm, asnjë problem, asnjë sjellje kundër rendit shoqëror, ata jetojnë në mesin tonë pa shkaktuar ndonjë tronditje morale, sociale etj sic mund të shkaktojnë kategoritë e tjera të listës.

Tabelat e mëposhtme tregojnë rezultatet e nxjerra për secilën kategori:

Me detyrë gjyqësore	Nuk i dua	I dua	Indeferent	Pa përgjigje
Përqindja	25.7	47.8	25.7	0.8

Racë tjetër	Nuk i dua	I dua	Indeferent	Pa përgjigje
Përqindja	26.1	47.3	25.3	1.2

Ekstremistë politikë	Nuk i dua	I dua	Indeferent	Pa përgjigje
Përqindja	69.0	13.5	15.9	1.6

Pijanecë	Nuk i dua	I dua	Indeferent	Pa përgjigje
Përqindja	88.2	6.1	5.3	0.4

Jo stabël emocionalisht	Nuk i dua	I dua	Indeferent	Pa përgjigje
Përqindja	66.5	13.9	16.7	2.9

Prostituta	Nuk i dua	I dua	Indeferent	Pa përgjigje
Përqindja	77.1	13.5	9.0	0.4

Me SIDA	Nuk i dua	I dua	Indeferent	Pa përgjigje
Përqindja	67.2	15.2	16.4	1.2

Të droguar	Nuk i dua	I dua	Indeferent	Pa përgjigje
Përqindja	86.9	6.6	5.7	0.8

Homoseksual	Nuk i dua	I dua	Indeferent	Pa përgjigje
Përqindja	78.3	10.7	10.2	0.8

Përsëri gjatë anketës ata u pyetën për homoseksualitetin dhe prostitucionit por këto ishin pjesë e liste gjërash për të cilat ata duhet të shpreheshin se sa i justifikonin si sjellje, në një shkallë nga 1 deri 10, ku 1 ishte nuk i justifikonin kurrë dhe arrihet deri në 10 që e justifikonin gjithmonë. Kjo ishte e përbërë edhe me faktor që dedektonin boshtin tradicional-shekullar që u morrën në shqyrtim në rezultatet e atij boshti. Pyetja ishte: “Për secilin nga pohimet e mëposhtme, a mund të na thoni se ai justifikohet gjithnjë diçka ndërmjet tyre sipas shkallës së mëposhtme?”

a) Homoseksualiteti

b) Prostitucioni

Nëse të anketuarit shprehen nga shkalla 1 deri në 4 duke mos i justifikuar atëherë ata i përkasin vlerave të mbijetesës, nëse shprehen nga shkalla 7 deri në 10 duke i justifikuar atëherë ata i përkasin vlerave të vetafirmimit.

Në lidhje me homoseksualitetin të anketuarit shprehen me 1 si kurrë e justifikuar 74.3% e tyre duke pasur një mazhorancë shumë të madhe dhe të fuqishme me 1 në krahun e vlerave të mbijetesës. Duke e bashkuar edhe me shkallët e tjera që janë të të njëjtit drejtim e çojnë 85.3%, ndërsa në anën e vlerave të vetafirmimit duke e justifikuar janë përgjigjur 5.5% në total duke u përgjigjur me 10 vetëm 1.3%. Tabela na jep variacionet e përqindjeve për secilën shkallë:

Justifikimi	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Nuk e di	Pa përgjigje
Homoseksual												
Përqindja	74.3	5.5	3.4	2.1	6.3	0.8	1.3	2.5	0.4	1.3	0.8	1.3

Pika tjetër ishte prostitucioni, për këtë të anketuarit përsëri u shprehën në krahun e vlerave të mbijetesës duke thënë për shkallën 1 përgjigje prej 77.6% të tyre dhe në total me këto vlera 89.8% e tyre. Ndërsa në krahun e vlerave të vetafirmimit pra ata të anketuar që e justifikojnë këtë fenomen janë 2% e tyre. Dhe duhet përmendur që asnjë nga të anketuarit nuk është përgjigjur me shkallën 10. Tabela na njeh me rezultatet e këtyre përgjigjeve:

Justifikimi	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Nuk e di	Pa përgjigje
Prostitucion												
Përqindja	77.6	5.9	3.8	2.5	4.6	1.7	.8	.8	.4	0	1.3	.4

Sic u përmend edhe më lart këndvështrimet që lidhen me punën, janë të ndarë tek shumë indikator të ndryshëm që secili na jep kontributin e tij në matjen e vlerave të mbijetesës dhe atyre të vetafirmimit. Fillimisht një pyetje që lidhet me 3 pohime, për secilën nga këto pohime të anketuarit i kërkohet që të thotë nëse është dakort ose nuk është dakort me këtë pohim. Sigurisht që ka mundësi të zgjedh që as njëra as tjetra, dmth indiferent ndaj pohimit që i shtrohet, si edhe nuk e di dhe pa përgjigje që janë përherë si opsione. A jeni dakort apo jo me pohimet e mëposhtme: 1. Kur vendet e punës janë të rralla, një burrë ka më shumë të drejtë për një punë se sa një grua. 2. Kur vendet e punës janë të rralla, duhen detyruar njerëzit e moshuar të dalin në pension më herët. 3. Kur vendet e punës janë të rralla, u duhet dhënë prioritet për vend pune shqiptarëve ndaj të huajve.

Ata që kanë vlera të mbijetesës janë dakort me këto pohime, që do të thotë besojnë se burrat kanë më shumë të drejtë për punë se sa një grua, që të moshuarit të dalin herët në pension

kur na ka vende pune të shumta dhe që tu jepet më shumë prioritet për punë vendasve sesa të huajve. Ndërsa ata që kanë vlera të vetafirmimit nuk janë dakort me pohimet e mësipërme. Për sa i përket pohimit të parë të anketuarit janë shprehur 30.7% dakort, që konsiderohen me vlerat e mbijetesës, ndërsa 56.1% nuk janë dakort që konsiderohen me vlerat e vetafirmimit. Tabela na jep rezultatet:

Burrat më shumë drejta pune se gratë	Dakort	Jo dakort	As njëra as tjetra	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	30.7	56.1	11.1	1.6	0.4

Për pohimin e dytë që lidhet me të moshuarit të anketuarit janë shprehur 46.3% dakort me këtë qëndrim duke besuar në një farë mënyrë që është një nga mënyrat që të rinjtë të mund të futen në ekonomi dhe në punë, si një mënyrë për të siguruar të ardhurat e tyre. Ndërsa 36.8% nuk janë dakort me një pohim të tillë duke u shprehur në anën e vlerave të vetafirmimit. Tabela na njeh me përqindjet përkatëse:

Të moshuarit në pension më herët	Dakort	Jo dakort	As njëra as tjetra	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	46.3	36.8	13.6	2.1	1.2

Për pohimin e tretë që parashikon një situatë kur vendet e punës janë të rralla dhe në këto kushte duhet tju jepet më shumë prioritet shqiptarëve sesa të huajve, ata shprehen që janë dakort me këtë pohim në masën 71.6% ndërsa 16.5% nuk janë dakort. Kuptohet që realiteti i deritanishëm shqiptar nuk ka hasur ndonjëherë valë emigracioni nga jashtë, dhe shumë të huaj që mund të zënë vendet e punës shqiptarëve por pavarësisht kësaj, qëndrimi është kundër tyre në rastin e vendeve të punës. Kurioz si qëndrim duke marrë parasysh faktin se shqiptarët, janë përballur vetë ose kanë të paktën një pjesëtar i afërt në emigracion me këndvështrimin e të huajit për vendin tjetër, mund të ishte pritur një qëndrim të ndryshëm. Por edhe kësaj rradhe pozicionohen përsëri me shumicë në boshtin e vlerave të mbijetesës. Më poshtë rezultatet në formë tabelare:

Shqiptarëve prioritet për punë sesa të huajve	Dakort	Jo dakort	As njëra as tjetra	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	71.6	16.5	10.7	0.4	0.8

Personat që mbartin vlerat të mbijetesës janë më të prirur të ndiejnë frikë se mund të humbasin vendin e tyre të punës dhe frikë se mund të kenë një ulje të nivelit të tyre të jetesës. Nuk është e rëndësishme nëse kjo frikë është e bazuar në realitetin e vështirë ekonomik të përgjithshëm, apo është thjesht një perceptim i këtij realiteti. Sigurisht kjo është e lidhur me atë që këta persona e konsiderojnë punën si të rëndësishme në jetën e tyre.

Ndërsa personat që mbartin vlerat e vetafirmimit janë më të prirur për të mos pasur frikë se mund të humbasin punën ose se mund të kenë ulje të nivelit të tyre të jetesës.

Pyetja e parë në lidhje me këtë ishte: “A keni frikë se së afërmi do të humbni apo duhet të ndryshoni vendin e punës?”¹ 1. Jo; 2. Po, kam frikë se do humbas vendin e punës; 3. Po, kam frikë se duhet të ndryshoj vendin e punës; 4. Nuk punoj 88. Nuk e di; 99. Pa përgjigje. Nga përgjigjet e të anketuarve doli që 51.4% nuk kanë frikë se mund të humbin apo të duhet ta ndryshojnë vendin e punës, përgjigje kjo në krahun e vlerave të vetafirmimit. Dhe në krahun e mbijetesës që përgjigjen po, pavarësisht nëse e humbin apo e ndryshojnë janë 28%. Mirëpo siç do ta shikojmë edhe nga tabela e përqindjeve më poshtë tek përgjigjet vëmë re që 11.9% janë pa punë dhe nuk i klasifikojmë dot, ndërsa një përqindje që nuk haset në pyetjet e tjera nuk janë përgjigjur, dmth 6.2% kanë thënë që nuk duan të japin përgjigje për këtë pyetje. Që në fakt ne mund të aludojmë që kjo mund të jetë një lloj frike tjetër që lidhet me humbjen e vendin të punës, sepse ata që ishin pa punë cilësohen si të tillë, edhe dalin edhe nga pyetjet e tjera të anketës që kërkon ku punojnë, të ardhurat etj. Këta që përgjigjen, me opsionin pa përgjigje janë të punësuar por mesa duket frika është më e madhe sesa thjesht ta thuash atë. Ky është një aludim dhe nuk supozon që u gjet arsyeja e vërtetë se përse janë përgjigjur kështu por ama nuk mund të lihet pa thënë që duke matur përgjigjet nuk e di, nuk punoj dhe pa përgjigje arrijmë në 20.6%. Që nëse do ti bashkangjiteshin këto shifra njëri nga krahëve të boshteve vlerore do na ndryshonin panoramën që na paraqitet. Tabela tregon konkretisht rezultatet:

Frikë për	Jo	Po, kam	Po, kam	Nuk punoj	Nuk e di	Pa

punën		frikë se do e humbas	frikë se do e ndryshoj			përgjigje
Përqindja	51.4	21.8	6.2	11.9	2.5	6.2

Ndërsa pyetja tjetër lidhet me frikën për uljen e nivelit të jetesës: “A keni frikë se së afërmi do të keni një ulje të nivelit tuaj të jetesës?”¹ 1. Po; 2. Jo: 88.Nuk e di; 99.Pa përgjigje. Kësaj pyetje janë përgjigjur 42.9% po, një drejtim që të çon drejt vlerave të mbijetesës, ndërsa 47.8% janë përgjigjur me jo, një drejtim që të çon drejt vlerave të vetafirmimit. Përsëri vëmë re një përqindje të konsiderueshme për opsionin nuk e di dhe pa përgjigje që sëbashku shkojnë në 9.3%. Tabela na njeh me rezultatet:

Frikë nga ulja e nivelit të jetesës	Po	Jo	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	42.9	47.8	8.2	1.1

“Në ç’masë mendoni se keni lirinë për të zgjedhur dhe kontrollin mbi jetën tuaj?” ishte një nga pyetjet e anketës duke ju dhënë mundësinë që të përgjigjeshin në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 fillonte me aspak dhe kuptohej një shkallë rritëse deri në 10 ku ishte shumë. Sigurisht edhe opsionet nuk e di dhe pa përgjigje. Ku përgjigjet nga 1 deri në 4(përfshirë) na indikojnë për vlerat e mbijetesës dhe nga 7 deri në 10(përfshirë) na indikojnë për vlerat e vetafirmimit. Në analizë të këtyre na del që 6.9% mund të klasifikohen nga përgjigjet e tyre në krah të boshtit të vlerave të mbijetesës dhe 77.2% e tyre në krahun e vlerave të

vetafirmimit, ndërsa kemi 19.6% që qëndrojnë në mes të këtyre dy prirjeve. Tabela e mëposhtme na njeh me përgjigjet për secilën nga nivelet e shkallës 1-10.

Liri dhe kontroll në jetën tuaj	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	1.2	0.4	4.1	1.2	11.8	7.8	10.6	15.9	10.6	35.1	0.8	0.4

Siç u përmend edhe më lart raporti midis kohës së lirë dhe punës është shumë i rëndësishëm si indikator për të matur se në cilin bosht vleror qëndrojnë të anketuarit. Kur u pyetën më lart për secilën veç e veç të anketuarit thanë për të dyja që janë shumë të rëndësishme. Por ashtu siç e sqaruam në pjesën teorike, vlerat që realisht kanë rëndësi dhe që dominojnë sjelljen e njeriut janë ato që janë më lart në hierarkinë e tij, dmth që në një nevojë për të zgjedhur mes të dyjave, ajo që do të zgjidhej. Ajo që do të zgjidhte tregon anën e vërtetë të profilit e tij vleror. Kjo gjë ju kërkua i të anketuarve të zgjidhnin vetëm njërin nga dy pohimet e kundërta që vendosnin në raport kohën e lirë me punën, ku njëri i jepte rëndësi kohës së lirë dhe tjetri punës. Pyetja e drejtuar ishte: “Me cilin nga pohimet e mëposhtme jeni me shumë dakort?”¹. Është koha e lirë e kënaqësitë dhe jo puna që bën që t’ia vlejë të jetohet jeta 2. Është puna dhe jo koha e lirë e kënaqësitë që bëjnë që t’ia vlejë që të jetohet jeta. Të jesh dakort me pohimin e parë do të thotë që kesh vlera të vetafirmimit dhe të jesh dakort me pohimin e dytë do të thotë të kesh vlera të mbijetesës. Kësaj pyetjeje të anketuarit ju përgjigjen në krahun e vlerave të mbijetesës ku puna bën që tja vlej të jetohet

jeta në krahasim me kohës së lirë në masën 81.3% ndërsa në krahun tjetër ku koha e lirë bën që të jetohet jeta u përgjigjen 17.1%. Tabela na njeh me rezultatet e pyetjes:

Ja vlen të jetohet jeta	Është koha e lirë e kënaqësitë dhe jo puna	Është puna dhe jo koha e lirë e kënaqësitë	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	17.1	81.3	0.8	0.8

Përsëri në kuadër të renditjes dhe hierarkisë vlerore të anketuarve ju kërkua të zgjidhnin kriterin më të rëndësishëm kur janë duke zgjedhur një vend pune , dhe përsëri nga e njëjta lista me 4 indikatorë të na tregonin edhe kriterin e dytë. Pyetja ishte: “Kur jeni në kërkim të një pune cilat gjëra ju duken më të rëndësishme nga kriteret e mëposhtme. Cili, do të ishte sipas jush më i rëndësishmi?” “Dhe kush vjen pas tij?”

- a) një pagë e mirë për të mos patur halle për para
- b) një vend pune të garantuar pa rrezik mbylljeje apo humbjeje
- c) të punosh me njerëz që shkon mirë
- d) të bësh një punë të rëndësishme që të japë ndjenjën se ke bërë diçka

Të anketuarit që zgjedhin si kriter parësor për të zgjedhur punën, pagën ose garancinë që nuk do mbyllet ose do ta humbnin i përkasin vlerave të mbijetesës dhe ata që zgjedhin si kriter parësor, marrëdhënien e mirë me njerëzit që punojnë dhe ndjenjën që po bëjnë diçka të rëndësishme i përkasin vlerave të vetafirmimit. Ndërsa kriteri dytësor na tregon prirjen

drejt njëres vlerë ose drejt tjetres, pra pasi kanë plotësuar kriterin e parë vlerën me të rëndësishme nga mund të anojnë, përsëri nga e njëjta apo mund të ndryshojnë.

Si kriter parësor të anketuarit zgjedhën një pagë të mirë në masën 47.6% dhe 22.5% zgjedhën garancinë e vendit të punës, që na çon që të anketuarit zgjedhin si kriter parësor për punësimin e tyre në masën 70.1% me vlera të mbijetesës. Ndërsa si kriter parësor marrëdhënien me njerëz që të shkosh mirë e zgjedhën 12.6% dhe ndjenjën që ke bërë diçka të rëndësishme si kriter e zgjedhën 16.4%, që bën që në anën e vlerave të vetafirmimit të kemi 29% të anketuarve. Tabela e mëposhtme na përmbledh rezultatet:

Kriter parësor	një pagë e mirë për të mos patur halle për para	një vend pune të garantuar pa rrezik mbylljeje apo humbjeje	të punosh me njerëz që shkon mirë	Ndenjën që ke bërë diçka të rëndësishme	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	47.6	22.5	12.6	16.4	0.5	0.4

Nga e njëjta liste do të zgjidhej edhe kriteri i dytë që i ndikon në zgjedhjen e vendit të punës. Të punosh me njerëz që shkon mirë është përzgjedhur nga të anketuarit në masën 31.7% por kjo nuk na flet për prirje drejt vlerave të vetafirmimit. Sepse duke parë përgjigjet 52% kanë zgjedhur dy kriteret që së bashku i përgjigjen vlerave të mbijetesës konkretisht

pagën dhe garancinë në punë, ndërsa së 46.7% kanë zgjedhur dy kriter që së bashku i përgjigjen vlerave të vetafirmimit konkretisht të punojnë me njerëz që shkojnë mirë dhe të kenë ndenjën që po bëjnë diçka të rëndësishme. Tabela na njeh me rezultatet:

Kriter	një pagë e	një vend	të punosh	Ndenjën që	Nuk e di	Pa
dytësor	mirë për të mos patur halle për para	punë të garantuar pa rrezik mbylljeje apo humbjeje	me njerëz që shkon mirë	ke bërë diçka të rëndësishme		përgjigje
Përqindja	25.6	26.4	31.7	15.0	0.9	0.4

Të anketuarve ju paraqit një listë më e gjatë me kriteret për një punë dhe ata nuk ishin të detyruar kësaj rradhe që të bënin një zgjedhje mes tyre por për secilin nga kriteret të mund të thonin sa i rëndësishëm është për ta nga 1 deri në 5, ku 1 është aspak i rëndësishëm deri në 5 që është shumë i rëndësishëm. Secili nga këto kriteret klasifikohet se i përket një drejtim vleror të caktuar të cilën ne do ta japin për secilin kriter, por duhet pasur parasysh që kjo pyetje na jep prirje të caktuara, që ne më pas mund të bëjmë një renditje por nuk na ndan boshtet vlerore nga njëri tjetri. Sepse mund të përgjigjen për secilën është shumë e rëndësishme se në këtë rast nuk janë përjashtuese të njera tjetrës, pse jo një punë ku mund ti kesh të gjitha përfitimet. Por ne duam të shikojmë nëse mund të krijojmë dot një shkallë preferencash mes tyre.

Pyetja konkretisht ishte: “Këtu kemi një listë me disa aspekte të një vendi pune apo një veprimtarie profesionale që konsiderohen ndonjëherë si të rëndësishme. Sipas jush sa të rëndësishme janë nga 1-5?” Listës po i bashkagjisim në kllapa se cilit bosht vleror i përket individi nëse i jep shumë rëndësi atij kriteri, por kjo nuk ka qënë në anketë (siç do ta shikoni anketën të gjithën në aneksin 1)

- a) Një pagë e mirë (vlerave të mbijetesës)
- b) Jo shumë presion (vlerave të mbijetesës)
- c) Një siguri e mirë e vendit të punës (vlerave të mbijetesës)
- d) Një punë që vlerësohet nga të tjerët (vlerave të vetafirmimit)
- e) Orare të mira (vlerave të mbijetesës)
- f) Mundësia për të provuar iniciativën (vlerave të vetafirmimit)
- g) Pushime shumë të mira (vlerave të vetafirmimit)
- h) Një punë ku mendoj se mund të bëj diçka (vlerave të vetafirmimit)
- i) Një punë me përgjegjësi (vlerave të mbijetesës)
- j) Një punë interesante (vlerave të vetafirmimit)
- k) Një punë që i korrespondon aftësive të mia (vlerave të mbijetesës)
- l) Ndjenja se bëj punë të mirë (vlerave të vetafirmimit)
- m) Një mjedis i mirë pune (vlerave të vetafirmimit)
- n) Ndjenja e të qenit të dobishëm për shoqërinë e të tjerët (vlerave të vetafirmimit)

Po i paraqesim me tabela për secilën nga kriteret në mënyrë të tillë që të krijohet ideja se si janë përgjigjur të anketuarit, më pas do të bëjmë një analizë ku do të nxjerrim sa është mesatarisht e rëndësishme për të gjithë të anketuarit, në mënyrë të tillë që të mund të arrijmë në një renditje të këtyre kriterëve sipas përgjigjeve që janë dhënë:

Pagë e mirë	Aspak rëndësishëm	Pak rëndësishëm	Deri diku i rëndësishëm	I rëndësishëm	Shumë rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjig je
%	0	0.8	3.7	14.7	80.8	0	0

Jo presion	Aspak rëndësishëm	Pak rëndësishëm	Deri diku i rëndësishëm	I rëndësishëm	Shumë rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjig je
%	4.1	4.1	13.5	25.4	52.9	0	0

Siguri	Aspak rëndësishëm	Pak rëndësishëm	Deri diku i rëndësishëm	I rëndësishëm	Shumë rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjig je
%	0	1.7	4.6	16.0	77.7	0	0

Vlerë sim	Aspak rëndësishëm	Pak rëndësishëm	Deri diku i rëndësishëm	I rëndësishëm	Shumë rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjig je
%	2.9	6.1	17.1	24.9	48.2	0.8	0

Orare	Aspak rëndësishëm	Pak rëndësishëm	Deri diku i rëndësishëm	I rëndësishëm	Shumë rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjig
-------	----------------------	--------------------	----------------------------	------------------	----------------------	-------------	---------------

							je
%	2.5	4.5	14.0	21.8	56.8	0.4	0

Inicia tiva	Aspak i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Deri diku i rendesishëm	I rëndësishëm	Shumë i rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjig je
%	2.1	6.2	17.8	25.3	47.7	0.8	0

Pushi me	Aspak i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Deri diku i rendesishëm	I rëndësishëm	Shumë i rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjig je
%	2.5	9.1	18.3	23.7	46.5	0	0

Bëj diçka	Aspak i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Deri diku i rendesishëm	I rëndësishëm	Shumë i rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjig je
%	1.2	5.8	13.2	25.1	54.3	0.4	0

Përgj egjësi	Aspak i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Deri diku i rendesishëm	I rëndësishëm	Shumë i rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjig je
%	5.4	9.5	22.3	28.1	34.3	0.4	

Interesante	Aspak i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Deri diku i rëndësishëm	I rëndësishëm	Shumë i rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjigje
%	2.5	6.2	18.1	28.8	44	0.4	0

Aftësi ve të mia	Aspak i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Deri diku i rëndësishëm	I rëndësishëm	Shumë i rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjigje
%	.8	2.1	4.5	14.5	78.1	0	0

Punë të mirë	Aspak i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Deri diku i rëndësishëm	I rëndësishëm	Shumë i rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjigje
%	1.2	1.2	9.5	23.2	64.7	0	0

Mjedis i mirë	Aspak i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Deri diku i rëndësishëm	I rëndësishëm	Shumë i rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjigje
%	1.2	0	6.6	23.6	68.6	0	0

Dobia	Aspak i rëndësishëm	Pak i rëndësishëm	Deri diku i rëndësishëm	I rëndësishëm	Shumë i rëndësishëm	Nuk e di	Pa përgjigje
-------	---------------------	-------------------	-------------------------	---------------	---------------------	----------	--------------

për shoqërinë	rëndësishëm	rëndësishëm	rendesishëm	rëndësishëm	rëndësishëm	e di	përgjigje
%	0.9	4.5	8.9	15.2	70.5	0	0

Tabelat na treguan se si janë përgjigjur të anketuarit për secilin kriter në shkallën me 5 parametra përcaktues. Duhet të kujtojmë që nga 14 kritere të renditura në listë: 6 janë kritere që lidhen me vlerat e mbijetesës dhe 8 janë vlera të vetafirmimit, lista është dhënë paraprakisht në anketë dhe nuk ka dalë si rezultat i përgjigjeve të hapura të së anketuarve. Për secilin nga kriteret e mësipërme ne nxorëm mesatarisht sa i rëndësishëm është për të gjithë të anketuarit, me këtë të dhënë ne mundëm të nxjerrim renditjen e mëposhtme midis kriterëve:

Nr.	Kriteri për punën	Nga 1-5 (sa i rëndësishëm për të gjithë të anketuarit)	Boshtit vleror që i përkasin
1	Mundësia për të provuar iniciativën	4.81	vetafirmim
2	Një punë që vlerësohet nga të tjerët	4.79	vetafirmim
3	Një pagë e mirë	4.76	mbijetesë
4	Një siguri e mirë e vendit të punës	4.70	mbijetesë
5	Një punë që i korrespondon aftësive të mia	4.67	mbijetesë
6	Orare të mira	4.61	mbijetesë

7	Një punë ku mendoj se mund të bëj diçka	4.60	vetafirmim
8	Një mjedis i mirë pune	4.58	vetafirmim
9	Ndjenja e të qenit të dobishëm për shoqërinë e të tjerët	4.50	vetafirmim
10	Ndjenja se bëj punë të mirë	4.49	vetafirmim
11	Një punë interesante	4.27	vetafirmim
12	Jo shumë presion	4.19	mbijetesë
13	Një punë me përgjegjësi	4.12	mbijetesë
14	Pushime shumë të mira	4.02	vetafirmim

Një konceptim mbi punën në një pyetje që kërkon të zgjedhësh vetë njërën nga dy pohimet që ju jepen të anketuarve, nga të cilat njëra i përket atyre që kanë vlera të mbijetesës dhe tjetra i përket atyre që kanë vlera të vetafirmimit. Pyetja ishte: “Me cilin nga të dy pohimet e mëposhtme jeni më shumë dakort?”¹. Është puna baza e krijimit të të gjitha vlerave materiale e shpirtërore; 2. Është puna baza e shfrytëzimit dhe e shtypjes kapitaliste. Përgjigjet që pranojnë pohimin 1 janë në boshtin e vlerave të mbijetesës ndërsa ata që pranojnë pohimin 2 janë në boshtin e vlerave të vetafirmimit. Në këtë pyetje të anketuarit janë shprehur 80.6% që puna është baza e krijimit të gjitha vlerave materiale dhe shpirtërore dhe 11.3% janë shprehur që puna është baza e shfrytëzimit dhe e shtypjes kapitaliste. Në fakt në këtë pyetje ka qënë dyshimi se mos fraza baza e shfrytëzimit dhe e shtypjes kapitaliste do të lidhej me një ideologji komuniste që shqiptarët e kanë pësuar për

50 vjet dhe kjo mund të ndikonte. Por kjo nuk është përgjigje e veçantë ndryshe nga të tjerat por në linjë me të tjerat që punën e konsiderojnë si shumë të rëndësishme, kështu që nuk ka pse të hidhen hipoteza ndikuese tek kjo pyetje. Tabela na jep rezultatet:

Puna	baza e krijimit të të gjitha vlerave materiale e shpirtërore	baza e shfrytëzimit dhe shtypjes kapitaliste	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	80.6	11.3	3.2	0.4

E fundit që lidhet me punën dhe përcakton në lidhje me boshtin mbijetesë-vetafirmim është pyetja: “Me cilin nga 3 pohimet e mëposhtme jeni dakort”: 1. Prodhimet e bëra në vendet e tjera mund të importohen e të shiten lirisht në Shqipëri; 2. Shitja e prodhimeve të huaja në Shqipëri do të duhej të kufizohej ngushtësisht me qëllim që të mbrohen vendet e punës lokale; 3. Apo duhen lënë vetëm prodhimet e jashtme që nuk prodhohen më në vend dhe të mbrohen prodhimet e vendit. Të anketuarit duhet të zgjedhin vetëm njërin nga tre pohimet. Përgjigjet që dakortësohen me pohimin e parë janë në krahun e vlerave të vetafirmimit, ndërsa përgjigjet që dakortësohen me pohimin e dytë dhe të tretë janë në krahun e vlerave të mbijetesës. Të anketuarit u përgjigjen dakort me pohimin 2 dhe 3 në masën 78.4% dmth në krahun e vlerave të mbijetesës, ndërsa dakort me pohimin 1 u përgjigjen 18.3%. Tabela na njeh me rezultatin:

Prodhimet e	Të	të kufizohej	Vetëm ato	Nuk e di	Pa përgjigje
-------------	----	--------------	-----------	----------	--------------

huaja	importohen e të shiten lirisht në Shqipëri	ngushtësisht me qëllim që të mbrohen vendet e punës lokale	nuk prodhohen më në vend dhe të mbrohen prodhimet e vendit		
%	18.3	24.0	54.4	2.1	1.2

Gjykimet vlerore siç dihet lidhen me atë nëse e gjykojmë një ngjarje të caktuar si të mirë apo si të keqe, kjo nisur nga vlerat e secilit. Për këtë arsye ju kërkua të anketuarve që pasi të t'ju thuheshin disa ndryshime që mund të ndodhin në të ardhmen në mënyrën e të jetuarit të shoqërisë ato do të thoshin nëse për ta kjo ishte gjë e mirë apo gjë e keqe. Sigurisht kishin edhe mundësinë të përgjigjeshin jam indiferent ndaj këtij ndryshimi, si për të thënë që për mua nuk ka rëndësi, është një lloj rruge e mesme që nuk i shërben ndarjes së qartë në dy boshtet. Në rastin e përgjigjeve nuk e di dhe pa përgjigje, si përherë nuk i lexohej ky opsion thjesht lihen në vullnetin e tyre nëse përgjigjeshin spontanisht kështu.

Pyetja ishte: “Po ju përmendim disa ndryshime në mënyrën e të jetuarit që mund të ndodhin në të ardhmen. A mund të na thoni për secilën prej tyre nëse do të ishte një gjë e mirë, e keqe, apo për ju s’ka rëndësi?”

-Do t’i vihet më pak rëndësi parave dhe të mirave materiale

-Puna do të zerë një vend më pak të madh në jetë

Për ndryshimet e mundshme nëse të anketuarit përgjigjen gjë e keqe tregon që do të qëndrojnë në krahun e vlerave të mbijetesës ose do të bëhen në krahun e vlerave të mbijetesës, edhe nëse përgjigjen gjë e mirë tregon që do të qëndrojnë me vlerat e vetafirmimit ose të bëhen të tillë.

Për ndryshimin e parë që besohet që do t'i vihet më pak rëndësi parave dhe të mirave materiale, të anketuarit janë përgjigjur që do ishte një gjë e keqe 23.7% të tyre dhe gjë e mirë në masën 48.2%, ndërsa indiferent ndaj ndryshimit në masën 23.7%. Shohim një masë të konsiderueshme drejt vlerave të vetafirmimit, më e madhe se masa aktuale që na dilte nga pyetjet e mësipërme. Tabela jep përgjigjet me përqindjen:

Më pak rëndësi parave	Gjë e keqe	Indiferent	Gjë e mirë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	23.7	23.7	48.2	3.7	0.8

Ndryshimi tjetër që ju është paraqitur atyre si i mundshëm për një të ardhme është që puna të zërë më pak vend në jetë, pra roli i punës të jetë më i vogël. Të anketuarit kur mendojnë për të ardhmen e konsiderojnë një gjë të mirë nëse bie roli i punës në jetë, atë përgjigjen që është gjë e mirë në masën 48.2%, që shkon në drejtim të vlerave të vetafirmimit dhe 33.1% në drejtim të vlerave të mbijetesës. Tabela na jep pasqyrën e përgjigjeve:

Më pak	Gjë e keqe	Indiferent	Gjë e mirë	Nuk e di	Pa
--------	------------	------------	------------	----------	----

rëndësi punës					përgjigje
Përqindja	33.1	19.2	43.7	3.3	0.8

Mirëpo element që vlen të merret në konsideratë është fakti që shumë nga të anketuarit janë përgjigjur indiferent për ndryshimin, që nëse tentojmë ta përkthejmë është nuk ka rëndësi se çfarë ndryshimesh do ndodhin, jam indiferent ndaj tyre dhe do vazhdoj të mbaj të njëjtin qëndrim, që në rastin tonë të njëjtat vlerë. Duke parë përgjigjet më lart janë fortësisht me profilin e mbijetesës si në lidhje me paranë dhe në lidhje me punën, që do të thotë se mund të supozohet që indiferenca është më e pritshme që të lidhet me vlerat e mbijetesës në këtë rast. Nga kjo, situata e përqindjeve të mësipërme na ndryshon se nëse konsiderohet edhe indiferent në krahun e mbijetesës, plus përgjigjen gjë e keqe që është, të dyja sëbashku kalojnë në përqindje ata që janë përgjigjur në krahun e vlerave të vetafirmimit. Megjithatë ndryshe nga përgjigjet e të tashmes, në këtë rast edhe në bashkim nuk kemi diferenca të mëdha përqindjesh por gati gati ndahen barazisht.

Gjatë studimit teorik ne kemi qartësuar se përse vlerat e vetafirmimit shikohen si ndikuese në nivelin e demokracisë efektive, pikërisht në këtë pjesë të përpunimit të rezultatit të punimit empirik ne mund të shikojmë vërtet lidhjen e natyrshme që vjen mes vlerave të vetafirmimit dhe tendencës së qytetarit për të qënë në qendër të vendimarrjes dhe procesit demokratik pra një demokraci efektive. Ndarjen mes vlerave të mbijetesës dhe atyre të vetafirmimit siç e paraqesin edhe indikatorët më lart, e bëjnë edhe konsideratat e individëve

se sa interesohen për politikën dhe për profilin e atyre që e bëjnë politikën, sa besim dhe vullnet kanë që të ndikojnë politikën në cilën do nga format që mund të ketë zë një qytetar i thjeshtë në vendimarrjen politike, mendimi dhe besimi i tij për qeverisjen e vendin dhe për institucione të tjera që i ndikojnë jetën e tij të përditshme dhe po ashtu si gjykon ai mbi tipologji të ndryshme të të sjellurit në sistemin politik dhe partiak në vend.

Le ti marrim me rradhë sipas pyetjeve të drejtuara të anketuarve dhe rezultatin e secilës në ndarjen e boshtit vleror. Pyetja që ju drejtua: “Në ç’masë jeni i interesuar për politikën?” 1. Aspak i interesuar; 2. Jo i interesuar; 3. Deri diku i interesuar; 4. I interesuar; 5. Shumë i interesuar. Përgjigjet aspak i interesuar dhe jo i interesuar i përkasin boshtit të vlerave të mbijetesës, ndërsa përgjigjet i interesuar dhe shumë i interesuar i përkasin boshtit të vlerave të vetafirmimit. Të anketuarit 42.2% në krahun e mbijetesës, 18% në krahun e vetafirmimit dhe në mes qëndrojnë 39.8%, të cilët do të kalojnë në të ardhmen ose në një krah ose në tjetrin. Aktualisht mbizotërojnë vlerat e mbijetesës në këtë rast. Mesatarisht të gjithë të anketuarit janë të interesuar për politikën në shkallën nga 1 deri në 5, në masën 2.5 janë të interesuar për politikë, qartësisht në vlerat e mbijetesës.

Interesi për politikën	Aspak i interesuar	Jo i interesuar	Deri diku i interesuar	I interesuar	Shumë i interesuar	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	34.4	7.8	39.8	9.0	9.0	0	0

Individët që besojnë që veprimtaria e tyre mund të ndryshoj politikën në nivel qendror dhe politikën në nivel lokal, kanë vlerat e vetafirmimit, që do të thotë që edhe do të sillen në këtë mënyrë. Siç shpjegojmë edhe në pjesën teorike lidhjen e vlerave me sjelljen, do të thotë që ata që besojnë se veprimtaria e tyre mund të ndryshoj diçka, veprojnë në mënyrë të tillë që kjo gjë të ndodh, nuk rrinë pasiv ndaj vendimeve të institucioneve që mund të jenë kundër interesave të tyre si qytetar. Dy pyetjet e radhës lidhen pikërisht me këtë fakt nëse besojnë se veprimtaria e tyre mund të ndryshojë politikën në nivel qendror edhe në nivel lokal.

Fillimisht u pyetën :“Sa besoni se me veprimtarinë tuaj mund ta ndryshoni politikën në Shqipëri: 1. Aspak; 2. Pak; 3. Deri diku; 4. Shumë; 88.Nuk e di; 99.Pa përgjigje. Pra me një shkallë me 4 masa, ku përgjigja aspak dhe pak lidhen me vlera të mbijetesës dhe përgjigja deri diku dhe shumë lidhen me vlera të vetafirmimit. Të anketuarit janë përgjigjur 74.6% duke zgjedhur aspak ose pak si alternativë dhe i përkasin vlerave të mbijetesës ndërsa 24.6% janë përgjigjur duke zgjedhur deri diku dhe shumë dhe i përkasin vlerave të vetafirmimit. Tabela mëposhtë na jep rezultatet sipas secilës alternativë:

Ndryshoni politikën qendrore	Aspak	Pak	Deri diku	Shumë	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	52.5	22.1	19.3	5.3	0.8	0

Më pas pyetja ishte: “Sa besoni se me veprimtarinë tuaj mund ta ndryshoni politikën në nivelin lokal” me të njëjtat alternativa që ishin më lart: 1. Aspak; 2. Pak; 3. Deri diku; 4. Shumë; 88.Nuk e di; 99.Pa përgjigje. Kësaj pyetje që e sjell politikën pak më afër në nivel lokal të anketuarit i janë përgjigjur me aspak dhe pak, 69.7% duke treguar vlera të mbijetesës. Ndërsa 28.3% janë përgjigjur deri diku dhe shumë duke treguar vlera të vetafirmimit. Tabela na njeh me rezultatet:

Ndryshoni politikën qendrore	Aspak	Pak	Deri diku	Shumë	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	44.7	25.0	19.3	9.0	1.6	0.4

Të anketuarve ju paraqit një listë me aktivitete të ndryshme politike sicc është peticioni, bojkoti, greva etj dhe për këto u kërkua që të mund të cilësonin nëse tashmë e kanë bërë një gjë të tillë, nëse do ta bënin, ose nëse s’do ta bënin kurrë. Vlerat aktuale na dalin tek pjesa nëse e kanë bërë një gjë të tillë deri sot ose nuk e kanë bërë, nëse e kanë bërë atëherë mbartin vlera të vetafirmimit, nëse nuk e kanë bërë atëherë mbartin vlera të mbijetesës. Nëse pjesa tjetër e pyetjes është për të parë nëse në një të ardhmen do ta bënin ose sdo ta bënin kurrë një veprimtari të tillë politike duke na ndihmuar neve të kuptojmë se sa të qëndrueshme i kanë vlerat e caktuara apo janë më fleksibël ndaj tyre në një të ardhme. Pyetja konkretisht ishte: Këtu keni një listë me disa forma të veprimtarisë politike dhe për secilën do të na thoni nëse tashmë e keni bërë, nëse do të mund ta bënit, ose nëse nuk do ta bënit, sido qofshin rrethanat?”

- a) Nënshkrimi një petition
- b) Pjesëmarrje në një bojkot
- c) Pjesëmarrje në një manifestim të lejuar
- d) Pjesëmarrje në grevë spontane
- e) Rrëmbim armësh dhe rebelim ndaj shtetit

Realiteti i këtyre viteve të tranzicionit demokratik i ka dhënë mundësinë shqiptarëve që të mund të merrnin pjesë në secilën nga këto veprimtari politike, qoftë edhe atë më ekstremen të rrëmbimin të armëve dhe rebelimin ndaj shtetit nëse sjellin ne mend vitin 1997. Fillohet me nënshkrimin e një peticioni, duke parë në rradhë të parë vlerat e sotme dhe më pas tendencën për të ardhmen dhe në këtë mënyrë do veprojmë me të gjitha veprimtaritë. Kësaj pyetje 30% i janë përgjigjur që tashmë e kanë bërë në krahun e vlerave vetafirmimit, që do të thotë që pjesa tjetër prej 65.9% nuk e kanë bërë ndonjëherë këtë gjë që qëndrojnë në krahun e vlerave të mbijetesës (në këtë rast përqindjen e nxjerrim duke mbledhur së bashku ata që janë përgjigjur do ta bëja ose sdo ta bëja kurrë, dhe duke mos marrë në konsideratë ata që janë përgjigjur nuk e di ose pa përgjigje, e njëjta metodë do të jetë për çdo përgjigje të tillë në veprimtaritë e tjera që do shqyrtojmë më pas).

Peticion	Tashmë e kam bërë	Nuk e kam bërë
Përqindja	30	65.9

Nga qytetarët që nuk e kanë bërë një petition (pra duhet të kujtojmë që kjo pjesë mbart aktualisht vlera të mbijetesës dhe ne kështu duam të kuptojnë nëse do mund të ndryshojnë apo do qëndrojnë në krahun që janë) shprehen 53.1% që do ta bënin me vlera të pritshme

vetafirmimi dhe 12.8% që nuk do ta bënin kurrë, me vlera të pritshme mbijetese. Tabela e mëposhtme na përmbledh rezultatin:

Peticion	Tashmë e bërë	Do ta bëja	S'do ta bëja kurrë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	30.0	53.1	12.8	3.3	0.8

Veprimtaria tjetër është pjesmarrje në një bojkot, të anketuarit janë përgjigjur 14.5% që tashmë e kanë bërë një gjë të tillë, duke na dhënë neve përkatësinë tek vlerat e vetafirmimit dhe 74.8% nuk e kanë bërë një gjë të tillë, duke na dhënë neve përkatësinë tek vlerat e mbijetesës.

Bojkot	Tashmë e kam bërë	Nuk e kam bërë
Përqindja	14.5	74.8

Ata që nuk e kishin bërë tashmë një bojkot janë shprehur 50% e tyre që do ta bënin pra drejt vlerave të vetafirmimit dhe 24.8% e tyre që nuk do ta bënin kurrë pra drejt vlerave të mbijetesës. Tabela e mëposhtme na tregon rezultatet e plota për këtë veprimtari:

Bojkot	Tashmë e bërë	Do ta bëja	S'do ta bëja kurrë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	14.5	50.0	24.8	9.5	1.2

E treta në listë është pjesëmarrja në një manifestim të lejuar, për këtë 27.3% e të anketuarve janë përgjigjur që tashmë e kanë bërë, duke treguar vlera të vetafirmimit dhe 67.8% nuk e kanë bërë, nuk kanë marrë pjesë në një manifestim të lejuar, duke treguar vlera të mbijetesës.

Manifestim i lejuar	Tashmë e kam bërë	Nuk e kam bërë
Përqindja	27.3	67.8

Kjo pjesë që nuk ka marrë pjesë në një manifestim të lejuar, 55% e tyre shprehën që do ta bënin një gjë të tillë që treguan mundësinë për adaptimin e vlerave të vetafirmimit dhe 12.8% shprehën që nuk do ta bënin kurrë duke treguar qëndrueshmëri në vlerat e tyre të mbijetesës. Tabela na jep rezultatet:

Manifestim i lejuar	Tashmë e bërë	Do ta bëja	S'do ta bëja kurrë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	27.3	55.0	12.8	3.7	1.2

Më pas kemi pjesëmarrje në një grevë spontane, ku të anketuarit janë shprehur që tashmë e kanë bërë 13.2% e tyre duke treguar vlera të vetafirmimit dhe që nuk e kanë bërë 74% duke treguar vlera të mbijetesës.

Greve spontane	Tashmë e kam bërë	Nuk e kam bërë
Përqindja	13.2	74

Duke menduar që greva dhe më pas rrëmbimi i armëve janë veprimtari deri diku ekstreme, që nuk ndodh shpesh dhe nuk mund të jetë vendim që domosdoshmëri mund ti ketë lindur

nevoja që ta merrnin të anketuarit. Atëherë gjykohet që për këto dy veprimtari, pjesa nëse do ta bëjë ose sdo ta bëja kurrë na tregon për vlera të tashme dhe jo vetëm të asaj që do të jetë në të ardhmen si në rastin e veprimtarive më lart. Kështu ata që tashmë nuk e kishin bërë një grevë janë shprehur që do ta bënin 26.9% e tyre që tregojnë vlera të vetafirmimit dhe 47.1% që nuk do ta bënin kurrë duke na treguar përsëri qëndrueshmëri në vlerat e mbijetesës. Rezultatet konkrete në tabelë:

Grevë spontane	Tashmë e bërë	Do ta bëja	S'do ta bëja kurrë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	13.2	26.9	47.1	10.3	2.5

E fundit është pjesëmarrja në një rrëmbim armësh dhe rebelim ndaj shtetit, si një formë ekstreme por e njohur e veprimtarisë politike të qytetarit. Ndoshta ky konsiderim si ekstreme ka bërë që të merreshin edhe përgjigje ekstremisht në krahun e vlerave të mbijetesës qoftë në gjykimin mbi ata që kanë bërë ose jo, qoftë nëse do ta bënin ose sdo ta bënin kurrë. Vetëm 5.4% e kanë bërë tashmë duke treguar vlera të vetafirmimit, pavarësisht se konteksti në të cilin ndodhi, shkaqet etj vlejnë për një analizë të thelluar, e rëndësishme është që konsiderohet formë reagimi kur qeverisja nuk të garanton liritë e tua dhe 84.4% nuk e kanë bërë një gjë të tillë duke qëndruar në anën e vlerave të mbijetesës.

Rrëmbim armësh	Tashmë e kam bërë	Nuk e kam bërë
Përqindja	5.4	84.4

Nga kjo mazhorancë absolute në drejtim të vlerave të mbijetesës, vetëm 5% shprehen që do ta bënin duke dhënë shenjat për vlera të vetafirmimit dhe përsëri mazhoranca ruhet me 79.8% që shprehen që nuk do ta bënin kurrë një gjë të tillë. Në tabelë gjejmë rezultatet:

Rrëmbim armësh	Tashmë e bërë	Do ta bëja	S'do ta bëja kurrë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	5.4	5.0	79.8	6.2	3.7

Të anketuarve ju paraqit një listë me institucione të ndryshme për secilin prej tyre veçmas të mund të shprehnin se sa besim kishin tek ato në shkallë nga 1-5 ku 1 është aspak besim, 2 pak besim, 3 deri diku besim, 4 mjaftueshëm besim dhe 5 është shumë besim. Në këtë rast besimi nuk shpreh gjithmonë të njëjtin krah të vlerave, besimi në disa institucione shpreh vlera vetafirmimi dhe besimi në disa institucione të tjera shpreh vlera të mbijetesës. Konkretisht le të japim pyetjen dhe listën e institucioneve dhe më pas sqarimet përkatëse: “Për secilin institucion të mëposhtëm thoni sa besim keni nga 1-5 ku 1 është aspak besim dhe 5 shumë besim?”

- a) Ushtria
- b) Ligjet
- c) Shtypi
- d) Televizioni
- e) Sindikatat
- f) Policia
- g) Qeveria

- h) Partitë politike
- i) Parlamenti
- j) Administrata
- k) Ndërmarrjet e mëdha
- l) Lëvizjet feministe
- m) NATO
- n) Bashkimi Evropian
- o) Kombet e Bashkuara

Besimi tek institucionet: ushtria, policia, qeveria, parlamenti, administrata, ndërmarrjet e mëdha na tregojnë për njerëz që kanë vlera të mbijetesës. Ndërsa mosbesimi, ose besimi i një niveli të ulët në këto institucione na tregojnë për njerëz që kanë vlera të vetafirmimit.

Besimi i madh tek institucionet: ligji, shtypi, televizioni, sindikatat, partitë politike, lëvizjet feministe, NATO, BE, OKB, flasin për njerëz që kanë vlera të vetafirmimit. Ndërsa mosbesimi, ose besimi i një niveli të ulët në këto institucione flasin për njerëz që kanë vlera të mbijetesës.

Le ti marrim me rradhën e mësipërme: fillimisht besimi tek ushtria. Në krahun e vlerave të mbijetesës kemi 34.9% të anketuarve dhe në krahun e vlerave të vetafirmimit duke mos treguar besim në këtë rast kemi 40.6%. Në fakt duhet thënë që ushtria në Shqipëri nuk është parë shumë si një institucion që lidhet me jetën e përditshme të njerëzve.

Besimi	Aspak	Pak	Deri	Mjaftueshëm	Shumë	Nuk e	Pa
Ushtria	besim	besim	diku	besim	besim	di	përgjigje

			besim				
përqindja	19.3	21.3	24.2	15.6	19.3	0.4	0

Besimi tek ligjet, në këtë pikë të anketuarit janë përgjigjur në anën e vlerave të mbijetesës duke shprehur aspak ose pak besim, në masën 38.3% të tyre dhe në anën e vlerave të vetafirmimit duke shprehur mjaftueshëm ose shumë besim 44.1% e tyre. Tabela na njeh me rezultatet:

Besimi ligjet	Aspak besim	Pak besim	Deri diku besim	Mjaftueshëm besim	Shumë besim	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	19.8	18.5	17.7	20.2	23.9	0	0

Shtypi është trajtuar si një institucion tjetër në një shtet demokratik. Të pyetur për besimin që kanë tek shtypi, të anketuarit janë përgjigjur në krahun e vlerave të mbijetesës 50.4%, ndërsa 20.9% e tyre janë shprehur në krahun e vlerave të vetafirmimit. Besimi tek shtypi shikohet si besim tek një burim informacioni alternativ mbi ngjarjet dhe vendimet që ndodhin nga qeverisja e vendit por jo vetëm, prandaj lidhet me vlerat e vetafirmimit. Tabela na njeh me rezultatet konkrete:

Besimi shtypi	Aspak besim	Pak Besim	Deri diku besim	Mjaftueshëm besim	Shumë besim	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	25.0	25.4	28.7	13.9	7.0	0	0

Në të njëjtën linjë është edhe besimi tek televizioni, 43,2% e të anketuarve janë në anën e besimit të vogël, dmth të vlerave të mbijetesës, ndërsa 27.6% e të anketuarve janë në anën e besimit të madh, dmth të vlerave të vetafirmimit. Tabela më poshtë na tregon rezultatet:

Besimi televizioni	Aspak besim	Pak besim	Deri diku besim	Mjaftueshëm besim	Shumë besim	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	18.9	24.3	29.2	17.3	10.3	0	0

Organizimi në sindikata të pavarura dhe lobimi për interesat e tua është një nga format e pjesëmarrjes dhe e shprehjes së demokracisë, sigurisht edhe matës i vlerave të vetafirmimit. Në këtë kuadër u pyetën edhe për besimin që kanë tek sindikatat: 62.3% u shprehën që nuk kanë besim ose kanë pak, dmth në anën e vlerave të mbijetesës, ndërsa 15.9% u shprehën që kanë mjaftueshëm besim ose shumë besim, duke shfaqur vlera të vetafirmimit. Tabela na jep rezultatet sipas përqindjeve:

Besimi sindikatat	Aspak besim	Pak besim	Deri diku besim	Mjaftueshëm Besim	Shumë besim	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	39.7	22.6	20.9	10.0	5.9	0.8	0

Besimi tek policia flet për një shoqëri që mbart vlerat e mbijetesës. Ndërsa në një farë mënyrë mosbesimi, në kuptimin e gjykimit e veprimeve të saj dhe pëlqimin ose jo sipas veprimeve që janë kryer dhe jo apriori thjesht nga autoriteti që buron nga uniforma flet për

vlera të vetafirmimit. Në këtë rast të anketuarit janë shprehur 32.2% në krahun e vlerave të mbijetesës dhe 28.8% në krahun e vlerave të vetafirmimit. Rezultatet në tabelën më poshtë:

Besimi policia	Aspak besim	Pak besim	Deri diku besim	Mjaftueshëm besim	Shumë besim	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	10.7	18.1	28.8	23.0	19.3	0	0

Përsa i përket besimit tek qeveria, të anketuarit u shprehën në krahun e vlerave të vetafirmimit 41.9% të tyre dhe në krahun e vlerave të mbijetesës 35%. Duhet thënë që qeveria kishte një kohë të shkurtër që ishte në detyrë, sepse anketa është zhvilluar në dhjetor 2013, gjë që mund të ndikoj që të flitej për më shumë besim tek qeverisja e sapozgjedhur dhe me një mazhoritet të madh deri diku. Tabela na njeh me rezultatet:

Besimi qeveria	Aspak besim	Pak besim	Deri diku besim	Mjaftueshëm Besim	Shumë besim	Nuk e di	Pa Përgjigje
përqindja	19.3	22.6	22.6	18.5	16.5	0	0.4

Një nga veprimtaritë më të suksesshme politike dhe më fuqi për tu bërë pjesë e vendimarrjes politike janë partitë politike. Mosbesimi në këtë formë të organizimit politik, përbën problem se cilat do të jenë format e plotësimit të interesave të grupeve të ndryshme sociale në mungesë të saj. Njerëzit me vlerat e mbijetesës nuk kanë besim ose kanë pak

besim, ne nga ankentimi na dolën 54.1%. Ndërsa njerëzit me vlerat e vetafirmimit kanë mjaftueshëm ose shumë besim, nga anketimi dolën 24.2% e të anketuarve. Duke marrë parasysh numrin e madh të partive politike që ekzistojnë në vendin tonë nuk mund të pritej një besim kaq i ulët tek partitë politike. Sepse në një farë mënyre mund të gjenin një parti që i ngjallte më shumë besim. Rezultatet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Besimi partitë	Aspak besim	Pak besim	Deri diku besim	Mjaftueshëm besim	Shumë besim	Nuk e di	Pa Përgjigje
përqindja	34.8	19.3	21.3	15.6	8.6	0	0.4

Parlamenti si institucioni që miraton ligjet dhe përfaqëson vullnetin e popullit, është shumë i rëndësishëm për jetën e qytetarëve sidomos në republikat parlamentare. Besimi tek ligjet e vendit tënd shpreh vlera të vetafirmimit, ndërsa e kundërta është në rastin e parlamentin, besimi tek institucioni gjatë këtij procesi shpreh vlera të mbijetesës. Qytetarët duhet të jenë dyshues, kontrollues dhe lobues në procesin ligjvënës vetëm kështu bëhen pjesmarrës të demokracisë dhe shprehin që kanë vlera të vetafirmimit. Kësaj pyetje të anketuarit ju përgjigjen në krahun e vlerave të vetafirmimit në masën 44.5% të tyre dhe në krahun e vlerave të mbijetesës 29.6% e tyre. Tabela na njeh me rezultatet:

Besimi parlamenti	Aspak besim	Pak besim	Deri diku besim	Mjaftueshëm besim	Shumë besim	Nuk e di	Pa Përgjigje
përqindja	24.3	20.2	25.5	17.3	12.3	0	0.4

E njëjta logjikë vlen edhe për administratën shtetërore që me procedurat dhe vendimet e përditshme ndikon dhe kushtëzon jetën e qytetarëve. Në krahun e mosbesimit apo besimit të pakët qëndrojnë 44.1% e të anketuarve, që shprehin vlera të vetafirmimit dhe në krahun mjaftueshëm besim dhe shumë besim qëndrojnë 28.8% e të anketuarve që shprehin në këtë mënyrë vlera të mbijetesës. Tabela na jep rezultatet që dolën:

Besimi administrata	Aspak besim	Pak besim	Deri diku besim	Mjaftueshëm Besim	Shumë besim	Nuk e di	Pa Përgjigje
përqindja	18.9	25.1	27.2	18.5	10.3	0	0

Realiteti shqiptar nuk e ka shumë të njohur konceptin e ndërmarrjeve të mëdha që mund të gjenden në vendet më të zhvilluara por gjithsesi ekzistojnë ndërmarrje të mëdha në kuptimin më shumë të biznesit të madh. Në këtë pikë të anketuarit janë shprehur në krahun e vlerave të mbijetesës 41.8% dhe në krahun e vlerave të vetëafimimit në masën 32.8%.

Tabela na njeh me rezultatet:

Besimi ndërmarrjet e mëdha	Aspak besim	Pak besim	Deri diku besim	Mjaftueshëm Besim	Shumë besim	Nuk e di	Pa Përgjigje
përqindja	13.5	19.3	24.6	25.4	16.4	0.8	0

Lëvizjet feministe në vendin tonë lidhen me ekzistencën e organizatave në mbrojtje dhe për fuqizimin e rolit të grave si dhe lobimin në forma të ndryshme për këtë gjë. Njerëzit që kanë vlera vetafirmimit i mbështesin këto lëvizje dhe shprehin një besim ndaj tyre në mënyrë të tillë që justifikohet edhe mbështetja më pas. Ndërsa e kundërta ndodh me njerëzit që kanë vlera të mbijetesës. Të anketuarit u përgjigjen 56.2% në krahun e vlerave të mbijetesës, ndërsa 27.5% u përgjigjen në krahun e vlerave të vetafirmimit. Më poshtë kemi rezultatet në formë tabelare:

Besimi lëvizjet feministe	Aspak besim	Pak besim	Deri diku besim	Mjaftueshëm Besim	Shumë besim	Nuk e di	Pa Përgjigje
përqindja	37.3	18.9	15.6	12.7	14.8	0.8	0

Përpara se të shqyrtojmë rezultatet për NATO, BE dhe OKB që janë raste të veçanta për realitetin shqiptar, jo vetëm për ne por edhe në përgjithësi për vendet e dala nga komunizmi në Europën Qëndrore dhe Juglindore. Është e udhës të ndalemi për të shpjeguar në tërësi rezultatin e nxjerrë nga kjo pyetje që rreshton disa institucione dhe kërkonte nivelin e besimit që kishin të anketuarit kundrejt tyre. Fillimisht në formë tabelare po tentojmë të reduktojmë rezultatin e dalë duke nxjerrë vlerat që tregonin të anketuarit sipas secilit institucion dhe nëse kjo tregonte mos besim apo besim duke e thjeshtuar për ta kuptuar më saktë dinamikën që do shpjegojmë më poshtë:

Institucioni	Vlera mbizotëruese që treguan të anketuarit	Niveli i besimit
Ushtria	Vetafirmim	Mosbesimi
Ligjet	Mbijetesë	Mosbesimi
Shtypi	Mbijetesë	Mosbesimi
Televizioni	Mbijetesë	Mosbesimi
Sindikata	Mbijetesë	Mosbesimi
Policia	Mbijetesë	Besim
Qeveria	Vetafirmim	Mosbesimi
Partitë politike	Mbijetesë	Mosbesimi
Parlamenti	Vetafirmim	Mosbesimi
Administrata	Vetafirmim	Mosbesimi
Ndërmarrjet e mëdha	Mbijetesë	Besimi
Lëvizjet feministe	Mbijetesë	Mosbesimi

Ajo që vihet re është që dominon mosbesimi dhe jo besimi në lidhje me të gjitha institucionet që është tipike e vlerave të mbijetesës, që do të thotë pavarësisht se na dalin edhe vlera të vetafirmimit në këtë pyetje, fakti që dominon mosbesimi është shenjë e qartë dhe indikator i qartë i shoqërive me vlera të mbijetesës. Mosbesim që vjen si rezultat edhe i periudhës komuniste që ka kaluar vendi ynë ku cdo njeri mund të paraqiste rrezik për sigurinë tënde sepse mund të dëshmonte apo spiunonte kundra teje.

Marrim në shqyrtim BE, NATO, OKB, të cilat i ndamë më vete sepse ndryshe nga institucionet e mësipërme për këto tre institucione ndërkombëtare, sidomos BE dhe NATO, por edhe OKB janë bërë një retorikë politike, mediatike, sociale duke folur pozitivisht gjatë gjithë kohës. Duke i konsideruar si shumë të rëndësishme, si zhvilluese për vendin, si mbrojtëse për interesat e vendit etj. Kështu që në këtë rast populli është i ndikuar nga kjo gjë që e bënë që të ketë besim tek këto institucione, edhe pse njohja reale me atë që përfaësojnë ato mund të jetë edhe minimaliste. Kjo na e bënë të dyshimtë që ti marrim rezultatet në analizë njëllor si institucionet e tjera, sepse ndryshe nga vendet e tjera perëndimore, vendet në tranzicion i shikojnë këto institucione si shpresa për demokratizim dhe zhvillim. Dhe nuk i gjykojnë shumë mbi normat, vlerat dhe aksionit e tyre sicc mund ta bënte një qytetar gjerman, francez etj. Për këto arsye paraqiten rezultatet por nuk i marrim në konsideratë në lidhje me boshtin vleror mbijetesë-vetafirmim.

Mjaftueshëm dhe shumë besim në lidhje me NATO-n është 72.1% e të anketuarve, në lidhje me BE-në është 79.1%, ndërsa 69.2% në lidhje me OKB. Nëse bëjnë një renditje kanë më shumë besim tek BE, pastaj NATO dhe në fund OKB. Që përsëri konfirmon idenë të ndikimit nga situata politike/mediatike që gjenden dhe çfarë kanë përfaqësuar publikisht këto tre institucione. BE ka dominuar dhe dominon retorikën tonë duke pasur edhe një ministri që punon posaçërisht për procesin e integritit, të gjitha partitë ndërtojnë sulme apo promocion mbi sukseset apo dështimet e tyre ose të kundërshtarëve në lidhje me procesin e integritit. Më poshtë po japim tabelat përkatëse për secilin nga institucionet:

Besimi	Aspak	Pak	Deri	Mjaftueshëm	Shumë	Nuk e	Pa
--------	-------	-----	------	-------------	-------	-------	----

NATO	besim	besim	diku Besim	besim	besim	di	përgjigje
Përqindja	5.3	7.0	14.8	34.2	37.9	0.4	0.4

Besimi BE	Aspak besim	Pak besim	Deri diku Besim	Mjaftueshëm besim	Shumë besim	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	5.3	4.9	10.7	27.5	51.6	0	0

Besimi OKB	Aspak besim	Pak besim	Deri diku Besim	Mjaftueshëm besim	Shumë besim	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	6.1	6.6	16.4	26.6	42.6	1.2	0.4

Duke përmbyllur kështu serinë tonë të pyetje që lidhen me indikatorët e përcaktuar nga Inglehart dhe Ëelzel si matës të llojit të vlerave, midis atyre të mbijetesës dhe atyre vetëafimimit. Nga përgjigjet e mësipërme duket qartë që shqiptarët (në këtë rast po përgjithësojmë nga të anketuarit) por të paktën qytetarët e Tiranës kanë një profil të qartë drejt vlerave të mbijetesës përkundrejt atyre të vetafimimit.

KAPITULLI VI :SHQYRTIMI I HIPOTEZAVE

U gjykua që do ishte me vend të merreshin në shqyrtim në një kapitull me vete, hipotezat e ngritura të këtij studimi. Sipas hapave të studimit mund të thuhet që kemi fillimisht një hipotezë që lidhet me vlerat që do të gjejmë në shoqërinë shqiptare sot, më pas hipotezën kryesore që merr në shqyrtim a gjejmë në vendin tonë korelacionin midis vlerave dhe demokracisë efektive, dhe në fund një hipotezë projektuese për të ardhmen e vlerave dhe demokracisë efektive.

U morr për bazë fillimisht hipoteza e Ronald Inglehart, që quhet “hipoteza e vlerave të mungesës” që sipas saj mund të themi që: rezulton që prioritetet vlerore të individit reflektojnë mjedisin socioekonomik, që do të thotë se vihet më shumë vlerë subjektive në ato gjëra që janë relativisht më të pakta (Inglehart,2000:220). Kuptohet se në Shqipëri, si një ndër vendet ish komuniste më pak të zhvilluara, një vend sot me një ekonomi që nuk munda kurrë deri tani të kapte majat, ose të paktën një qëndrueshmëria dhe një formalitet, mirëqënia materiale e individëve është relativisht e ulët. Prandaj është e pritshme që individët shqiptarë të apirojnë më shumë për një mirëqënie ekonomike më të lartë, sidomos për pagë më të lartë, stabilitet të çmimeve dhe siguri e zhvillim ekonomik. Pra, tendenca e dinamikës së profilit vleror të shoqërisë shqiptare të jetë drejt përvijimit të të ashtuquajturit “sistem i vlerave të mbijetesës” sesa drejt “sistemit të vlerave të vetafirmimit”, më shumë drejt “sistemi të vlerave tradicionale” sesa drejt “sistemit të vlerave shekullare”. Po ashtu e një profili materialist sesa të atij postmaterialist.

Nga rezultatet empirike në kapitullin e mëparshëm hipoteza e pranuar nga ne, e huazuar nga Inglehart merr një konfirmim të metejshëm, që do të thotë që:

1. Profili vleror i qytetarëve mbi 15 vjeç të qytetit të Tiranës në vitin 2013, ka shumë ngjasa ti përkas vlerave të mbijeteësës përkundrejt vlerave të vetafirmimit.
2. Profili vleror i qytetarëve mbi 15 vjeç të qytetit të Tiranës në vitin 2013, ka shumë ngjasa ti përkas vlerave tradicionale përkundrejt vlerave shekullare.
3. Profili vleror i qytetarëve mbi 15 vjeç të qytetit të Tiranës në vitin 2013, ka shumë ngjasa ti përkas vlerave materialiste përkundrejt atyre postmaterialiste.

Ndërkohë hipoteza kryesore e studimit është: “Niveli i vlerave të vetafirmimit në Shqipëri shkon në propocion të drejtë me nivelin e demokracisë efektive” Dy implikimet që rrjedhin nga kjo hipotezë pune janë: Implikim 1: Sa më i madh të jetë niveli vlerave të vetafirmimit në Shqipëri aq më e madhe do të jetë shkalla e demokracisë efektive. Implikim 2: Sa më i vogël të jetë niveli i vlerave të vetafirmimit në Shqipëri aq më e vogël do të jetë shkalla e demokracisë efektive.

Nga testimi i hipotezës fillestare që ishte në kuadër të një hulumtimi eksplorues u nxorr që në Tiranë mbizotërojnë vlerat e mbijetesës përkundrejt atyre të vetafirmimit. Siç u përmend edhe në kontekstin historik, të njëjtën gjë ka nxjerrë edhe studiuesi Aleksandër Kocani që ka bërë matje të profilit vleror të shoqërisë shqiptare, si për elektoratin e Tiranës në vitet 1998, 2003, 2004, 2008, 2010, 2011 dhe për gjithë shoqërinë shqiptare në vitin 1998 dhe ka dalë në konkluzionin që: “Më e mundshme është që profili vleror i elektoratit të qytetit të

Tiranës dhe më shumë ngjasë edhe atij të vendit në përgjithësi, të jetë kryesisht i tipit materialist apo të mbijetesës” (Kocani, 2013:65)

Duke qënë se niveli i vlerave të vetafirmimit nga matja e parë e studiuesit Kocani në 1998 dhe në anketimin tonë na doli i ulët përkundrejt vlerave të mbijetesës. Pritet që të na qëndroj hipoteza, tani më në nivel shpjegues, duke na u faktuar implikimi i dytë që lidhet me nivelin e ulët të vlerave të vetafirmimit: “Sa më i vogël të jetë niveli i vlerave të vetafirmimit në Shqipëri aq më e vogël do të jetë shkalla e demokracisë efektive”. Pra pritej të matej një nivel i ulët i demokracisë efektive në Shqipëri, që tendenca e dyjave të korelonte dhe të mund të flitej për një konfirmim të mëtejshëm të hipotezës së Inglehartit në Shqipëri. Ose e kundërta nëse nga matjet për nivelin e demokracisë efektive në vendin tonë do na rezultoj një nivel i lartë, atëherë do ishte zbuluar një kundërfakt për hipotezën e Inglehartit, që nuk e konfirmon atë.

Gjykohet që niveli i demokracisë efektive të matet në periudhën 2002-2013, por duke qënë se për 2013 ende nuk janë përpunuar rezultatet e Bankës Botërore që na shërbejmë siç e shpjeguam më lart për llogaritje. Do të llogaritet situata e demokracisë efektive nga viti 2002 deri në vitin 2012, duke marrë në shqyrtim kështu një dhjetëvjeçarë, ku kanë qeverisur të dyja partitë kryesore politike në Shqipëri, ajo socialiste dhe ajo demokratike.

Duke marrë parasysh metodologjinë e paraqitur më sipër do të llogaritet niveli i demokracisë efektive në periudhën 2002-2012 dhe më pas do tentohet të kuptohet më shumë rreth rezultateve.

Fillimisht le të nxjerrim DRI për secilin nga vitet duke u bazuar në raportet e Freedom House

Shqipëria 2002 (Freedom House, 2002)

Shqipëria 2002	Liritë Civile	Liritë Politike
	4	3

Nga sa më lart llogarisim DRI për vitin 2002, sipas modelit të mësipërm:

DRI, 2002 Shqipëria	Liritë Civile	Liritë Politike	Bashkimi	Inversion and zero-basing: 14 – (CLR + PRR)	Percent standardization (DRI): (14 – (CLR + PRR))/0.12
	4	3	7	7	58.33

Shqipëria 2003 (Freedom House, 2003)

Shqipëria 2003	Liritë Civile	Liritë Politike
	3	3

Nga sa më lart llogarisim DRI për vitin 2003, sipas modelit të mësipërm:

DRI, 2003 Shqipëria	Liritë Civile	Liritë Politike	Bashkimi	Inversion and zero-basing: 14 –	Percent standardization (DRI): (14 – (CLR
------------------------	---------------	--------------------	----------	--	--

				(CLR + PRR)	+ PRR)/0.12
	3	3	6	8	66.66

Shqipëria 2004 (Freedom House, 2004)

Shqipëria 2004	Liritë Civile	Liritë Politike
	3	3

Nga sa më lart llogarisim DRI për vitin 2004, sipas modelit të mësipërm:

DRI, 2004 Shqipëria	Liritë Civile	Liritë Politike	Bashkimi	Inversion and zero-basing: 14 – (CLR + PRR)	Percent standardization (DRI): (14 – (CLR + PRR))/0.12
	3	3	6	8	66.66

Shqipëria 2005 (Freedom House, 2005)

Shqipëria 2005	Liritë Civile	Liritë Politike
	3	3

Nga sa më lart llogarisim DRI për vitin 2004, sipas modelit të mësipërm:

DRI, 2005 Shqipëria	Liritë Civile	Liritë Politike	Bashkimi	Inversion and	Percent standardization
------------------------	---------------	-----------------	----------	---------------	-------------------------

				zero-basing: 14 – (CLR + PRR)	(DRI): (14 – (CLR + PRR))/0.12
	3	3	6	8	66.66

Shqipëria 2006 (Freedom House, 2006)

Shqipëria 2006	Liritë Civile	Liritë Politike
	3	3

Nga sa më lart llogarisim DRI për vitin 2006, sipas modelit të mësipërm:

DRI, 2006 Shqipëria	Liritë Civile	Liritë Politike	Bashkimi	Inversion and zero-basing: 14 – (CLR + PRR)	Percent standardization (DRI): (14 – (CLR + PRR))/0.12
	3	3	6	8	66.66

Shqipëria 2007 (Freedom House, 2007)

Shqipëria 2007	Liritë Civile	Liritë Politike
	3	3

Nga sa më lart llogarisim DRI për vitin 2007, sipas modelit të mësipërm:

DRI, 2007 Shqipëria	Liritë Civile	Liritë Politike	Bashkimi	Inversion and zero-basing: 14 – (CLR + PRR)	Percent standardization (DRI): (14 – (CLR + PRR))/0.12
	3	3	6	8	66.66

Shqipëria 2008 (Freedom House, 2008)

Shqipëria 2008	Liritë Civile	Liritë Politike
	3	3

Nga sa më lart llogarisim DRI për vitin 2008, sipas modelit të mësipërm:

DRI, 2008 Shqipëria	Liritë Civile	Liritë Politike	Bashkimi	Inversion and zero-basing: 14 – (CLR + PRR)	Percent standardization (DRI): (14 – (CLR + PRR))/0.12
	3	3	6	8	66.66

Shqipëria 2009 (Freedom House, 2009)

Shqipëria 2009	Liritë Civile	Liritë Politike
----------------	---------------	-----------------

	3	3
--	---	---

Nga sa më lart llogarisim DRI për vitin 2009, sipas modelit të mësipërm:

DRI, 2009 Shqipëria	Liritë Civile	Liritë Politike	Bashkimi	Inversion and zero-basing: 14 – (CLR + PRR)	Percent standardization (DRI): (14 – (CLR + PRR))/0.12
	3	3	6	8	66.66

Shqipëria 2010 (Freedom House, 2010)

Shqipëria 2010	Liritë Civile	Liritë Politike
	3	3

Nga sa më lart llogarisim DRI për vitin 2010, sipas modelit të mësipërm:

DRI, 2010 Shqipëria	Liritë Civile	Liritë Politike	Bashkimi	Inversion and zero-basing: 14 – (CLR + PRR)	Percent standardization (DRI): (14 – (CLR + PRR))/0.12
	3	3	6	8	66.66

Shqipëria 2011 (Freedom House, 2011)

Shqipëria 2011	Liritë Civile	Liritë Politike
	3	3

Nga sa më lart llogarisim DRI për vitin 2011, sipas modelit të mësipërm:

DRI, 2011 Shqipëria	Liritë Civile	Liritë Politike	Bashkimi	Inversion and zero-basing: 14 – (CLR + PRR)	Percent standardization (DRI): (14 – (CLR + PRR))/0.12
	3	3	6	8	66.66

Shqipëria 2012 (Freedom House, 2012)

Shqipëria 2012	Liritë Civile	Liritë Politike
	3	3

Nga sa më lart llogarisim DRI për vitin 2012, sipas modelit të mësipërm:

DRI, 2012 Shqipëria	Liritë Civile	Liritë Politike	Bashkimi	Inversion and zero-basing: 14 – (CLR + PRR)	Percent standardization (DRI): (14 – (CLR + PRR))/0.12

	3	3	6	8	66.66
--	---	---	---	---	-------

Tanimë mund të bëhet tabela përfundimtare mbi Indeksin e të Drejtave Demokratike në Shqipëri nga viti 2002-2012

Shqipëria në vitin	DRI
2002	58.33
2003	66.66
2004	66.66
2005	66.66
2006	66.66
2007	66.66
2008	66.66
2009	66.66
2010	66.66
2011	66.66
2012	66.66

Tabela 10 : Indeksi i të Drejtave Demokratike, Shqipëri 2002-2012

Mesa vihet re nga tabela më lart, Shqipëria ka ruajtur duke filluar që nga viti 2003 një nivel konstant të së drejtave demokratike, pavarësisht nëse në qeverisje kanë qënë të majtët apo të djathtët. Duke ju kthyer tabelës që klasifikon shtetet në bazë të nivelit të së drejtave demokratike, Shqipëria qëndron në (More Incompletely Democratic) që do të thotë në

shtetet që janë: jo plotësisht demokratike, të cilat anojnë më shumë nga mangësitë e garantimit të së drejtave se sa nga plotësimi tërësor i tyre. Pra ka dalë nga dy pjesat e para të skemës që klasifikojnë vendin si autokratik dhe është futur në fillimin e asaj që mund të shndërrohet më vonë demokraci e plotë.

Për të nxjerrë EDI, tani do të llogaritet edhe RLI, pra Indeksin e Shtetit të së Drejtës në po këto vite. Për të nxjerr RLI do të përpunojmë dy indikatorët që mund të marrim nga database i të dhënave që ofron Banka Botërore, duke marrë në konsideratë vetëm dy: Indikatorin e Shtetit të së Drejtës dhe Indikatorin e Kontrollin të Korrupsionit. Pasi të përpunohen dy indikatorët sipas formulës së tre autorëve, mesatarja e tyre do na nxjerr RLI. Të dhënat e mëposhtme janë marrë nga faqja zyrtare e Bankës Botërore dhe janë të disponueshme për të gjithë. (Banka Botërore, 2013)

Fillojmë të llogarisim RLI, sipas viteve në tabelën e mëposhtme, duke kujtuar edhe njëherë që COS janë pikët e vëzhguara, LOS janë pikët më të ulta të vëzhguara, COS, pikët më të larta të vëzhguara.

Viti	COS	LOS	HOS	RLI
2002	21.05	9.52	33.81	0.47
2003	21.53	11.90	34.29	0.43
2004	26.32	15.24	38.10	0.48
2005	25.84	14.29	36.67	0.51
2006	27.75	17.14	40.00	0.46

2007	27.75	18.10	41.43	0.41
2008	32.69	20.57	41.63	0.57
2009	36.49	25.47	45.75	0.54
2010	40.76	30.66	48.58	0.56
2011	38.97	29.91	47.66	0.51
2012	35	27	45	0.44

Tabela11 : Indeksi i Shtetit të së Drejtës, Shqipëri 2002-2012

Duke llogaritur në të dhjetat vitet edhe DRI dhe RLI tani mund të llogarisim Indeks të Demokracisë Efektive për Shqipërinë 2002-2012.

	DRI	RLI	EDI
2002	66.66	0.47	31.33
2003	66.66	0.43	28.66
2004	66.66	0.48	31.99
2005	66.66	0.51	33.99
2006	66.66	0.46	30.66
2007	66.66	0.41	27.33
2008	66.66	0.57	37.99
2009	66.66	0.54	35.99
2010	66.66	0.56	37.32
2011	66.66	0.51	33.99
2012	66.66	0.44	29.33

Tabela 12 : Indeksi i Demokracisë Efektive, Shqipëri 2002-2012

Teorikisht EDI varion nga 100 pikë që flet për një demokraci efektive në nivel të plotë, ky qytetari është në qëndër të sistemit politik, social dhe ekonomik deri në 0 pikë ku nuk ekziston demokraci efektive, është thjesht një sistem autokratik shumë larg vendosjes së qytetarit në qëndër të sistemit. Nga tabela 5 vëmë re që niveli i demokracisë efektive në Shqipërinë e 10 viteve nga variuar nga 27 në 37, mesatarisht niveli është tek 35.8 pikë për këtë dhjetëvjeçar. Kjo flet për një sistem demokratik jo eficient në lidhje me plotësimin e të drejtave dhe detyrimeve ndaj qytetarit, një pseudo-demokraci, apo siç e emërton edhe raporti i fundit i Freedom House, një rregjim hibrid, demokraci tranzicioni. Këtu gjendet me vend edhe konstatimi që bën studiuesi Tarifa: “Pavarësisht legjislacionit të ri dhe një kushtetute eklektike që ka miratuar, Shqipëria ende nuk ka një Rechtsstaat, një shtet ligjor, në të cilin, të gjithë aktorët politikë kryesorë, veçanërisht qeveria demokratike dhe aparati shtetëror, të japin rregullisht llogari” (Tarifa&Tarifa, 2009:65).

Ajo që bën përshtypje në tabelën e 10 vjeçarit të Shqipërisë janë dy fakte: I pari është një fakt kurioz që lidhet me tabelën 11, me llogaritjen e RLI, në 10 vite niveli më i lartë i RLI dhe ai më i ulët gjenden pranë e pranë, njëri vit pas tjetrit, konkretisht niveli më i ulët në 2007 dhe niveli më i lartë në 2008, duke lëvizuar shumë vetëm për një vit (që normalisht dallohet edhe tek EDI (tabela 12). Në qeverisje në të dyja vitet dhe kur kemi nivelin më të ulët dhe më të lartë të dhjetë vjeçarit ka qënë Partia Demokratike dhe kryeministri Sali Berisha, pra nuk ka ndodhur ndonjë ndryshim në drejtim të qeverisjes së vendit. Në këtë kuadër mund të aludohet për dy ngjarje që mund të jenë të lidhura me këto shifra të 2007 dhe 2008, duke mos e ditur sa afër apo larg qëndrojnë nga e vërteta. Ngjarja e parë lidhet me faktin që 2007 përfaqësonte vitin që do organizoheshin zgjedhjet e para vendore të

organizuara nga Partia Demokratike në pushtet dhe testi i parë i Edi Ramës si kryetar i Partisë Socialiste, pas marrjes së saj në 2005 si rrjedhojë e dorëheqjes së Fatos Nanos. Teste të rëndësishme për të dyja partitë kryesore në vend, kjo mund të ketë ndikuar në rritjen e nivelit të klientelizmit, favorizimeve, nepotizmave si në pushtet qëndror ashtu edhe lokal. Ngjarja e dytë është që në nëntor të 2007, zëvendësohet kryeprokurori i Shqipërisë, ikën Theodhori Sollaku, i papëlqyer dhe në një klimë jo të mirë bashkëpunimi me qeverinë e djadhtë, shkarkohet dhe në krye vjen Ina Rama. Duke bërë kështu që viti 2008 të jetë viti i saj i parë i punës si kryeprokurore dhe angazhimi, vullneti, fytyra e re mund të kenë ndikuar në ndryshime përsa i përket shtetit të së drejtës dhe kontrollit të korrupsionit. Kjo edhe nga fakti që punën më të rëndësishme, peshën kryesore kur vjen fjala tek shteti i së drejtës e ka pushteti i tretë ai gjyqësor, që nuk mund të kuptohet pa organet e prokurorisë. Përsa i përket kësaj ngjarje të dytë që mendohet se ka qënë edhe më ndikuesja, do ishte me interes të llogarisnim më vonë kur të dalë raporti i Bankës Botërore, RLI për vitin 2013, sepse nga tabela vëmë re që RLI për vitin 2012, ka përsëri rënie që shënon fundin e mandatit si kryeprokurore të Ina Ramës. Duke vënë re tabelën ne kemi vetëm dy momente kohore që nuk gjykohet dot për fenomenin, megjithatë ngelet në interes që të shikohet në më shumë momente nëse ka korealicion të RLI me fillimin dhe fundin e mandatit të një kryeprokurori në Shqipëri. Sepse viti 2007, është viti i fundit i mandatit të Z. Sollaku dhe ka ulje RLI, dhe viti 2012 është fundi i mandatit të Znj. Rama dhe ka ulje të RLI. Ngelet për tu gjykuar në punime të mëvonshme.

Fakti i dytë që bën përshtypje edhe shumë thelbësore është që niveli i Indeksit të së Drejtave Demokratike që nga 2003 qëndron i pandryshuar në këto vite, në nivelin 66.66,

duke treguar të paktën që në këtë aspekt nuk kemi pasur rënie por as progres, dhe qëndrojnë shumë mirë në krahasim me indeksin e shtetit të së drejtës. Siç u tha edhe më lart ky indeks RLI, llogarit sa zbatohet shteti i së drejtës dhe sa kontrollohet korrupsioni në një vend, në këtë pikë ne kemi dale në nivel shumë të ulët. Dhe të gjitha variacionet që krijohen në EDI, janë variacione të shkaktuara nga RLI. Kjo do të thotë që problemi më i madh i demokracisë në vendit tonë nuk është pasja e të drejtave demokratike, politike dhe civile në ligje, sigurisht ato janë dhe njerëzit i dinë që sipas ligjit dhe rregullave i kanë këto të drejta, por problemi qëndron që njerëzit nuk i gëzojnë dot këto të drejta. Minohet mundësia që të mund të jesh pjesëtar i barabartë i shoqërisë me të drejta të plota, për aq kohë sa shteti i së drejtës që të garanton ty paprekshmërinë dhe të drejtat nuk funksion mirë dhe funksion në bazë të korrupsionit. Pra të drejtat i gëzojnë më mirë ata qytetar që mund të jenë pjesë e sistemit të korrupsionit dhe manipulimit sesa çdo qytetar tjetër në republikën e Shqipërisë.

Në kuadër të matjeve të 10 viteve të EDI për Shqipërinë u arrit në përfundimet se:

Shqipëria përsa i përket Indeksit të së Drejtave Demokratike qëndron në nivel konstant pas 2002 që na bën të klasifikohemi si një vend me një demokraci jo të plotë, në nivelin 66.66 pikë nga 0 që është tërësisht autokratike deri në 100 që është tërësisht demokratike. Do të thotë që punë kemi ende për të bërë në afirmimin e lirive politike dhe lirive civile të qytetarëve por që niveli nuk është tejet problematik që mund të jetë shtypës për individët.

Ndërsa Indeksi i Shtetit të së Drejtës, është në nivel shumë problematik, dhe të ulët duke qëndruar mesatarisht në nivelin 0.53 pikë në këto 10 vite të marra në shqyrtim, dmth 2002-2012, ndërkohë që shkalla është 0 atje ku nuk kemi shteti e të drejtës dhe kontroll të

korupsionit deri në 1.0 atje ku kemi shtetit e të drejtës dhe kontroll të korupsionit. Shifrat tona qëndrojnë rreth nivelit mesatar. Ky indeks ndikon shumë edhe nivelin e demokracisë efektive e cila del në këto 10 vite qëndron mesatarisht në nivelin 35.8, që nuk arrin dot as një nivel mesatar të demokracisë efektive, por klasifikohemi kështu me nivel të ulët të demokracisë efektive. Në këtë mënyrë mund të pohohet se tranzicioni postkomunist ende vazhdon, “deri sa shteti ligjor dhe bashkë me të, funksionimi i shtetit mbi baza demokratike të rutinizohen dhe të konsolidohen përtej një stadi ku një “kthim mbrapa” bëhet praktikisht i pamundur” (Tarifa&Tarifa, 2009:65)

Duke qënë se teorikisht u sqarua se si vlerat e vetafirmimit shkaktojnë demokracinë efektive në një vend, tashmë korelimin mes të dyja e nxjerrim edhe nga matjet e bëra si për profilin vleror të shqiptarëve, ashtu edhe për nivelin e demokracisë efektive. Të dyja në nivel të ulët, sepse vlerat e mbijetësës kanë shkaktuar nivel të ulët të demokracisë efektive. Hipoteza e Inglehartit merr një konfirmimin të metejshëm empirik duke treguar lidhjem mes nivelit të vlerave të vetafirmimit dhe nivelit të demokracisë efektive.

Pritshmëria ishte që hipoteza të konfirmohej dhe kjo e bën më të domosdoshme për të kuptuar a mund të bëhet një parashikim për një tendencë të ardhme të vlerave, në mënyrë të tillë që të mund të kuptojmë a do ketë shpresë demokracia efektive në të ardhmen në vendin tonë. Por edhe nëse hipoteza nuk do të konfirmohej një lloj pritshmërie për të ardhmen do të ishte me vend dhe e mirëpritur nga studiuesit e shkencave sociale.

Siç përcakton Inglehart (Inglehart, 1990) do të pritet diferenca mes grup-moshave të ndryshme sepse këto grupe kanë jetuar eksperiencë të ndryshme formuese. Ekziston sipas tij një vonesë kohore mes ndryshime në kontekstin ekonomik dhe më pas pasojat politike duke u ndjekur nga llogjika e zëvendësimit të brezave që ndodh tek vlerat.

Kështu që duhet të zbulohet për vendin tonë lidhja mes vlerave dhe grupmoshës që i përkasin të anketuarit? Në përgjigje të kësaj kemi ngritur hipotezën: “Niveli i vlerave të vetafirmimit të një shoqërie korrelohet në mënyrë të zhdrejtë me moshën e qytetarëve” Pra thënë më thjeshtë, niveli i vlerave të vetafirmimit do të jetë më i lartë tek brezat e rinj që kanë moshë më të vogël sesa tek ata të vjetër me moshë më të madhe”. Pritet që të gjejmë ndryshim midis të anketuarve që i përkasin moshës 15-24 vjeç dhe atyre që i përkasin grup moshës mbi 65 vjeçarëve, përkatësisht dy moshat ekstreme të studimit. Studiuesi Kosta Bajraba shprehet që: “të rinjtë janë sjellësit e vlerave të reja shoqërore e shpesh edhe mbartësit kryesorë të tyre” (Barjaba, 2011:74). Dhe nëse gjendet ky ndryshim, atëherë i qëndrohet logjikës së sipërmendur: Pritet që të gjendet profil vleror me më shumë vlera të vetafirmimit tek të rinjtë dhe më shumë profil vleror me vlera të mbijetesës tek të moshuarit. Kjo do të jetë shpresa për demokracinë efektive në të ardhmen të jetë në nivel më të lartë, në të kundërt atëherë shpresat janë më të ulta për të gëzuar demokraci efektive.

Në kuadër të kësaj hipoteze që qëndron në llojet e hulumtimeve parashikues, është zgjedhur të ndërtohet me crosstabe (tabela të kryqëzuara) që janë një mjet i fuqishëm statistikor i SPSS për të parë nëse dallojmë ndryshime mes dy grupmoshave ekstreme. Pra a është faktori moshë ndikues në vlerat që kanë njerëzit. Nëse zbulohet ky ndryshim, pra zbulohet

korelim mes faktorit moshë dhe vlerave, atëherë do të shikohet nëse është sinjifikativ apo jo si korelim. Këtë me anë të dy mjeteve që na ofron SPSS tabelat me koeficientët Chi square (chi square tests) dhe Phi and Cramers'V (symmetric measures).

Fillimisht për të ndërtuar tabelat e kryqëzuara u nxorrën pyetjet të cilat janë të lidhura drejtpërdrejtë me matjen e profilit aktual në boshtin mbijetesë-vetafirmim. Ashtu siç duket tek rezultatet empirike, ka edhe pyetje që tentojnë të kuptojnë dinamika të së ardhmes, ashtu si edhe pyetje të boshteve të tjerave vlerore. Në këtë drejtim pyetjet që do të merren në shqyrtim, të cilat do risillen në vemendjen tuaj tashmë duke bërë për secilën tabelat e kryqëzuara me variablin moshë lidhen me çështjet e mëposhtme që ndajnë vlerat e mbijetesës nga ato të vetafirmimit: a) tolerimi dhe pranimi i grupeve të veçanta shoqërore; b) kriteri parësor për një vend pune; c) raporti i punës me kohën e lirë; d) liria dhe kontrolli që besojnë se kanë në jetën e tyre; e) interesi për politikës; f) mendimi se mund ta ndikojnë apo ndryshojnë politikën në nivel lokal apo qendror; g) besimi tek institucionet; j) besimi tek të tjerët.

Në lidhje me pikën a, pyetje e bërë në anketim ishte: “Do ju them nje listë me kategori të ndryshme njerëzish. A mund të na thoni se ndër to ka nga ata që nuk do të dëshironit t'i kishit si komshinj? Cilët?” Nuk i dua (1); I dua(2); Indiferent (88) Pa pergjigje(99).

Lista ishte: 1. Njerëz që kanë një detyrë gjyqësore; 2.Njerëz të një race tjetër; 3.Ekstremistë politikë; 4.Pijanecë; 5. Njerëz jo të qëndrueshëm emocionalisht; 6.Prostituta; 7.Njerëz të sëmurë nga SIDA; 8. Të droguar; 9. Homoseksualët. Duke eliminuar dy kategoritë e para sepse kanë rezultuar me vlera të vetafirmimit shikohet nëse do gjenden

ndryshime për 7 kategoritë e tjera. Më poshtë jepen tabelat e kryqëzuara për secilin nga kategoritë për të krijuar një panoramë të qartë:

Ekstremistë politikë:

vitilindjes * Ekstremiste Crosstabulation

Count

		Ekstremiste				Total
		Nuk dua	i I dua	Indiferent	Pa pergjigje	
vitilindjes	15-24 vjec	29	9	19	0	57
	25-34 vjec	35	4	8	1	48
	35-44 vjec	33	6	5	2	46
	45-54 vjec	29	3	5	0	37
	55-64 vjec	20	5	1	0	26
	mbi 65 vjec	20	4	1	1	26
	Total	166	31	39	4	240

Pijanece:

vitilindjes * Pijanece Crosstabulation

Count

		Pijanece				Total
		Nuk dua	i I dua	Indiferent	Pa pergjigje	
vitilindjes	15-24 vjec	46	5	6	0	57
	25-34 vjec	44	3	1	0	48
	35-44 vjec	41	3	1	1	46
	45-54 vjec	30	4	3	0	37
	Total	161	15	11	1	188

	55-64	26	0	0	0	26
	mbi 65	24	0	2	0	26
Total		211	15	13	1	240

Njerëz jo të qëndrueshëm emocionalisht:

vitilindjes * Jostabel Crosstabulation

Count

		Jostabel				Total
		Nuk dua	i I dua	Indiferen t	Pa pergjigje	
vitilindjes	15-24 vjec	33	9	13	2	57
	25-34 vjec	38	4	4	2	48
	35-44 vjec	29	7	9	1	46
	45-54	25	5	7	0	37
	55-64	17	5	3	1	26
	mbi 65	17	4	4	1	26
	Total	159	34	40	7	240

Prostituta:

vitilindjes * Prostituta Crosstabulation

Count

		Prostituta				Total
		Nuk dua	i I dua	Nuk e di	Pa pergjigje	
vitilindjes	15-24 vjec	42	9	6	0	57
	25-34 vjec	33	12	3	0	48
	35-44 vjec	31	7	7	1	46
	45-54	30	4	3	0	37

	55-64	25	0	1	0	26
	mbi 65	23	1	2	0	26
Total		184	33	22	1	240

Njerëz të sëmurë nga SIDA:

vitilindjes * MeSIDA Crosstabulation

Count

		MeSIDA				Total
		Nuk dua	i I dua	Indiferen t	Pa pergjigje	
vitilindjes	15-24 vjeç	37	9	10	1	57
	25-34 vjeç	26	10	11	1	48
	35-44 vjeç	27	9	8	1	45
	45-54	25	7	5	0	37
	55-64	23	1	2	0	26
	mbi 65	21	1	4	0	26
	Total	159	37	40	3	239

Të droguar:

vitilindjes * Droguar Crosstabulation

Count

		Droguar				Total
		Nuk dua	i I dua	Nuk e di	Pa pergjigje	
vitilindjes	15-24 vjeç	48	3	6	0	57
	25-34 vjeç	44	2	1	1	48
	35-44 vjeç	38	5	2	1	46
	45-54	29	5	2	0	36

55-64	26	0	0	0	26
mbi 65	22	1	3	0	26
Total	207	16	14	2	239

Homoseksualët:

vitilindjes * Homoseksual Crosstabulation

Count

		Homoseksual				Total
		Nuk dua	i I dua	Nuk e di Pa pergjigje		
vitilindjes	15-24 vjec	41	7	9	0	57
	25-34 vjec	29	12	6	1	48
	35-44 vjec	40	1	4	1	46
	45-54	28	5	4	0	37
	55-64	25	0	0	0	25
	mbi 65	23	1	2	0	26
Total		186	26	25	2	239

Nga tabelat e kryqëzuara vihet re që për secilën nga kategoritë nuk shikohen ndryshime në lidhje me përgjigjet që të mund të na çoj të mendohet për një korelim të mundshëm mes moshës dhe vlerave. Në këtë pyetje si grup-mosha 15-24 vjeç ashtu si ajo mbi 65 vjeç, pra dy ekstremet e tabelës kanë një shpërndarje të përgjigjeve pak a shumë uniforme, gjë që nuk flet për ndonjë korelim të mundshëm. Në këtë pyetje bëhet edhe e padomosdoshme marrja në shqyrtim i koeficientëve që shikojnë sinjifikancën së shoqërimit, sepse nuk u gjet shoqërim.

Në lidhje me pikën b, pyetja e bërë në anketim ishte: “Kur jeni në kërkim të një pune cilat gjëra ju duken më të rëndësishme nga kriteret e mëposhtme. Cili, do të ishte sipas jush më i rëndësishmi?” “Dhe kush vjen pas tij?” : 1. një pagë e mirë për të mos patur halle për para; 2. një vend pune të garantuar pa rrezik mbylljeje apo humbjeje; 3. të punosh me njerëz që shkon mirë 4. të bësh një punë të rëndësishme që të japë ndjenjën se ke bërë diçka. Le të paraqesim tabelën e kryqëzuara në lidhje me kriterin parësor për punën:

Kriteri parësor për punën:

vitalindjes * kriter1pune Crosstabulation

Count

		kriter1pune							Total
		nje page mire	e pune garantuar rrezik humbjeje	e njerez pa shkon mire	qe pune rendesishme	te Nuk e di	Pa pergjigje		
vitalindjes	15-24 vjec	34	8	3	11	1	0		57
	25-34 vjec	19	7	12	8	0	0		46
	35-44 vjec	19	10	5	12	0	0		46
	45-54	14	13	6	3	0	0		36
	55-64	9	9	1	1	0	0		20
	mbi 65	12	5	1	3	0	1		22
	Total	107	52	28	38	1	1		227

Në këtë përgjigje vihet re një shoqërim mes moshës dhe kriterëve parësorë për punë, të rinjtë kanë një tendencë për të vlerësuar si kriter edhe faktin që është një punë e rëndësishme. Le të shikojmë nëse ky shoqërim është statistikisht domethënës:

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	43.702^a	25	.012
Continuity Correction			
Likelihood Ratio	37.947	25	.047
Linear-by-Linear Association	.292	1	.589
N of Valid Cases	227		

a. 18 cells (50.0%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .09.

Symmetric Measures

	Value	Asymp. Error ^a	Std. Approx. T ^b	Approx. Sig.
Nominal by Phi	.439			.012
Nominal Cramer's V	.196			.012
N of Valid Cases	227			

a. Not assuming the null hypothesis.

b. Using the asymptotic standard error assuming the null hypothesis.

Shifra që marrim nga koeficientët na tregon 0.012, që është më i vogël se kufiri i lejueshëm 0.05. Mund të thuhet që në këtë rast ka një shoqërim statistiki domethënës midis dy variablave në shqyrtim.

Në lidhje me pikën c, pyetje e bërë në anketim ishte: “Me cilin nga pohimet e mëposhtme jeni me shumë dakort?”¹ 1. Është koha e lirë e kënaqësitë dhe jo puna që bën që t’ia vlejë të jetohet jeta 2. Është puna dhe jo koha e lirë e kënaqësitë që bëjnë që t’ia vlejë që të jetohet jeta. Më poshtë tabela e kryqëzuar për të kuptuar nëse gjendet shoqërim këtu ose jo.

Raporti punë-kohë e lirë

vitolindjes * Punakohalire Crosstabulation

Count		Punakohalire						Total
		koha e lire puna dhe jo 5 vlen jeta	puna dhe jo puna koha e lire vlen jeta	11	nuk e di	Pa pergjigje		
vitalindjes	15-24 vjec	14	43	0	0	1	1	59
	25-34 vjec	11	35	0	1	0	0	47
	35-44 vjec	3	41	0	0	1	1	46
	45-54	5	32	0	0	0	0	37
	55-64	6	19	1	0	0	0	26
	mbi 65	2	24	0	0	0	0	26
	Total	41	194	1	1	2	2	241

Në këtë tabelë të kryqëzuar vihet re nga shpërndarja që nuk është e legjitimuar të flitet për shoqërim mes dy variablave. Pra edhe në këtë rast nuk do marrim në shqyrtim koeficientët e sinjifikancës.

Pyetja që lidhet me pikën d ishte: “Në ç’masë mendoni se keni lirinë për të zgjedhur dhe kontrollin mbi jetën tuaj?” duke ju dhënë mundësinë që të përgjigjeshin në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 fillonte me aspak dhe kuptohej një shkallë rritëse deri në 10 ku ishte shumë. Tabela e kryqëzuar për përgjigjet e kësaj pyetje na jep këtë rezultat:

vitalindjes * Lirizgjedhjes Crosstabulation

Count	Lirizgjedhjes										Total
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
											Nuk e di Pa pergjigje

vitalindjes	15-24 vjec	0	0	4	2	9	4	12	10	4	14	0	0	59
	25-34 vjec	1	0	0	0	6	4	4	8	10	13	1	0	47
	35-44 vjec	0	0	1	0	6	1	2	6	4	26	0	0	46
	45-54 vjec	0	0	2	0	1	4	5	4	6	15	0	0	37
	55-64 vjec	2	0	1	0	2	2	2	6	2	8	0	1	26
	mbi 65	0	1	2	1	5	4	0	4	0	8	1	0	26
Total		3	1	10	3	29	19	25	38	26	84	2	1	241

Në këtë tabelë të kryqëzuar mund të gjykohet për një shoqërim midis dy variablave të marrë në shqyrtim. Për këtë shikohen koeficientët që na tregojnë sinjifikancën:

Chi-Square Tests

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	83.594^a	55	.008
Continuity Correction			
Likelihood Ratio	79.826	55	.016
Linear-by-Linear Association	1.800	1	.180
N of Valid Cases	241		

a. 56 cells (77.8%) have expected count less than 5. The minimum expected count is .11.

Symmetric Measures

	Value	Asymp. Error ^a	Std. Approx. T ^b	Approx. Sig.
Nominal by Phi	.589			.008
Nominal by Cramer's V	.263			.008
N of Valid Cases	241			

a. Not assuming the null hypothesis.

b. Using the asymptotic standard error assuming the null hypothesis.

Shifra që merret nga koeficientët na tregon 0.008, që është më i vogël se kufiri i lejueshëm 0.05. Mund të thuhet që edhe në këtë rast ka një shoqërim statistikisht domethënës midis dy variablave në shqyrtim.

Përsa i përket pikës e, pyetja e bërë në anketim ishte: “Në ç’masë jeni i interesuar për politikën?” 1. Aspak i interesuar; 2. Jo i interesuar; 3. Deri diku i interesuar; 4. I interesuar; 5. Shumë i interesuar. Tabela e kryqëzuar për këtë pyetje:

vitilindjes * interesipolitiken Crosstabulation

Count

		Interesipolitiken					Total
		aspak interesuar	i jo interesuar	i deri diku interesuar	i i interesuar	shume interesuar	
vitilindjes	15-24 vjec	21	9	20	5	4	59
	25-34 vjec	20	2	19	2	4	47
	35-44 vjec	24	5	11	3	3	46
	45-54	7	3	23	4	0	37
	55-64	7	0	11	4	4	26
	mbi 65	4	1	10	4	7	26
	Total	83	20	94	22	22	241

Kjo tabelë e kryqëzuar na tregon shoqërim mes variablave por në krahun e kundërt të hipotezës tonë, dmth të rinjtë janë më aspak ose pak të interesuar për politikën, sesa të moshuarit, pra më fort në krahun e vlerave të mbijetesës. A është ky shoqërim sinjifikativ? Le të shikojmë tabelat e dy koeficientëve:

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	44.823^a	20	.001
Continuity Correction			
Likelihood Ratio	46.991	20	.001
Linear-by-Linear Association	12.840	1	.000
N of Valid Cases	241		

a. 16 cells (53.3%) have expected count less than 5. The minimum expected count is 2.16.

Symmetric Measures

	Value	Asymp. Error ^a	Std. Approx. T ^b	Approx. Sig.
Nominal by Phi	.431			.001
Nominal Cramer's V	.216			.001
N of Valid Cases	241			

a. Not assuming the null hypothesis.

b. Using the asymptotic standard error assuming the null hypothesis.

Shifra që marrim nga koeficientët na tregon 0.001, që është më i vogël se kufiri i lejueshëm 0.05. Mund të thuhet që ky shoqërim që u gjet është statistikisht domethenës midis dy variablave në shqyrtim.

Pika f lidhet me perceptimin e tyre se sa mund ta ndikojnë me veprimtarinë e tyre politikë, qoftë lokale, qoftë qendrore. Së pari, pyetja e drejtuar ishte: “Sa besoni se me veprimtarinë tuaj mund ta ndryshoni politikën në Shqipëri: 1. Aspak; 2. Pak; 3. Deri diku; 4. Shumë; 88.Nuk e di; 99.Pa përgjigje. Le të shikojmë tabelën e kryqëzuar:

vitilindjes * nivel kombetar Crosstabulation

Count

		nivel kombetar					Total
		aspak	Pak	deri diku	shume	nuk e di	
vitilindjes	15-24 vjec	29	13	14	2	1	59
	25-34 vjec	23	8	12	3	1	47
	35-44 vjec	29	8	6	3	0	46
	45-54	19	11	6	1	0	37
	55-64	15	5	5	1	0	26
	mbi 65	12	8	3	3	0	26
Total		127	53	46	13	2	241

Nga sa vihet re, nuk mund të flitet për shoqërim midis dy variablave, në këtë rast.

Pyetja tjetër ishte për nivelin lokal: “Sa besoni se me veprimtarinë tuaj mund ta ndryshoni politikën në nivelin tuaj lokal” me të njëjtat alternativa që ishin më lart: 1. Aspak; 2. Pak; 3. Deri diku; 4. Shumë; 88.Nuk e di; 99.Pa përgjigje. Tabela e kryqëzuar më poshtë na tregon se edhe në këtë rast nuk gjëndet shoqërim midis dy variablave:

vitilindjes * nivel lokal Crosstabulation

Count

		nivel lokal						Total
		Aspak	pak	deri diku	shume	nuk e di	pa pergjigje	
vitilindjes	15-24 vjec	20	17	15	5	2	0	59
	25-34 vjec	20	10	7	8	1	1	47
	35-44 vjec	27	6	7	5	1	0	46

45-54	16	13	6	2	0	0	37
55-64	13	6	7	0	0	0	26
mbi 65	12	8	5	1	0	0	26
Total	108	60	47	21	4	1	241

Në lidhje me pikën g, dmth besimin apo mosbesimin tek institucionet, në shqyrtim do të marrim ato institucione që kanë lidhje me demokracinë efektive dhe që përgjigjet kanë dalë në boshtin e mbijetesës. Pra nuk marrin në shqyrtim psh: BE, NATO etj sepse e shpjeguam në pjesën e punimit empirik se pse janë specifike disa institucione në rastin e Shqipërisë. Pyetja e drejtuar ishte: Për secilin institucion të mëposhtëm thoni sa besim keni nga 1-5 ku 1 është aspak besim dhe 5 shumë besim?” Institucionet që do marrim në shqyrtim janë: ligjet, shtypi, televizioni, sindikata, policia, partitë politike.

Tabelat e kryqëzuara për secilën:

Ligjet:

vitalindjes * ligjet Crosstabulation

Count

		Ligjet						Total
		aspak besim	jo besim	shume deri besim	diku mjaftueshem besim	shume besim		
vitalindjes	15-24 vjec	10	12	16	10	11		59
	25-34 vjec	9	9	10	10	10		48
	35-44 vjec	12	9	6	10	8		45
	45-54	8	5	6	7	11		37
	55-64	5	5	4	4	8		26
	mbi 65	4	4	1	7	10		26
	Total	48	44	43	48	58		241

Shtypi:

vitilindjes * shtypi Crosstabulation

Count

		Shtypi						Total
		aspak besim	jo besim	shume deri besim	diku mjaftueshem besim	shume besim		
vitilindjes	15-24 vjec	17	11	20	7	4	59	
	25-34 vjec	10	13	14	9	2	48	
	35-44 vjec	16	10	15	3	2	46	
	45-54	9	14	8	5	1	37	
	55-64	5	7	4	5	5	26	
	mbi 65	4	6	8	5	3	26	
	Total	61	61	69	34	17	242	

Televizioni:

vitilindjes * televizioni Crosstabulation

Count

		Televizioni						Total
		aspak besim	jo besim	shume deri besim	diku mjaftueshem besim	shume besim		
vitilindjes	15-24 vjec	15	10	20	8	6	59	
	25-34 vjec	9	12	13	11	2	47	
	35-44 vjec	9	11	17	6	3	46	
	45-54	4	15	8	7	3	37	
	55-64	5	6	3	5	7	26	
	mbi 65	4	5	8	5	4	26	
	Total	61	61	69	34	17	242	

Total	46	59	69	42	25	241
-------	----	----	----	----	----	-----

Sindikata:

vitolindjes * sindikata Crosstabulation

Count

		Sindikata							Total
		aspak besim	jo besim	shume deri besim	diku mjaftueshem besim	shume besim	nuk e di		
vitolindjes	15-24 vjec	16	16	16	10	0	1		59
	25-34 vjec	21	14	8	4	0	0		47
	35-44 vjec	18	7	10	4	3	1		43
	45-54	19	9	4	2	3	0		37
	55-64	9	4	7	2	3	0		25
	mbi 65	11	4	4	2	5	0		26
	Total	94	54	49	24	14	2		237

Policia:

vitolindjes * policia Crosstabulation

Count

		Policia						Total
		aspak besim	jo besim	shume deri besim	diku mjaftueshem besim	shume besim		
vitolindjes	15-24 vjec	9	16	15	12	7		59
	25-34 vjec	6	11	13	14	4		48
	35-44 vjec	5	8	14	10	9		46
	45-54	3	1	12	12	9		37
	55-64	2	4	9	3	8		26
	Total							

	mbi 65	1	4	5	5	10	25
Total		26	44	68	56	47	241

Partitë politike:

vitilindjes * partite Crosstabulation

Count

		Partite							Total
		aspak besim	jo besim	shume deri besim	diku mjaftueshem besim	shume besim	pa pergjigje		
vitilindjes	15-24 vjec	19	15	10	9	5	1		59
	25-34 vjec	20	6	10	9	3	0		48
	35-44 vjec	23	5	10	7	1	0		46
	45-54	9	10	10	6	2	0		37
	55-64	6	7	5	1	7	0		26
	mbi 65	8	4	6	5	3	0		26
	Total	85	47	51	37	21	1		242

Për të gjashta institucionet të marra në shqyrtim më lart, duke parë tabelat e kryqëzuara vihet re që nuk gjëndet shoqërim midis dy variablave.

Pika e fundit e marrë në shqyrtim është besimi tek tjetri, të anketuave ju drejtua pyetja: “Në përgjithësi, a do të thonit që mund t’i besohet shumicës së njerëzve apo që duhet të jesh i kujdesshëm kur ke të bësh me të tjerët? 1. Mund t’i besohet shumicës së njerëzve; 2. Duhet të jesh i kujdesshëm; 88. Nuk e di; 99. Pa përgjigje. Le të paraqesim më poshtë tabelën e kryqëzuar, e cila nuk na tregon asnjë shoqërim mes dy variablave.

vitilindjes * Besimitjetrit Crosstabulation

Count

Besimitjetrit	Total
---------------	-------

		Mund besohet shumices njerezve	ti Duhet kujdesshem se	i Nuk e di	Pa pergjigje	
vitilindjes	15-24 vjec	5	48	2	0	55
	25-34 vjec	4	44	0	0	48
	35-44 vjec	0	46	0	0	46
	45-54	3	34	0	0	37
	55-64	2	24	0	0	26
	mbi 65	0	25	0	1	26
	Total	14	221	2	1	238

Nga sa më lart në testim të hipotezës që lidhej me një ndryshim të mundshëm mes grup-moshave që kishin jetuar eksperiencia të ndryshme formuese, u morrën në shqyrtim 20 faktorë që përcaktojnë vlerat e mbijetesës përkundrejt atyre të vetafirmimit, duke bërë në këtë mënyrë edhe 20 tabela të kryqëzuara. Nga rezultatet e nxjerra, na del që në 20 vetëm në 2 u gjet shoqërim dhe ky ishte sinjifikativ dhe në drejtim të hipotezës tonë, në 17 nuk u gjet shoqërim mes dy variablave gjë që nuk konfirmon hipotezën tonë, dhe në 1 rast u gjet shoqërim edhe sinjifikativ por në drejtim të kundërt të hipotezës tonë.

Kjo na bën të besojmë që hipoteza e Inglehartit në lidhje me diferencimin e vlerave tek grup-moshat më të reja nuk mund të gjejë konfirmim në Shqipëri. Kjo nuk e bën hipotezën e hedhur të mos ketë vlerë.

Shpjegimi për këtë moskonfirmim të hipotezës lidhet me këto konsiderata:

Inglehart e ngre hipotezën e ndryshimit të vlerave mes grupmoshave, dmth që më të rinjtë kanë vlera vetafirmimi më shumë sesa më të vjetrit, nisur mbi premisën e tij bazë që e mbrojtë edhe kundra çdo sulmi, që ky ndryshim vjen si rezultat i eksperiencës formuese të ndryshme që kanë përjetuar këta breza. Pritshmëria për më shumë vlera vetafirmimit nisët nëse i kthehemi skemës së paraqitur të ndryshimeve të vlerave, nga rritja ekonomike, ashtu siç ai i quan rritja e burimeve për veprim. Në këtë mënyrë ne prisnin që të lindur nga viti 1990, sot 24 vjeç, dhe deri në vitin 1999, sot 15 vjeç, të kenë eksperiencë formuese të ndryshme nga të lindurit minimalisht në vitin 1949, sot 65 vjeç dhe ndoshta deri në vitet 1930 sot rreth moshës 80 vjeçarë.

Të parët janë lindur në demokraci, janë rritur në një ekonomi kapitaliste, me një shtet të stabilizuar, me mundësi të barabarta për të pasur akses në burime, pa privime për shkak të tipareve të ndryshme që mund të kenë, me një akses të madh në informacion, me burime shumë të zhvilluara teknologjike, me një formim shkollor me kurikula perëndimore etj. Të dytët kanë përjetuar luftëra, kanë përjetuar mungesën e shtetit dhe shtetin diktatorial, një shtet shtypës, me mungesë të theksuar lirie dhe mundësisht, me një ekonomi të centralizuar, pa shumë akses në informacion që mund të donin port ë kontrolluar, me burime të pakta teknologjike dhe me pak formim shkollor, ose me formim shkollor me kurikula lindore. Këto na bënin të besohej që hipoteza e Inglehartit do mund të qëndronte edhe për këto dy breza ekstreme të shoqërisë shqiptare.

Për të kuptuar më shumë se përse të gjitha këto ndryshime nuk reflektojnë ndryshim vleror, u morrën në shqyrtim për aq vite sa kishim të dhëna dmth nga viti 1980 deri në 2013,

nivelin e GDP-së në Shqipëri, që lidhet drejtpërdrejtë me situatën ekonomike të qytetarëve.

Tabela e mëposhtme na e tregon gjendjen si më poshtë:

Burimi: IMF, *World Economic Outlook* (April 2014) (<http://knoema.com/tbocëag/gdp-by-country-1980-2013#Albania>)

	Albania		
	GDP, current prices, billion \$US	GDP, current PPP dollars, bln.	Real GDP Groëth, %
1980	1.8	5.0	2.7
1981	2.1	5.7	5.7
1982	2.2	6.3	2.9
1983	2.2	6.6	1.1
1984	2.2	7.0	2.0
1985	2.2	7.1	-1.5
1986	2.4	7.6	5.6
1987	2.4	7.8	-0.8
1988	2.4	7.9	-1.4
1989	2.6	9.0	9.8
1990	2.1	8.4	-10.0
1991	1.3	6.3	-28.0
1992	0.8	6.0	-7.2
1993	1.4	6.7	9.6
1994	2.2	7.5	9.4
1995	2.7	8.3	8.9
1996	3.0	9.2	9.1
1997	2.2	8.4	-10.2
1998	2.7	9.6	12.7
1999	3.4	10.7	10.1
2000	3.6	11.8	7.3
2001	4.1	13.0	7.9
2002	4.4	13.7	4.2
2003	5.7	14.8	5.8
2004	7.4	15.6	5.7
2005	8.2	16.9	5.8
2006	9.0	18.4	5.4
2007	10.7	20.0	5.9
2008	13.0	21.9	7.5
2009	12.1	22.8	3.3

	Albania		
	GDP, current prices, billion \$US	GDP, current PPP dollars, bln.	Real GDP Groëth, %
2010	11.8	23.9	3.8
2011	12.7	25.2	3.1
2012	12.3	25.9	1.3
2013	12.9	26.5	0.7
2014	13.9	27.5	2.1
2015	14.7	28.9	3.3
2016	15.9	30.7	4.2
2017	17.3	32.7	4.5
2018	18.8	34.8	4.5

Tabela 13: GDP e Shqipërisë sipas FMN, nga viti 1980-2013 dhe parashikimi deri ne 2018

Duke parë tabelën vihet re që Shqipëria ende nuk ka përjetuar ndonjë bum të madh ekonomik, ndonjë ndryshim rrënjësor në të gjitha klasat e saj përbërëse në lidhje me burimet ekonomike, fuqinë ekonomike, edhe atë siç e quan Inglehart sigurinë ekonomike. Pavarësisht ndryshimeve në sistemin politik nga komunizëm në demokraci, dhe gjithë ndryshimeve që i përmendëm më lart që ishin pikërisht si rrjedhojë e këtij ndryshimi, Prandaj nuk u morr konfirmim të kësaj hipoteze sepse aludimi është që pavarësisht që ka lindur në vitin 1940 apo 1990, asnjëri nga këta individ në eksperiencën e tij formuese nuk ka ndjerë siguri të plotë ekonomike që të mund më pas të mendoj dhe të formoj vlerat vetafirmuese. Me të vërtetë ato kanë nivele të ndryshme pasigurie ekonomike, sepse nuk mund të krahasohen me njëri tjetrin. Por gjithsesi gjykohet se vlerat nuk ndryshojnë në nivele të ndryshme të pasigurisë ekonomike. Nëse ajo është pasiguri ekstreme apo pasiguri minimale ngelet në perceptimin e eksperiencën formuese të njeriut një pasiguri ekonomike. Ndoshta do të gjehet kjo diferencë midis grupmoshave kur një grupmoshë që lind rreth vitit 2018 sipas parashikimeve të GDP-së së FMN-së dhe rritet në një zhvillim të plotë

ekonomik do të ketë ndryshim nga grupmoshat më të moshuara që përmendëm më lart, që nuk e kanë pasur këtë zhvillim.

KAPITULLI VII: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për vlerat dhe demokracinë dy terma dhe koncepte qendrorë të shkencave sociale, që janë edhe bazat e këtij punimi, ne kemi arritur të japin një përkufizim, me qëllim që t'i qartësojmë, por edhe jemi munduar që t'i bëjmë të matshme në kuadër të tezës kryesore të punimit doktorat.

Vlerat duke i kuptuar si kritere të rëndësishme gjykimi, mbi të cilat individi udhëhiqet në mënyrë të vetëdijshme ose jo, për të bërë zgjedhjet e tij në jetë dhe për të gjykuar të tjerët dhe shoqërinë. Të lidhura patjetër me aspekte kulturore të shoqërisë, në të cilën jeton individi, por edhe të lidhura me përvojat që ka gjithsecili. Karakteristikat bazë të vlerave që evidentuam, duke marrë parasysh përkufizimet dhe punimet e autorëve më të rëndësishëm në këtë fushë, rezultoi që vlerat mund t'i konsiderojmë si “projekte ideale”, të cilat i kanë njerëzit për një jetesë të denjë. Që të mund të flasim për vlera për aq kohë sa njerëzit kanë të drejtën e përzgjedhjes, me vullnetin e tyre të lirë, ndërkohë që nuk mund të flasim për vlera kur ato imponohen nga pushteti dhe mund të vijnë si rezultat i nënshtrimit dhe i frikës. Po ashtu vlerat mund të shihen si karakteristikë e veprimit njerëzor, që do të thotë se veprimet tona ne i kryejmë të nisura nga vlerat që mbartin, dhe çdo veprim reflekton vlerat tona, por edhe gjykimin tonë mbi veprimin e të tjerëve nëse është i drejtë ose jo dhe këtë e bëjmë duke u nisur nga vlerat tek të cilat ne besojmë. Kjo na ka legjitimuar edhe faktin që vlerat i matën me anë të një ankete ku njerëzit janë pyetur për sjellje të ndryshme dhe kanë dhënë mendime mbi situata reale apo hipotetike, sepse vlerat reflektohen dhe modelojnë

sjelljen e njeriut. Një arsye kjo që vë përsëri në dukje atë që kemi thënë në fillim lidhur me rëndësinë e studimit, sepse vlerat janë udhërrëfyeset e sjelljes, dhe sjellja është motori i funksionimit të një shoqërie.

Sa më sipër kjo lidhet edhe me një karakteristikë tjetër të vlerave, me atë që e kemi evidentuar; me faktin që ka një karakter të lidhur me përditshmërinë, se çdo ditë ne duhet të veprojmë në një shoqëri dhe kjo na çon në nevojën e gjykimeve vlerore për veten dhe për të tjerët. Vlerat formohen gjatë gjithë jetës dhe ndryshojnë, ato nuk janë statike të një njeri, sepse njeriu është qenie reflektuese, përpunuese e informacionit të ri. Kjo na bën të nevojshëm edhe matjen e tyre kohë pas kohë me qëllim që t'i kuptojmë më mirë. Duhet mbajtur parasysh që kur flasim për vlera, flasim për vlerat e një shoqërie të dhënë në një kohë të dhënë, pra kanë edhe një karakter sociokulturor. Edhe dy karakteristika të fundit janë karakteri dualistë i vlerave, që do të thotë për çdo vlerë ekziston një antivlerë, dhe vlerat kanë një hierarki mes njëra tjetrës dhe varet nga individi dhe situatë vendosja e tyre në një rend nga superiore në inferiore.

Modelin e klasifikimit të vlerave morëm atë të Ronald Inglehart dhe Vëzhgimit Botëror të Vlerave, që i ndan në tre boshte kryesore që për të tria ne e matëm shoqërinë shqiptare. 3 boshtet janë: vlerat materialiste përkundrejt vlerave postmaterialiste; vlerat tradicionale përkundrejt vlerave shekullare; vlerat e mbijetesës përkundrejt vlerave të vetafirmimit.

Demokracinë duke e kuptuar me konceptin dhe shqyrtimin që na vjen nga Welzel dhe Inglehart(2008) pra koncepti i demokracisë efektive. Koncepti kupton demokracinë në lidhje me sa ka vënë në qendër të vendimmarrjes dhe të proceseve në qeverisje, qytetarin,

duke e trajtuar atë si të barabartë dhe të rëndësishëm. Siç e përmendëm edhe në punim Welzel dhe Inglehart thonë që “zhvillimi i “demokracisë efektive” tregon përvetësimin nga ana e njerëzve të thjeshtë të burimeve dhe të vlerave që u lejojnë atyre tu bëjnë presion me efektshmëri elitave” (Welzel&Inglehart, 2008:138).

Për të shqyrtuar hipotezat e ngritura u përdorën metodat sasiore, që për matjen e profilit vleror u krye një anketim në qytetin e Tiranës, në dhjetor 2013, me 250 të anketuar. Ndërsa për matjen e nivelit të demokracisë efektive u përdorën të dhënat nga raportet e Bankës Botërore dhe nga raportet e Freedom House që duke i përpunuar sipas skemës së autorëve të mund të prodhonim të dhënat për vendin tonë.

Si përfundim në lidhje me hipotezat e ngritura në punim mund të themi që:

Së pari, hipoteza e parë hulumtuese në lidhje me profilin vleror që do të gjenin ishte “se prioritet vlerore të individit reflektojnë mjedisin socioekonomik, që do të thotë se vihet më shumë vlerë subjektive në ato gjëra që janë relativisht më të pakta”. Pra, tendenca e dinamikës së profilit vleror të shoqërisë shqiptare të jetë drejt përvijimit të të ashtuquajturit “sistem i vlerave të mbijetesës” sesa drejt “sistemit të vlerave të vetafirmimit”, më shumë drejt “sistemi të vlerave tradicionale” sesa drejt “sistemit të vlerave shekullare”. Po ashtu e një profili materialist sesa e një profili postmaterialist. Nga rezultatet e anketimit na dolën këto rezultate në lidhje me 3 boshtet vlerore të Inglehart-it:

1. Profili vleror i qytetarëve mbi 15 vjeç të qytetit të Tiranës, në vitin 2013, ka shumë gjasa t’i përkasë vlerave të mbijetesës përkundrejt vlerave të vetafirmimit.

2. Profili vleror i qytetarëve mbi 15 vjeç të qytetit të Tiranës, në vitin 2013, ka shumë gjasa t'i përkasë vlerave tradicionale përkundrejt vlerave shekullare.
3. Profili vleror i qytetarëve mbi 15 vjeç të qytetit të Tiranës, në vitin 2013, ka shumë gjasa t'i përkasë vlerave materialiste përkundrejt atyre postmaterialiste.

Së dyti, hipoteza qendrore e punimit, që është “Niveli i vlerave të vetafirmimit në Shqipëri shkon në proporcion të drejtë me nivelin e demokracisë efektive”. Për të shqyrtuar këtë hipotezë na duheshin të dhëna për profilin vleror ndër vite dhe jo vetëm matja jonë sepse gjykojmë për nivel që lidhet me postkomunizmin në Shqipëri. Për të kuptuar nivelin e vlerave të vetafirmimit morën për bazë studimet e studiuesit Aleksandër Kocani (2013) që ka bërë matje në vitet 1998, 2003, 2004, 2008, 2010, 2011. Për të njëjtën periudhë matën edhe nivelin e demokracisë efektive në vendin tonë nga viti 2002-2012 duke u nisur edhe nga raportet sistematike të Bankës Botërore dhe Freedom House.

Nga matjet na rezulton që të dyja janë në nivel të ulët, pra si vlerat e vetafirmimit, po ashtu edhe niveli i demokracisë efektive. Sepse besojmë se vlerat e mbijetesës kanë shkaktuar nivel të ulët të demokracisë efektive. Hipoteza e Inglehart-it merr një konfirmim të mëtejshëm empirik duke treguar lidhjen mes nivelit të vlerave të vetafirmimit dhe nivelit të demokracisë efektive.

Së treti, hipoteza që lidhet me një të ardhme shprese ose jo të demokracisë efektive në vendin tonë. Këtu morën për bazë një tjetër hipotezë të Inglehart-it që është “ Niveli i vlerave të vetafirmimit të një shoqërie korrelohet në mënyrë të zhdrejtë me moshën e

qytetarëve”. Pra thënë më thjesht, niveli i vlerave të vetafirmimit do të jetë më i lartë te brezat e rinj, që kanë moshë më të vogël, sesa tek ata të vjetër me moshë më të madhe”. Për këtë ne bëmë një analizë me anë të tabelave të kryqëzuara që ofron programi SPSS, duke marrë në shqyrtim pyetjet thelbësore, që lidhen me profilin vleror që lidhet vetëm me boshstin mbijetesë-vetafirmim, midis të rinjve të moshës 15-24 vjeç dhe atyre mbi 65 vjeç. U morën në shqyrtim 20 faktorë, që përcaktojnë vlerat e mbijetesës përkundrejt atyre të vetafirmimit, duke bërë në këtë mënyrë edhe 20 tabela të kryqëzuara. Nga rezultatet e nxjerra, na doli që nga të 20-të tabelat, vetëm në 2 u gjet shoqërim dhe ky ishte sinjifikativ dhe në drejtim të hipotezës, në 17 nuk gjetëm shoqërim mes dy variablave që nuk konfirmon hipotezën, dhe në 1 rast gjetëm shoqërim edhe sinjifikativ, por në drejtim të kundërt të hipotezës. Pra nuk gjetëm konfirmim të hipotezës që lidhej me shpresat e demokracisë në të ardhmen në vendin tonë. U tentua që t’i jepnim një shpjegim kësaj situate dhe e nisëm reflektimin me faktin që pritshmëria e hipotezës së Inglehart-it për më shumë vlera të vetafirmimit vjen nga rritja ekonomike, ashtu siç ai i quan rritja e burimeve për veprim që kanë pasur brezat e ndryshëm mes njëri -tjetrit në eksperiencat e tyre formative. Këtu pamë edhe çelësin e shpjegimit, që mendoj se na sqaron pse nuk u konfirmua kjo hipotezë e Inglehart-it në vendin tonë, pikërisht se rritja e vërtetë ekonomike nuk ka ndodhur ndonjëherë vërtet dhe në mënyrë substanciale. Morëm të dhënat e GDP-së nga periudha e fundit e komunizmit dhe deri sot, bashkë me një parashikim, dhe pamë se nuk kishte ndonjë ndryshim të madh cilësor, apo bum ekonomik që mund të ndikonte të rinjtë në vlerat e tyre.

Duhet të themi që ekonomia është faktor shumë i rëndësishëm, që na del që në profilin vleror që do të ketë një shoqëri ashtu edhe në nivelin e demokracisë që do ketë kjo shoqëri. Kjo edhe në logjikën e teorisë funksionaliste që përbënte për ne edhe teorinë e madhe shpjeguese për studimin tonë. Shoqëria funksionon si një organizëm i gjallë, në ekuilibër ku ndryshimi në secilën pjesë çon në ndryshimin e pjesës tjetër.

Në kuadër të gjetjeve dhe hulumtimit të kryer në këtë punim mund të rekomandojmë që:

Së pari, duhen vazhduar studime të tjera, të mëtijshme në drejtim të kuptimit të profilit vleror të vendit tonë. Kjo e domosdoshme për të kuptuar sesi po lëviz shoqëria, në ç'drejtim shkon vektori i vlerave, me çfarë shpejtësie ose ngadalësie janë duke ecur ndryshimet vlerore. Asnjë shoqëri nuk është pasive dhe immune ndaj ndryshimit të vlerave, pavarësisht se gjendja shoqërore mund të duket si e qëndrueshme dhe ndryshimet mund të mos jenë shumë të perceptueshme nga syri i njerëzve të thjeshtë. Studiuesit i takon të kapë edhe nuancat e ndryshme të këtij profili, në mënyrë që të mund të parashikojë sjellje të caktuara që mund të çojnë në dëme masive për shoqërinë.

Së dyti, duhen vazhduar studimet e tjera në lidhje me demokracinë, të cilat e shikojmë si të lidhur me vlerat si edhe në këtë punim. Por duhet hyrë edhe në analiza të tjera për të matur elemente të tjera ndërhyrëse në proces që mund të jenë shpjeguese dhe të rëndësishme. Sepse kuptimi, shpjegimi dhe promovimi i demokracisë është shumë më kompleks sesa thjesht një teori lineare edhe pse jo simplifikuese që tregon vetëm një varësi të saj me vlerat. Edhe pse për rrjedhojë vlerat janë nga elementet më thelbësore të sjelljes së njeriut dhe të demokracisë.

Së treti, duhet mbajtur parasysh se për vlerat dhe demokracinë, siç doli nga punimi, rëndësi dhe rol të madh ka dhe luan ekonomia. Një frymëmarrje më e madhe e ekonomisë, më shumë punë për të rritur shpirtin e sipërmarrjes, më lehtësira për të bërë një biznes, një ekonomi që fillon edhe profilizohet mund të jenë parakushte të domosdoshme për vlerat dhe demokracinë. Kuptohet që këshillat e duhura do të jepen nga ekonomistët dhe studiuesit e shkencave ekonomike, ashtu siç është janë të udhës edhe studime ndërdisiplinore. Pa mohuar këtu rolin e rëndësishëm të ligjeve, të shtetit, të sipërmarrjes etj.

Së katërti, duhet bërë një punë e madhe për sistemin e edukimit të vlerave. Nga punimi ynë doli se vlerat janë rezultat edhe i lidhjes së individit me agjentët e ndryshëm të socializmit, siç janë shkolla, familja, grupi shoqëror etj. Në këtë aspekt nëse duam të rrisin nivelin e vlerave të vetafirmimit, një nga mënyrat ku mund të ndërhyhet edhe më lehtë është edukimi vleror që mund të bëhet në shkollë me anë të teksteve mësimore, por edhe me anë të aktiviteteve ekstrakurikulare.

Së pesti, është e rëndësishme të vihet në dukje rëndësia e shoqërisë civile në të gjithë procesin vlera-demokraci. Shoqëria civile është një nga promotorët e demokracisë efektive, është një nga mënyrat ku qytetarët mund ta shohin veten si pjesëmarrës të rëndësishëm dhe të barabartë. Për këtë arsye organizatat, qendrat, lëvizjet e ndryshme sociale duhen promovuar dhe duhen parë si mundësi e mirë për angazhimin shoqëror. Pa dashur që këtu të merren në analizë gjithë problematikat, që mund të ketë shoqëria civile sot në Shqipëri,

gjithsesi vlen të konsiderohet si e rëndësishme. Vlen të bëhen projekte dhe studime për fuqizimin, rritjen dhe bërjen e saj sa më gjithëpërfshirëse për të gjithë qytetarët.

Së fundmi, në kuadër të rekomandimeve, nuk mund të lëmë pa përmendur një faktor shumë të rëndësishëm, që lidhet me mendësinë e shqiptarëve dhe me kulturën e tyre, të ndikuar shumë nga ato që mund t'i quajmë shenja otomane-komuniste, si dy periudhat më të rëndësishme në të cilat ka jetuar populli shqiptar. Kjo kulturë e lidhur sidomos me periudhën komuniste ka bërë që të mungojë ndërgjegjja sociale, ndërgjegjja për të reaguar për çështjet, që mund të prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose që mund të prekin komunitetin ku ti jeton. Koncepte të tilla si komunitet, vullnetarizëm, kolektivitet, aksion i përbashkët qytetar etj, fatkeqësisht duke qenë të keqpërdorura gjatë periudhës së komunizmit, shihen si të lidhura me atë sistem dhe është mbajtur një qëndrim tërësisht refuzues ndaj tyre duke i njehsuar me atë trashëgimi të keqe politike të vendit. Duhet bërë një punë e madhe për të sqaruar konceptet, të paktën për brezat e rinj, me qëllim që t'i shohin si koncepte të qytetarisë dhe të vullnetit të tyre të lirë për të qenë pjesëmarrës në vendimet dhe në punët e vendit ku jetojnë, qoftë kjo komunë apo bashki, por edhe në nivel qendror.

Vlerat dhe demokracia ndikojnë në jetën tonë; ato na e bëjnë jetën më të mirë ose më të keqe, më të bukur ose më të shëmtuar, por të dyja, ashtu si edhe çdo gjë tjetër, varen nga vullneti ynë. Të gjithë së bashku duhet të kemi vullnet që të bëjmë një ndryshim cilësor dhe një hap të madh drejt vlerave të vetafirmimit dhe drejt demokracisë efektive.

Shtojca 1 : Anketa « Profili vleror »

Nr _____

Kodi i anketuesit _____

ANKETIM PROFILI I VLERAVE

“Përshëndetje jemi nga Universiteti European i Tiranës. Në kuadrin e një punimi doktorature jemi duke bërë një studim mbi vlerat e rëndësishme në jetë të shqiptarëve. Do të dëshironim të kishim mendimin tuaj lidhur me këtë temë. Bashkëpunimi juaj do të japë një kontribut të rëndësishëm për studimin tim por edhe për konceptimin me të mirë të shoqërisë shqiptare. Ju faleminderit që pranoni të bashkëpunoni!

P.1	“Për secilën nga gjërat e mëposhtme, a mundeni të më thoni sa e rëndësishme është për ju nga 1 tek 5. Ku 1 është Aspak e rëndësishme dhe 5 është shumë e rëndësishme. KA A.R. P.R. D.R. E R SH.R N/D P/P P.1a Familja.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 P.1b Miqtë.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 P.1c Koha e lirë.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 P.1d Politika.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 P.1e Puna.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 P.1f Feja.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	1
P.2	“Duke marrë parasysh gjithçka, a do të thoni se jeni... 1. Aspak i lumtur..... 2. Jo shumë lumtur..... 3. Deri diku i lumtur..... 4. Mjaftueshem i lumtur..... 5. Shumë i lumtur..... 88. Nuk e di 99. Pa përgjigje	1 2 3 4 5 88 99
P.3	“Në tërësi, si do ta paraqitni gjendjen tuaj shëndetësore në këtë çast? A do të thonit se ajo është... [Për numrat çift të pyetësorit, të lexohet nga 1 te 5, për ato tek, të lexohet nga 5 te 1] 1. Shumë e keqe..... 2. E keqe..... 3. E pranueshme..... 4. E mire..... 5. Shumë e mire?”..... 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	1 2 3 4 5 88 99
P.4	“Me cilin nga këto dy opinione jeni më shumë dakord? [Vetëm një përgjigje]	

	1.Duhen dashur dhe respektuar gjithnjë prindërit tanë, pavarësisht nga cilësitë dhe të metat e tyre.....	1
	2.Nuk e kemi për detyrë të respektojmë dhe të duam prindërit tanë kur ata nuk e kanë merituar me sjelljen dhe qëndrimin e tyre.....	2
	88.Nuk e di	88
	99.Pa përgjigje	99
P.5	“Në përgjithësi, a do të thonit që mund t’i besohet shumicës së njerëzve apo që duhet të jesh i kujdesshëm kur ke të bësh me të tjerët? 1. Mund t’i besohet shumicës së njerëzve..... 2. Duhet të jesh i kujdesshëm.....	1 2
	88. Nuk e di	88
	99. Pa përgjigje	99
P.6	“Do ju them një listë me kategori të ndryshme njerëzish. A mund të na thoni se ndër to ka nga ata që nuk do të dëshironit t’i kishit si komshinj? Cilët?” [Shënoni një përgjigje për çdo rresht] Nuk i dua (1) I dua(2) Indiferent(88) Pa përgjigje(99)	
6a	Njerëz që kanë një detyrë gjyqësore.....1.....2.....88.....99	
6b	Njerëz të një race tjetër..... 1.....2.....88.....99	
6c	Ekstremistë politikë.....1.....2.....88.....99	
6d	Pijanecë.....1.....2.....88.....99	
6e	Njerëz jo të qëndrueshëm emocionalisht.....1.....2.....88.....99	
6f	Prostituta.....1.....2.....88.....99	
6g	Njerëz të sëmurë nga SIDA.....1.....2.....88.....99	
6h	Të droguar.....1.....2.....88.....99	
6i	Homoseksualët.....1.....2.....88.....99	
P.7	“A jeni dakord apo jo dakord me pohimet e mëposhtme?” dak. jo as njëra nuk pa dak. as tjetr e di përgj.	
7a	Kur vendet e punës janë të rralla, një burrë ka më shumë të drejtë për një punë se sa një grua.....1.....2.....3.....88.....99	
7b	Kur vendet e punës janë të rralla, duhen detyruar njerëzit e moshuar të dalin në pension më herët.....1.....2.....3.....88.....99	
7c	Kur vendet e punës janë të rralla, u duhet dhënë prioritet për vend pune shqiptarëve ndaj të huajve.....1.....2.....3.....88.....99	

P.13	“Në ç’masë mendoni se keni lirinë për të zgjedhur dhe kontrollin mbi jetën tuaj?” Aspak Shumë 01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	88 99
P.14	“Me cilin nga pohimet e mëposhtme jeni me shumë dakort?” 1.Është koha e lirë e kënaqësitë dhe jo puna që bën që t’ia vlejë të jetohet jeta 2. Është puna dhe jo koha e lirë e kënaqësitë që bëjnë që t’ia vlejë që të jetohet jeta 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	8 9
P.15a P.15b	“Kur jeni në kërkim të një pune cilat gjëra ju duken më të rëndësishme nga kriteret e mëposhtme. Cili, do të ishte sipas jush më i rëndësishmi?” “Dhe kush vjen pas tij?” i pari i dyti - një pagë e mirë për të mos patur halle për para.....1.....1 - një vend pune të garantuar pa rrezik mbylljeje apo humbjeje.....2.....2 - të punosh me njerëz që shkon mire.....3.....3 - të bësh një punë të rëndësishme që të japë ndjenjën se ke bërë diçka.....4.....4 -Nuk e di.....88.....88 -Pa përgjigje.....99.....99	
P.16	“Këtu kemi një listë me disa aspekte të një vendi pune apo një veprimtarie profesionale që konsiderohen ndonjëherë si të rëndësishme. Sipas jush sa të rëndësishme janë nga 1-5?” [shënoni të gjitha përgjigjet] 16a Një pagë e mirë.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 16b Jo shumë presion.1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 16c Një siguri e mirë e vendit të punës1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 16d Një punë që vlerësohet nga të Tjerët.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 16e Orare të mira.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 16f Mundësia për të provuar Iniciativën.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 16g Pushime shumë të mira..1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	

16h	Një punë ku mendoj se mund të bëj diçka.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
16i	Një punë me përgjegjësi..1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
16j	Një punë interesante.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
16k	Një punë që i korrespondon aftësive të mia.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
16l	Ndjenja se bëj punë të mirë.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
16m	Një mjedis i mirë pune1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
16n	Ndjenja e të qenit të dobishëm për shoqërinë e të tjerët1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
P17	“Me cilin nga të dy pohimet e mëposhte jeni më shumë dakort?” 1.Është puna baza e krijimit të të gjitha vlerave materiale e shpirtërore 2.Është puna baza e shfrytëzimit dhe e shtypjes kapitaliste 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	88 99
P.18	“A mund të thoni sa jeni dakort me secilën prej thënieve të mëposhtmen nga 1 deri në 5?” Ku 1 aspak dakort, 2 jo dakort, 3 deri diku dakort, 4. Dakort, 5. Shumë dakort. 18a “Unë synoj që të rris mirëqenien vetëm me punë të ndershme.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 18b “Për të rritur mirëqenien krahas punës së ndershme do të përdor edhe çdo mjet tjetër ligjor (% të huave, interesave bankare e aksione etj.).....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 18c “Për të rritur mirëqenien do të përdor çdo lloj pune apo aktiviteti qoftë e ndershme ose jo, ligjore ose jo.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
P.19	“Në qoftë se nuk kryeni një veprim kriminal (vrasje, grabitje, përdhunim etj.) këtë e lini pa bërë sepse : 1. Do të kapeni dhe do të ndëshkoheni ligjërisht..... 2. Do të hyni në konflikt me të afërmit e të dëmtuarit..... 3. E konsideroni moralisht të palejueshme”..... 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	1 2 3 88 99

P.20	“Në këtë çast ju jeni...” [Lexoni përgjigjet e mundshme. Kodoni vetëm një përgjigje] 1. i (e) martuar..... 1 2. bashkëjetoni (pa martesë)..... 2 3. i (e) divorcuar..... 3 4. i (e)ndarë..... 4 5. i (e) ve..... 5 6. beqar (e)..... 6 99. Pa përgjigje 99	
P.21	“Keni patur një apo dy fëmijë? Në se po sa?” [] [kodoni “0” nëse personi nuk ka patur fëmijë] pa përgjigje 99	
P.22	“Sipas jush, cili është numri ideal i fëmijëve në një familje?”.....[] 88.Nuk e di 88 99.Pa përgjigje 99	
P.23	“A jeni ju dakord me opinionin se “Martesa është një institucion i kapërcyer?” 1. Aspak dakort..... 1 2. Jo dakort..... 2 3. Deri diku dakort..... 3 4. Dakord..... 4 5. Shume dakort..... 5 88.Nuk e di 88 99.Pa përgjigje 99	
P.24	“Nëse ju do të duhet të kishit vetëm një fëmijë, do të preferonit një djalë apo një vajzë?” 1. Një djalë..... 1 2. Një vajzë..... 2 3. Njëlloj është [nëse përgjigjja jepet spontanisht]..... 3 Nuk e di 9 Pa përgjigje	
P.25a P.25b	“Këtu keni të renditura disa qëllime që Shqipëria duhet të përcaktojë për dhjetë vitet e ardhshme. Cili nga ato ju duket më i rëndësishmi?” [vetëm një përgjigje] [vetëm një përgjigje] Më i rënd. Pastaj - Një nivel të lartë të rritjes ekonomike.....1.....1 - Sigurimi në vend i një ushtrie të fortë për t’u mbrojtur.....2.....2 - Të bëhet që njerëzit të thonë fjalën e tyre në punë, në lagje, në komunë.....3.....3	

	- Përpjekja për t'i bërë qytetet e fshatrat tona më të bukura.....4.....4 Nuk e di.....8.....8 Pa përgjigje.....9.....9	
P.26a P.26b	“Midis qëllimeve të paraqitura më poshtë a mund të tregoni se cili ju duket më i rëndësishëm ?” [vetëm një përgjigje] “Dhe cili vjen më pas?” [vetëm një përgjigje] Më i rënd. Pastaj - Mbajtja e rendit në vend.....1.....1 - Përmirësimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimet e qeverisjes.....2.....2 - Lufta ndaj rritjes së çmimeve.....3.....3 -Garantimi i lirisë së shprehjes.....4.....4 Nuk e di.....8.....8 Pa përgjigje.....9.....9	
P.27a P.27b	“Këtu kemi një listë tjetër. Sipas jush cili është më i rëndësishëm?” [vetëm një përgjigje] “Dhe cili vjen më pas?” [vetëm një përgjigje] Më i rënd. Pastaj - Të paturit e një ekonomie të qëndrueshme.....1.....1 - Progresi drejt një shoqërie më pak jo personale dhe më humane.....2.....2 - Progresi drejt një shoqërie ku idetë vlerësohen më shumë se sa paratë.....3.....3 - Lufta kundër kriminalitetit.....4.....4 Nuk e di.....8.....8 Pa përgjigje.....9.....9	
P.28	“A mendoni se dallimet Veri/Jug (Gegëri/Toskëri) janë: 1. Shumë të mëdha..... 2. Të mëdha..... 3. Të vogla..... 4. S’ka fare..... 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	1 2 3 4 88 99
P.29	“Nese gjendemi në situatën e një lufte, a jeni gati të luftoni për vendin tuaj?” 1. Po..... 2. Jo..... 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	1 2 88 99

P.30	“Po ju përmendim disa ndryshime në mënyrën e të jetuarit që mund të ndodhin në të ardhmen. A mund të na thoni për secilën prej tyre nëse do të ishte një gjë e mirë, e keqe, apo për ju s’ka rëndësi?” gjë e gjë e nuk pa keqe indiferent mire e di përgj.	
30a	Do t’i vihet më pak rëndësi parave dhe të mirave materiale.....1.....2.....3.....88.....99	
30b	Puna do të zerë një vend më pak të madh në jetë.....1.....2.....3.....88.....99	
30c	Do të ketë angazhim më tepër për zhvillimin e teknologjive të reja.....1.....2.....3.....88.....99	
30d	Do të respektohet më tepër autoriteti.....1.....2.....3.....88.....99	
30e	Do t’i kushtohet më tepër rëndësi jetës familjare.....1.....2.....3.....88.....99	
P.31	KA “Në ç’masë jeni i interesuar për politikën?” 1. Aspak i interesuar..... 2. Jo i interesuar..... 3. Deri diku i interesuar..... 4. I interesuar..... 5.Shume i interesuar..... 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	2 1 2 3 4 5 88 99
P.32	“Sa besoni se me veprimtarinë tuaj mund ta ndryshoni politikën në Shqipëri: 1. Aspak..... 2. Pak..... 3. Deri diku..... 4. Shume 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	1 2 3 4 88 99
P.33	“Sa besoni se me veprimtarinë tuaj mund ta ndryshoni politikën në nivelin tuaj lokal: 1. Aspak..... 2. Pak..... 3. Deri diku..... 4. Shume..... 88.Nuk e di	1 2 3 4 88

	99.Pa përgjigje	99
P.34	“Këtu keni një listë me disa forma të veprimtarisë politike dhe për secilën do të na thoni nëse tashmë e keni bërë, nëse do të mund ta bënit, ose nëse nuk do ta bënit, cilatdoqofshin rrethanat?” [një përgjigje për çdo rresht] Tashmë do ta s’do ta Nuk Pa e bërë bëja bëja kurrë e di përgj.	
34a	Nënshkrimi një peticion.....1.....2.....3.....88.....99	
34b	Pjesëmarrje në një bojkot.....1.....2.....3.....88.....99	
34c	Pjesëmarrje në një manifestim të lejuar.....1.....2.....3.....88.....99	
34d	Pjesëmarrje në grevë spontane.....1.....2.....3.....88.....99	
34e	Rrëmbim armësh dhe rebelim ndaj shtetit.....1.....2.....3.....88.....99	
P.35	“Në lidhje me politikën, thuhet se ka të majtë dhe të djathtë. Ju ku e fusni veten në përgjithësi në këtë shkallë?” 01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 e Majtë e Djathtë 88. Nuk e di 99. Pa përgjigje	88 99
P.36	“Këtu keni një listë të partive kryesore që janë përfaqësuar edhe në Parlament. Cila prej tyre ju duket më bindëse nga pikëpamja e objektivave dhe veprimtarisë?” [Vetëm një përgjigje. Shëno numrin e partisë së zgjedhur ose emrin e saj nëse ajo është një “Tjetër”] 1. PS Partia Socialiste..... 01 2. PD Partia Demokratike..... 02 3. LSI Lidhja Socialiste për Integrim..... 03 4. PDIU Partia Drejtesi Integritet Unitet..... 04 5. AK Alenca Kuq e zi..... 05 6. PSD Partia Social-Demokrate..... 06 7. PR Partia Republikane..... 07 8. PBDNJ Partia e Mbrojtjes të Drejtave të Njeriut..... 08 9. LZHK Levizja për Zhvillim Kombëtar..... 09 10. Tjetër parti [Specifikoni]..... 10 11. Asnjë parti..... 11 88. Nuk e di 99. Pa përgjigje	01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 11 88 99
P.37	[Vetëm për ata që i janë përgjigjur pyetjes së mësipërme] “Me këtë parti ju ndjeheni i (e) lidhur fortë, mjaft apo pak?” 1. i (e) lidhur fort me këtë parti.....	1

	2. i (e) lidhur mjaft me këtë parti.....	2
	3. i (e) lidhur pak me këtë parti.....	3
	Nuk e di	8
	Pa përgjigje	9
P.38	“Shqipëria bën pjesë në vendet anëtarë të NATO-s. A ishit ju plotësisht apo më tepër dakord për të hyrë në NATO, ose plotësisht apo më tepër jo dakord për të?” 1. Plotësisht pro..... 2. Më tepër pro..... 3. Më tepër kundër..... 4. Plotësisht kundër..... Nuk e di Pa përgjigje	1 2 3 4 8 9
P.39	“Në qoftë se bashkimi kombëtar (Shqipëri, Kosovë, Çamëri) është i mundur ju personalisht jeni : 1. Krejtësisht pro..... 2. Pro..... 3. Kundër..... 4. Krejtësisht kundër..... Nuk e di Pa përgjigje	1 2 3 4 8 9
P.40	“A mendoni se bashkimi kombëtar do të ishte një ndryshim : 1. Shumë i dobishëm..... 2. Disi i dobishëm..... 3. Pak i dobishëm..... 4. Aspak i dobishëm..... 5. I dëmshëm..... Nuk e di Pa përgjigje	1 2 3 4 5 8 9
P.41	“Me cilin nga 3 pohimet e mëposhtme jeni dakort”: 1. Prodhimet e bëra në vendet e tjera mund të importohen e të shiten lirisht në Shqipëri..... 2. Shitja e prodhimeve të huaja në Shqipëri do të duhej të kufizohej ngushtësisht me qëllim që të mbrohen vendet e punës lokale..... 3. Apo duhen lënë prodhimet e jashtme që nuk prodhohen më në vend dhe të mbrohen prodhimet e vendit..... 88. Nuk e di 99. Pa përgjigje	1 2 3 88 99
P.42	“Për secilin institucion të mëposhtëm thoni sa besim keni nga 1-5 ku 1 është aspak besim dhe 5 shumë besim?” [Një përgjigje për çdo rresht]	

	Institucionet fetare.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
42a	Ushtria.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
42b	Ligjet.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
42c	Shtypi.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
42d	Televizioni.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
42e	Sindikatat.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
42f	Policia.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
42g	Qeveria.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
42h	Partitë	
42i	politike.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
42j	Parlamenti.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
42k	Administrata.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
42l	Ndërmarrjet e mëdha...1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
42m	Lëvizjet feministe.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
42n	NATO.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
42o	Bashkimi	
42p	Evropian.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
	Kombet e Bashkuara.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
P.43	“Ç’mendim keni për mënyrën se si po qeveriset Shqipëria. Në shkallën e mëposhtme 1 shënon shumë keq, kurse 10 shumë mirë”.	
P.43a	“Sipas mendimit tuaj cili ishte gjendja e sistemit politik 2-3 vite më parë?” Zgjidhni një numër në shkallën e mëposhtme shumë keq 01 02 03 04 5 06 07 08 09 10 shumë mirë Nuk e di 88 Pa përgjigje 99	
P.43b	“Sipas kësaj shkalle ku vendoset sistemi politik i sotëm?” shumë keq 01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 shumë mirë Nuk e di 88 Pa përgjigje 99	
P.43c	“Sipas jush cila do të jetë situata në 2-3 vitet e ardhshme?” shumë keq 01 02 03 04 06 07 08 09 10 shumë mirë 88.Nuk e di 88 99.Pa përgjigje 99	
P.44	“Këtu keni disa tipe të ndryshme të sistemeve politike. Për secilin prej tyre si e mendoni si menyre qeverisjeve nga 1 tek 5, ku 1 shume e keqe, dhe 5 shume e mire?	
P.44a	Të kesh një udhëheqës të fortë që nuk ka pse të shqetësohet për parlamentin dhe zgjedhjet.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 T’u lihet specialistëve	

P.44b	dhe jo qeverisë, për të vendosur për atë që është më e mira për vendin.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
P.44c	T'ia lemë ushtrisë që të marrë vendimet.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
P.44d	Të kesh një sistem politik demokratik.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
P.45	“Sa është e rëndësishme për ju në se udhëheqësit politik janë nga Veriu (Gegnia) apo nga Jugu (Toskëria): 1. Shumë..... 2. Disi..... 3. Pak..... 4. Aspak..... 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	1 2 3 4 88 99
P.46	“Cila pikëpamje politike që mbrojnë partitë, sipas jush është më e mira?” 1. Një drejtues partie duhet të mbrojë prerazi pikëpamjen e tij edhe nëse të tjerët s’janë dakord me të..... 2. Një drejtues partie duhet të jetë i gatshëm të bashkëpunojë me grupet e tjera edhe në se vihen në pikëpyetje vlera të rëndësishme..... 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	1 2 88 99
P.47	“Si e gjykoni politikën e vendeve të mëposhtëme ndaj Shqipërisë në pesë-gjashtë vitet e fundit: shumë miqësore, miqësore, korrekte, jomiqësore, armiqësore: AR. JM K M. SHM N/D P/P 1. Greqia.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 2. Maqedonia.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 3. Serbia.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 4. Mali i Zi.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 5. Italia.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 6. Turqia.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 7. Franca.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 8. Gjermania.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 9. SHBA.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 10. Rusia.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 11. Anglia.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
P.48	“Sipas jush cila është përgjegjësia më e rëndësishme e qeverisë?” 1. Të sigurojë rendin në shoqëri.....	1

	Apo: 2. Të respektojë lirinë individuale..... 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	2 88 99
P.49	“A jeni shumë i kënaqur, mjaft i kënaqur, mjaft i pakënaqur, shumë i pakënaqur me mënyrën se si qeveritarët e drejtojnë vendin?” 1. Shumë i pakënaqur..... 2. Mjaft i pakënaqur..... 3. I kënaqur 4. Mjaft i kënaqur..... 5. Shumë i kënaqur..... 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	1 2 3 4 5 88 99
P.50	“Për cilët nga popujt e mëposhtëm keni shumë simpati, simpati, pak simpati, aspak simpati, urrejtje: U. A.S. P.S. S. SH.S. N/D P/P 1. Grekët.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 2. Maqedonasit.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 3. Serbët.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 4. Malazezët.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 5. Italianët.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 6. Turqit.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 7. Francezët.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 8. Gjermanët.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 9. Amerikanët.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 10. Rusët.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99 11. Anglezët.....1.....2.....3.....4.....5.....88.....99	
P.51	“A i përkisni një feje?” Nëse nuk i përket asnjë feje() [kodoni 0] Nëse Po: cilës? 1. Myslimane..... 2. Ortodokse..... 3. Katolike..... 4. Bektashiane..... 5. Evangjeliste..... 6. Bahai..... 7. Tjetër.[Specifikoni]..... 88 Nuk e di 99.Pa përgjigje	1 2 3 4 5 6 7 88 99
P.52	“A jeni rritur në një atmosferë fetare në shtëpi?” 1. Po..... 2. Jo..... 88.Nuk e di	1 2 88

	99.Pa përgjigje	99
P.53	“Sa shpesh keni marrë pjesë në shërbimet fetare kohët e fundit?” 1. Më shumë se një herë në javë..... 1 2. Një herë në javë..... 2 3. Një herë në muaj..... 3 4. Vetëm gjatë festave fetare të veçanta..... 4 5. Një herë në vit..... 5 6. Më pak se një herë në vit..... 6 7. Kurrë, praktikisht kurrë..... 7 88.Nuk e di 88 99.Pa përgjigje 99	
P.54	“Pavarësisht nga fakti nëse ju shkoni në xhami apo kishë, a do të thoni se ju jeni” [Për numrat e pyetësorit ÇIFT, lexoni nga 1 tek 3, për ato TEK, lexoni nga 3 tek 1] 1. Një nga fetarët..... 1 2. Një nga jo fetarët..... 2 3. Një ateist i bindur..... 3 88.Nuk e di 88 99.Pa përgjigje 99	
P.55	“Deri në ç’masë Zoti është i rëndësishëm në jetën tuaj?” Aspak i rënd. Shumë i rënd. 01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 88.Nuk e di 88 99.Pa përgjigje 99	
P.56	“Për secilin nga pohimet e mëposhtme, a mund të na thoni se ai justifikohet gjithnjë diçka ndërmjet tyre sipas shkallës së mëposhtme?” [Lexoni listën, përmendni çdo frazë dhe shënoni nga 1 te 10] kurrë e justifikuar gjithnjë e justifikuar 01 02 03 04 05 06 07 08 09 10 Nuk e di = 88, Pa përgjigje = 99	
P.56a	Kërkimi më tepër se sa të takon i subvencioneve nga qeveria.....[]	
P.56b	Përpjekja për të mos paguar biletën në transportet publike.....[]	
P.56c	Të fshehtë të ardhurat për mos pagim taksash.....[]	
P.56d	Të blej diçka kur e di që është gjë e vjedhur.....[]	
P.56e	Pranimi i ryshfetit në ushtrimin e detyrës.....[]	
P.56f	Homoseksualiteti.....[]	
P.56g	Prostitucioni.....[]	
P.56h	Aborti.....[]	
P.56i	Divorci.....[]	

P.56j	Eutanazia (d.m.th. të ndihmsh që të vdesë dikë që është i pashërueshëm.....[]	
P.56k	Vetëvrasja.....[]	
P.57	“Midis njësive gjeografike të mëposhtme cilës ndjeni se i përkisni në radhë të parë?” [Vetëm një përgjigje] “Po pastaj?” [Vetëm një përgjigje] e parë e dytë - Lagjes tuaj.....1.....1 - Qytetit tuaj.....2.....2 - I gjithë vendit (Shqipëria).....3.....3 - Europa.....4.....4 - Bota.....5.....5 - Nuk e di.....8.....8 - Pa përgjigje.....9.....9	
P.58	“Deri në ç’masë jeni krenar që jeni shqiptar?” 1. Aspak krenar..... 2. Jo shume krenar..... 3.Krenar..... 4. Mjaft krenar..... 5. Shume krenar..... 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	1 2 3 4 5 88 99
P.59	“A keni lindur në Shqipëri?” 1. Po----- (kalo 61) Në cilin rreth? [Saktësoni]_____ 2. Jo----- Në cilin vend keni lindur? 1. Francë..... 2. Itali..... 3. Gjermani..... 4 Greqi..... 5. Kosove..... 6 Tjetër [Saktësoni].....	01 02 03 04 05 06
P.60	[Nëse i lindur jashtë shtetit] “Kur keni ardhur në Shqipëri?” 1. Gjatë dy viteve të fundit..... 2. Ka 3-5 vjet..... 3. Ka 6-10 vjet..... 4. Ka 11-15 vjet..... 5. Ka më shumë se 15 vjet..... 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	1 2 3 4 5 88 99
P.61	“A keni jetuar dhe punuar në ndonjë shtet të huaj. Në se po: 1. Në cilin shtet[] 2. Sa vite.....[] 99.Pa përgjigje	1 2 99

P.62	“Në se keni punuar ndonjëherë jashtë Shqipërisë, cili ka qenë lloji i punës që keni bërë: 1. Punë mendore..... 2. Punë fizike..... 99.Pa përgjigje	1 2 99
P.63	“Në ç’masë mendoni se janë përhapur në Shqipëri korrupsioni dhe ryshfeti?” 1. Pothuajse asnjë i zgjedhur politik nuk është ngatërruar në veprime të këtij tipi..... 2. Disa të zgjedhur politikë janë implikuar..... 3. Shumica e të zgjedhurve politikë janë të implikuar..... 4. Pothuajse të gjithë të zgjedhurit politikë janë të implikuar. 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	1 2 3 4 88 99
P.64	KA Gjinia e personit të pyetur: 1. Mashkull..... 2. Femër.....	3 1 2
P.65	“A mund të na thoni vitin e lindjes?” 19..... 99.Pa përgjigje	99
P.66	“Kjo do të thotë që ju jeni _____ vjeç” 99.Pa përgjigje	99
P.67	“Kush është shkolla e fundit që keni ndjekur?” [Vetëm një përgjigje] 1. Asnjë formim shkollor/profesional..... 2. Shkollë e detyruar (fillore, 8 ose 9 vjeçare)..... 3. Shkollë profesionale dyvjeçare..... 4. Shkollë e mesme e përgjithshme..... 5. Shkollë e mesme teknike..... 6. Universitet. Shkollë e lartë..... 7. Shkollë pasuniversitare/Gradë, Titull shkencor..... 99.Pa përgjigje	1 2 3 4 5 6 7. 99
P.68	[Në rast të përgjigjes së 1 ose 99 kalo në pyetjen 69] “A e keni ndjekur këtë shkollë/formim deri në fund dhe keni siguruar diplomën përfundimtare?” 1. Po, ndjekur deri në fund e siguruar diplomën..... 2. Jo..... 99.Pa përgjigje	1 2 99
P.69	“Në ç’moshë keni mbaruar studimet/formimin?” Mosha në vit []......	
P.70	“A jetoni me prindërit tuaj?” 1. Po.....	1

	2. Jo.....	2
	99. Pa përgjigje	99
P.71a	“A keni aktualisht një vend pune?”	
	1. Po.....[Kalo te 71b]	1
	2. Jo.....[Kalo te 71c]	2
	99.Pa përgjigje	99
P.71b	Nëse Po: “A keni ju:	
	1. Vend pune me kohë të plotë (≥30 orë në javë).....	1
	2. Vend pune me kohë të pjesshme (< 30 orë në javë).....	2
	3. I pavarur me kohë të plotë.....	3
	4. I pavarur me kohë të pjesshme.....	4
	99.Pa përgjigje	99
P.71c	Nëse Jo: “A jeni ju:	
	1. Në pension/e tërhequr nga puna.....	1
	2. Grua/burrë shtëpiak (e).....	2
	3. Student (e).....	3
	4. Pa vend pune.....	4
	5. Tjetër, specifikojeni.....	5
	99.Pa përgjigje	99
P.72	“Kush është (apo ishte) emërtimi i saktë i profesionit tuaj? Nëse keni/kishit më shumë se një profesion, i atij të vendit të punës kryesor” [Kërkoni emërtimin e saktë të profesionit. Për shembull nëse përgjigje është “mësues”, kërkoni lëndën që jep dhe tipin e shkollës. Apo, nëse përgjigjja është “nëpunës” kërkoni ç’lloj nëpunësi dhe në cilin institucion]	
P.73	“Në punën tuaj të tanishme (në punën e fundit) [për personat pa punë apo në pension], keni/kishit persona nën përgjegjësinë tuaj?”	
	1. Po.....	1
	2. Jo.....	2
	99.Pa përgjigje	99
	Nëse PO, sa?.....[]	
	99.Pa përgjigje	99
P.74	“A punoni (a keni punuar [për personat pa punë apo në pension])në sektorin privat, apo në sektorin publik?”	
	1. Sektori privat.....	1
	2. Sektori publik (qendror, në rreth, në komunë).....	2
	3. Tjetër.....	3
	99.Pa përgjigje	99
P.75	“Cili fiton më shumë në familjen tuaj?”	

	1. Vetë personi i intervistuar.....[kalo në P.80] 2. Burri/gruaja apo partneri.....[kalo në P.76] 3. Prinderit (njeri nga te dy).....[kalo në P.76] 4. Të dy fitojnë pak a shumë të njëjtën gjë.....[kalo në P.76] 5. Femijet (njeri).....[kalo në P.76] 99. Pa përgjigje	1 2 3 4 5 99
P.76	“A ka ky person sot një vend pune?” 1. Po..... 2. Jo..... 99. Pa përgjigje	1 2 99
P.77	“Cili është (apo ishte) emërtimi i saktë i profesionit të tij? Nëse ky person ka (kishte) më shumë se një profesion, atë të punës kryesore”. [Kërkoni emërtimin e saktë të profesionit. Shembull nëse përgjigja është “mësues”. Kërkoni lëndën që jep dhe tipin e shkollës. Apo, nëse përgjigja është “nëpunës”, kërkoni çfarë nëpunësi dhe në cilin institucion]	
P.78	“Në punën e tij ky person a ka (patur) persona nën vartësi? Sa?[.....] 99.Pa përgjigje	99
P.79	“A punon (ka punuar) në sektorin privat apo në sektorin publik?” 1. Sektorin privat..... 2. Sektorin publik (qendror, të rrethit, të komunës)..... 3. Tjetër..... 99.pa përgjigje	1 2 3 99
P.80	“Gjatë këtyre viteve, familja juaj a ka:” 1. Kursyer para..... 2. Në përgjithësi, vetëm ia ka dalë të jetojë..... 3. Nuk ka mundur fare të kursejë..... 4. Nuk ka mundur të kursejë dhe ka marrë borxh..... 99. Pa përgjigje	1 2 3 4 99
P.81	“Cilës klasë sociale i do ta percaktonit veten?” 1. Klasës së lartë..... 2. Klasës mesatare të lartë..... 3. Klasës mesatare të ulët..... 4. Klasës punëtore..... 5. Klasës së ulët..... 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	1 2 3 4 5 88 99
P.82	“Na duhet një e dhënë mbi të ardhurat tuaja (të çiftit) mujore. Të jeni i sigurt se ajo do të mbetet midis nesh (konfidenciale). Në listën e mëposhtme keni disa kategori pagash e të ardhurash të	

	shënuara me gërma. Zgjidhni njëren prej tyre. r = më pak se 10 000 lekë t = midis 10 001 dhe 20 000 lekë z = midis 20 001 dhe 30 000 lekë q = midis 30 001 dhe 50 000 lekë n = midis 50 001 dhe 60 000 lekë u = midis 60 001 dhe 70 000 lekë k = midis 70 001 dhe 90 000 lekë i = midis 90 001 dhe 100 000 lekë j = më shumë se 100 000 lekë 88.Nuk e di 99.Pa përgjigje	01 02 03 04 05 06 07 08 09 88 99
P.83	“A e shihni televizorin? Nëse PO: sa kohë mesatarisht kaloni para televizorit në një ditë normale të javës [Jo të shtunë e të dielë]? 1.Nuk shoh televizion..... 2.Më pak se një orë në ditë..... 3. 1-2 orë në ditë..... 4. 2-3 orë në ditë..... 5. më shumë se tre orë në ditë..... 99.pa përgjigje	1 2 3 4 5 99
	PYETJE PËR ANKETUESIN	
P.84	Ora dhe fundi i intervistës: [][].....	KA
P.85	Data: [][][].....	4
P.86	Gjatë intervistës personi ishte: 1. Shumë i interesuar..... 2. Mjaft i interesuar..... 3. Pak i interesuar.....	1 2 3
P.87	Klasa e nivelit të jetesës 1. Shumë mirë nga gjendja..... 2. E mesme e lartë..... 3. E mesme e ulët..... 4. Modeste.....	1 2 3 4

Bibliografia

Burime Parësore:

Abramson, P. R.& Inglehart, R. (1995) *Value Change in Global Perspective*. Ann Arbor: University of Michigan Press

Alfaro, J. (1988) *De la cuestión del hombre a la cuestión de Dios*. Salamanca: Signama.

Almond, G. A.&Verba, S. (1963) *The Civic Culture: Political Attitudes and Democracy in Five Nations*. Princeton, NJ: Princeton University Press

Angell, R. C. (1951) *The moral integration of american cities*. Chicago: University of Chicago Press

Anketa “Profili Vleror” e zhvilluar nw Tiranw, nw dhjetor 2013.

Ball, T. & Dagger, R. (2000) *Political Ideologies and the Democratic Ideal*. New York, etc.:Longman, 3rd edition

Barney, D.D (2005) *Communication Technology*. Vancouver: UBC Press

Biberaj, E. (2011) *Shqipëria në tranzicion, rruga e vështirë drejt demokracisë 1990-2010*. Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, AIIS

Boyer, J. P (1992) *The People’s Mandate: Referendums and more democratic*. Canada. Toronto:Dundurn Press

Bunes, M. & Elexpuru, I (1994) *Los valores de la comunidad educativa y el proyecto educativo de centro*. Aula de innovación educativa Nº 32

Camps, V.(1993) *El malestar de la vida publica*. Barcelona: Grijalbo

Carreras, Ll. Et al (1997) *Como educar en valores. Materiales, textos, recursos y tecnicas*. Madrid: Ediciones narcea S.A

Coyne, J. C. (1988) *Strategic therapy*. In J. Clarkin, G. Haas, & I. Glick (Eds.) New York: Guilford Press.

Dahl, R.A (1998) *On democracy*. New Haven:Yale University Press

del Re, E.C. (2000) Motivacionet sociale të krizës. tek Kosta Barjaba, Alberto Gasparini “*Rruga shqiptare e modernizimit. Ngjarje, klasa politike, njerëz dhe marrëdhënie ndërkombëtare*” Tiranë: Instituti i Sociologjisë Ndërkombëtare GORIZIA

DeRisi, J.W & Butz, G. (1975) *Writing behavioral contracts: a case simulation practice manual*. Research Press

Dhima, A. (2010) *Hyrje në Antropologji*. Tiranë: Ideart

Diamond, L. (1999) *Developing democracy toward consolidation*. London: The Johns Hopkins University Press

Elezi, I. (2006) *Kanuni i Labërisë*. Tiranë: Toena

Feather, N. (1990) Bridging the gap between values and actions: Recent applications of the expectancy-value model. In E. T. Higgins & R. M. Sorrentino (Eds.), *Handbook of motivation and cognition: Foundations of Social Behavior*, (pp. 151-192). New York: Guilford Press.

Feather, N. (Ed.). (1982) *Expectations and actions: Expectancy-value models in psychology*. Hillsdale, NJ: Earbaum.

Featherstone M (1991) *Consumer Culture and Postmodernism*. London: Sage.

Ferrater Mora, J. (1964) *Diccionario de Filozofia*. Tomo II L-Z. Quinta Edicion, Buenos Aires: Editorial Sud Americana

Fierro, M. & Carvajal, P. (2003) *Mirar la practica docente desde los valores*. Mexico, gedisa, S.A

Fronidizi, R. (1992) *Que son los valores? Introduccion a la axiologia*. Mexico: Fondo de Cultura Economica

Gjecovi, Sh.(2005) *Kanuni i Lek Dukagjinit*. Tiranë: Kuvendi

Gjuraj, E. (2013) *Kultura kombëtare në kulturën organizative*. Tiranë: UET Press

Gonzalez Lucini, F. (1990) *Educacion en valores y diseno curricular*. Madrid: Alhambra

Gould, C. (1996) Equality, Difference, Public Representation. Democracy and Difference: *Contesting the Boundaries of the Political* Edited by Seyla Benhabib, Princeton University Press

- Hall, B. P. (1995) *Values Shift: Understanding Personal and Organizational Transformation*. Twin Lights Publications, Rockport, M.A
- Hall, B. P. (1998) *Knowledge Management and the Values Factor*. Knowledge Management, London, UK
- Hall, B.P & Tonna, B. (2006) *Spiritual Connections: The Journey of Discipleship and Christian Values*. Wipf & Stock Publishers
- Hartmann, R. (1965) *The structure of value: foundations of scientific axiology*. Southern Illinois University Press
- Held, D. (1993) *Prospects for Democracy: North, South, East, West*. California:Stanford University Press
- Hernandez, F. (2009) *Aprender a Aprender*. Barcelona: Editorial Oceano
- Hertzler, J. O. (1946) *Social Institutions*. New York: McGraw-Hill Book Co
- Hofstede, G. (1984) *Culture's Consequences*. United States of America: Sage Publications
- Holden, B. (1974) *The nature of democracy*. London: Thomas Nelson & Sons
- Inglehart, R. & Norris, P. (2003) *Rising Tide: Gender Equality and Cultural Change around the World*. New York: Cambridge University Press
- Inglehart, R. & Welzel, Ch. (2005) *Modernization, cultural change, and democracy : the human development sequence*. New York : Cambridge University Press.
- Inglehart, R. (1977) *The Silent Revolution: Changing Values and Political Styles Among Western Publics*. Princeton, NJ: Princeton University Press.
- Inglehart, R. (1990) *Culture Shift in Advanced Industrial Society*. Princeton, NJ:Princeton University Press.
- Inglehart, R. (1997) *Modernization and Postmodernization: Cultural, Economic and Political Change in 43 Societies*. Princeton: Princeton University Press.
- Inkeles, A.& Smith, D.H (1974) *Becoming Modern: Individual Change in Six Developing Countries*.Cambridge. Mass: Harvard University Press
- Jackman, R. W. & Miller, A.R. (2004) *Before Norms: Institutions and Civic Culture*. Ann Arbor: University of Michigan Press.

Kaltsounis, Th. (2013) *Demokratizimi i Shqipërisë, demokracia nga brenda*. Tiranë: UET Press

Kluckhohn, C. (1951) Value and value-orientations in the theory of action. E botuar në *Toward a General Theory of Action*, ed. T.Parsons dhe E. Shils. Cambridge: Harvard University Press, 388-433

Kocani, A. (1999) *Konflikti në Shqipëri dhe "lufta e perëndive" në Shqipëria në tranzicion dhe vlerat*. Tiranë: Fondacioni Soros

Kocani, A. (2006) *Metodat e kërkimit sociologjik*. Tiranë: Universiteti UFO

Kocani, A. (2013) *Hulumtumi i sistemit të vlerave në republikën e Shqipërisë në periudhën postkomuniste*. Tiranë: Albanian University Press

Kohlberg, L.(1984) *Essays in moral development: The psychology of moral development*. Vol II. San Francisco: Harper Row.

Lametovic, V. (1999) Paqëndrueshmëria politike në Europën Lindore dhe Qëndrore. Në përmbledhjen e Verner Vajdenfeld: *Demokracia dhe ekonomia e tregut në Europën Lindore*, Tiranë: Shtëpia e Librit dhe Fondacioni SOROS

Lewis, H. (1998) *La cuestión de los valores humanos*. Barcelona: Gedisa

Ligji Nr.8417 *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë* datë 21.10.1998

Luyten, W. (1967) *Fenomenología existencial*. Mexico: Carlos Lohé

Marin, R. (1976) *Valores, objetivos y actitudes en educacion*. Valladolid: Minon

Maslow, A. (1954) *Motivation and personality*. New York: Harper & Row

Mayer, L. C. (2003) *Politikat krahësuese*. Tiranë: Botimet ORA dhe SOROS

Parsons, T. (1951) *The social system*. New York: Free Press

Poletti, R. (1983) “De la nécessité de reparler des valeurs professionnelles” pp.76-97. *Journées de Perfectionnement: Valeurs, identité et pratiques infirmières*. Paris: Centre Chrétien des professions de Santé.

Putnam, R. (1993) *Making Democracy work. Civic Tradition in modern Italy*. New York: Princeton University Press

- Ravlin, E. C & Meglino, B. M. (1987) Effects of Values on Perception and Decision Making: A Study of Alternative Work Values Measures. *Journal of Applied Psychology* 72: (666–673)
- Rocca, R. M. (2000) *Shqipëria, rrënjët e krizës*. Tiranë
- Rocher, G. (1973) *Introducción a la sociología genera*. Barcelona: Herder
- Rokeach, M. (1973) *The nature of human values*. New York, Free Press
- Rokeach, M. (1979) *Understanding human values*. New York, Free Press
- Savater, F.(1991) *El valor de educar*. Mexico:Ariel
- Scheler,M (1916, re 2000) *El formalismo en la etica y la etica material de los valores*. Madrid:Caparros
- Schwartz, S. H. (2006) Basic human values: Theory, measurement, and applications. *Revue française de sociologie*
- Schwartz, S. H.(1990) The universal content and structure of values. *Theoretical Advances and Empirical Test in 19 countries*. Jerusalem: The Hebrew University. Department of Psychology.
- Sills, D. (1977) *Enciclopedia Internacional de las ciencias sociales*. Madrid:Aguilar
- Sinani, Gj (1999) *Fenomeni fetar në Shqipëri. në Shqipëria në tranzicion dhe vlerat*. Tiranë: Fondacioni Soros
- Sorokin, P. (1947) *Society, Culture, and Personality*. New York: Harper & Row
- Spranger, E. (1928) *Types of men: the psychology and ethics of personality*. Halle: M. Niemeyer
- Super, D. E. (1990) *A life-span, life-space approach to career development*. D. Brown & L. Brooks (Eds.)San Francisco: Jossey-Bass
- Tafili, E. (2008) *Tranzicioni politik në Europën Qëndrore dhe Lindore*. Tiranë: SHBLU
- Tarifa, F.& Krisafi, K.& Tarifa, E. (2009) *Paradigma e tranzicionit demokratik*. Tiranë: OMBRA
- Tarde, G. (2010) *Social Laws: An Outline of Sociology*. Read Books

Taylor, C. R. (1989) *Fundamentals of Nursing. The art and science of Nursing care*. EEUU: Sipprucott.

Theodorson, A. G & Theodorson, G.A. (1970) *A Modern Dictionary of Sociology*. Methuen

Torralba, F.(2001) *Cent valors per viure*. Lleida: Pages Editors.

Triandis, H. C, Bontempo, R., Villareal, M. J., Asai, M., & Lucca, N. (1988). Individualism and collectivism: Cross-cultural perspectives on self-ingroup relationships. *Journal of Personality and Social Psychology*,54, 323-338

Vila-Abadal, J. (1998) *Valors vells,nous valors*. Barcelona: Proa

Villoro, L. (1997) *El poder y el valor. Fundamentos de una etica politica*. Mexico: El colegio Nacional/ FCE

Wallace, R. A & Wolf, A. (2006) *Contemporary Sociological Theory: Expanding classical tradition*. 6ed Upper Saddle River. New York: Prentice Hall

William, R. (1958) *Culture and Society*. New York: Doubleday & Company, Inc

William, R. (1974) *Television, technology and cultural form*. London: Fontana

Williams, R. (1968) The concept of values. *International Encyclopedia of the Social Sciences*, vol 16. New York: Macmillan and Free Pree

Burime Dytësore

Abramson, P. R. (1997) Probing Well Beyond the Bounds of Conventional Wisdom. *American Journal of Political Science* 41 (April): 675-82

Abramson, P. R. & Ellis, S. & Inglehart, R. (1997) Research in Context:Measuring Value Change. *Political Behavior* 19 (March): 41-59.

Adler, F. (1956) The value concept in Sociology. *American Journal of Sociology*, Vol 62. No.3 :272-279

Alexander, A. & Welzel, Ch. (2008) Measuring Effective Democracy: The Human Empowerment Approach. *World Values Research* 1(1): 1-34.

Alexander, A. & Welzel, Ch. (2011) Measuring Effective Democracy: The Human Empowerment Approach. *Comparative Politics* 43(3): 271-289

Alexander, A.& Inglehart, R & Welzel, Ch. (2012) Measuring Effective Democracy: A Defense. *International Political Science Review* 33(1): 41-62

Artikull i publikuar në World Values Survey, autorët nga WVS, marrë nga http://www.worldvaluessurvey.org/ëvs/articles/folder_published/article_base_54, kontrolluar më 17 qershor 2013

Artikull i publikuar në World Values Survey, autorët nga WVS, marrë nga http://www.worldvaluessurvey.org/index_surveys kontrolluar më 17 qershor 2013

Artikull mbi R.K. Merton marrë nga <http://www.sociologyguide.com/thinkers/RK-Merton.php> kontrolluar në 24 janar 2014

Bachika, R. & Schulz, S.M. (2011) Values and culture in the social shaping of the future. *Current Sociology* 59(2) 107–118

Bollen, K. & Paxton, P. (2000) Subjective Measures of Liberal Democracy. *Comparative Political Studies* 33: 58-86.

Casper, G. & Tufis, C. (2002) Correlation versus Interchangeability. *Political Analysis* 11 (2): 1-11.

Censusi i popullsisë dhe i banesave (2012) Tiranë:Instat

Clarke, H. D.& Dutt, N. (1991) *Measuring value change in western industrialized societies: the impact of unemployment*. *American Political Science Review* Vol.85: 905-920

Conover, P. J & Feldman, S. (1984) Group identification, values and the nature of political belief. *American Politics Quarterly*, Vol 12. No 2: 151-175

Dervishi, Z. (2005) Vullnetarizmi - ind i domosdoshëm për funksionimin e humanizimit e shoqërisë, *Politika dhe Shoqëria*, Revistë Shkencore e Institutit të Studimeve Politike dhe Sociale, Vëll.8 Nr.1 (15)

Dutch, R. M. & Taylor, M.A. (1993) Postmaterialism and economic condition. *American Journal of Political Science*, Vol 37, August: 747-779

Feather, N. (1992) Values, valences, expectations, and actions. *Journal of Social Issues*, 48(2) :109-124.

Feather, N. (1995) Values, valences, and choice: The influence of values on the perceived attractiveness and choice of alternatives. *Journal of Personality and Social Psychology*, 68(6), 1135-1151.

- Flanagan, S. C. (1979) Value Change and Partisan Change in Japan: The Silent Revolution Revisited. *Comparative Politics* 11 (April): 253-78.
- Inglehart, R. & Abramson, P.R. (1994) Economic Security and Value Change. *American Political Science Review* 88 (June): 336-354
- Inglehart, R. & Abramson, P.R. (1999) Measuring Postmaterialism. *American Political Science Review* 93 (September): 665-677
- Inglehart, R. & Baker, W. (2000) Modernization, cultural change and persistence of traditional values. *American Sociological Review*, Vol 65, No.1 :(19-51)
- Inglehart, R. & Flanagan, S.C. (1987) Value Change in Industrial Societies. *American Political Science Review* 81 (December): 1289-1319
- Inglehart, R. & René Rabier, J. (1986) Political Realignment in Advanced Industrial Society: From Class-Based Politics to Quality-of-Life Politics. *Government and Opposition* 21 (October): 456-479
- Inglehart, R. (2000) Globalization and Postmodern Values. *The Washington Quarterly*, Vol 23, No.1 (215-228)
- Inglehart, R. (2008) Changing Values among Western Publics from 1970 to 2006. *West European Politics* 31 (January-March): 130-46.
- Inglehart, R.& Klingemann, H.D. (1976) "Party identification, ideological preference and the left-right dimension among western mass publics." *In Party identification and beyond: representations of voting and party competition*, ed. Ian Budge, Ivor Crewe, and Dennis J. Farlie. New York: Wiley, 243-273
- Inglehart, R.& Welzel, Ch. (2013) Political Culture and Democracy: Analyzing Cross-Level Linkages. *Comparative Politics* Vol. 36, No. 1 (Oct., 2003), 61-79
- Kapstein, B.E. & Converse, N. (2008) Poverty, Inequality and Democracy: Why democracies fail. *Journal of Democracy*, Vol 19, No.4: 57-68
- Kaufmann, D.& Kraay, A. & Mastruzzi, M. (2007) *Governance Matters V*. World Bank Policy Research Department Working Paper 3630, Washington, D.C.: World Bank.
- Kekezi, H. (2008) Pluralizmi politik- Europa lindora dhe përvoja e shqipërisë. *Studime Sociale*, Vëll. 2 Nr.1
- Knutsen, CH. (2010) Measuring effective democracy. *International Political Science Review* 31(2): 109–28.

Krasniqi, A. (2012) *Europa Juglindore në periudhën postkomuniste, analizë e sistemeve partiake dhe qeverisëse*. Tiranë: teza doktrale, e aksesueshme ne [https://www.google.al/search?q=Afrim+Krasniqi+\(+2012\)+Europa+Juglindore+ne+periudhen+paskomuniste%2C&oq=Afrim+Krasniqi+\(+2012\)+Europ+parë+për+herë+të+fundit+në+20+mars+2013](https://www.google.al/search?q=Afrim+Krasniqi+(+2012)+Europa+Juglindore+ne+periudhen+paskomuniste%2C&oq=Afrim+Krasniqi+(+2012)+Europ+parë+për+herë+të+fundit+në+20+mars+2013)

Maslow, A. (1985) A theory of human motivation. *Psychological Review*, 50, 370-296

Meglino, B. M. & Ravlin, E. C. & Adkins, C. L. (1991) A work values approach to corporate culture: A field test of the value congruence process and its relationship to individual outcomes. *Journal of Applied Psychology*, 74, 424–432.

Munck, G.L. & Verkuilen, J. (2002) Conceptualizing and Measuring Democracy. *Comparative Political Studies* 35 (1): 5-34.

Passet, R. (1983) “Valeurs, et identité dans une société donnée” pp.9-23. *Journées de Perfectionnement: Valeurs, identité et pratiques infirmières*. Paris: Centre Chrétien des professions de Santé.

Raporti i Freedom House mbi liritë civile dhe politike në Shqipëri 2002, marrë nga http://www.freedomhouse.org/report/freedom-World/2012/albania#.Ut2LXvso_cs parë për herë të fundit më 22 prill 2014.

Raporti i Freedom House mbi liritë civile dhe politike në Shqipëri 2003, marrë nga http://www.freedomhouse.org/report/freedom-World/2003/albania#.Ut5ëB_so_cs parë për herë të fundit më 22 prill 2014.

Raporti i Freedom House mbi liritë civile dhe politike në Shqipëri 2004, marrë nga http://www.freedomhouse.org/report/freedom-World/2004/albania#.Ut5vufso_cs parë për herë të fundit më 22 prill 2014.

Raporti i Freedom House mbi liritë civile dhe politike në Shqipëri 2005, marrë nga http://www.freedomhouse.org/report/freedom-World/2005/albania#.Ut5vV_so_cs parë për herë të fundit më 22 prill 2014.

Raporti i Freedom House mbi liritë civile dhe politike në Shqipëri 2006, marrë nga http://www.freedomhouse.org/report/freedom-World/2006/albania#.Ut5vE_so_cs parë për herë të fundit më 22 prill 2014.

Raporti i Freedom House mbi liritë civile dhe politike në Shqipëri 2007, marrë nga http://www.freedomhouse.org/report/freedom-World/2007/albania#.Ut5uyfso_cs parë për herë të fundit më 22 prill 2014.

Raporti i Freedom House mbi liritë civile dhe politike në Shqipëri 2008, marrë nga http://www.freedomhouse.org/report/freedom-World/2008/albania#.Ut5ulfso_cs parë për herë të fundit më 22 prill 2014.

Raporti i Freedom House mbi liritë civile dhe politike në Shqipëri 2009, marrë nga http://www.freedomhouse.org/report/freedom-World/2009/albania#.Ut5uMPso_cs parë për herë të fundit më 22 prill 2014.

Raporti i Freedom House mbi liritë civile dhe politike në Shqipëri 2010, marrë nga http://www.freedomhouse.org/report/freedom-World/2010/albania#.Ut5t2Pso_cs parë për herë të fundit më 22 prill 2014.

Raporti i Freedom House mbi liritë civile dhe politike në Shqipëri 2011, marrë nga http://www.freedomhouse.org/report/freedom-World/2011/albania#.Ut5tffso_cs parë për herë të fundit më 22 prill 2014.

Raporti i Freedom House mbi liritë civile dhe politike në Shqipëri 2012, marrë nga http://www.freedomhouse.org/report/freedom-World/2012/albania#.Ut2LXvso_cs parë për herë të fundit më 22 prill 2014.

Raporti i Përmbledhur i Bankës Botërore (2013) The World Wide Governance Indicators, 2013 Update, Aggregate Indicators of Governance 1996-2012, www.govindicators.org

Rokeach, M. (1985) Inducing change and stability in belief systems and personality structures. *The Journal of Social Issues*, 41, 153-171.

Schwartz, S. H. & Bilsky, W. (1990) Toward a theory of the universal content and structure of values: extensions and cross-cultural replications. *The Journal of Personality and Social Psychology*, Vol.58: 878-891

Schwartz, S. H (1992) Universals in the content and Structure of Values. *Theoretical Advances and Empirical Test in 20 countries*. M. Zanna (eds) Advances in experimental social psychology (99. 1-65) NY:Academic Press

Schwartz, S.H. (1994) Are there universal aspects in the structure and content of human values? *Journal of Social Issues* Vol. 50: 19-45

Schwartz, S. H. & Bardi, A. (2001) Value hierarchies across cultures: taking a similarities perspective. *Journal of Personality and Social Psychology*. Vol 32: 268-290

Sciarini, P.&Fingers, M. (1991) Les dimensions de l'espace politique suisse et l'integration de la "nouvelle politique ecologique". *Revue francaise de science politique* Vol 41, No.4: 537-559

Shively, W. P.(1991) Feature Review of Culture Shift in Advanced Industrial Society. *Journal of Politics* Vol. 53, February: 235-238

Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, marrë me email pas një kërkesë me shkrim nga punonjësja Manjola Skana, 12 qershor 2013.

Të dhëna të marra në lidhje me pagesën mesatare të popullsisë shqiptare marrë nga INSTAT nga <http://www.instat.gov.al/al/themes/pagat-dhe-kosto-e-pun%C3%ABs.aspx> parë për herë të fundit më 30 Prill 2014

Vështrim mbi GDP-në e Shqipërisë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Burimi: IMF, World Economic Outlook (April 2014) (<http://knoema.com/tbocwag/gdp-by-country-1980-2013#Albania>) parë për herë të fundit më 10 Maj 2014

Warren, M.E. (2006) Political Corruption as Duplicitous Exclusion. *Political Science and Politics* 39:803-7.

Welzel, Ch & Inglehart, R. (2008a) The role of ordinary people in democratization. *Journal of Democracy*, Vol 19,.No. 1: (126-140), lexuar në *Journal of Democracy en Espanol* (174-190)

Welzel, Ch. & Inglehart, R. (2008b) Democratization as Human Empowerment. *Journal of Democracy* 19(1): 126-4.